


PESHKATARËT E SHPIRTRAVE NJERËZORË  
Ideja e manipulimit dhe manipulimi i ideve

Gjuro Shushnjq



© LOGOS·A  
S H K U P  
P R I S H T I N Ë  
T I R A N Ë  
2 0 1 7

**Gjuro Shushnjiq**  
**PESHKATARËT E SHPIRTRAVE NJERËZORË**  
**Ideja e manipulimit dhe manipulimi i ideve**

**Boton: LOGOS-A**

**Biblioteka: LEXO**

**Për botuesin: Adnan Ismaili**  
**Kryeredaktor: Husamedin Abazi**  
**Redaktor biblioteke: Ali Pajaziti**  
**Redaktor gjuhësor: Edison Çeraj**

**Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi**  
**Redaktor teknik: Naser Fera**  
**Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili**  
**Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup**  
**Shtypi: Focus Print**  
**Rr. Pellagonia 3 - Shkup**

**ISBN 978-9989-58-670-5**

**[www.logos](http://www.logos)**

**Copyright©Logos-A, 2017**

**Tirazhi: 500**

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.**

**Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.**

**Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.**



**PESHKATARËT**  
**E SHPIRTRAVE NJERËZORË**  
**Ideja e manipulimit dhe manipulimi i ideve**

**Gjuro Shushnjiq**

**E PËRKTHEU NGA SERBISHTJA:**


**Skënder Latifi**

**TITULLI I ORIGINALIT:**

**Đuro Šušnjić,**

**RIBARI LJUDSKIH DUŠA:**

**Ideja manipulacije i manipulacija idejama,**  
**"Čigoja Štampa", botimi i 7-të, Beograd, 2008.**





## PËRMBAJTJA:

|  |    |
|--|----|
| “PESHKATARËT” VAZHDOJNË TË GJUAJNË .....                         | 9  |
| PARATHËNIE PËR BOTIMIN E KATËRT .....                            | 17 |
| Historia si thashethem .....                                     | 21 |
| Gjuha e armatosur .....  | 26 |
| Rezistencat .....  | 33 |
| PARATHËNIE .....   | 35 |
| HYRJE .....  | 43 |
| Format e kontrollit mbi sjelljet ose pse manipulimi? .....       | 47 |
| Simbolet (idetë) janë armë .....                                 | 50 |
| Njohuritë shkencore dhe manipulimi.....                          | 53 |
| <br>   |    |
| <b>PJESA E PARË</b>  |    |
| Shprehjet, supozimet, njohuritë .....                            | 57 |
| <br>   |    |
| <b>VËREJTJET METODOLOGJIKE.....</b>                              | 59 |
| Origjina e fjalës .....  | 59 |
| Shprehjet e ngjashme .....                                       | 60 |
| Socializimi dhe manipulimi .....                                 | 61 |
| Ideologjia dhe manipulimi .....                                  | 64 |
| Përkufizimi i manipulimit.....                                   | 69 |
| Manipulimi si formë tjetërsimi .....                             | 72 |
| <b>TEZAT (TEORIKE) BAZË DHE NJOHURITË (SHKENCORE)</b>            |    |
| <b>MBI TË CILAT MBËSHTETET MANIPULIMI.....</b>                   | 74 |
| Të kuptuarit e njeriut .....                                     | 74 |
| Të menduarit dhe sjellja për të mësuar.....                      | 77 |
| Dy kriteret për vlerësimin e ideve: çfarë është e vërtetë? ..... | 79 |
| Idetë kanë funksion integrues/çintegrues .....                   | 82 |

|  |    |
|--|----|
| Audienca shndërrohet në turmë.....                           | 84 |
| Manipulimi dhe struktura e opinioneve në shoqëri/grupe ..... | 86 |
| Funksioni manipulues i gjuhës .....                          | 87 |

## PJESA E DYTË

|  |            |
|--|------------|
| Struktura e konceptit.....                               | 91         |
| <b>MANIPULUESI.....</b>                                  | <b>93</b>  |
| Dy tipa autoriteti (udhëheqjeje) .....                   | 94         |
| Autoriteti dhe e vërteta .....                           | 96         |
| Shtirirja e pushtetit të udhëheqësit (autoritetit) ..... | 98         |
| Udhëheqësi dhe situata.....                              | 100        |
| Vetitë vetjake të udhëheqësit.....                       | 101        |
| <b>MESAZHI .....</b>                                     | <b>108</b> |
| Roli i fjalëve.....                                      | 108        |
| Njeriu vdes, fjala jeton.....                            | 114        |
| Karakteristikat e mesazhit.....                          | 117        |
| <b>TURMA .....</b>                                       | <b>132</b> |
| Turmat apo klasat? .....                                 | 133        |
| Personaliteti autoritar.....                             | 138        |
| <b>KUSHTET .....</b>                                     | <b>148</b> |
| Vetëharresa në veprim .....                              | 148        |
| Ndarja e punës si burim varësie.....                     | 151        |
| Midis dy gurëve të mullirit .....                        | 153        |
| Frika si mjet sundimi.....                               | 156        |
| Gjuetia bëhet në ujë të turbullt .....                   | 160        |
| Vdekja e idealit.....                                    | 162        |
| Monopoli mbi përkufizimin e realitetit.....              | 164        |
| <b>BARTËSIT E MESAZHIT .....</b>                         | <b>165</b> |
| Zgjatimi është mesazhi .....                             | 173        |
| <b>PROBLEMI .....</b>                                    | <b>178</b> |

|  |            |
|--|------------|
| <b>NUK KA PAJTIM TË PËRGJITHSHËM PËR PROBLEMIN .....</b>                         | <b>191</b> |
| <b>MOTIVIMI .....</b>  | <b>202</b> |
| <b>Llojet e motiveve .....</b>   | <b>208</b> |
| <b>PASOJAT .....</b>   | <b>219</b> |
| <br>   |            |
| <b>PJESA E TRETË</b>   |            |
| <b>Fushat dhe zbatimi .....</b>  | <b>237</b> |
| <br>   |            |
| <b>VEITË E SHOQËRISË CIVILE .....</b>  | <b>239</b> |
| <b>REKLAMA .....</b>   | <b>247</b> |
| <b>Kontrolli i tregut nëpërmjet kontrollit të nevojave të konsumatorit .....</b> | <b>247</b> |
| <b>Nga plotësimi i nevojave drejt krijimit dhe shfrytëzimit të tyre .....</b>    | <b>249</b> |
| <b>Drejt konsumit iracional .....</b>  | <b>260</b> |
| <b>PROPAGANDA .....</b>  | <b>265</b> |
| <b>Nga akti deri te mendimi për aktin.....</b>                                   | <b>265</b> |
| <b>Idetë dhe qëndrimet politike si mallra .....</b>                              | <b>267</b> |
| <b>Mendimi zyrtar dhe opinioni publik .....</b>                                  | <b>270</b> |
| <b>Nga vetëdija drejt nënvetëdijes.....</b>                                      | <b>273</b> |
| <b>INDOKTRINIMI.....</b>   | <b>278</b> |
| <b>Mbështetja te besimi.....</b>   | <b>278</b> |
| <b>Breza të formuar sipas porosisë.....</b>                                      | <b>280</b> |
| <b>Djerrina mendore.....</b>   | <b>286</b> |
| <b>INDUSTRIA E ARGËTIMIT .....</b>   | <b>289</b> |
| <b>Shfrytëzimi i instinkteve, nevojave.....</b>                                  | <b>289</b> |
| <b>Argëtimi dhe hallet.....</b>  | <b>292</b> |
| <b>“Mendja lavire” .....</b>   | <b>296</b> |
| <b>PREDIKIMET FETARE .....</b>   | <b>298</b> |
| <b>Funksioni i simboleve religjioze.....</b>                                     | <b>303</b> |

**PJESA E KATËRT**

|   |            |
|---|------------|
| <b>Kufijtë dhe kritika .....</b>                                  | <b>311</b> |
| <b>KUFIJTË E MANIPULIMIT .....</b>                                | <b>313</b> |
| <b>KRITIKA E MANIPULIMIT NGA PIKËPAMJA<br/>E HUMANIZMIT .....</b> | <b>328</b> |
| <b>Njeriu .....</b>   | <b>331</b> |
| <b>Liria .....</b>  | <b>338</b> |
| <b>Morali.....</b>  | <b>340</b> |
| <b>E vërteta .....</b>  | <b>344</b> |
| <b>Politika .....</b>   | <b>346</b> |
| <b>Revolucioni .....</b>  | <b>349</b> |
| <b>SHËNIM PËR AUTORIN .....</b>                                   | <b>355</b> |
| <b>LITERATURA.....</b>  | <b>357</b> |
| <b>INDEKSI.....</b>   | <b>369</b> |

## “PESHKATARËT” VAZHDOJNË TË GJUAJNË

*Ashtu si çdo situatë jetësore që përbën një sfidë drejtuar njeriut, dhe vendos përpara tij një problem që ai duhet ta zgjidhë, çështja e kuptimit të jetës mund të parashtrohet anasjelltas: njeriu nuk pyet për kuptimin e jetës, por është jeta ajo që i shtron atij pyetje, të cilave duhet t'u japë përgjigje. Ama jetës mund t'i përgjigjesh vetëm duke i dhënë përgjigje jetës tënde. Jetës mund t'i përgjigjesh vetëm nëse je i përgjegjshëm.*

V. E. Frankl

Sinqerisht u gëzova kur mora vesh se libri *Peshkatarët e shpirtrave njerëzorë*, i Gjuro Shushnjiqit, ishte përkthyer në shqip dhe po përgatitej për botim. Gjëja e parë që më erdhi në mendje ishte se mos ndoshta po vjen me vonë, duke qenë se libri është botuar disa dekada më parë. Por, përgjigjja ishte e qartë: aspak, sepse gjithçka në këtë libër është aktuale edhe sot. Koha që jetojmë, sipas shumicës së mendimtarëve të urtë, është tepër e vështirë, ndaj dhe nuk mund të flasim për “kontrollin”, sekretin, manipulimin, ngaqë këto janë bërë pjesë e sistemeve që ne votojmë dhe përkrahim.

Megjithatë, përpara se të flas për vetë librin, dua të rrëfej diçka lidhur me të, që më ka ndodhur teksa isha student në Sarajevë. Sëpari, ky libër nuk qe i mirëpritur nga sistemi në ish-Jugosllavi, dhe në Bosnjën e “Muslimanëve” (me “M” të madhe) ishte edhe më i papëlqyer (kurse në Kosovë dhe Maqedoni as që ishte botuar). Për arsye të peshës dhe rëndësisë që kishte, libri shitej shumë shpejt. Unë arrita të

gjej një kopje të tij në një librari në Mostar. Në kthim e sipër për në Shkup bashkë me disa shokë, në aeroportin e Sarajevës, librin në fjalë e mbante në dorë një nga shokët, dhe me ta pikasur polici, e pyeti se ç'libër ishte. Doli se polici ishte një nga të "mençurit" që e dinte rrezikun e librit, ngaqë titulli i tij kish qenë në listën e zezë. Shoku u shqetësua pak. Unë isha pas tij dhe, me një zë pak të lartë, thashë se libri ishte i imi. Polici më pyeti mënjëherë se për çfarë më duhej. Kjo vërejtje e policit më pëlqeu, edhe pse nuk kisha ndonjë simpati për policët e sistemit, sepse as ne nuk ishim nga të simpatizuarit e policëve.

Një ngjarje tjetër tërheqëse në lidhje me këtë libër është se në vitin 1983, kur u burgosën "Muslimanët e Rinj" në Bosnjë e Hercegovinë, kur ata të shërbimit erdhën për të më bastisur shtëpinë, përpos disa librave që kishin ngjyrim disident, gjendej edhe libri në fjalë. Ishte shumë domethënëse vërejtja e një prej inspektorëve: "Këta janë njësoj: që të gjithë mbajnë të njëjtën literaturë."

Libri që po i jepet lexuesit është një nga librat më të jashtëzakonshëm të botuar anëve tona viteve të fundit. Autori i tij, Gjuro Shushnjiq, është i njohur përnjë rreth të ngushtë lexuesish, kryesisht nga hapësira e ish-Jugosllavisë; ndërsa te ne, më në fund, pas gati katër dekadash, do i paraqitet publikut libërdashës si një hulumtues i talentuar dhe i mençur në fushën e sociologjisë. Gjuro Shushnjiq përdor një gjuhë që thërret për një ndërgjegje kritike, e cila synon ndërgjegjësimin e njeriut, pavarësisht sistemeve shoqërore nëpër të cilat kalon. Ai përdor fraza të shkurtra, duke cituar thënie të mendimtarëve më të mirë, që kanë një peshë të jashtëzakonshme për çdo kohë dhe çdo sistem. Ndjej vësh-tirësi teksa hedh këto fjalë për botimin shqip të këtij libri, sepse autori e ka thënë tanimë, ose është duke e thënë atë

që më ka shqetësuar prej vitesh dhe na ka dëmtuar: kontrolli, manipulimi, deri te keqpërdorimi i fesë dhe fetarëve, pa folur për ateizmin dhe ateistët vulgarë. Pikërisht për këtë arsye, nuk mëtoj të them diç më tepër veç asaj që kam ndjerë si kënaqësi duke e lexuar në gjuhën origjinale. Besoj se “reklamën” ia kam bërë ashtu siç e ka merituar, sidomos në mjedisin tonë, ku asokohe nuk lexohej gjë tjetër në një gjuhë të huaj përveç “Boshko Buhës”.

Një nga simptomat themelore të perëndimit të një kulture të caktuar është zhdukja e dijes mbi domethëniet e përmbajtjeve të saj në vetëdijen e rojeve dhe veprimtarëve të saj. Ashtu siç dëshmon për këtë qasja në të gjitha periudhat e dekadencës: kultura, shenjat, simbolet dhe idetë zgjasin falë një inercietë thjeshtë në transmetimin material. Por, vetëdija e bashkëkohësve të këtyre periudhave është gjithnjë e më larg mundësisë për të njohur domethëniet burimore të përmbajtjeve të transmetimit.

Dukuria e zhdukjes së domethënieve shkakton një kundërmasë të pavetëdijshme: periudhën e dekadencës e karakterizon edhe një përpjekje intelektuale e jashtëzakonshme, e orientuar drejt depërtimit në domethëniet e përmbajtjeve të kulturës. Më kot. Më kot, sepse të gjitha debatet – shpesh edhe të ashpra – rreth domethënieve, vetëm sa përshpejtojnë proceset e largimit prej tyre. Dhe ngaqë në këso rastesh aftësitë spekulative të shpirtit përpiqen ta kompensojnë harresën e qenies, në vend të njohjes së domethënieve burimore, liria e arbitraritetit të shpirtit çon drejt pafundësisë së figurave fantastike dhe të përçudnuara, të cilat shpesh janë antiteza të së vërtetës.

Ky pasion hermeneutik kontribuon në përhapjen dhe përshpejtimin e procesit të dekadencës, ngaqë shter të gjitha energjitë, madje edhe ato që janë të domosdoshme për

krijim. Në vend që të shpëtojë të tashmen e vet, në vend që të përgatitet për të ardhmen, kultura e dekadencës është fundekrye e kthyer nga debatet për domethëniet e përmbytjeve të së kaluarës. Prandaj, kultura e fundit e Perandorisë Romake është nën shenjën e tepricës së gramatikanëve, retorikëve, shkruesve dhe klasifikuesve. Me analogji, edhe kultura moderne është nën shenjën e mbizotërimit të disiplinave analitike dhe introspektive: semiologjia, psikanaliza, strukturalizmi, hermeneutika dhe retorika e re, semantika, linguistika e kështu me radhë. Kjo zhvendosje e rëndesës kryesore të kulturës drejt disiplinave analitike dhe introspektive, i përgjigjet me saktësi rrezikut që përmban fenomeni i humbjes së domethënies, edhe pse rezultati është i kundërt me ato qëllime të pavetëdijshme të energjive të fundit të kulturës së Perëndimit. Bëhet fjalë për fenomenin që Ernst Jünger e ka përkufizuar në termat “bota si domethënie në shpërbërje e sipër”. Në këtë botë domethëniesh në shpërbërje e sipër, kushti kryesor i ekzistencës është absurdi. Sipas Camus-ë, në botën e absurdit, njeriu është “një i huaj që nuk njeh as veten”. Le të perifrazojmë një mendim të Demokritit, ku njeriu është pasojë e “lojës” mes domosdoshmërisë dhe absurdit. Ligjet e domosdoshmërisë janë të panjohura, ose i kanë humbur të gjitha domethëniet e tyre në vetëdijen e njeriut modern, ato domethënie të cilat filozofët e antikitetit ia këshillonin njeriut për një jetë në harmoni me natyrën. Pra, mbetet absurdi, ose nuk jeni të sigurt për të nesërmen, sepse ajo mund t’i ngjajë fermës së kafshëve në romanin me të njëjtin titull të Orwell-it. Kështu, absurdi bën të pamundur njohjen e rreziqeve të mëdha, duke shterur ato energji që mund t’i largonin këto rreziqe. Ironia e fatit është se pikërisht absurdi është shenja e parë e rrezikut ku mund të hasë vetëdija e udhëzuar drejt njohjes së tërësisë së rreziqeve.

Ne jetojmë në një botë të zhurmshme, të mbingarkuar me informacion dhe porosi të të gjitha llojeve. Jemi mësuar të dëgjojmë gjuhën e zhurmshme të shoqërisë sonë, që shpesh di të jetë e rreme, ndërkohë që kemi harruar gjuhën e qetë të trupit – gjuhën që thotë të vërtetën. Njerëzit nuk mbështeten edhe aq te mendja dhe shikimi i tyre, nganjëherë as mbi intuitën e tyre, por kryesisht shohin rregullat shoqërore, autoritetet ose atë që u ofrohet – në çfarëdo forme – si e vërtetë dhe e drejtë. Natyrisht, rregullat janë të mira; edhe autoritetet janë të mirë, sepse pa to do ndodhte – siç është bërë zakon të thuhet – “shkatërrimii sistemit” dhe humbja e besimit. Kështu që, shoqëria si e tillë as që mund të funksiononte. Por, kjo nuk do të thotë se autoritetet do thonë gjithnjë të vërtetën. Ka shumë syresh që kanë pozita të larta dhe duhet të kujdesen për nevojat e shoqërisë në të cilën jetojnë. Mirëpo ata kujdesen për nevojat e tyre, ndërsa të tjerët i manipulojnë.

Fjala “manipulim” rrjedh nga fjala latine *manus* – “dorë” dhe *polare* – “përshtatje”, “sheshim”, “mbulim me dorë”, “përgatitje”. Në përdorimin origjinal, fjala manipulim i është referuar përpunimit të një gjëje a gjësendi duke përdorur duart me shkathtësi. Ai që rezultonte i shkathët dhe i aftë në këtë përpunim teknik të materialit, quhej manipulues apo operator. Më pas fjala u zhvillua në atë trajtësa nëpërmjet saj filloi të shënjohej çdo lloj operimi apo drejtimi mendjehollë, i shkathët dhe i aftëi gjërave apo njerëzve për të arritur një qëllim të përbashkët.

*Peshkatarët e shpirtave njerëzorë*, idenë e manipulimit duke e manipuluar e manipulon dhe e bën të lodhshme, që ta pranojë me patjetër manipulimin (nuk e le të qetë manipulimin).

Sot fjala manipulim është e ngarkuar me domethënie negative dhe zakonisht shënjon raportet midis njerëzve, ku

disa ushtrojnë ndikim mbi të tjerët për të realizuar një interes personal apo grupor. Këto janë forma të veçanta kontrolli mbi sjelljen e individëve dhe grupeve, dhe ata nuk janë fare të vetëdijshëm për këtë. Në komunikimin publik, zakonisht politik, në radhë të parë ai është i motivuar nga interesi. Folësi shfrytëzon shkathtësinë e vet folëse për të bindur bashkëbiseduesin apo publikun për vërtetësinë e pohimeve dhe vlefshmërinë e veprimeve të tij. Në këtë rast, më së shumti ai shfrytëzon përparësitë e veta (për shembull, autoritetin, pasurinë, informimin etj.) dhe dobësitë e dëgjuesit. Por, e njëjta gjë është edhe me karakteristikat e situatës së komunikimit, ku mund të shfrytëzohet pasiguria dhe dobësia e situatës, gjenda shpirtërore etj.

Manipuluesit mund të ndodhen në akëcilin mjedis shoqëror: në familje, në rrethin shoqëror, në punë e kështu me radhë. Por, situata bëhet akoma më e rrezikshme kur ata gjenden në majën e hierarkisë, apo në ndonjë pozicion tjetër të jetës publike, gjë që, fatkeqësisht, haset shpesh (siç është rasti me një president, politikan, shef, shkencëtar, udhëheqës shpirtëror, polic, gazetar...). Në bazë të kërkimeve të dëritanishme, manipulues të vërtetë ka pak, por çështja është se janë në pozita të larta shoqërore. Në publik mund të manipulojnë masa të mëdha njerëzish, të shkaktojnë konflikte të ndryshme dhe fatkeqësi të shumta. Për fat të keq, një numër i madh manipuluesish fshihen pas pozitave të nderuara dhe të larta shoqërore, ndaj dhe është e vështirë të dallohen. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se manipuluesit janë gënjeshtarë. Zakonisht nuk njihen përmes të folurit, por përmes gjuhës së qetë të trupit. Gënjeshtria mund të pikaset nga prania e disa sinjaleve negative, si: shikimi i ngulitur apo “bredhës”, mbyllja e shpeshtë e syve, gjestet vetëngushëlluese, shuplakat e shtrënguara grusht (që ose lëvi-

zin tepër, ose pushojnë rreptë), muskujt e ngrirë në fytyrë dhe tendosja e përgjithshme në trup, puna negative e shpu-tave dhe ngjyra e zërit. Por, ndryshe nga aspektet e tjera të gjuhës së trupit, gënjeshtërështë e vështirë të hetohet. Në fakt, nga gjestet e izoluar nuk mund të konstatohet se di-kush po mashtron; prandaj u duhet kushtuar vëmendje edhe shenjave të tjera mbështetëse: duhet vëzhguar i gjithë kon-teksti dhe situata në të cilën përfshihetnjë person i caktuar.

Ka njerëz qëmendojnë se manipulimi është i plotfuqi-shëm. Nga ana tjetër, ka edhe nga ata që mendojnë se është i pafuqishëm. Ne nuk është mirë të jemi pjesë e asnjërit prej këtyre dy qëndrimeve. Në fakt, siç e thamë tashmë, në kra-hasim me numrin e shoqërisë, ka pak manipulues. Së kën-dejmi, në shoqëri ka akoma alternativa në mendim, besim dhe sjellje. Megjithatë, ndonëse të paktë në numër, manipu-lesit zënë pozita të larta shoqërore, dhe janë të shkathët për të vënë “maskat” e duhura, ndaj dhe janë mjaft të pranishëm në publik. Madje, nganjëherë, nëse i shikojmëme vëmendje fushatat politike parazgedhore, mund të na duket sikur e kanë përmbysur jetën publike. Pra, më e mira është të dalim në përfundimin se manipulimi, sidoqoftë, është i fuqishëm.

Një manipulues i fuqishëm, autoritar dhe i shkathët nuk i drejton këshillat e tij më kot, por përpiqet t’i formëso-jë në atë mënyrë që të godasin të gjitha llojet e motiveve nje-rëzore. Me këtë rast ai i shfrytëzon të gjitha sinjalet e veta joverbale (zërin, qëndrimin, gjestet, mimikën), duke qenë se e njih mirë fuqinë e gjuhës së qetë trupore. Ai e di që publi-ku, sa më pozitivisht ta vlerësojë folësin për sa i takon kë-shillave joverbale, aq më ndikim do të kenë këshillat e tij verbale. Gjithsesi, ngushëllimi qëndron te fakti se trupi nje-rëzor nuk mund të gënjehet, prandaj, një dëgjues dhe vëzh-gues i vëmendshëm i marrëdhënieve publike mund të zbu-

lojë çdo mashtrim të mundshëm. Në fakt, Einstein-i ka thënë të vërtetën në këto dy fjali: “Mendja intuitive është një dhuratë e shenjtë, ndërsa mendja racionale është një shërbëtorë e përhershme. Ne kemi krijuar një shoqëri që çmon shërbëtorët dhe harron dhuntitë.”

Fuqia e manipulimit nuk është e gjitha rrjedhojë e shkathësisë së manipulimit, sesa e një qëndrimi miratues nga ana e individit dhe/apo grupit. Pra, përgjegjësia nuk bie vetëm mbi manipuluesin, por më tepër mbi shoqërinë dhe dëgjuesit që ata zgjedhin. Njeriu njihet sipas veprave të tij, dhe kështu vihet re fare mirë që çdokush ka lirinë e zgjedhjes.

Më duket se me këtë formë trajtuese po gaboj në lidhje me librin, sepse mbi idenë e manipulimit, mashtrimit dhe lojës që bëhet me njeriun e ditëve tona, Gjuro Shushnjiq ka bërë një paraqitje filozofike, sociologjike dhe psikologjike. Ai depërton thellë dhe me një mjeshtri të veçantë paraqet probleme të ndryshme, duke filluar që nga shkenca, e cila sipas idesë marksiste dhe teorisë së materializmit lufton metafizikën. Në këtë pikë ai përdor një gjuhëtë thjeshtë metaforike, të qartë dhe të prerë, sidomos kur reflekton në këtë mënyrë: “Nëse Zoti nuk ekziston, atëherë pse një përqindje e madhe e njerëzimit beson tek Ai?” Pastaj e çmoj Shushnjiqin ngaqë i pëlqejnë shumë aforizmat dhe filozofia e aforizmit.

*Peshkatarët e shpirtrave njerëzorë* është një ndër ato vepra të rralla që nuk e lodh lexuesin që kërkon të vërtetën. Dua ta mbyll këtë vërtetim me një anekdotë të treguar nga vetë autori, i cili qe futur në një librari për të pyetur për librin e tij. E pat kërkuar te librat e filozofisë dhe sociologjisë, por nuk e kish gjetur. Kur kishte pyetur shitësin, ai i qe përgjigjur: “Po, mund ta gjeni te këndi i librave për kafshët/peshqit.”

*Ismail Bardhi*

*mars, 2017*

## PARATHËNIE PËR BOTIMIN E KATËRT

*Heshtja mbetet gjithnjë një mundësi; në të kundërt,  
mundësia tjetër është vetëm të akuzuarit.*

Tolstoi

Në këtë libër trajtohet çështja se si udhëhiqen dhe si mashtrohen njerëzit dhe popujt, pa qenë të vetëdijshëm për këtë. Ky është një rrëfim për prijësit, pas të cilëve nuk mbetet asnjë gjurmë gjaku, por jomë pak të rrezikshëm, sepse ata nuk vrasin trupin – ata lëndojnë shpirtin.

K. Lorenz-i e konsideron manipulimin e njerëzve si një ndër tetë mëkatet vdekjeprurëse të njeriut të qytetëruar (*civilized man's eight deadly sins*), dhe mendon se rreziku nga “shpërlarja e trurit” nuk është zvogëluar, sidoqë është rritur numri i atyre që janë të vetëdijshëm për këtë rrezik. Fakti që jemi të vetëdijshëm për të na jep gjasa që t’i shmangemi. Vetëdija po depërton në botë. Ne që fluturojmë shtohemi, qoftë edhe me krahë të thyer. S’jemi vetëm pluhur e hije. Orwell-i i sheh gjërat shumë zi, kur në romanin 1984 shkruan: “Jemi të vdekur. Jeta jonë e vërtetë është në të ardhmen. Në të do të marrim pjesë si grushta pluhuri dhe copëza kockash.”

Fuqia ndaj të mirës dhe të keqes është e pandjeshme. Përdorimi i forcës mund të jetë i mirë, por edhe i keq. E keqja duhet të shpjegohet, por nuk duhet të arsyetohet, sepse e arsyetuar ajo depërton në tabelën e vlerave. Kështu, kur arsyetohet përdorimi i forcës, atëherë forca nuk duket si dhunë, si në rastin kur për “një kamp përqendrimi” thuhet se është “një vendbanim strategjik”. Ngadoqë ta shtrydhin njeriun, trupërisht apo shpirtërisht, le ta dinë se na atakojnë

edhe ne. Mund ta pushtojnë gjithë botën, por kur të kemi humbur shpirtin ata shndërrohen në lypsarë që meritojnë mëshirë. Vullneti për fuqi dhe pushtet është një tipar qenësor i historisë sonë.

Ku dallojnë pushtetarët e sotëm nga pushtetarët e tjerë në historinë e njeriut dhe shoqërisë? Pushtetarët në të kaluarën i kanë kushtuar kujdes çështjes se çfarë *bëjnë* qytetarët e tyre, kurse pushtetarët e sotëm përqendrohen më shumë në pikën se çfarë mendojnë *qytetarët* e tyre. Orwell-i ka kundruar kthjellët: “Partisë nuk i intereson akti i hapur: gjëja e vetme që na intereson është mendimi. Ne nuk synojmë t’i zhdukim armiqtë tanë – ne i ndryshojmë ata.” Shpëlarja e trurit, që nënkupton formësimin e vetëdijes, po shndërrohet në detyrën themelore të pushtetarëve. Sërish Orwell-i: “Pushteti i vërtetë, forca për të cilën duhet të luftojmë ditë e natë, nuk është pushteti mbi gjësendet, por mbi njerëzit... Pushtet do të thotë ta bësh copë e çikë shpirtin e njeriut, e më pas ta ribësh në formën e dëshiruar. A e ke të qartë tani se çfarë bote po ndërtojmë?”

Dallimi tjetër i rëndësishëm mes pushtetarëve të dikurshëm dhe këtyre që janë sot është se pushtetarët e dikurshëm e kanë parë fuqinë si një mjet për arritjen e disa qëllimeve të tjera, kurse këta të tanishmit e shohin pushtetin si qëllim në vetvete. “Ne e dimë mirë se askush nuk e rrëmben pushtetin për të hequr dorë prej tij. Pushteti nuk është mjet – ai është qëllim.” (1984)

Prej të gjithë motiveve që vënë në lëvizje qenien njerëzore, më i forti është vullneti për pushtet. Ai nuk mjaftohet me kontrollimin e sjelljes së jashtme të turmave, por synon të kontrollojë edhe sjelljen e brendshme të tyre, sidomos nëse ndonjë është i jashtëzakonshëm për sa i takon fuqive shpirtërore. Kjo është arsyeja se pse i shmangen pushtetarët

shfrytëzimit të fuqisë së zhveshur, dhe gjithnjë e më tepër anojnë kah fuqia pa dhunë, kah gjetja e një vendbanimi në shpirta dhe kah kontrolli i vetëdijes. Dikush diku ka konstatuar në mënyrë vizionare:

*Njëri sy gjithnjë sheh  
njeri, dije, gjë s'i fsheh.*

Realitetin nuk e përkufizojnë ata që e njohin më së miri, por ata që e zotërojnë atë. Ata i imponojnë përkufizimet për realitetin si të vërtetat e vetme. Përkufizimet dominante janë ato të njerëzve që qeverisin. Këto përkufizime janë psikologjikisht dominante, ndonëse gnoseologjikisht të pavlefshme. Për peshkatarët e shpirtave njerëzorë e vërteta është një nocion psikologjik, jo teorik. Kjo do të thotë se një ide vlerësohet se sa bindëse është, e jo se sa është e vërtetë. Peshkatarë është duke fituar për sa i përket besimit, dhe duke humbur në rrafshin e së vërtetës. Në fakt, atij nuk i intereson besimi. Për këtë mund të bindeni në mënyrë shumë të thjeshtë: thoni të vërtetën dhe ai nuk do t'ju besojë. S'ka rëndësi se për çfarë të vërtete bëhet fjalë, nëse është në formë ëndrreapo zhgjëndrre. Ajo që është e rëndësishme është nëse mund të sundojë sipas dëshirës së tijpërmes saj, edhe pa ndihmën e së vërtetës.

Të kuptuarit e të vërtetës shtyhet tutje në favor të mbizotërimit në realitet. Dashuria ndaj të vërtetës i lë vendin vullnetit për pushtet. Kultura jonë është e mbushur me përkufizime mashkullore për të vërtetën, dhe ne vetëm mund të hamendësojmë se si mund të dukej e vërteta në përkufizimet femërore. E vërteta përkufizohet nga pikëpamja e forcës, kurse forca është parim mashkullor. Përkufizimet zyrtare për të vërtetën mbizotërohen nga përkufizimet individuale: te çdo individ shfaqet shqetësimi kur mënyra se si e sheh ai të vërtetën bie ndesh me mënyrën se si e shohin atë

të tjerët e rëndësishëm, sidomos nëse këta të fundit janë të pushtetshëm.

Individit nuk i kushton asgjë sa profesioni, dhe asgjë nuk e shtyn më fort drejt kopesë sesa ndjenja ose vetëdija për rrezikun e jashtëm. Nga përvoja e përditshme dhe nga kërkimet shkencore dihet fort mirë se rreziku i jashtëm, në të shumtën e rasteve i afron dhe i bashkon njerëzit, që sipas të gjithë kriterëve të tjerë janë shumë të distancuar e të përçarë. Kur një bashkësie njerëzish, ku nuk mund të gjesh dy vetë që pajtohen për një gjë, i kanoset një rrezik i jashtëm, ata gjejnë gjuhën e përbashkët. Nëse nuk gjejnë një gjuhë të përbashkët, do përfundojnë në një varr të përbashkët.

Në lidhje me mendimet kanë patur guximin të qëndrojnë në të paepurpërpara vdekjes, por kur vjen rreziku i vdekjes ngjeshen me njëri-tjetrin si delet kur shfaqet ujku. Në grup ndihet më i sigurt, ndonëse nuk ka bazë për një siguri reale. Motivi për të mbijetuar është më i fortë se arsyeja dhe shkaqet e saj. Në rrethana të tilla ndodh rënia e vetëdijes në shkallën më të ulët, ndjenja se individ i është pjesë përbërëse e diçkaje më të madhe dhe më të rëndësishme për jetën. Vetëdija është sakrifikuar në favor të motivit për të mbijetuar dhe kthehet në nivelin fëmijëror të jetës shpirtërore. Ky kthim te kopeja është i dukshëm në veçanti në rastet e luftërave, kur qenia e arsyeshme takohet me çmendurinë. Mjerimi adhuron shoqërinë. Pikërisht për këtë arsye, asnjëherë si sot nuk ka qenë e mundshme të krijohen kushte ku qëndrimi vetjak të përputhet me atë të "opinionit publik", sepse në të shkuarën nuk ishte e mundur që opinionin publik të formohej në mënyrë artificiale.

Grigja përvetëson një ideologji të caktuar kur tek ajo sheh nevojat, interesat dhe dëshirat e veta. Edhe këtu, për të disatën herë, shihet qartë se nuk është fare e rëndësishme

vërtetësia e ideologjisë; por, ajo që ka rëndësi është që ajo t' u përgjigjet pritshmërive masovike, edhe nëse këto përgjigje janë të rreme. Fakti që një ideologji e caktuar ndryshon botën nuk do të thotë se ajo është e vërtetë, sepse ne dimë për shumë ideologji të pavërteta që e kanë ndryshuar botën rrënjësisht, por nuk e kanë bërë atë më të mirë. Gjithashtu, dimë për ide të vërteta, të cilat nuk janë pranuar nga bota dhe kanë mbetur si rrëfime të bukura për vendlindjen.

Sot, më e rëndësishme më duket brenga për të ruajtur disa gjëra, kundër të cilave punon koha jonë, e zbratur nga e vërteta dhe plot frikë, sesa përpjekja përtë krijuar vlerave të reja. Çdo relacion që nuk është dialogjik, domosdoshmërisht nënkupton raporte force dhe mbizotërimi. Dhe meqë të gjitha marrëdhëniet tona, në fakt, janë marrëdhënie force, na bëhet e ditur se dialogu është i pafuqishëm, sepse dialogu nënkupton marrëdhënie mes të barabartëve. Sot vendoset pa ne për fatin tonë, mënjanë nesh dhe kundër nesh, diku larg në mjediset e fuqisë dhe pushtetit. Nëse një grup njerëzish bëjnë ligje sipas dëshirës së tyre, atëherë vullneti i tyre është ligj. Kur ata t' i përmbahen ligjeve që kanë gatuar vetë, atëherë do urdhërojnë burgosjen e vetvetes.

### **Historia si thashethem**

Pushtetarët kanë përlyer dhe kanë shkatërruar gjithçka që kanë shtënë në dorë. Këtu, sa për ilustrim, do të tregoj shkurtimisht qëndrimin e tyre të çartur ndaj të kaluarës dhe gjuhës. Ndërsa për ndikimin e tyre vrapar ndaj sistemit edukativo-arsimor kam shkruar shpesh në njëzet e pesë vitet e fundit.

Biseda për të kaluarën zhvillohet në shumë mënyra, në veçanti tek ne, që jemi të ngarkuar me të. Këtu luhet vazh-

dimisht drama e kësaj pjese të botës, ku kemi të bëjmë me një fushë ndarjesh tragjike. Këtu historia numëron varret. Nuk thuhet më kot se këtu shënohet dendësia më e madhe e historisë, se Ballkani lëngon nga tepria e historisë, se popujt e vegjël bëjnë bujë që të jenë të mëdhenj në një drejtim të caktuar; ndërsa popujt e mëdhenj bëjnë paqe konform interesave të tyre.

Nga rrjedh kjo nevojë e fortë për ta shqyrtuar vazhdimisht të kaluarën? Pse historia shkruhet gjithnjë nga e para? Cilat janë arsyet ideore dhe ideologjike për riformësim të asaj që tanimë ka ndodhur?

Historiani i shtron pyetje të kaluarës për të marrë përgjigje për të tashmen. Ai bën regjistrimin e përvojave të rëndësishme – pasqyrën e vuajtjeve dhe shpresave – në të kaluarën, të cilat kanë një domethënie dhe një rëndësi jetike për aktualitetin. Sa më mirë që ta njohim të kaluarën tonë, aq më e madhe bëhet sasia e përvojës sonë, e kështu edhe mundësitë për vendime, pra mundësitë për një zhvillim më racional(e) dhe më njerëzor(e). Ne merremi me mënyrën e mendimit dhe besimit të pararendësve tanë, me qëllim që ta kuptojmë më mirë mendimin dhe besimin, por edhe për të siguruar mundësi krahasimi. Ne mësojmë rreth tyre për të kuptuar veten.

Historia i shqyrton/heton përsëri burimet e historisë, të sakta e të pasakta qofshin, sa herë që ndryshon teorinë për ngjarjen historike. Teoria e sfidave dhe përgjigjeve jep një imazh për të vërtetën historike, teoria e strukturës dhe procesit (ndryshe nga teoria e ndjenjës dhe përvojës) ofron një imazh tjetër për atë që ka ndodhur, kurse teoria e personaliteteve të mëdha (ndryshe prej teorisë së njeriut të vogël) nxjerr në pah imazhin e tretë të ngjarjes historike. Kurdo që historiani e ndryshon ose e zëvendëson teorinë e vet, ai du-

het ta ndriçojë të kaluarën në një mënyrë tjetër. Fjala vjen, nëse historiani shfrytëzon teorinë strukturore të historisë, që ngre pyetje për ndryshime strukturore, atëherë atij nuk i intereson fati im dhe fati yt. Ajo është një histori e vogël, private. Atij i intereson historia e popujve, e shteteve, e ushtrive, turmave, klasave etj., dhe jo ashtu siç e ndjen dhe e shpreh individi. Gjithashtu, kur historiani zbulon një burim të ri për historinë, që hedh një dritë të re mbi ndodhitë e moçme, ai i përvishet rindriçimit të këtyre ndodhive, dhe kështu ai e rishkruan historinë. Historiani ka të drejtë legjitime për të, sepse të vërtetën historike e përcakton si pajtim të teorisë me faktet.

Filozofi i historisë i vlerëson ngjarjet historike në bazë të një kuptimi që ndodhet jashtë historisë –për shembull, sa ngjarje të caktuara historike i shërbejnë çlirimit të njeriut (Hegel-i), ose shpëtimit të tij (teologët). Nëse një ngjarje nuk i shërben vetëdijes për lirinë apo shpëtimit, ajo është krejtësisht e parëndësishme dhe e pakuptimtë. Një ngjarje mund të jetë e rëndësishme në bazë të pasojave socio-psikologjike, por e vogël për nga rëndësia; kurse një ngjarje tjetër, e vogël për nga pasojat, qëllon të jetë e madhe për nga domethënia. Kur në shkrimet e shenjta thuhet “është plotësuar afati” apo “ka ardhur koha”, kjo nënkupton se është mbushur me të vërtetën dhe kuptimin, me besim e dashuri, e jo me ndodhitë vetvetishme, si lëvizje natyrore pa kurrfarë kuptimi dhe vlere. Në këtë kuptim mund të themi se ngjarjet e mëdha historike janë të rralla, sikurse janë të rralla personalitetet e mëdha (personalitetet e dalluar nuk është e domosdoshme të jenë të mëdhenj) – të mëdhenj për pyetjet që kanë shtruar, për nga rezultatet mbresëlënëse që kanë prodhuar, për nga kuptimi që kanë pasur dhe që e kanë akoma.

Ngjarjet nga e kaluara ideologu i interpreton në përputhje me interesin e tij, kështu që faktet i ribën sipas dëshirës, ose shpik të reja. Është pikërisht kjo arsyeja se pse për një ideolog/historian të tillë thuhet shpeshse “historia na mëson të mos u besojmë historianëve”, apo “atë që kanë arritur të bëjnë historianët s’e ka bërë asnjëherë historia”, ose “historia është ajo gjë me të cilën merren historianët”, ose “e gjithë historia është mashtrim” e kështu me radhë. Është fakt se për shumicën e ngjarjeve historike nuk dimë asgjë nga përvojat personale, por vetëm nga rrëfimet në libra, të cilët i kanë treguar dhe shkruar të tjerët, kryesisht ideologët. E gjithë e kaluara jeton si vetëdije për të kaluarën, si kujtim. Ndryshimi i kësaj vetëdijeje nënkupton ndryshim edhe për vetë të kaluarën.

Orwell-i është afër të vërtetës kur shkruan: “Gjasat janë shumë të mëdha që çdo fjalë nëpër librat e historisë, madje edhe ata që janë pranuar pa u filtruar të jenë fantazi e pastër.” (1984)

Nëse e gjithë kjo është e ditur, atëherë janë të logjikshme arsyet e atyre që pretendojnë se përpos historisë zyrtare duhet shkruar edhe një histori jozyrtare, si shtojcë ose përmirësim: burimet joformale të historisë ndodh që të përmblajnë gjysmën tjetër të së vërtetës. Mbizotërimi i shkencës zyrtare mbi atë jozyrtare nënkupton dominimin e konceptit mbi përvojën, ligjit të përgjithshëm mbi historinë vetjake. Çdo kulturë ose sistem kulturor zyrtar duhet të ketë në konsideratë kulturoren ose ato përvoja jozyrtare të cilat nuk përputhen me matricën kulturore zyrtare.

Ekziston edhe një qasje jo vetëm e mundshme, por edhe e arsyeshme për të kaluarën tonë. Historiani nuk duhet të flasë vetëm për atë që ka ndodhur, por edhe për atë që nuk ka ndodhur, por që mund të ndodhte. E kaluara është për-

plot mundësi të dështuara: krahas mundësive të realizuara rreshtohen shumë të parealizuara. Përgjatë historisë janë realizuar shpesh edhe mundësi të këqija, të cilat mund të shmangeshin me më shumë vullnet të mirë dhe vetëdije nga ana e atyre që kanë marrë vendime kyç. Kjo është mënyra e shkrimit të historisë që mbetet si detyrë historike. Këtë ka anticipuar Saint Simone për Revolucionin Francez: “Unë nuk ia zë për të madhe për atë që ishte, por për atë që mund të ishte.”

Në veprën *Nxënësi i djallit* të Shaw-it shfaqet një pjesë mes gjeneralit dhe majorit lidhur me çështjen nëse ushtria duhet të tërhiqet ose të qëndrojë në frontin e luftës. Gjenerali është për tërheqjen nga fronti, kurse majori është pro luftës, dhe i thotë gjeneralit të vet: “Ç’do të thotë historia për këtë akt?” Gjenerali, duke mbledhur plaçkat e veta, ia kthen: “Historia do të gënjejë, si gjithmonë. Kryesorja është që ne ta shkruajmë atë.” Edhe këtu bëhet fjalë për interpretimin ideologjik të ngjarjeve historike, ku pala ngadhënjyese e ribën të kaluarën sipas interesave të saj, duke mos marrë parasysh kurrfarë kriteresh racionale dhe mendore. E vërtetë historike konsiderohet çdo gjëqë përputhet me interesat e saj; kurse e pavërtetë konsiderohet gjithçka që bie ndesh me këto interesa.

Çështja nëse historinë e shkruajnë fituesit apo humbësit duhet të zëvendësohet me çështjen se cilat kushte duhen plotësuar për të ndërtuar një histori të vërtetë, pavarësisht se kush e shkruan atë. Me fjalë të tjera, cilat janë ato kushte që duhet të plotësojë një mendim për t’u pranuar si i vërtetë, sepse ndërgjegjja historike dhe shkenca historike nuk janë e njëjta gjë. Pavarësisht nga fakti nëse fituesi ndodhet në anën e fitimtarëve apo humbësve, nëse i përmbahet kriterëve të një pune të mirë në shkencë, ai mbetet në territorin e

shkencës historike dhe jo në atë të ideologjisë apo filozofisë së historisë, apo të teologjisë.

### Gjuha e armatosur

Gjuha mund të jetë në shërbim të së vërtetës dhe në shërbim të gënjeshtërs, dhe përmes saj mund të shprehen dhe përcillen me sukses si njëra ashtu edhe tjetra. Gjuha mund të jetë në shërbim të ruajtjes ose të prishjes së rendit; ajo mund t'i shërbejë vajtimit për të kaluarën ose celebrimit të saj; përmes gjuhës, një çështje e caktuar mund të bëhet e qartë ose e kuptueshme, por edhe e paqartë dhe e pakuptueshme. E thënë shkurt, në këtë rast fjalët vlerësohen për nga aspekti i fuqisë së tyre, e jo nga aspekti i së vërtetës. Fjalët janë armë, përmes të cilave ndryshohet ose arsyetohet bota.

Nëse dikush mendon se fjala nuk është edhe aq e fuqishme, atij mund t'i përgjigjemi si vijon: "Edhe një fuqi e paktë mbetet fuqi, ashtu sikundërse edhe një dollar i vetëm, ndonëse përbën një vlerë të papërfillshme, sidoqoftë mbetet para", shkruan Parsons-i në veprën *Shoqëritë moderne*. Nëse mendohet se nga dyluftimi me anë të fjalëve nuk rezulton me doemos luftë, atëherë ia vlen të citojmë V. Bukowski-n: "Luftë nuk do të ketë; por, do ketë një luftë të atillë për paqe, saqë nuk do mbeten as dy gurë bashkë."

Nëse ushtrohet dhunë mbi fjalët dhe dhunë përmes fjalëve, kemi të bëjmë me përgatitjen për një dhunë të vërtetë. Lufta përmes fjalëve i paraprin fjalës përmes armës, kështu që Ranko Bugarski duket se ka të drejtë kur thotë: "Me gjasë, në kartat gjuhësore qëndron lufta qytetare."

Gjuajtja nga dhjetëmetërshi i paraprin gjuajtjes me top. Këto janë fjalë pas të cilave ka pasoja të dukshme: ka fjalë të

pakëndshme, helmuese e vdekjeprurëse, përmes të cilave arrihet një efekt tmerrues mbi shpirtin dhe kujtesën njerëzore.

Të gjitha sëmundjet e shoqërisë, më së pari shfaqen si sëmundje të gjuhës: nëse gjuha është e sëmurë, e tillë është edhe shoqëria. Një gjuhë e sëmurë është gjithnjë paraprijëse e një shoqërie të sëmurë. Burgjet e para, krimet dhe varret e para përgatiten në gjuhë dhe në fjalime. Minat e para janë gjuhësore: së pari shpërthejnë në gjuhë dhe fjalime, e më pas në shtëpi dhe qytete.

Betejat gjuhësore kanë qenë paraprijëse të atyre ushtarake: aradhat goditëse të forcës së shtatë, të pajisura me fjalë me mbushjen më të fuqishme ideologjike, së pari kanë nisur të lufta mediatike, duke mos e shkëputur qoftë edhe për një çast lidhjen me “ministrinë e së vërtetës”, prej ku kanë marrë udhëzime për çdo hap të ardhshëm në këtë luftë të shëmtuar e shkatërrimtare. Chomsky shkruan: “Ekziston një shaka standarde që na thotë se gjuha është dialekt me armatë dhe marinë. Këto nuk janë ide linguistike.”

Sado që politikanët dhe mjetet e komunikimit masiv kanë shërbyer për shpërthimin e luftës, lufta nuk do të niste asnjëherë nëse thellë brenda njerëzve, në natyrën e tyre, nuk do ishte instinkti luftarak. Musil-i konstaton se “s’ka dyshim se lufta perceptohet si diçka tradicionale, madje mund të themi se është një institucion periodik”. Të mos bëhemi naivë: njerëzit nuk janë engjëj. Solovjevi na tregon për një gjeneral i cili pat deklaruar me sinqeritet: “Pas Zotit dhe Ruisë, më shumë se çdo gjë dua ushtrinë në përgjithësi dhe artilerinë në veçanti.” Nëse natyra e çdo njeriu është e ndritur dhe e errët në të njëjtën kohë, atëherë nuk ka arsye që e mira t’i përshkruhet vetëm njërës kurse e keqja tjetrës. Ama mëkate ka në të dyja anët. “Nëse themi se nuk kemi gabuar, e bëjmë gënjeshtar; kurse fjalët e tij nuk i kemi brenda nesh.” (Gjoni, 1: 10)

Nëse fjalët nuk mund të shkaktojnë ndryshime qenësore shoqërore, këto ndryshime kuptohen në to, interpretohen dhe vlerësohen. Për këtë arsye, mjetet e komunikimit masiv janë vetë përgjegjëse për vëzhgimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndryshimeve. Efektiviteti i tyre nuk mund të mohohet, madje as përgjegjësia për pasojat e shkaktuara. Vetë porositë vijnë nga mjediset e fuqisë shoqërore dhe të pushtetit politik, kështu që mediumet janë më tepër ndërmjetësues dhe përcjellës sesa krijues të këtyre porosive: zakonisht mediumet janë nën mbikëqyrjen e ashpër të forcës dhe pushtetit. Analistët pajtohen me qëndrimin se mjetet e komunikimit masiv, në njëfarë mase janë përgjegjës. Prandaj dhe një analist me arsye thekson se “së këndejmi, ligjërisht, mediumet mund të konsiderohen përgjegjës për atë që bëjnë dhe që nuk bëjnë; madje edhe nëse janë të detyruar për një sjellje të caktuar, e bëjnë pa vullnetin e tyre”. Në kohë krize, në veçanti në luftë, liria e mjeteve publike është e kufizuar për shkak të të ashtuquajturave interesa sipërore, pra kombëtare.

Të gjitha frikërat, ngërçet dhe urrejtjet e kanë mbushur ligjëratën dhe gjuhën e politikës dhe të mediave masive shumë më përpara se të vihen re me sy të thjeshtë në fytyrat e njerëzve, të pjesëmarrësve në dramën e përgjakshme në kopshtin zoologjik ballkanik. Nga ligjëratat dhe gjuha mund të konstatohet për fytyrën e vërtetë të njerëzve dhe drejt kujt synon njëri apo tjetri. Ankthi metafizik ka marrë formë fizike. Mlladen Llaziq përshkruan në mënyrë të saktë këtë gjendje: “E tillë që përgatitur skena për luftën qytetare: regjimet nacionaliste ishin kurorëzuar, qenë programuar ndjenjat shoveniste të popullatës, kurse përzierja etnike/fetare ishte e atillë që e drejta e çdokujt nënkuptone padrejtësi ndaj tjetrit.” Nuk mund të mos na kujtohen klithjet e Niet-

zsche-s: “Na jepni pak ajër të freskët! Le të përfundojnë një çast e më parë kjo gjendje absurde në të cilën ka rënë Europa. A qëndron ndonjë ide pas këtij nacionalizmi ngulmues? Çfarë kuptimi ka t’i ngjallësh këta shpirta të imët të këndellur në këtë çast kur gjithçka shënjon interesat e mëdha të përbashkëta? Kultura e vërtetë ka nevojë për kryqëzime dhe pasurime të ndërsjella.”

Fjalët janë një material i rrezikshëm dhe i ndezshëm, prej të cilit besimtarët ndërtojnë tempujt e tyre, kurse ideologët fuqinë e vet. Interesat e kanë helmuar gjuhën tonë dhe ne bëhemi patologjikisht të vetëdijshëm se fjalët tona “janë të mbushura me helm gjarëprinsh”. “Edhe gjuha është zjarr, një botë përplot me padrejtësi.” (Jakovit, 5: 13) Është një zjarr që Zoti ia fali gjuhës: gjuha ka fuqi magjike të nxisë ndjenjat, mendimet dhe veprimet, nga më të mirat deri te më të poshtrat. Edhe gjuha e dëlirë e fesë së krishterë është e ndotur me kuptime ideologjike, gjë që duket qartë nëse përmbillet analiza e përmbajtjes së mediave fetare. Edhe tek ato ka shprehje që janë të pavërteta, të paqëlluara ekumenikisht, të rrezikshme politikisht, të dëmshme moralisht, shqetësuese psikologjikisht dhe shkatërruese shoqërisht. Birvish pat thënë: “Gënjeshtër është e vërtetë (realitet), kurse e vërteta nuk mund të jetë gënjeshtër.”

Kisha nuk duhet të jetë as kundër e as pro, por mbi çdo ideologji laike. Velimiroviq thotë: “Nën çatinë e saj ka vend për të gjitha partitë; ama ajo nuk duhet të jetë nën çatinë e askujt!” Por, ne jemi dëshmitarë të faktit në vijim: kur tendosën marrëdhëniet mes “republikave motra”, prishen marrëdhëniet mes “kishave motra”. Në të dyja kishat ka nisur lëvizja nga ekumenizmi drejt nacionalizmit: ideologjia e kombit është përforcuar me teologjinë e kombit. Nëse dihet që identiteti fetar dhe kombëtar në këtë hapësirë janë të li-

dhur ngushtë me njëri-tjetrin, atëherë është e sigurt se shenjtërimi i kombit ka kontribuar për ashpërsimin e intolerancës fetare, pikërisht mes atyre popujve që kanë të njëjtën prejardhje, që flasin të njëjtën gjuhë dhe besojnë të njëjtin Zot. Dy popuj, me të njëjtën prejardhje, me të njëjtën gjuhë dhe fe! Nëse i ndan ajo që i bashkon, shtrohet pyetja se si i ndan ajo që i dallon?

Ai që i percepton fjalët ekskluzivisht si mjet për mirëkuptim mes njerëzve, e privon veten nga mundësia për t'i kuptuar ato në funksion të nevojave të tjera dhe tjetërfare. Një prej këtyre nevojave është simbolike: fjalët janë të përkatësisë etnike ose fetare. Fjala ose fjalia e parë e shprehur pagabueshëm shpalos identifikimin etnik dhe fetar të folësit, pra atë që e dallon nga të gjithë popujt dhe fetet e tjera. Gjuha dhe shkrimi, që kanë lindur nga nevoja për (mirë)kuptim mes njerëzve, këtu kanë rolin e dallimit dhe ndarjes. Fjala mund të afrojë, por edhe të distancojë. "Nga e njëjta gojë del si bekimi ashtu edhe mallkimi." (Jakovit, 2: 3, 7: 9)

Nëse pikasen ndryshime të shprehjet dhe gjuha e një bashkësie, kombëtare apo fetare qoftë, atëherë është e sigurt se bëhet fjalë për ndryshime në orientimin vleror/ideologjik, përkatësisht në qëndrimet politike. Kjo ngaqënjë orientimi vleror/ideologjik (për shembull, ideologjisë së nacionalizmit ose asaj të klerikalizmit) i përshtatet një fjalor i caktuar dhe i njohur. Nga një fjalor mund të konstatohet drejtimi vleror/ideologjik. Nëse në lojën gjuhësore përdoren shpesh shprehje si "kthimi të rrënjët", "mëmëdhe", "feja e të parëve", "etërit e kombit", "shenjtëritë kombëtare" e të ngjashme, atëherë është e qartë se po nis një periudhë e çmendur nacionaliste: simbolet kombëtare vërshojnë në hapësirën shpirtërore. Domethënia dhe rëndësia simbolike e "shenjtërive kombëtare" kapërcen atë që është e rrokshme dhe e

kuptueshme me mendje, dhe ndërkohë mbetet më shumë nga ajo që ndjehet dhe besohet. Njëra anë e simbolit kërkon të kuptuarit, kurse tjetra të ndjerit. Simboli është një urë mes të vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes: në të ka diçka nga arsyeja, por edhe diçka nga zemra. Këtë e dinë fort mirë nacionalistët e gjuhës, prandaj dhe e shfrytëzojnë mjeshtërisht.

Simbolet kyç mund të merren si tregues të nxehjes sociopatologjike për një fe dhe popull të caktuar, që në të njëjtën kohë nënkupton edhe ftohjen e marrëdhënieve me fetë dhe popujt e tjerë. Ashtu siç kalon koha, ndjehet rritja e tensionit dhe etendosjes së gjuhës, gjë që të kujton më shumë kazanin që nxehet deri në vlim sesa vendin ku bashkohen mendime të arsyeshme dhe njerëzore me përkujdesje e kritere.

Nga gjuha e sotme mund të lexohet ajo që do ndodhë nesër: spastrimit etnik të hapësirës i paraprin spastrimi etik i gjuhës; krijimit të kombeve të pastër i paraprin krijimi i gjuhëve kombëtare të pastra; pastrimet në gjuhë paralajmërojnë pastrimet në shtet. E thënë troç: fotografinë më të saktë për një bashkësi mund ta përftojme më shumë nëse njohim ligjëratën dhe gjuhën e saj sesa kushtetutën dhe ligjet. Marrëdhëniet mes dy bashkësive pasqyrohen në gjuhë: marrëdhëniet mes tyre njihen në raportet mes fjalëve. Pas luftës së vërtetë për ndryshimin e statusit shoqëror dhe politik të një bashkësie fshihet përpjekja e saj për ndryshimin e gjuhës dhe ligjëratës.

Analiza e përmbajtjes së botimeve të një bashkësie, zakonisht ka të bëjë me atë që është thënë në to e jo me atë që nuk është thënë, ndonëse është menduar: nën çdo fjali të shkruar mund të shtohet një e pashkruar. Nganjëherë, duke marrë parasysh të vërtetën, më e qenësishme është ajo që nuk shprehet sesa ajo që shprehet: ajo që është shprehur përcakton deri diku atë që është thënë dhe se si është thënë.

Përmes koncepteve ideologjike zbulohet por edhe fshihet diçka. Këto koncepte janë kundërthënëse për nga natyra. Këtë e ka hetuar shumë mirë Orwell-i te 1984: "Të thuash rrena me vetëdije dhe t'i besosh sinqerisht ato; të harrosh çdo fakt kur bëhet i pafavorshëm, dhe më pas, kur bëhet i nevojshëm, ta harrosh sërish –ta nxjerrësh nga harresa për aq kohë sa ke nevojë. Të mohosh ekzistencën e të vërtetës objektive dhe gjatë gjithë kohës të kesh parasysh faktin e mohuar. E gjithë kjo është domosdoshmëri. Dhe kështu deri në pafundësi: me faktin që rrena është gjithnjë një hap përpara të vërtetës."

Ndonëse Orwell-i e ka zbritur deri në stadin e karikatürës gjuhën ideologjike, nuk mund të mohohet se vërejtja e tij lidhur me prishjen dhe varfërimin, por edhe lidhur me keqpërdorimin e gjuhës është me vend. Se në çfarë mase jemi të burgosur te ligjërata dhe gjuha ideologjike tregojnë edhe vitet 1990, kur si në pëllëmbë të dorës është vënë re se ekzistojnë njerëz të atillë që zhdukin dhe çkuptimësojnë gjithë atë që ndërtojnë dhe fisnikërojnë të mirët e të vyerit.

Sa më tepër të flasin pushtetarët, aq më pak mendojnë. Mbyllja te ligjërata dhe gjuha ideologjike është shenjë e prapambetjes dhe pandjeshmërisë shpirtërore për përmbajtjet e tjera të përvojës. Nga copëzat e fjalëve të huaja sajojnë diçka kinse si të tyren, copëza që nuk janë as fjalë e as mendime të tyre: e gjitha është diçka tashmë e keqpërdorur dhe e konsumuar.

Mbetet shpresa se do të vijë një brez që do i përjashtojë nga fjalori fjalët dhe kuptimet e tyre, dhe do krijojë një gjuhë më të afërt me jetën, më të afërt me të vërtetën. Urtari i vjetër kinez tërheq vërejtjen: "Kur fjalët humbasin domethënien, njerëzit humbasin lirinë."

## Rezistencat

Të kesh sistem ideologjik do të thotë të jetosh dhe të veprosh në një hapësirë mbytëse, në një hapësirë pa befasi dhe pa risi. Paqartësia dhe pasiguria arrijnë kulmin kur dalim prej sistemit. Kështu që ruaju nga sistemi i mbyllur, sado i sigurt të ndihesh brenda tij. Kemi edhe këtë reflektim nga Wittgenstein-i në këtë kontekst: “Vështirësitë në të cilat ka rënë mendimi janë të ngjashme me ato të njeriut kur ndodhet në një dhomë nga e cila synon të ikë. Përpjekjet e para i fillon nga dritarja, por nuk ia del, pasi është shumë lart. Më pas mundohet përmes oxhakut, por ai është shumë i ngushtë. Në fakt, i duhej vetëm të kthehej dhe të shihte derën, që ishte e hapur gjatë gjithë kohës.”

Ekspertët e shpëlarjes së trurit janë të detyruar të pranojnë paaftësinë e tyre kur përballen me të rinj që nuk shfaqin interes për mësimet e tyre, qoftë ngaqë nuk janë të aftë që t’i kuptojnë në mënyrën e pritur, qoftë ngaqë ndërpresin mundësinë e ndikimit. Në të dyja rastet nuk lejojnë të drejtohen e as të mashtrohen. Kur iu përmendet jeta partiake dhe veprimi politik, shumica e tyre janë të ftohtë, sepse nuk presin asgjë. Ngjajnë me bashkësitë e vogla të krishtera në fillim të erës sonë, të tjetërsuara nga shoqëria por të afërta nga brenda. Në vetëdijen e tyre mbizotëron ideja e përjetimit të drejtpëdrejtë. Ndërsa e ardhmja u intereson, siç u interesojnë lojërat e tjera të fatit. Ata që e duan ndryshimin nuk mund ta realizojnë. Kurse ata që mund ta realizojnë, nuk e duan.

Fromm-i shënon se historia njerëzore ka filluar me aktin e padëgjueshmërisë njerëzore. Të padëgjueshmit janë të nevojshëm për shoqërinë, si oksigjeni për frymëmarrjen. Njeriu është një genie që luan bixhoz, dhe nganjëherë është

i gatshëm të fusë gjithçka në lojë: jo vetëm jetën e vet, por edhe të tjetrit. Në këtë pikëkryqëzim rrugësh, në telashet e përzgjedhjes njeriu rritet ose bie. Ka të atillë që ndjekin jehonën e tyre dhe e pranojnë sfidën, me shikimin e përqendruar në një vend të largët. E gjithë jeta e tyre është arritje e përvojës mbi lirinë dhe kufijtë e saj. Ka edhe të atillë që jetojnë pak, por përjetojnë shumë, ngaqë janë ankuar. Kur ankohesh apo rebelohesh, përjeton fëmijën brenda vetes, njeriun e kulluar. E drejta e njeriut për rebelim nuk vjetrohët asnjëherë. Njeriu i rebeluar hap kornizën e lirisë së tij dhe u zbulon të tjerëve mundësitë e tyre. Ai pushton çdo pëllëmbë të lirisë së vet, duke mos arritur asnjëherë në fund. Sikur të arrinte lirinë absolute, atëherë do të kishte edhe lirinë për të vrarë; domethënë, jo vetëm t'i mohojë lirinë tjetrit, por edhe vetë parimin e lirisë. Kur humbet një gjë nuk ke humbur asgjë. Kur humbet liria ka humbur gjithçka.

Njerëzit me mendime dhe imagjinatë të bujshme janë të padurueshëm për sistemin totalitar, dhe për këtë arsye, sistemi, një pjesë të forcave të veta i drejton nga thyerja e tyre. Sistemi është i sigurt se rreziku vjen prej tyre, pikërisht ngaqë nuk mund t'i kontrollojë me mënyra të zakonshme. Ata hidhen tutje me ashpërsi nga një diktaturë *out of the date*, për shkak të nënshtrimit ndaj të vërtetës. Më pas gjykohen menjë heshtje të rëndë. Përgjithësisht sistemi nuk i frikësohet masës: masës mund t'i jepen të gjitha liritë shpirtërore, por çdo të bëjë ajo me to kur në shpirtin e saj nuk janë shfaqur akoma nevojat për këto liri. Ata që janë në fund nuk duhet të frikësohen nga rënia.

I gatshëm për të humbur,  
Gjuro Shushnjq

Beograd, mars, 1995

(e përkthet: Ali Pajaziti)

## PARATHËNIE

*“Jam mjaftueshëm i juaji që t’ju them të vërtetën.”*

Victor Hugot

I dashur lexues, të siguroj se faqet e këtij libri do të jenë të lehta për t’u lexuar dhe të vështira për t’u menduar. Nevojiten përpjekje të mëdha dhe ushtrime për hapjen e shpirt-rave drejt pranimit të atyre të vërtetave që janë kundër tyre.

Një mesnatë (1972), kur djali im që ishte vetëm dy vjeç u zgjua papritur nga një ëndërr dhe filloi të bërtiste me gjithë fuqinë që kishte: “KULSENI NË LUGOBANKË!”, unë hapa shpirtin tim të blinduar. Fëmija i drobitur përsëriste një reklamë televizive: “KURSENI NË JUGOBANKË!

Përjetimi i pazakontë në atë errësirë më vetëdijesoi për disa gjëra të rëndësishme: a. fëmija e mban mend edhe atë që nuk e kupton; b. e përsërit në mënyrë të pavetëdijshme atë që nuk e kupton; c. mëson edhe atëherë kur nuk është i vetëdijshëm se po mëson; d. sjelljet e tij kontrollojnë edhe faktorët e pandërgjegjshëm; e. pranon mesazhe para se të jetë në gjendje që t’ia besojë përvojës së tij; f. nuk ka vetëdije për të pavetëdijshmen; g. përvojat e pranuar në mënyrë të pavetëdijshme dalin në pah (në plan të parë) në një gjendje të caktuar (në gjumë).

Në atë çast vendosa që për disa vite në vijim, të merrem në mënyrë sistematike me peshkatarët e shpirt-rave njerëzore, fuqinë dhe pafuqinë e tyre; me metodat e tyre të bindjes pa dhembje. Kështu ky mendim zuri fill në kokën time; i dëboi të gjitha mendimet e tjera dhe nisi të më mundonte. “Është e çuditshme se në qoftë se të mundon një mendim,

atëherë atë e gjen kudo, shprehet gjithandej, madje ia ndjen aromën edhe në ajër.”<sup>1</sup> E vetmja mënyrë për t’u çliruar nga një mendim i tillë i mundimshëm është që ta shprehësh atë, për aq sa na jep mundësi gjuha jonë e varfër. (Sepse fjala është një mendim jo i besueshëm; pothuajse gjithmonë shpreh edhe atë që nuk duam.)<sup>2</sup>

E vërteta shumohet kur shpërndalet. Ndaj jam përpjekur që ta përhap sa më gjerë mendimin tim, në mënyrë që të nxis sa më shumë njerëz që të mendojnë për rreziqet që na kanosen të gjithëve; që ata ta thonë fjalën e tyre. “Të shkruarit, nëse është i qëlluar (siç mund të bindeni që unë mendoj për tekstin tim), është thjesht një emër tjetër për të biseduar. Ashtu sikurse çdonjë prej atyre që dinë të sillen në një shoqëri të mirë nuk e marrin guximin t’i thonë të gjitha, ashtu edhe shkrimtari, i cili i di kufijtë e mirësjelljes, nuk e merr guximin që të mendojë për gjithçka. Respektin më të madh që ai mund t’i afrojë aftësive shpirtërore të lexuesit, është përgjysmimi i punës së tij, për t’i lënë vend lexuesit që edhe ai nga ana e vet të mendojë diçka, ashtu siç bën vetë shkrimtari.”<sup>3</sup> E vlerësoj faktin që biseda është tolerante<sup>4</sup> dhe e kulturuar, e rëndësishme dhe vendimtare në shoqërinë e njerëzve të kuptueshëm, të cilët, për faktin se janë të vetëdijshëm për kufizimet e tyre profesionale, janë të gatshëm që t’i mposhtin ato kufizime përmes pjesëmarrësve të tjerë të barabartë në dramën e jetës njerëzore.

<sup>1</sup> Mann, *Tonio Kreger*, Rad, Beograd, 1963 f. 24.

<sup>2</sup> “Për ne është më e çmuar ajo që mbetet pa u thënë.” (Žid, *Novi plodovi*, Svjetlost, Sarajevë, 1958, f. 222)

<sup>3</sup> L. Stern, *Tristram Šendi*, Prosveta, Beograd, 1962, f. 144-5.

<sup>4</sup> “Mbajeni mend: toleranca shndërrohet në krim nëse i shërben të keqes.” (Mann, *Magični breg*, Prosveta, Beograd, 1962, f.642).

Nuk kërkoj as nam e as famë<sup>5</sup>, por vetëm të vërtetën. E kërkoj të vërtetën për ata që i bëjnë atentat asaj në mënyrën që “të jetë e padukshme për sytë e njerëzve”. E kërkoj të vërtetën për ata të cilët i japin emrin e lartësuar “teori” interresit të tyre. E kërkoj të vërtetën për ata që rrojnë me gënjeshtrën. Ndoshta është poeti ai që di të akuzojë më mirë: “Të kalosh mendime të errëta në vetëdije dhe të bësh pafajësi prej tyre. Të prokurosh përjashtimin e krimit të fshehtë; vrazhdësinë tënde ta shtysh si bukuri; prej pavyeshmërisë të ndërtosh përsosmërinë. Të ledhatosh kamën; të thithësh helm; të kesh kujdes për butësinë e lëvizjeve të tua dhe për muzikalitetin e zërit. Të kalosh shikimin e huaj te shikimi yt. Nuk ka gjë më të vështirë se kjo. Nuk ka asgjë më të dhimbshme se kjo.”<sup>6</sup>

Njerëzit nuk janë të vetëdijshëm, ose nuk janë aq sa duhet të vetëdijshëm se jetën e tyre të përditshme e mbikëqyrin grupet e fuqishme, që përmes mediave masive lëshojnë shiun e simboleve të organizuara dhe të përzgjedhura me kujdes, funksioni i të cilave nuk është që të informojnë botën, por të shfrytëzojnë nevojat e botës. Qëllimi kryesor i këtij “radiokativiteti shpirtëror” përbëhet prej “kurdisjes” së shpirtrave njerëzorë<sup>7</sup>, ndërkaq pasoja kryesore është zhvendosja e vullnetit të tyre për vetëvendosje. Ata shpirtra të fuqishëm që nuk i ka mposhtur akoma jeta, të cilët kanë zgjedhur të jenë ndihmëtarë të së vërtetës; të cilët mendojnë për atë që harrohet nga shumica, tërheqin vërejtjen se “kur individi bëhet i marrë apo thjesht sëmuret, dhe sillet në mënyrë skizofrene, ne themi se ka dalë mendsh. Kur një grup i

<sup>5</sup> Shumë më kanë lavdëruar, por shumë pak syresh më kanë kuptuar!

<sup>6</sup> V. Igo, *Pomorci*, Rad, Beograd, 1955, f. 194.

<sup>7</sup> “Lënda e parë që përpunojmë është materiali prej të cilit përbëhet mendimi njerëzor.” (V. Pakard, *Industrija svesti*, Sedma sila, Beograd, 1967, f. 111).

madh njerëzish sillet në të njëjtën mënyrë ndaj nesh, themi se janë pjesë e një kulture të veçantë”<sup>8</sup>, dhe marrëzinë e tyre e quajmë kulturë.

Disa studiues, që nuk pranojnë të ecin me kokën ulur, që shpirtërisht janë më të pasur sesa të afërmit e tyre, pasi janë të vetëdijshëm për varfërinë në të cilën jetojnë, duhet t’u tërheqin vëmendjen vëllezërve të tyre për një formë të re dhune: dhuna shpirtërore,<sup>9</sup> pasojat e së cilës mund të jenë shumë më të rënda se pasojat e dhunës fizike. Nëse pasojat e dhunës shpirtërore shihen edhe si pasoja të dhunës fizike, atëherë mund të konstatojmë shumë shpejt se kemi shumë më tepër njerëz që janë shpirtërisht të gjymtë sesa me të meta fizike.

Lëndimet shpirtërore janë më të thella se lëndimet trupore.<sup>10</sup>

Punëtori në fushën e shkencave shpirtërore, nëse tashmë ka zgjedhur të jetë pastrues i shoqërive, në radhë të parë duhet të jetë pastrues i gjuhës me të cilën flasin grupet e pushtetshme shoqërore. Gjuha e të fuqishmëve zbulon dhe fsheh atë që është me rëndësi për ta – interesin. Në emër të interesit ata janë të aftë të pështyjnë të vërtetën në sy. “Nuk e fëlliq njeriun ajo që ai fut në gojë, por ajo që del prej goje. Kjo e fëlliq njeriun.”<sup>11</sup>

<sup>8</sup> J. Henry, *Culture Against Man*, Vintage Books, New York, 1965, p. 94.

<sup>9</sup> “...dhe gjithashtu dimë se shkenca e re e psikologjisë e ka mësuar si zbulime djallëzore, që në të kaluarën nuk i ka disponuar as tetari, as prifti as zëdhënësi...” (Toynbee, *Istraživanje istorije*, Prosveta, Beograd, 1977, libri II, f. 413).

<sup>10</sup> “...çfarë vlere kanë shprehje si “personalitet” apo “karakter” nëse dëshmohet se vetitë thelbësore të njeriut mund të manipulohen me veprime të zakonshme? Ç’ndodh me përgjegjësinë dhe ndërgjegjen, drejtësinë dhe moralin.” (E. Lausch, *Manipuliranje mozgom*, Stvarnost, Zagreb, 1976, f. 15-16).

<sup>11</sup> “...ti surrat i ndyrë, fjalët e të cilit nuk vijnë prej mendjes, por krijohen diku tjetër dhe janë të papastra e plot kalbësi.” (Mann, *Legenda o Jospiu*, II, O. Keršovani, Rijeka, 1960, f. 1234)

Autorët modernë, në fushën e shkencës mbi njeriun janë identikë me mullinjtë që bluajnë shumë, por që në thasët e tyre gjendet shumë pak miell. Pikërisht për këtë u jam drejtuar shpesh më të moshuarve, jo vetëm në fushën e shkencës për njeriun, por edhe në fushën e letërsisë së mirë. Është e gjatë lista e emrave të tyre, emra të cilët nuk mund t'i përmend pa hequr kapelën. "Secili i ka më shumë borxh të tjerëve sesa vetvetes."<sup>12</sup> Por, intelekti im, dyshues dhe mosbesues, nuk ia ka dalë që të vendoset në një sistem të caktuar, prandaj dhe ka kërkuar follenë e vet, por nuk e ka gjetur; sepse jeta nuk është sistem.

Unë nuk e fus veten te grupi i fuqishëm i sociologëve, të cilët krenohen me kufizimin (specializimin) e tyre, sepse përpiqem që një problem të caktuar shkencor ta trajtoj nga shumë këndvështrime dhe të tërheq vëmendjen jo vetëm për pasojat teorike, por edhe për ato praktike (për disa zgjidhje shkencore). Unë nuk jam as nga ai tip sociologësh dhe filozofësh që janë të aftë t'u përgjigjen pyetjeve që u shtrohen pa shpjeguar asnjë nga përgjigjet. Këtu jam orvatur që të shpjegoj dhe kuptoj sa më mirë vetëm një pyetje, i vetëdijshëm që shumë pyetjeve të tjera nuk u jam përgjigjur – sepse nuk e di përgjigjen. Gjithashtu nuk kam as aftësinë që të them atë që nuk mendoj. Nëse sociologu nuk është një sy shoqëror për të pikasur atë që nuk e shohin shumica e njerëzve, është më mirë që ta varë penën diku. Megjithatë, nëse e pikas, por refuzon ta thotë duke u shprehur me fjalë të zakonshme, atëherë është i lig dhe nuk e meriton emrin mik/shok (*socius* – "mik"/"shok").

Kam pasur nderin që para botimit, këtë libër ta lexojnë dhe ta vlerësojnë njerëz të shkolluar dhe mendimtarë, si:

<sup>12</sup> Žid, *Novi plodovi*, f. 200.

prof. dr. Rudi Supek dhe dr. Nikolla Millosheviq. Nuk e di se si t'i falënderoj, përveçse të pranoj publikisht se pa kritikën e tyre të rëndësishme ky libër do të ishte më i varfër, dhe do i mungonin gjëra të rëndësishme. Si ekspertë, por edhe si humanistë, ata më kanë bindur se në kritikën tonë humaniste gjendja nuk është e mjerë, siç është menduar këto dhjetë vitet e fundit. Do të jem i kënaqur në çastin që do bindem se krahas një numri të madh kritikësh gjaknxehtë dhe me mendësi shterpë, – të cilëve mungesa e dije dhe kulturës së përgjithshme nuk ju paraqet pengesë për të gjykuar publikisht atë që nuk e kuptojnë, që i gjykojnë personalitetet të cilëve nuk iu afrohen as të thembra, dhe që të keqen e tyre e shtrydhnin prej vetes duke e pagëzuar si kritikë<sup>13</sup> – rrojnë dhe punojnë autorë të rëndësishëm që nuk e kuptojnë kritikën si mosmarrëveshje personale<sup>14</sup>, por si një betejë të gjatë intelektuale kundër “anarkisë shpirtërore dhe regjimit të vetë marrëzisë”.<sup>15</sup> Më duhet ta pranoj se vlerësimet e tyre lajkatuese për këtë studim kanë përkëdhelur sqimën time, por megjithatë më të dobishme për mua ishin kritikrat dhe vërejtjet e tyre, të cilat i kam inkorporuar në çdo vend të këtij libri.

Ndoshta lexuesi i mësuar me mënyrën pozitive të të menduarit do të ma marrë për të madhe ngaqë mendimet e mia vlerësuese i fus shpesh si dëshmi objektive shkencore, dhe i ngjyros me bindjet e mia vetjake. Nuk them se lexuesi nuk ka të drejtë, por ama di që me këtë veprim as unë nuk

<sup>13</sup> “Kritika që merret me përmbajtjen është një kritikë në dyluftim, dhe në dyluftim nuk kemi të bëjmë me çështjen a është fisnik kundërshtari, i aftë, *interesant*. Kundërshtari duhet goditur. (Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 76)

<sup>14</sup> “...eci me mendimet e mia mbi kokat e tyre. Kur të dua të ec mbi gabimet e mia, do të isha përsëri mbi ta dhe mbi kokat e tyre.” (Nietzsche, *Tako je govorio Zaratus-tra*, Mladost, Zagreb, 1975, f. 116.)

<sup>15</sup> Marx & Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 37.

gabo. Ja arsyeja: bindjen time nuk e kam marrë si të vërtetë shkencore, por të vërtetën shkencore e kam përvetësuar si bindje vetjake.

Në këtë studim, për fatin e keq të kritikëve të mi dhe për fatin e mirë të lexuesve, mendimet e artistëve i kam cituar vetëm për një qëllim: që të jenë një ilustrim i bukur (jo prova) për idetë që i kam zhvilluar në mënyrë sistematike, ashtu siç kam ditur dhe me aq sa kam mundur. Përzgjedhja e ideve është domosdoshmëri e drejtimit të ideve bazë të punës, domethënë më është dashur që të lexoj letërsi me një ide të krijuar qysh më parë. Me këtë rast, mendimet e artistit, të qëndisura në strukturën time mendore, fituan një kuptim të ri dhe ushtruan atë funksion që autorët e tyre nuk ua kishin dhënë. Nëse dikush mendon se me këtë transformim prej tekstit letrar në kontekstin sociologjik kam varfëruar kuptimin dhe funksionin e këtyre mendimeve, atëherë mund të përgjigjem se këto mendime nuk kanë vetëm një kuptim dhe vetëm një funksion: ndoshta kuptimi dhe funksioni i tyre i vërtetë ka të bëjë me shpjegimin (shpalosjen) e tyre.

Gj. Sh.  
Beograd, 1976

*“Me grepin më të mirë sot zë për vete peshqit  
më të çuditshëm njerëzorë.”<sup>16</sup>*

*“Veçanërisht bota njerëzore, deti njerëzor – pikërisht këtu e  
hedh grepin tim të artë dhe them: hapu greminë njerëzore.”*

Nietzsche,  
*Kështu foli Zarathustra*

<sup>16</sup> Nietzsche, *Tako je govorio Zarathustra*, Mladost, Zagreb, 1975, f. 116.

## HYRJE

*“Është koha për gjah. Në fakt jo për gjah të egër,  
por për gjah të butë, të kultivuar; për gjah të fshehur,  
për gjah mbi ata që përkulin shpirtin.”*

Nietzsche

Të gjithë ne mundohemi që të bindim dikë, sepse të gjithë jemi të bindur për diçka dhe duam që dikush tjetër të pranojë bindjet tona. Të bindurit, si formë raportesh shoqërore nuk mund të anashkalohej, sepse të bindurit është pjesë e përvojës sonë të përditshme, qoftë kur përpiqemi të ndikojmë mbi qëndrimet e të tjerëve, qoftë kur tjerët përpiqen të ndikojnë mbi qëndrimet tona.

Bindja është e vjetër sa vetë njeriu, por jo çdo njeri ka pasur mundësi që t'i bindë të tjerët për atë që ai beson apo nuk beson. Nuk është fjala për çështjen se jo çdo njeri ka pasur apo ka fuqi *personale* që të bindë dikë, por për faktin se fuqia e të bindurit, në radhë të parë varet nga *pozicioni* në strukturën shoqërore, *qasja* te informacioni dhe te *mjetet* teknike për bindje masive.

Pandehet se individët apo grupet që gëzojnë një pozitë të privilegjuar në organizimin shoqëror, të cilët kanë qasje te informacioni dhe te mjetet e përgjithshme të komunikimit, si dhe të cilët i njohin teknikat e bindjes, *mund të bindin cilindo të mendojë dhe të veprojë çfarëdo qoftë.* “The time has come when if you give me any normal human being and couple of weeks, I can change his behavior from what is now to whatever you want it to be, if it's physically possib-

le. I can't make him fly by flapping his wings, but I can turn him from a Christian into a Communist and vice versa."<sup>17</sup>

Ekzistojnë mendimtarë që mendojnë se në rrethanat e manipulimit të përgjithshëm nuk mund të flitet fare për ekzistencën e opinionit publik, në veçanti të opinionit kritik. "Shumica pohojnë se ajo që e hidhëron më shumë njeriun është fakti se ai beson se janë mendimet që ai përfaqëson lirshëm të cilat i ka pranuar ose përzgjedhur, për aq sa mendimet ekzistenciale janë të përcaktuara për të siç është përcaktuar ngjyra e flokëve apo aroma e frymës."<sup>18</sup> "Sot askush nuk ka mendjen e vet. Sot ka shumë pak mendje personale."<sup>19</sup>

Marcuse dhe Sartre mendojnë se atë që ne e quajmë *zgjedhje të lirë* e ka përgatitur dikush tjetër për ne. Ne nuk veprojmë konform natyrës sonë. Natyra jonë parësore është ajo natyrë që ne e kemi pasur para se mediat masive ta modifikojnë atë bazë.<sup>20</sup> Autori ynë, Rudi Supek, gjithashtu tërheq vërejtjen: "Sa është e mundur që një njeri të ketë bindjen e tij vetjake në një shoqëri që për çdo ditë, pafundësisht, është e ekspozuar para veprimit të mjeteve bashkëkohore të komunikimit masiv, mjete këto që ndodhen nën kontrollin e një pakice shoqërore, të një grupi monopolist?"<sup>21</sup>

Prej këtyre bindjeve, natyrisht që ekzistojnë fakte të caktuara që u japin atyre fuqi dëshmuese.

Si është e mundur që njerëzit që reklamojnë disa gjëra të parëndësishme, të padobishme, të nxisin nevojën masive për to?

<sup>17</sup> Deklaratë e James McConnelit, e cituar sipas: M. Karlins and H. I. Abelson, *Persuasion*, How Opinions and Attitudes are Changed, Springer Publishing Company, Inc., New York, 1970, p. 1.

<sup>18</sup> Gide, *Kovači lažnog novca*, Prosveta, Beograd, 1961, fq. 398.

<sup>19</sup> Dostojevski, *Zli dusi II*, Rad, Beograd, 1967, f. 85.

<sup>20</sup> I pari në *Čovek jedne dimenzije*, i dyti në *Davo i gospod bog*.

<sup>21</sup> R. Supek, "Masovne komunikacije i propaganda", në *Socialna psihologija*, Rad, Beograd, 1972, f. 284.

Si është e mundur që politikani demagog ta bindë turmën që të pranojë si të vërtetë atë që më parë e ka deklaruar si të pavërtetë, dhe si të pavërtetë atë që më përpara e ka pranuar si të vërtetë?

Si është e mundur që mësuesit (duke përfshirë këtu edhe mediat masive) i edukojnë dhe arsimojnë brezat që të mendojnë si mësuesit e tyre, dhe nuk e ndjejnë nevojën për modele të tjera të të menduarit?

Si është e mundur që “drejtorët e uzinave të ëndrrave” të nxisin konsumin masiv të atyre zbulimeve që s’kanë asnjë vlerë kulturore?

Si është e mundur që prifti arrin t’i bindë njerëzit (shpirtërisht të shëndoshë) që të braktisin besimin te Zoti që e kanë pasur gjatë gjithë jetës, dhe të besojnë tek një Zot që ka qenë i panjohur dhe i huaj për ta?<sup>22</sup>

Në të gjitha rastet nuk bëhet fjalë për çështjen se me kalinim e kohës njerëzit kanë më shumë përvojë dhe kuptojnë më thellë, dhe dalëngadalë ndryshojnë edhe *Weltanschauung*-un tyre, por për braktisjen e ndjenjave, bindjeve, qëndrimeve dhe sjelljeve për të cilat kanë qenë në gjendje të japin edhe jetën, dhe adoptimin e një këndvështrimi të ri, i cili është i ndryshëm, madje edhe kundërthënës me të parin. Në të gjitha këto raste, në veçanti me manipulimin e shkahthtë të simboleve, domethënë pa përdorimin e mjeteve mekanike dhe fiziologjike, – stimulimi elektrik i trurit, serumi i së vërtetës, alkooli, duhani, hashashi, LSD, heroina, kofeina,

<sup>22</sup> Mund të thuhet edhe më tepër: si është e mundur që psikanalisti të bindë pacientin se të gjitha neurozat e tij janë shkaktuar nga urrejtja që ka për të atin, ndërkohë që ai ishte i bindur se i ati ishte njeriu më i dashur në botë për të? Si është e mundur që hetuesi, pa përdorur dhunë, e shtyn të akuzuarin që të pranojë atë që nuk ka bërë? Më gjerë në këtë kontekst, shih: William Sargant, *Battle for the Mind*, Pan Books LTD, London, 1959.

kokaina, morfiumi, mjetet për komandimin apo dëbimin e ëndrrave, mjetet për qetësim apo ngritje të adrenalines/për zbutjen e ndjenjave të pakëndshme, mjetet dehëse dhe kërpuhda meksikane, hipnoza dhe përzierjet e ndryshme kimike – arrihet që në vetëdijen apo nënvetëdijen e njerëzve të futen ide të cilat dalëngadalë ose shpejt i shtyjnë ata drejt asaj rruge të cilën nuk e kanë pasur qëllim. Sikur të mos ekzistonte ndikimi i sajuar, ata nuk do i hynin kurrë kësaj rruge.

Nuk e di a është e nevojshme të pohoj se nuk është i vogël numri i atyre që pandehin se të bindurit është një përpjekje e kotë dhe se nëpërmjet teknikave të bindjes mund të arrihet vetëm efekti, saqë individët dhe grupet i forcojnë edhe më shumë qëndrimet që tashmë kanë marrë, dhe se është e vështirë të flitet për një ndryshim radikal qëndrimesh.<sup>23</sup>

Bindjet për forcën e të bindurit, siç e shohim, bëjnë një trajektore nga gjithëfuqia drejt pafuqisë; që do të thotë se kur është fjala për manipulimin e simboleve, para se gjithash jemi të gjykuar paraprakisht që t'i japim përparësi bindjeve karshi njohurive. Bindjet për fuqinë dhe pafuqinë e manipulimit kanë arritur të mashtrojnë shpirta që nuk e kanë shprehjen, ose nuk e ndjejnë nevojën që të kërkojnë dëshmi të vërteta, por mjaftohen me mendime mashtruese që, për fat të keq, shlyhen me shumë vështirësi, pavarësisht se faktet flasin kundër këtyre mendimeve. Do i lejojmë të dy palët – ajo që beson te gjithëfuqia dhe ajo që është e bindur mbi pafuqinë e manipulimit – të kenë të drejtë, derisa të dëshmohet e kundërta.

<sup>23</sup> Me këtë pajtohen gati të gjithë studiuesit, dhe gati të gjithë eksperimentet për paragjykimet vërtetojnë pikërisht këtë. Është i vështirë ndryshimi i paragjykimëve. "Kush mund ta rrënojë me arsye atë që turma e ka besuar pa arsye?" (Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, Mladost, Zagreb, 1975, f. 268)

## Format e kontrollit mbi sjelljet ose pse manipulimi?

Çdo shoqëri ka mjetet (metodat) me anë të të cilave “fut në brazdë” anëtarët e saj atëherë kur ata e rrezikojnë “rendin dhe paqen” ekzistuese.

Mjeti i parë është dhuna e vrazhdë fizike ose forca e detyrimit. Kontrolli i sjelljes përmes përdorimit të forcës fizike nuk është efikas, “sepse nëse e thyni njeriun duke e munduar, ai do t’ju urrejë përgjithmonë”, dhe do përpiqet të ndryshojë gjendjen e vet duke mos bërë llogari se ç’mjete do përdorë dhe nuk do mbajë përgjegjësi për atë që do bëjë. Krahas kësaj, ai që ushtron dhunë (detyrim), ndjen gjithnjë frikë prej atij mbi të cilin ushtrohet dhunë. “Burgu nuk është asgjë. Burgu krijon vetëm urrejtje. Këtë duhej të kuptonin të gjithë armiqtë tanë.”<sup>24</sup> “Nëse do të ishte e mundur që egërsirën e fjetur te njeriu ta ndaloni duke e burgosur apo me dënim në botën tjetër, gjithsesi unë mendoj se emblema më e lartë e njerëzimit do të ishte cirku zbutës me shkopin goditës, e jo predikuesi që viktimizohet. Por, e vërteta na tregon se nuk qe dhuna që e ngriti njeriun mbi kafshët, por muzika dhe e vërteta e papërballueshme, atraktiviteti i modelit të saj. Mendohet se deri më sot, porositë më të rëndësishme në Ungjill janë ato që janë përfshirë te urdhëresat. Për mua është më e rëndësishme që Krishti flet prej rrëfimeve nga jeta, duke e ndriçuar të vërtetën me rastet e përditshmërisë. Në bazën e këtij veprimi mbështetet mendimi se familjarizimi midis të vdekurve është i pavdekshëm dhe se *jeta është simbolike, sepse është e rëndësishme.*<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Hemingway, *Za kim zvono zvoni*, Matica srpska, Novi Sad, 1967, f. 52.

<sup>25</sup> Pasternak, *Doktor Živago*, I, Prosveta, Beograd, 1975, f. 76. “Më së shumti duhet të mbështetemi mbi të vërtetën, që ndaj metodave të dhunës, në bazë të vetë natyrës, nuk mund të arrihet asgjë.” (Lenjin, *Izabrana dela*, vëll. 13, Kultura, Beograd,

Prej kohësh dihet se fuqia e shpërblimit (për një sjellje të caktuar) është më efikase se sa fuqia e dënimit. Sociologu më i shkëlqyer midis shkrimtarëve dhe shkrimtari më i shkëlqyer midis sociologëve, Balzaku, shkruan: “Çdo pushtet përpiqet të rrojë sa më gjatë. Që qeveritë të rrojnë, sot, ashtu si dikur, duhet të pranojnë në vallen e tyre njerëzit e fuqishëm, duke i marrë ata kudo që ndodhen, me qëllimin që të krijojnë mbrojtës dhe me anë të tyre t’u rrëmbejnë turmave ndjenjat dhe guximin për t’u revoltuar... Shteti i përshpejton revolucionet.”<sup>26</sup> Ai që është shpërblyer, ndjen mirënjohje ndaj atij që e ka shpërblyer; ai ndjen përgjegjësi që në të ardhmen, sjellja e tij afatgjatë të kënaqë pritshmërinë dhe përkushtimin e shpërblyesit.

Mjeti i tretë i fuqishëm me anë të të cilit kontrollohet sjellja e pjesëtarëve të shoqërisë, janë *normat shoqërore*, qoftë në formën e ligjit (normat juridike), qoftë në forma morale (imperativët moralë), qoftë urdhëresat fetare (dhjetë urdhëresat) apo udhëzimet ideologjike, ose thjesht normat zakonore. Për aq sa norma zakonore, morale, juridike, religjioze apo ideologjike është karakteristikë e grupit dhe për aq sa anëtarët e grupi i përmbahen asaj, e vlerësojnë dhe e përjetojnë atë si të tyren, ajo shërben si mënyrë e prituri, madje edhe si një mënyrë ideale sjelljeje për të gjithë anëtarët e grupit (shoqërisë). Normat juridike, morale dhe religjioze, ndërkombëtarizohen bashkë me kohën. Kjo do të thotë që sjellja me kohë bëhet e pavarur prej pranisë së drejtpërdrejtë të autoritetit të normave ose individit, të cilët kontrollojnë nënshtrimin ndaj normave. *Përbrendësimi* i kontrollit nuk do të thotë zhbërje e kontrollit, por transferim i tij nga rre-

1960, f. 120) “Ne nuk dëshirojmë vetëm një: elementin e detyrimit. Ne nuk duam që në parajsë të shtyhem nga dhuna.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 313)

<sup>26</sup> Balzac, *Slike iz seoskog života*, O. Keršovani, Rijeka, 1961, f. 503.

thanat e jashtme në brendësinë e vetëdijes, ku kontrolli tashmë është më pak i dukshëm, por jo më pak efikas. Por, pjesa dërrmuese mbetet e vetëdijshme për fuqinë represive të normës.

Historia politike dhe ushtarake është plot me shembuj të fuqisë karizmatike. Kjo është fuqia që ka një personalitet i veçantë mbi turmën, pavarësisht faktit se a ka veti prijësi apo turma beson se ai i ka ato. Kjo fuqi mbështetet te frika irracionale e respektit dhe besimit të pagabueshmëria e prijësit. “Autoriteti karizmatik është një nga fuqitë e mëdha revolucionare të historisë, por në formën e pastër ai ka një karakter plotësisht autoritar dhe zotërues.”<sup>27</sup>

Për ne ka një rëndësi të veçantë fuqia mbi mendimin apo teknika e sundimit me anë të përdorimit të simbolit (idesë). Përpjekja që sjelljet e individit apo të grupit të kontrollohen përmes manipulimit të shkathët me anë të simboleve (ideve), shënon një kthesë për metodat e sundimit, ngaqë *metodat e vrazhdëta të detyrimit zëvendësohen me teknikat e buta të bindjes*. “Heq dorë nga sundimi i trupave tuaj për të sunduar shpirtat tuaj.”<sup>28</sup> Nuk ka gjë më të marrë se ngadhënjimi Lavdia e vërtetë është të bindësh.”<sup>29</sup> “Sepse pushteti dhe mbikëqyrja është në fjalë, jo në duar. Ke diçka për të thënë apo për të dhënë, ndonjë vërejtje për mendimet e mia?”<sup>30</sup>

Ajo që e dallon manipulimin prej metodave të njohura historike të kontrollit të sjelljeve është: a. manipulimi është “bindje pa dhimbje”, për të cilën njerëzit nuk janë të vetëdijshëm, sepse nuk e ndjejnë detyrimin; b. manipulimi mbë-

<sup>27</sup> Weber për pushtetin karizmatik, më gjerësisht: Djurić, *Sociologija Maxa Webera*, Matica Hrvatska, Zagreb, 1964, f. 238.

<sup>28</sup> Sartre, *Djavo i gopsod bog*, Prosveta, Beograd, 1966, f. 154.

<sup>29</sup> Igo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 81.

<sup>30</sup> Mann, *Legenda o Josipu*, I, O. Kersovani, Rijeka, 1960, f. 106.

shtetet te studimi shkencor i njeriut; c. janë zgjeruar dimensionet e sundimit (mediat masive); d. varësia e individit nga organizatat e fuqishme dhe nga institucionet që kanë monopolin e informacionit është e frikshme; e. ndarje e punës dhe specializimi i pengon individët që të arrijnë të kuptojnë atë që po ndodh me shoqërinë civile, prandaj janë të detyruar që këtë pamje të shoqërisë ta marrin prej atyre që ua ofrojnë këtë pamje; f. manipulimi nuk është një formë e institucionalizuar e sundimit – prandaj dhe ai që e ka këtë fuqi nuk duhet të thotë se si do e përdorë, kur dhe për ç’qëllim. Kështu që, për qytetarët, qëllimi i vërtetë mbetet i panjohur.

Vështrimi fluturimthi i llojeve të kontrollit social, tregon se format e kontrollit po ndryshojnë. Këto i vënë në punë grupet e fuqishme të interesit në shoqëri, por kontrollet nuk vdesin. Kontrolli bëhet më pak i dukshëm, por jo më pak i fuqishëm.

### **Simbolet (idetë) janë armë**

Çdo lloj cytjeje që vjen prej mjedisit natyror dhe social, qenia njerëzore i përgjigjet me ndryshime në funksionimin fiziologjik (ndryshimet në frymëmarrje, në tensionin e gjakut, të rrahurat e zemrës, tendosja e muskujve etj.), me regjistrim ndjenjash (dhimbje, gëzim, frikë, pikëllim), me interpretimin njohës (tezat, hipotezat, teoritë, filozofia) dhe jep vlerësime (e mirë, e moralshme, e pamoralshme, e bukur, e shëmtuar, e këndshme etj.).

Nuk ka arsye që ndaj simboleve (ideve), ashtu si ndaj cytjeve specifike që vijnë prej mjedisit kulturor, qeniet njerëzore të mos reagojnë në mënyrë identike. “Në këtë pikë shqyrtimet do thonë se njeriu jeton në botën e fjalës si objekt, ashtu siç jeton në botën e sendeve si objekte. Individit

që dëgjon një orator apo lexon një libër është thelluar në të njëjtën mënyrë në një botë të krijuar prej fjalëve dhe fjalive, ashtu si në botën reale, e krijuar prej ndenjësive, tavolinave dhe trotuareve.<sup>31</sup> “Mos vallë normat që mbretërojnë në një familje, të cilat mund të kuptohen vetëm përmes interpretimit, nuk janë në të njëjtën mënyrë pjesë e mjedisit, ashtu si orenditë shtëpiake apo peizazhi?”<sup>32</sup>

Një supozim shkencor thotë se qëndrimet e individit dhe grupeve ruajnë një lidhje të fortë – simbolike, strukturore, funksionale – me rrethanat e jashtme, dhe është e nevojshme që këto të fundit të ndryshohen, nëse synohet ndryshimi i këtyre qëndrimeve. Nëse ndryshimi i qëndrimeve mund të pritët vetëm si pasojë e ndryshimeve të rrethanave të jashtme<sup>33</sup>, nuk shosh arsye se pse një organizim i ri i simboleve (parastrukturim) të vlerësohet si ndryshim i jashtëm, që sipas logjikës së shëndoshë, do të ketë ndikim të fortë në qëndrimet e vjetra.

Njeriu i kohës sonë jeton në kohën e simboleve dhe mund të themi se jeta e tij varet nga interpretimi i këtyre simboleve. *Simbolet janë mjedisi i vërtetë jetësor i tij.* Duke qenë se simboli shënon diçka konkrete (dukuri, marrëdhënie, situatë) – ndërkaq njerëzit kanë përvojë me këto gjëra, që janë të ruajtura te këto simbole – madje edhe atëherë kur nuk mungon vetë objekti, qenia njerëzore reagon nga simboli, që në këtë rast zëvendëson objektin dhe ky reagim bëhet si-

<sup>31</sup> D. Kreč, R. S. Kračfeld, I. L. Balaki, *Pojedinac u društvu*, Udžbenik socialne psihologije, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Srbije, Beograd, 1968, f. 36.

<sup>32</sup> K. Manhajm, *Ideologija i utopija*, Nolit, Beograd 1968, f. 36

<sup>33</sup> “There are many varieties of “behavior modification” and many different formulation, but they all agree on the essential point: behavior can be changed by changing the condition of which it is a function.” (B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 150)

kur ai të ndodhej aty.<sup>34</sup> Prandaj, me një drejtim të shkathët të simboleve (ideve) arrihet i njëjti ndryshim (në ndjenja, qëndrime dhe sjellje) që arrihet me ndryshimin e rrethana-ve natyrore dhe sociale.

Tani përballemi me çështjen e pritur: ti analizon manipulimin e njerëzve përmes manipulimit të ideve (simboleve), ndërsa ne dimë se sipas Marx-it nuk janë idetë fuqitë lëvizëse të historisë, por revolucionet. Mos ndoshta po u jep ideve atë fuqi që sipas Marx-it nuk e kanë? Pra, a nuk po i përshkruhet manipulimit fuqia me idetë, që në të vërtetë nuk e ka?

Pavarësisht faktit se klasikët e marksizmit kanë shkruar për rolin, fuqinë dhe pamundësinë e ideve në histori<sup>35</sup>, sot është e nevojshme që të paraqiten disa fakte në lidhje me fuqinë e ideve (simboleve) në formimin e mendimeve, bindjeve dhe sjelljeve të njerëzve.

Sot, edhe ekonomistët, të cilët qëndrojnë më afër qëndrimit të determinizmit ekonomik, e pranojnë se idetë shkencore luajnë një rol vendimtar në prodhimin e punës – dy të tretat e produktivitetit varen prej zbatimit të ideve shkencore në prodhim. Më tej, burimet e pasurisë së një shoqërie nuk duhen kërkuar te dhuntitë e natyrës apo të rastit, te

<sup>34</sup> Për aq sa mjedisi njerëzor vjen duke u bërë simbolik, – në kuptimin që njeriu të jetë i rrethuar prej simboleve – largimi prej vetë gjërave është po aq i madh dhe përvoja e drejtpërdrejtë zëvendësohet me mësimin e simboleve.

<sup>35</sup> Në studimet klasike të marksizmit, fare rrallë hasim qëndrime të ndryshme për sa i përket rolit dhe fuqisë së ideve në zhvillimin historik të shoqërisë. Marx-i shkruan: "Arma e kritikës, gjithsesi nuk mund ta ndërrojë kritikën e armës; forca materiale duhet justifikuar me forcën materiale, por vetë teoria shndërrohet në forcë materiale kur përfshin të gjitha masat." (*Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 80) Në një vend tjetër shprehet kështu: "Këtu, sikurse në përgjithësi tek ideologët, duhet parë se ata i vendosin medoemos sendet në kokë dhe e vlerësojnë ideologjinë e tyre si një fuqi krijuese, si dhe si qëllimi i të gjitha raporteve njerëzore, ndërkohë që ajo është vetëm shprehje dhe simptomë." (*Nemačka ideologija*, II, Kultura, Beograd, 1964, f. 147)

numri i banorëve, te madhësia e fuqisë punëtore apo te sasia e kapitalit të investuar, por ekskluzivisht te fryma njerëzore dhe te aftësia e shndërrimit të ideve të reja në formë materiale. “Dija është pushtet.”

Madje edhe ata që e kundërshtojnë fuqinë e ideve në modelimin e ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve, janë të detyruar që t’u njohin ideve fuqinë e madhe në atë çast kur i kontrollojnë, censurojnë apo i ndalojnë ato me të gjitha mjetet. Fakti se çdo qeveri i kontrollon apo përpiqet t’i kontrollojë mjetet e komunikimit masiv, siç kontrollon fuqinë ushtarake, në fakt është pranim se tek ato mjete është forca e re, sepse përmes tyre mund të përhapen ide, mund të ndikohet mbi ndjenjat, bindjet dhe sjelljet reale të masave. Nëse marksistët nuk do ta pranonin rolin parësor të ideve në zhvillimin historik të shoqërisë, atëherë ata duhej ta hidhnin poshtë edhe rolin e socializmit si ide me të cilën jeton gjysma e botës, ndërkaq gjysma tjetër e kërkon këtë sistem. “Në fillim socializmi luftonte për ekzistencë, e në anën tjetër i qëndronte borgjezia që besonte te forcat e veta, që mbronte liberalizmin me guxim dhe përpikëri, si sistem të tërë të kuptimit ekonomik dhe politik. Socializmi ia doli. Tashmë, në mbarë botën e civilizuar, ai ka mbrojtur të drejtën e vet për të ekzistuar. Tani ai po lufton për pushtet...”<sup>36</sup>

### **Njohuritë shkencore dhe manipulimi**

Te rasti i manipulimit shihet qartë detyra e vërtetë e shkencës: detyra e shkencës është që të arrijë te njohuritë për sjelljen njerëzore, duke studiuar rrethanat e ndryshme (natyrore, sociale dhe kulturore), e jo të manipulojë njerëzit.

<sup>36</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 41.

Fakti që këto të dhëna shfrytëzohen edhe për qëllime të tjera nuk është karakteristik vetëm për njohuritë që sjell shkenca mbi njeriun. Është për t'u habitur që njohuritë që janë të dedikuara për të çliruar njeriun, shfrytëzohen për robërimin e tij. Por, fatmirësisht këto njohuri, të cilat i japin mundësi manipuluesit që të ndikojë te sjelljet tona, na lejojnë edhe ne që t'i kundërvihemi manipulimit, me kushtin që t'i përvetësojmë këto njohuri dhe të zhvillojmë fuqinë kritike.<sup>37</sup>

Njohuritë e dala nga ky studim, i cili mbështetet te dijet e një lënde të vëllimshme, të fituara prej hulumtimeve në fushën e psikologjisë sociale, të mediave masive, nga kërkimi sociologjik i funksionimit të ideve (simboleve) në jetën sociale, te analiza psiko-analitike në strukturën e përjetimeve në vetëdije/nënvetëdije, te analiza teorike – letrare dhe, nëse më lejohet, duke u mbështetur te përvojat personale dhe në vështrimin sistematik – do të jenë në interes të nxënësve, studentëve dhe mësimeve të tyre, të cilët dëshirojnë të njihen me tezat teorike/metodologjike dhe me njohuritë shkencore mbi të cilat mbështetet manipulimi, në interes të politikanëve dhe demagogëve të çdo tipi që t'i freskojnë dhe t'i avancojnë përvojat në këtë punë të pandershme të tyre dhe, të lexuesve kureshtarë, të cilët kanë akoma vullnet, që ta ruajnë pavarësinë e tyre dhe lirinë e përzgjedhjes.

Në fund ndjej nevojën të theksoj se si te mjetet e informimit, në mënyrë sensacionale tërhiqet vëmendja nga rreziku mbi përdorimin dhe drejtimin e mjeteve mekanike dhe kimike (demagogjia në epruvetë). Nëse mendojmë më mirë, të gjitha këto lloje të kontrollit të sjelljes kërkojnë qasje individuale ose grupore, dhe nuk ka gjasa që asnjë prej këtyre llojeve të kontrollit të zbatohet në përmasa masive. Ai që

<sup>37</sup> Krahaso M. Karlins, *Persuasion*, p. 143.

zbatohet në përmasa masive është pikërisht manipulimi i turmave nëpërmjet drejtimit të shkathët të simboleve (ideve) – dhe që në fakt fshihet prej opinionit dhe mënjanohet, që gjithsesi është vetëm pjesë e veprimit manipulues të atyre që kontrollojnë simbolet (idetë) që emetohen nëpërmes këtyre mjeteve të informimit (kësaj here lexo: manipulimit masiv). “Sot, manipulimi i trurit bëhet në mënyrë masive, pa energji elektrike dhe kimikate pastruese, pa mundime. Kështu që, askush deri më tani nuk e ka pastruar trurin në këtë mënyrë kaq fine.”<sup>38</sup>

<sup>38</sup>Erwin Lausch, *Manipulacija mozgom*, Stvarnost, Zagreb, 1976, f. 236-245. Në përgjithësi libri i dedikohet analizës së pasojave që shkakton zbatimi i mjeteve elektrike, mekanike dhe kimike në punën dhe funksionimin e trurit. “Sot, për gjendjen dhe funksionimin e pjesëve të trurit, dihet aq shumë, sa që me një orientim të caktuar të goditjeve të energjisë elektrike mund të arrihet që njeriu të lëvizë siç lëvizin kukullat e dirigjuara. Përmes një hapjeje të vogël në një pjesë të caktuar të trurit futen elektroda të holla sa fija e flokut, madje mund të mbillen edhe nën lëkurën e kokës. Goditjet me energji elektrike jo vetëm që nxisin lëvizjet motorike të trupit, por edhe ndjenja si frika, agresiviteti, gëzimi etj. Kjo teknikë, me anë të përforcimit kompjuterik mund të përsoset edhe më shumë. Tanimë ajo përdoret edhe në shumë klinika për shërimin e epilepsisë dhe të të sëmurëve psikikë.” (P. Andress dhe C. Kilian, *Fantasticna naučna istraživanja*, Parapsihologija: Izmedju nemogućeg i nauke, Stvarnost, Zagreb, 1974, f. 26)



**PJESA E PARË**  
**Shprehjet, supozimet, njohuritë**



## VËREJTJET METODOLOGJIKE

*“Në kufijtë e çdo disipline në fushën e shkencave shoqërore,  
lënda shkapërderdhet.”*

Habermas

### Origjina e fjalës

Njerëzit e kanë manipuluar njëri-tjetrin që prej kohëve të lashta<sup>39</sup>, por shkenca mbi manipulimin fillon në shekullin tonë. Madje edhe shprehja *manipulim* në gjuhën shkencore paraqitet vetëm në vitet gjashtëdhjetë, dhe në mënyrë sistematike nis të përdoret në vitet shtatëdhjetë.

Vetë fjala *manipulim* është një farkëtim i ri latin: *manus* – “dora”, *pulare* – “lëmoj”, ta kalosh dorën përmbi, të përmirësosh, të kurdisësh, të prekësh. Në kuptimin origjinal, manipulimi kishte të bënte me përpunimin e një objekti të caktuar përmes shfrytëzimit të shkathët të duarve. Ai i cili ishte veçanërisht i shkathët dhe i shpejtë në këtë përpunim teknik quhej manipulues, ose operator.

Më vonë fjala është zhvilluar në atë mënyrë sa nis të tregojë një lëvizje të kujdesshme, të shkathët (sot do thoshin lëvizje profesionale), manipulim apo administrim të gjërave ose njerëzve, me qëllim përmbushjen e një qëllimi të përbashkët. Kjo shprehje nuk shkakton akoma ndonjë mendim

<sup>39</sup> Për teknikën e manipulimit mund të mësojmë nga leximi i librave antikë të retorikës, e deri testudimet e reja që i kushtohen bindjes së turmave. (Shih: *Brockhaus Enzyklopadie, zwolfter Band*, F. A. Brockhaus, Wiesbaden. 1971, S. 90) Në Besëlidhjen e Re lexojmë: “Dhe Jezui iu tha: Ejani pas meje dhe do t’iu bëj gjahtarë njerëzorë.” (*Ungjilli sipas Markut*, kap I, parag. 17)

që manipulimi apo administrimi është një punë e pander-shme, që nuk sjell dobi, një punë jo e mirë.

Nocioni *manipulim* sot është ngarkuar me shtresa negative semantike, dhe zakonisht përcakton marrëdhëniet midis njerëzve, me ç'rast një palë ndikon mbi palën tjetër, me qëllim arritjen e një interesi të caktuar vetjak apo grupor (si, p. sh., kur një udhëheqës politik manipulon zgjedhësit). Kështu, në fjalorin e Webster-it lexojmë se të manipulosh, përveç të tjerash, nënkupton të ndryshosh apo shtrembë-rosh (numrat, llogaritë etj.) për qëllime vetjake; përfitim, mashtrim, trillim, dredhi<sup>40</sup> etj.

### Shprehjet e ngjashme

Nuk e di se ku do më shpjerë përpjekja kur të kemi vi-zatuar kufijtë e qartë midis nocionit të manipulimit dhe të gjitha shprehjeve të ngjashme, sepse në gjuhën e përditsh-me, por edhe në një gjuhë shkencore, hasim një shumësi shprehjesh, përmbajtja e të cilave pak a shumë ndeshet, ndërthuret dhe puqet me përmbajtjen dhe gjerësinë e mani-pulimit. Ja një listë me terma të ngjashëm që është jo e plo-të: socializimi, ideologjizimi, propaganda (ekonomike dhe politike), indoktrinimi, industria e vetëdijes, predikimi, bin-dja, ndikimi, sugjerimi, modelimi i shpirtave njerëzorë, fu-qia pa dhunë, dhuna pa fuqi, kontrolli i mendimeve, operi-mi i shpirtit, shpëlarja e trurit, popullimi i kokës, pushtim i vetëdijes, dhunë shpirtërore, dajaku më i ri ideor, dora e fshehtë etj. Madje përmenden edhe institucionet që i usht-rojnë këto: qendrat për reformën e ndërgjegjes, spitalet për

<sup>40</sup> *Webster's New World Dictionary*, The World Publishing Company, Cleveland and New York, 1962, p. 893.

reforma ideologjike, shtëpitë për të menduar, vendpastrimet ideologjike, ministritë e së vërtetës e kështu me radhë.

Ata individë që manipulojnë me sukses quhen bindës të fshehur, propagandues, indoktrinues, agjitorë, pushtues të vetëdijes, heronj të mendimit të rremë, arkitektë të ndërgegjes moderne, profesorë të bindjes, peshkatarë të shpirt-rave njerëzorë.

Për të mbërritur deri te shprehja e qartë dhe empirike e manipulimit, duhet gjetur pak hapësirë, të paktën për analizën e atyre shprehjeve që hasen më së shumti: socializimi, ideologjizimi, propaganda, indoktrinimi, industria e vetëdijes, predikimi...

### **Socializimi dhe manipulimi**

Të jesh i vetëdijshëm për dallimet mes këtyre dy formave të fuqishme të komunikimit, – përcjelljes së kuptimit nëpërmjet simboleve – përgjithësisht nënkupton të jesh në gjendje t'i rezistosh manipulimit. Këtu do ofroj disa “shenja njohjeje”, duke pasur parasysh metodat, përmbajtjet, qëllimet, motivet dhe pasojat, për të paralajmëruar se dallimi midis socializimit dhe manipulimit nuk është dallim në shkallë, por është më shumë dallim në lloj/tip.

Ai që socializon shfaqet për të mësuar të tjerët se si mund të mendojnë (besojnë, vlerësojnë, bëjnë). Ndërsa ai që manipulon përpiqet t'i shtyjë të tjerët të mendojnë ashtu siç mendon (beson, vlerëson, bën) ai:

- ai që socializon ofron qëndrimet (aksiomat, faktet) për të cilat ekziston një ujdë e përbashkët; ai që manipulon, ka gjithnjë përpara diçka për të cilën nuk ekziston ujdë e gjithëmbarshme (ai tani dëshiron ta krijojë këtë);

- ai që socializon paraqet alternativat; ai që manipulon përpiqet që t'i eliminojë alternativat;

- ai që socializon i mëson të tjerët të dyshojnë edhe tek ato gjëra që atyre u duken të padyshimta; ai që manipulon i shtyn të tjerët që të mos dyshojnë te ato gjëra që janë të dyshimta;

- ai që socializon përdor të dhëna të verifikuara; ai që manipulon i keqpërdor të gjitha të dhënat (prandaj nuk bëhet fjalë për mungesë evidence);

- ai që socializon gjykon me arsye; ai që manipulon gjykon pa arsye;<sup>41</sup>

- ai që socializon ndërton autoritetin racional; ai që manipulon imponon autoritetet irracional<sup>42</sup>;

- ai që socializon nuk përcakton se çfarë do mendojnë të tjerët për një gjë të caktuar; ai që manipulon i shtyn të tjerët të mendojnë ashtu siç ai dëshiron që ata të mendojnë;

- ai që socializon, ofron ide; ai që manipulon, imponon ideologjinë;

- ai që socializon, mund të përhapë të pavërteta në mënyrë të pavetëdijshme; ai që manipulon me vetëdije përhap gënjeshtër ose gjysmë të vërteta;

- ai që socializon përcjell te të tjerët njohuri të reja; ai që manipulon rrënjos bindje te të tjerët;

- ai që socializon hyn në një marrëdhënie mësimi reciprok; ai që manipulon krijon raportin i fortë-i dobët;

<sup>41</sup> "Të theksosh padurimin vetjak si argument teorik!" (F. Engels, sipas: Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 13, Kultura, Beograd, 1960, f. 452)

<sup>42</sup> Për këtë dallim të rëndësishëm shih: Erih From, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 109 dhe më tej: "...ka sqaruar një mënyrë të sigurt që njeriu të mos mashtrohet kurrë, dhe kjo mënyrë përbëhet prej faktit se ai duhet të heqë dorë përgjithnjë nga gjykimi sipas vetes, të mbështetet vazhdimisht te gjykimi i kujdestarëve të tij." (Žid, *Kovači lažnog novca*, Prosveta, Beograd, 1961, f. 346)

- ai që socializon ofron të vërtetën si mesazh; ai që manipulon e ofron mesazhin e tij si të vërtetë;

qëllimi i atij që socializon është që të tjerët të mësojnë gjëra të rëndësishme në lidhje me diçka; qëllimi i tij që manipulon është t'i shtyjë të tjerët të besojnë se ajo që ai po thotë për një gjë është e rëndësishme për ta, si dhe t'i bëjë të besojnë se është e mirë për ta;<sup>43</sup>

- ai që socializon ka si qëllim që të zgjerojë njohuritë e subjekteve të tij; ai që manipulon e ka të rëndësishme të ngushtojë mundësitë racionale të objekteve të tij;

- ai që socializon dëshiron të zhvillojë ndjenjën, nevojën për liri<sup>44</sup> dhe për dinjitet të personalitetit; për atë që manipulon, liria dhe dinjitetit paraqesin vështirësi të mëdha;<sup>45</sup>

- ai që socializon ka para vetes një qëllim të plotë (formimin e një personaliteti të plotë); ai që manipulon ka para vetes një qëllim të pjesshëm;

- ai që socializon sqaron qëndrimet; ai që manipulon përpiqet t'i forcojë ose t'i ndryshojë qëndrimet ekzistuese;

- ai që socializon zhvillon shijen dhe nevojat e audiençës; ai që manipulon nxit shijet dhe nevojat e turmave;

- ai që socializon zhvillon mundësitë e njerëzve të tjerë; ai që manipulon forcon epërsinë e tij;

- ai që socializon i përgatit njerëzit për të krijuar (realizimi i mundësive të tyre);<sup>46</sup> ai që manipulon i përgatit ata që të jenë konformistë;<sup>47</sup>

<sup>43</sup> "Ndoshta ti mund të më thuash... se pse ai, ashtu lirshëm, derdh shpirtin e tij në veshët e mi. Mundesh?" (Džems Džoj, *Portret umetnika u mladosti*, Rad, Beograd, 1964, f. 203)

<sup>44</sup> Shih: Marx - Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 32.

<sup>45</sup> "Freedom and dignity illustrate the difficulty. They are the possessions of the autonomous man of traditional theory, and they are essential to practices in which a person is held responsible for his conduct and given credit for his achievement." (B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 25)

- ai që socializon formon shpirtra të hapur; ai që manipulon formon një vetëdije të mbyllur;
- ai që socializon zhvillon aftësinë për të menduar në mënyrë të pavarur; ai që manipulon i bën njerëzit të varur.

### Ideologjia dhe manipulimi

Ideologjia është një mënyrë të menduari te individët dhe grupet që është e kushtëzuar nga shoqëria, dhe që i përgjigjet një tipi të veçantë shoqëror – shoqërisë klasore (represive). Njerëzit mendojnë sipas mënyrës në të cilën jetojnë – një mënyrë tjetërsuese (klasore).<sup>48</sup> Vetëdija ideologjike është vetëdija e njeriut të tjetërsuar, një vetëdije e shtrembëruar, e vërteta e një bote që është shtrembëruar; vetëdija e vërtetë e një botë të rreme.<sup>49</sup>

Termi *ideologji* këtu nuk po përdoret akoma në kuptimin që ideologjia është mashtrim i vetëdijshëm (gënjeshtër). “Sigurisht që ky mashtrim mund të kuptohet vetëm nëse sqarohet kuptimi i tij klasor. Ky nuk është mashtrim, nuk është “vjedhje” (për ta thënë vrazhdë) – është një ide e rreme që vjen si rezultat i gjendjes ekonomike të klasës.

<sup>46</sup>Të rrallë janë ata mendimtarë (si Fromi, Marcuse, Maslow) që angazhohen që procesi i socializimit, në të njëjtën kohë të jetë edhe proces individualizimi; pra, zhvillim i mundësive të veta, ose siç thotë Maslow, vetërealizim.

<sup>47</sup>Në kuptimin që hasim në gjuhën gjermane për fjalët *dressierten Anpassung* (përshtatje e ushtruar).

<sup>48</sup>Njerëzit do të pushojnë të lëndojnë në mënyrë tjetërsuese (klasore) “atëherë kur sundimi klasor të pushojë së qenuri formë e rregullimit shoqëror, pra atëherë kur nuk është më e nevojshme që interesi i veçantë klasor të paraqitet si interes i përgjithshëm...” (Marks-Engels, *Rani radovi*, po aty, f. 315)

<sup>49</sup>Krahaso Marks-Engels, *Rani radovi*, f. 293: “Për sytë që aftësia e të shikuarit është ndërtuar në rrethanat e tjetërsimit të vërtetë, marrëdhëniet nuk janë bërë ndryshe: gënjeshttrat e spekulimit janë gënjeshttra të vetë kohës, për aq sa spekulimi është i saktë.” (Andrija Krešić, *Humanizam i socijalizam*, (Përmbledhje punimesh), I, Naprijed, Zagreb, 1963. f. 18.)

Borgjezi i imët gjendet në atë gjendje ekonomike, rrethanat jetësore të tij janë të atilla, sa ai nuk mund të mos e mashtrojë veten. Përkundër vullnetit të tij, ai luhatet në mënyrë të pashmangshme herë nga borgjezia e herë nga proletariati... E kaluara e tij e tërheq kah borgjezia, ndërsa e ardhmja kah proletariati.<sup>50</sup>

Duket se W. Stark ka bërë një dallim të mirë midis ideologjisë dhe gënjeshtërs. Ai mendon se që të dyja janë të lidhura me të pavërtetën, por për aq sa ai që gënjen e di mirë të vërtetën, ndërsa ai që mendon ideologjikisht, shpeshherë nuk është i vetëdijshëm se po i mashton të tjerët, madje edhe veten.<sup>51</sup> “Ai që nuk e di të vërtetën nuk mund të gënjejë.” (Miodrag Milenković)

Kur fillon të mashtrojë e të gënjejë me vetëdije ideologjia?

Ideologjitë e ndryshme madje dhe të kundërta janë të domosdoshme në një shoqëri e cila është e çarë në klasa në bazën e saj. Nëse këto ideologji të ndryshme apo ideologji të kundërta nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën në të drejtën e shprehjes dhe jetës publike, mund të themi se ato nuk gënjejnë, dhe se i shprehin dallimet apo ndoshta edhe interesat e kundërta klasore si të vërteta të klasës së tyre vetëm në një mënyrë racionale.<sup>52</sup> Në çastin që një nga këto të vërteta klasore – racionalizimi i interesave të një klase – priret të imponohet si një e vërtetë e vetme e shoqërisë – ideologjia shndërrohet në një mashtrim të ndërgjegjshëm, në gënjeshtëri. Që Marx-it nuk i ka shpëtuar edhe ky kuptim i ideolo-

<sup>50</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. II, f. 46 (nënvizoi Gj. Sh.).

<sup>51</sup> *The Sociology of Knowledge*, London, Routledge and Kegan Paul, 1958.

<sup>52</sup> Prej analizës së vetëdijes ideologjike, del se ideologjia ka një kriter krejtësisht të caktuar të së vërtetës. E vërtetë është gjithçka që i përgjigjet interesit klasor, ndërsa ajo që nuk i përgjigjet këtij interesi nuk është e vërtetë. Ideologjitë janë ide në shërbim të një interesi të kufizuar. Në përgjithësi, pjesëtarët e një klase e pranojnë si të vërtetë çdo ide që plotëson interesat e tyre.

gjisë, dëshmojnë fjalët nga ideologjia gjermane: “...paraqitjet ku interesat e vërteta personale etj. janë formuluar si interesa gjithëpërfshirëse bëjnë pjesë në radhën e frazave që idealizojnë, në radhën e iluzioneve të vetëdijshme, në radhën e dyfytyrësisë së paramenduar.”<sup>53</sup>

Në rastin e parë, roli i gjuhës ideologjike është të shprehë interesin e klasës; në rastin e dytë, të fshehtë interesin e kufizuar klasor, në atë mënyrë që ta paraqesë atë si interes të të gjithë shoqërisë. Në rastin e parë, gjuha është një mjet për komunikim; në rastin e dytë një mjet manipulues.

Duke qenë se interesi i vërtetë i klasës është ai që ajo fsheh, kjo dhe e vërteta në këtë interes nuk është ajo që klasa pohon se është. Kjo e vërtetë është vetëm një koncept (shenjë, simbol) prapa të cilit fshihet një realitet më i thellë. Për të arritur këtë realitet të thellë duhet analizuar koncepti kritik i shprehjes, sepse “të gjitha marrëdhëniet në gjuhë mund të manifestohen si shprehje”.<sup>54</sup> Me analizën e shprehjeve zbërthejmë edhe atë që ka dashur të fshehtë gjuha ideologjike – interesin e vërtetë klasor.<sup>55</sup>

Kur kemi dijeni për dy kuptimet e shprehjes së ideologjisë, ideologjia si fjalë tjetër për vetëdijen klasore dhe ideologjia si një mashtrim i qëllimshëm, atëherë mund të krijoj-

<sup>53</sup>*Nemačka ideologija*, I, Kultura, Beograd, 1964, f. 337 dhe gjithashtu në f. 194, 214 dhe 216 (nënvizoi Gj. Sh.) “Ideologjia është një formë e vetëdijes vlerësuese e cila buron nga pozicioni parcializues i njeriut dhe synon të këtë pozitë që ta justifikojë dhe imponojë si formë të vetme të qenies njerëzore.” (M. Životić, “Problem definisanja ideologije”, *Filozofski pregled*, nr. 3, 1957, f. 56)

<sup>54</sup> *Nemačka ideologija*, f. 72.

<sup>55</sup> Kur vjen puna te ideologjia, atëherë fjala është për

- a) ndonjë klasë shoqërore (grup) që ka
- b) interesin klasor (grupor) dhe e cila kryen
- c) racionalizimin e këtij interesi, dhe këtë racionalizim
- d) e imponon si vetëdije të vetme të vërtetë, dhe kështu
- e) bën interpretimin vlerësues të realitetit (ekskluzivisht në interesin klasor).

më një lidhje midis ideologjisë dhe manipulimit. Kuptimi i parë i fjalës *ideologji* nuk ka kurrfarë lidhjeje me manipulimin; kuptimi i dytë i ideologjisë përputhet me manipulimin në metodë, përmbajtje, qëllime, motive dhe pasoja.

Manipulimi si fjalë, shpeshherë paraqitet – si në gjuhën e përditshme ashtu edhe në gjuhën shkencore – duke u shkëputur nga hijet e atyre shprehjeve të cilat deri në vitet shtatëdhjetë të këtij shekulli (XX) kanë qeverisur me kuptimin e vet: propaganda, indoktrinimi, industria e vetëdijes, predikimi. Të gjitha këto fjalë paraqesin format specifike të kontrollit të sjelljeve të individëve (ose grupeve), dhe për këtë ata individë dhe ato grupe nuk janë fare të vetëdijshëm. Me fjalë të tjera, e përbashkëta e këtyre fjalëve përbëhet nga fakti se secila syresh paralajmëron mundësinë e kontrollit të vetëdijshëm të një lloji sjelljeje njerëzve; ndërsa këta njerëz nuk janë të vetëdijshëm se sjelljet e tyre i dirigjon “një dorë e padukshme”. Te shprehja manipulim, sikurse te një fjale që është në qendër të vëmendjes, përmbalidhen në një kuptim më të gjerë dhe më të thellë të gjitha këto fjalë të përmbajtjes dhe vëllimit të ngushtë; kështu që fitojmë një shprehje teorike mjaft të shpërndarë, por mjaftueshëm të përcaktuar, fuqia analitike e së cilës i tejkalon kuptimet e kufizuara të çdonjërës prej fjalëve të cituara. Vizioni: në sferën ekonomike, manipulimi i konsumatorëve merr formën e reklamës; në sferën politike merr formën e propagandës; në sferën pedagogjike, manipulimi (i studentëve dhe nxënësve) merr formën e indoktrinimit; sa i takon kohës së lirë, merr formën e industrisë së argëtimit; dhe në fushën e jetës religjioze, manipulimi (i besimtarëve) merr formën e predikimit fetar.<sup>56</sup>

<sup>56</sup> Manipulimi është një nocion më i lartë, i cili i përfshin të gjithë nocinet *më të ulët*.

*Reklama* mund të përcaktohet si diçka e paramenduar; përhapje sistematike dhe e kontrolluar e simboleve nga ana e një grupi të pushtetshëm prodhuesish, që nën këto simbole fshehin synimin e tyre për përfitim ekonomik, duke e paraqitur interesin e tyre ekonomik si nevojë e të gjithë konsumatorëve, me qëllim nxitjen e tyre, këta të fundit duke mos qenë të vetëdijshëm për këtë – se po blejnë jo vetëm produkte që kënaqin nevojat e tyre, por edhe produkte të panevojshme.

*Propaganda* këtu përkufizohet si përhapje e paramenduar, sistematike dhe kontroll mbi simbolet nga ana e një grupi politik, që përmes këtyre simboleve fsheh interesin e vet politik, duke e paraqitur atë si interesin e të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, me qëllim që – pa përdorur dhunë fizike – t'i nxisë ata të mendojnë dhe të veprojnë në atë formë që t'i përgjigjen qëllimeve politike të këtij grupi, e me këtë rast njerëzit mendojnë se këto vendime po i ndërmarrin vetë në mënyrë të lirë.

*Indoktrinimi* mund të përshkruhet si përhapje e ideologjisë së klasës sunduese në mënyrë të planifikuar, sistematike dhe të kontrolluar, – me anë të së cilës ajo fsheh, justifikon dhe forcon fuqinë shoqërore dhe pushtetin politik – me qëllim që brezat e rinj, nëpërmjet sistemit arsimor, ta miratojnë këtë ideologji si sistemin e vet interpretues, orientues dhe veprues, duke mos ndjerë nevojën e një këndvështrimi tjetër në kundërimin e botës.

*Industria e argëtimit* dhe ëndërrimit mund të përcaktohet si një mënyrë metodike e veprimit mbi instinktet masive dhe shijet me ndihmën e simboleve të ndryshme, funksioni i të cilëve nuk është që të kultivojnë, por të pushtojnë instinktet dhe shijet e turmave.

*Predikimi fetar* është zgjerim me shkathtësi i simboleve fetare në mënyrë sistematike dhe të kontrolluar nga ana e një grupi “barinjsh shpirtërorë”, që nevojat e tyre për sundim (shpirtëror) i manifestojnë si një etje e pangopur e turmave për shpëtimin e shpirtit”,<sup>57</sup> me qëllim që të nxisin turmën që në mënyrë të pandjeshme dhe pa kurrfarë dyshimi<sup>58</sup> të pranojë dhe të ndjekë<sup>59</sup> këtë besim, – vlera e të cilit nuk varet edhe aq prej dëshmimeve logjike e as nga ato psikologjike<sup>60</sup> – që paraqitet si e vetmja kornizë orientuese<sup>61</sup> në një botë ku mund ta humbasësh kaq lehtë rrugën.<sup>62</sup>

### **Përkufizimi i manipulimit**

Ne nuk mund ta dimë me siguri se a manipulon apo jo dikush, për aq sa nuk kuptojmë se ç’domethënie ka fjala manipulim. Prandaj do përmendim elementet përkatës të konceptit të manipulimit, dhe në bazë të tyre do ofrojmë një përkufizim të qartë teorik dhe empirik.

Elementet bazë të shprehjes, që njëherësh përbëjnë strukturën bazë të këtij studimi, janë:

- manipuluesi (burimi i mesazhit, dërguesi i mesazhit),
- mesazhet që dërgohen në masë (përmbajtja, forma, koha),

<sup>57</sup> “Dëgjoni mësuesit tuaj dhe nënshtrojuuni atyre, sepse ata kudjesen për shpirtat tuaj.” (*Qarkorja për hebrenjtë*, kap. 13, par.17)

<sup>58</sup> “Por, le të bëjnë diçka me besimin, pa dyshuar për asgjë; sepse ai që dyshon është si valët e detit, që ngrihen dhe ulen nga erërat.” (*Qarkorja e Jakovit*, kap. 1, par. 6). “Kush heziton është i papranishëm në të gjithë rrugët e tij.” (po aty, kap. 1, par. 6)

<sup>59</sup> “Sepse ashtu sikurse trupi pa shpirt është i vdekur, po ashtu edhe besimi pa vepra të mira është i vdekur.” (po aty, kap. 2, par. 26) “Kështu edhe besimi që nuk ka vepra, vetvetiu është i vdekur.” (po aty, par. 17)

<sup>60</sup> “Besimi është pritje e fuqishme për atë që shpresojmë dhe një dëshmi për atë që nuk shohim.” (*Qarkorja për hebrenjtë*, kap. 11, par. 1)

<sup>61</sup> “Kush vjen pas meje nuk do të ecë nëpër errësirë, por do ketë dritën e jetës.” (*Ungjilli sipas Gjonit*, kap. 11, par. 1)

<sup>62</sup> “...kush ecën nëpër errësirë nuk e di se ku po shkon.” (po aty, kap. 12, par. 35)

- turma e cila manipulohet (pranuesi i mesazhit),
- kushtet socio-psikologjike në të cilat kumtohet mesazhi,
- mjetet teknike, nëpërmjet të cilave transmetohet mesazhi;
- çështje publike me të cilat ka të bëjë mesazhi;
- për problemin nuk ekziston një ujdi e përgjithshme,
- por ekziston interesimi për mesazhe (motivimi);
- pasojat që shkakton mesazhi.

Prej kësaj buron përkufizimi:

Manipulimi mund të përkufizohet si një veprim i pararenduar, si veprim sistematik dhe i kontrolluar, ose si një mori veprimesh me ndihmën e të cilëve manipuluesi, duke u shërbyer me mjete simbolike, në kushte të përshtatshme psiko-sociale për të, përmes mjeteve të komunikimit dërgon mesazhe të caktuara në turmë, me qëllim që të ndikojë të bindjet, qëndrimet dhe sjelljet e një numri të madh njerëzish, në mënyrë që ata, rreth çështjeve për të cilat nuk ka një ujdi të përgjithshme dhe për të cilat ata janë të interesuar jetësisht, t'i orientojë drejt bindjes, qëndrimeve dhe vlerave të manipuluesit, dhe për këtë veprim ata të mos jenë fare të vetëdijshëm.

Nëse krahasohet ky përkufizim i manipulimit (si formë socio-ekonomike e komunikimit) me formulën klasike të Lasvelit, "who says what in which channel to whom with what effect"<sup>63</sup>, do vihet re menjëherë se formula e Lasvelit, megjithëse e thekson burimin e mesazhit, përmbajtjen e mesazhit, mjetet për të përcjellë mesazhin, pranuesin e mesazhit si dhe efektin që shkakton mesazhi, në të njëjtën kohë neglizhohen kushtet socio-psikologjike ku mesazhi bëhet

<sup>63</sup> Harold D. Lasswell, "The Structure and Function of Communication in Society", in Lyman Bryson (ed), *The Communication of Ideas*, Institute for Religious and Social Studies, 1948, p. 37.

publik, synimet e dërguesit të mesazhit, problemin me të cilin ka të bëjë mesazhi dhe motivimin për mesazhet.<sup>64</sup>

Një tjetër dallim i rëndësishëm midis përcaktimit të ofruar për manipulimin dhe shumicës së përkufizimeve që kanë ofruar teoricienët e komunikimit, përbëhet nga fakti se shumica e tyre i kushtojnë më tepër kujdes këtij apo atij elementi të nocionit, – disa theksojnë rëndësinë e burimit<sup>65</sup> të mesazhit, të tjerët formën<sup>66</sup> dhe përmbajtjen e mesazhit, të tretët mjetet teknike,<sup>67</sup> të katërtit pranuesin e mesazhit,<sup>68</sup> të pestët efektet<sup>69</sup> e mesazhit, të gjashtë rrethanat<sup>70</sup> në të cilat bëhet publik mesazhi – kurse përkufizimi i ofruar nuk i kushton ndonjë vëmendje të veçantë cilitdo element të shprehjes, por i sjell ata në raporte midis tyre, me analizën e të cilave zbulohet thelbi i nocionit të manipulimit.

Marrëdhëniet e zakonshme midis elementeve që përmban përkufizimi i ofruar i manipulimit, në fakt përbëjnë teo-

<sup>64</sup> Për aq sa di, teoricientët prekin më së shumti gjashtë elemente. Shih. Ph. Zimbardo and E. B. Ebbesen. *Influencing Attitudes and Changing Behavior*, Adison-Wesley London, 1969, p. 17: R. Jakobson, "Closing Statements: Linguistics and Poetics", in: *Style in Language*" (T. A. Sebeok, ed.) MIT Press, Cambridge. Massa. USA, pp. 350-377.

<sup>65</sup> Për shembull, K. B. Andersen, *Persuasion: Theory and Practice*, Allyn and Bacon, Boston, 1971.

<sup>66</sup> D. C. Barnlund, "Toward a Meaning Centered Philosophy of Communication", *Journal of Communication*, 12 December 1962. pp. 198-202; W. L. Brembeck and W. S. Howell, *Persuasion: A Means of Social Control*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, N. J., 1952.

<sup>67</sup> G. N. Cordon, *Persuasion: The Theory and Practice of Manipulative Communication*, Hastings House, New York, 1971, Chs. 1, 3, 5, 6.

<sup>68</sup> Zhvendosja e theksit prej burimit të mesazhit në pranuesin e mesazhit, vetvetiu nënkupton se kjo është një mënyrë e qëlluar që të fshihet manipuluesi dhe interesi i tij.

<sup>69</sup> Shih: W. C. Fotheringham, *Perspectives on Persuasion*, Allyn and Bacon, Boston, 1966, në veçanti kapitujt 1, 2.

<sup>70</sup> Ndoshta është vepra më e mirë për kushtet në të cilat mesazhi bëhet publik: *Social Contexts of Messages*, (E. A. Carswell and R. Romrnetvelt, eds.), Academic Press, London and New York, 1971.

rinë e manipulimit. Për shembull, ekziston lidhja e zakonshme ndërmjet autoritetit të manipuluesit dhe efektit të mesazhit të tij, midis efektit të mesazhit dhe rrethanave socio-psikologjike ku mesazhi bëhet publik, midis njetit teknik dhe efikasitetit të mesazhit, midis vetive të turmës (personalitetit) dhe efikasitetit të mesazhit.

Dhe e treta, dispozita e ofruar e manipulimit na tregon se për manipulimin nuk do të ketë qasje nga këndvështrimi i cilësdo disiplinë shkencore, – siç ndodh dëndur – sepse “brenda kufijve të çdo discipline të veçantë në fushën e shkencave shoqërore, lënda e trajtuar shkapërderdhet”.<sup>71</sup> E vërteta është tërësia.<sup>72</sup> Në ndarjen shkencore të punës është thyer tërësia. Nga këndvështrimi i cilësdo shkencë, nuk është e mundur njohja e tërësisë apo e së vërtetës. Prandaj, të kuptuarit e kësaj që vijon kërkon nga lexuesi të paktën njohjen e koncepteve bazë të filozofisë, sociologjisë (veçanërisht sociologjinë e dijes, sociologjinë e gjuhës dhe sociologjinë e komunikimit masiv), psikologjisë sociale, psikanalizës, por edhe të shkencave politike.

### **Manipulimi si formë tjetërsimi**

Në këtë pikë është menjëherë i mundur kundërshtimi i bazuar metodologjik: në analizë do humbasë koncepti i tjetërsimit, sepse ai reduktohet në një prej niveleve të tjetërsimit – në manipulim.

Ky rrezik është i pranishëm gjithmonë, dhe çështja qëndron te fakti se a jemi të vetëdijshëm për këtë apo jo. Për mua është e qartë se një koncept i tillë i pasur si koncepti i tjetërsimit, medoemos që humb nga pasuria e shtresave të

<sup>71</sup> Habermas, *Javno mnenje*, Kultura, Beograd, 1969, f. 3.

<sup>72</sup> Hegel, *Fenomenologija duha*.

tij, dhe i kaluar në një koncept operacional, varfërohet në atë masë sa mund të pyesim se a është kjo një rrugë e sigurt për t'u tradhtuar kuptimi i konceptit?

Më duket se përpara të njëjtit rrezik qëndrojnë të gjithë studiuesit. Vetë Marx-i ka treguar se si një koncept filozofik si tjetërsimi, të cilin ai e ka trajtuar në veprat e tij të hershme, është konkretizuar në punimet e tij të mëvonshme (për shembull, te *Kapitali*), ku fjala tjetërsim ndeshet gjithnjë e më rrallë, dhe shumë më shpesh në format konkrete të tjetërsimit – fetishizimi i mallit, kapitali, shfrytëzimi etj. Madje mund të duket se Marx-i e ka braktisur konceptin e tjetërsimit, por analiza më e përafërt zbulon se ndryshimi është vetëm te gjuha, ndërsa thelbi mbetet i pandryshuar. Në vend të debatit të pastër teorik për tjetërsimin e njeriut, gjithnjë e më shpesh hasim analiza konkrete rreth praktikave të tjetërsimit të punëtorëve dhe kapitalistëve (“shitja është praktikë tjetërsimi”)<sup>73</sup>.

Përcaktimi operativ i shprehjes, pa dyshim është përmbytësish më i varfër se përcaktimi teorik, mirëpo për këtë arsye mundëson verifikimin e disa dimensioneve eksperimentale të konceptit (kjo nuk do të thotë se këto mund të jenë gjithmonë dimensionet më të rëndësishme, por vetëm ato që mund të maten dhe vërehen në mënyrë empirike).<sup>74</sup>

<sup>73</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 71.

<sup>74</sup> “Nëse shumë vlera nuk mund të maten, kjo është rrjedhojë e faktit se ato janë koncepte të këtyre formave (profitit, rentës etj. – Gj.Sh), që vetvetiu mund të maten.” (L. Althusser, *Kako citati kapital*, f. 167)

## TEZAT (TEORIKE) BAZË DHE NJOHURITË (SHKENCORE) MBI TË CILAT MBËSHKETET MANIPULIMI

*“Në shërbim të së keqes është njëfarë logjike e zhdërvjellët,  
e shkathët, që arrin ta vrasë të vërtetën me  
zhdërvjelltësi në errësirë.”*

Hugo

Para së gjithash, kuptimi i manipulimit kërkon një njohje të supozimeve themelore, mbi të cilat ai bazohet.

### Të kuptuarit e njeriut

Me ose pa vetëdije, manipuluesi nisët nga konceptimi i njeriut si produkt i rrethanave të jashtme. Sjellja e qenieve njerëzore përcaktohet nga kushtet ku jetojnë, dhe me ndryshimin e këtyre kushteve të jashtme mund të ndryshohen edhe bindjet, mendimet dhe veprimet e tyre.

Pjesa më e madhe e ndjenjave, bindjeve dhe veprimeve tona është e nxitur prej ndryshimeve të mjedisit të jashtëm natyror dhe social, dhe mund të themi pa e tepruar se shumica e njerëzve “luajnë” ashtu siç imponojnë vetë rrethanat. “E gjitha varet nga fakti se në ç’rrethana dhe në cilin mjedis ndodhet njeriu. Çdo gjë varet nga mjedisi, sepse personalisht njeriu nuk është asgjë.<sup>75</sup> Mjedisi përcakton njeriun, madje edhe atëherë kur ai e ndërron atë.<sup>76</sup>

<sup>75</sup> Dostojevski, *Zločin i kazna*, Rad, Beograd, 1967, f. 398.

<sup>76</sup> B. F. Skinner, *Nauka i ljudsko ponašanje*, Obod, Cetinje, 1969. f. 519; F. W. Matson, *The Broken Image*, Anchor Books, Doubleday and Company, Inc., Garden City, New York, 1966, p. 30.

Ky paralajmërim filozofiko-teorik për gjendjen e njeriut në botë zgjatet në një qëndrim metodologjik të qartë: “Hipoteza se njeriu nuk është i lirë është thelbësore për zbatimin e metodës shkencore në studimin e sjelljes njerëzore.<sup>77</sup> Kjo ngaqë sjellja e njeriut varet prej rrethanave të jashtme. Prandaj me ndryshimin (manipulimin) e këtyre rrethanave, mund të ndryshohet edhe sjellja e tij.

Nëse në rrethanat e ndryshueshme të mjedisit të tij natyror, social dhe kulturor, do të përgjigjej gjithnjë në një mënyrë krejtësisht racionale, pra ekskluzivisht në harmoni me qëndrimin e tij racional, atëherë përpjekjet për t’u ndryshuar rrethanat e tij të jashtme do të dështonin. Por, sipas rregullit, në përgjithësi qenia njerëzore nuk përgjigjet në mënyrë të pastër racionale ndaj sfidave të ndryshimit të mjedisit të saj. Përkundrazi, një pjesë e madhe e reagimeve të qenies ndodh pa një kontroll të vetëdijshëm të saj, që jep mundësi ndikimi në sjellje, dhe ajo të mos jetë e vetëdijshme për këtë. Porsa qenia njerëzore gjendet në rrethanat e ndryshuara, pikaset menjëherë se ajo fillon t’i përshitasë sjelljet e veta konform rrethanave, dhe në këtë drejtim më shumë i vijnë në ndihmë mekanizmat e pavetëdijshëm sesa ata të vetëdijshëm. Mendohet se ekzistojnë më shumë se 20.000 rrugë refleksive, që mbrojnë dhe kujdesen për një rrjedhë sa më të suksesshme të proceseve jetësore, dhe për këtë nuk kërkohen vendime të vazhdueshme nga ana e trurit.<sup>78</sup>

Duke u nisur nga ajo që njerëzit mendojnë, flasin dhe veprojnë nuk mund të përfundojmë prerë se a e bëjnë këtë me apo pa vetëdije. Përveç mendimit dhe vullnetit të vetëdijshëm, ekziston edhe mendimi dhe vullneti i pavetëdij-

<sup>77</sup> B. F. Skinner, po aty.

<sup>78</sup> Erwin Lausch, *Manipuliranje mozgom*, Stvarnost, Zagreb, 1976, f. 209.

shëm. I thellë është shpirti njerëzor, shumë më i thellë nga sa mendon një copëz e vetëdijshme e shpirtit, që ne e quajmë intelekt (mendje, arsye). Së fundmi, psikanaliza na ka hapur dyert e nëntokës psikike, dhe me dritën e metodës së saj ka ofruar katet e fundit të jetës sonë shpirtërore (psikike).

Vetëm Freud-i e ka bërë të dukshëm dallimin e madh midis psikës dhe të vetëdijshmes, duke specifikuar se e vetëdijshme është vetëm një pjesë e psikës, si një realitet i gjerrë. Më vonë, Jung-u deklaroi qartë se “psika është diç më shumë se vetëdija”, se “vetëdija nuk është psikë e plotë e njeriut”, dhe se ai “i cili mohon ekzistencën e të pavetëdijshmes, në të vërtetë është i sigurt se njohuritë tona të tanishme për jetën psikike janë të plota”.

Shpeshherë Freud-i na kujton se psikanaliza “nuk ka ndërmend dhe nuk bën asgjë më shumë se zbulimi i të pavetëdijshmes në jetën shpirtërore”; se ajo nuk synon “transformimin e të pavetëdijshmes në të vetëdijshme”; se “të vetëdijshmen e bën të pavetëdijshme”; se depërton “në sfondin e pavetëdijshëm të vetëdijes”. Psikanaliza ka bërë të mundur që gremina e cila ndodhet në ne të flasë me gjuhën e saj.

“Manipuluesit e thellë” përdorin njohuritë e psikanalizës për ekzistencën e shtresës së vetëdijshme, nënvetëdijshme dhe jo të vetëdijshme në jetën psikike të njerëzve. Ata shfrytëzojnë dallimin e bërë nga Freud-i midis Unit (në jetën shpirtërore nënkupton intelekt) dhe Idit (në jetën shpirtërore përfaqëson instinktet), gjë që Freud-i e përvijoi në trajtën e një pamjeje si vijon: “Raporti i Egos me Idin do të krahasohet me raportin e kalorësit me kalin. Kali siguron energji që kalorësi të ndërrojë pozicion, ndërsa kalorësi ka të drejtë të përcaktojë cakun, që të komandojë lëvizjet e kafshës së fuqishme. Por, midis Egos dhe Idit, shpeshherë dhe

për së tepërmi luhet ai rasti që nuk është ideal, që kalorësi duhet ta çojë kalin atje ku ai dëshiron të shkojë.”<sup>79</sup>

Njeriu nuk është vetëm qenie racionale, – ky është një mashtrim racionalist – por edhe irracionale, dhe ky fakt mundëson që të ndikohet te sjellja e tij, jo vetëm me mjete racionale, por edhe me mjete irracionale, madje me këto të fundit me më shumë efikasitet.

### **Të menduarit dhe sjellja për të mësuar**

Nëse ndryshimi i kushteve në të cilat jetojnë njerëzit nuk është i mundur ose është i lidhur me vështirësitë, atëherë manipulimi nuk bazohet te ndryshimi i kushteve të jashtme, por te ndryshimi i perceptimit të këtyre kushteve. Nëse manipuluesi nuk mund ta ndryshojë këtë realitet, ai mund të ndryshojë perceptimin e këtij realiteti. Nëse ai nuk mund të ndikojë mbi fenomenet, ai nuk mund të ndikojë mbi qëndrimet e njerëzve për fenomenet. “Shpeshherë njeriu ka mundësi që të ndryshojë botën e tjetrit duke futur fjalë në mjedisin e tij, ashtu siç mund të fusë lopë, makina dhe pallate. Prandaj është sugjeruar mundësia se me ndryshimin e mjedisit të individit përmes fjalëve, do jemi në gjendje që të bëjmë edhe ndryshime identike në sjelljen e tij, të cilat mund t’i realizojmë duke ndryshuar mjedisin me anë të manipulimit të objekteve. Për këtë arsye, gjuha ka një efekt të veçantë në ndryshimin e qëndrimeve, sikurse edhe në nxitjen e nevojave dhe futjen e ndryshimeve në sjellje.”<sup>80</sup>

<sup>79</sup> Freud, *Nova predavanja*, Matica srpska, Novi Sad, 1969, f. 167-8. Shih gjithashtu: *Uvod u psihoanalizu*, f. 17, 355, 363, 407 I 420; po ashtu: Jung, *Çovjek i njegovi simboli*, Mladost, Zagreb, 1973, f. 23, 75 dhe 102.

<sup>80</sup> D. Kreč, R. S. Kračfeld, I. L. Balaki, *Pojedinac u društvu*, (Udžbenik socijalne psihologije), Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Srbije, Beograd, 1972, f. 284.

Pavarësisht nga fakti se a vendos manipuluesi që të ndryshojë rrethanat e jashtme apo perceptimin e këtyre rrethanave (qëndrimeve), ai arrin të njëjtin efekt/ndryshim në sjellje.<sup>81</sup>

Realitetin shoqëror (zakonisht) nuk e përkufizojnë ata që e njohin më mirë atë, por ata që e sundojnë këtë realitet. Përkufizimet e tyre ata i imponojnë në një mënyrë të pahtueshme, me të gjitha mundësitë e mundshme; kështu që, në fakt, këto bëhen edhe përkufizime dominuese për realitetin. Me këtë rast, përgjithësisht, këto përkufizime paraqesin racionalizimin e interesave grupore. Për të ruajtur pushtetin, pushtetarëve nuk iu nevojiten ekskluzivisht idetë e vërteta, por ideologjitë, nëpërmjet të cilave rendi ekzistues i gjërave përsoset dhe shndërrohet në ligj. Në të njëjtën kohë kontrollohet rreptësisht paraqitja e ideve dhe ideologjive të reja, duke iu prerë rruga që të dalin në publik. Ato ide dhe ideologji që nuk mund të depërtojnë në rrjetin e institucioneve shtetërore (shoqërore) të censurës, në fakt mbeten të panjohura për ata që kanë më shumë nevojë për to – dhe këta janë brezat e rinj. Siç e thotë Fromm-i, për ta kjo është një zonë e pavetëdijshme. Ky është edhe një rast që tregon qartë se si është kushtëzuar struktura e mendimit prej strukturës së shoqërisë.<sup>82</sup>

<sup>81</sup> Sjellja e njerëzve nuk duhet të jetë në harmoni me pikëpamjet e tyre në të gjitha rastet. Për aq sa në publik njerëzit sillen ashtu siç kërkon manipuluesi, në jetën private ata mund të ndjekin qëndrime të tjera. Por, për manipuluesin ka rëndësi që publikisht të sillen ashtu siç do ai. Shkalla në të cilën ndahen njerëzit në personalitete private dhe publike, reflekton thjesht masën e përcarjes së përgjithshme të unitetit shoqëror dhe është indikator i situatave të thella konfliktuale në shoqërinë si tërësi. Vetë fakti i ndarjes së sjelljeve njerëzore në publike dhe private dëshmon për presionet shoqërore dhe jolirinë. Hulumtimet e opinionit publik u bënë të mundura vetëm atëherë kur përfundoi procesi historik i ndarjes së njeriut si personalitet publik dhe privat, në qytetar abstrakt dhe qytetar privat. E vërteta u zhvendos në sferën private, dhe nëse ekziston ende, atëherë ajo është atje.

<sup>82</sup> Shih librin e tij *Revolution of Hope*.

Me të drejtë Marx-i ka vënë re se mendimet në një shoqëri janë mendime të klasës sunduese<sup>83</sup>, dhe përmbajtja dhe forma që hasim në analizën e vetëdijes shoqërore, në të shumtën varet nga fakti se çfarë vlerësohet si e vërtetë, e mirë, e bukur, e shenjtë nga shtresa sunduese në atë shoqëri. Nuk duhet të befasohe mi nëse analiza e vetëdijes shoqërore tregon se kësaj vetëdijeje i mungojnë disa dimensione thelbësore të mendimit, ndjenjave dhe vlerësimit, dhe se shumë brezave u është mohuar padrejtësisht qasja tek ato ide dhe vlera që i japin jetës një kuptim më të plotë dhe më human. Kjo e ka shtyrë vështruesin e madh që të pohojë me hidhërim se “kur truri i njerëzimit të jetë fare pranë syve të tu, i hapur si faqja e një libri, ti do kesh shënuar mbi atë faqe: pranojeni, se ashtu është”.<sup>84</sup>

### Dy kriteret për vlerësimin e ideve: çfarë është e vërtetë?

Manipuluesi e di fort mirë se njerëzit dinë t’i vlerësojnë idetë (simbolet, të dhënat, teoritë, filozofitë, deklaratat, qëndrimet, fjalët etj.), jo vetëm në lidhje me përmbajtjen, por edhe në lidhje me funksionin që ato kryejnë në jetën individuale dhe shoqërore. Me fjalë të tjera, kriteret për vlerësimin e ideve janë të dyfishta: kriteri gnoseologjik dhe socio-psikologjik.<sup>85</sup> Kjo do të thotë se një ide e caktuar mund të vlerësohet jo vetëm për shkak të faktit se a është (shkencërisht) e vërtetë apo e rreme, por edhe për çështjen se a pajtohet me grupin dhe përvojat, interesat dhe nevojat vetjake. Pra, duhet bërë dallimi midis të vërtetës, që shkencërisht është e

<sup>83</sup>Rani radovi, *Kultura*, Zagreb, 1953, f. 313.

<sup>84</sup>Igo, *O slobodi nastave*, në: Besede, *Kultura*, Beograd, 1976, f. 278.

<sup>85</sup>Kjo logjikë vjen nga supozimi i parë: në qoftë se një njeri është genie e arsyeshme dhe e paarsyeshme, atëherë mund të presim se çdo ide do ta vlerësojë të paktën në dy mënyra: gnoseologjike dhe psikologjike.

pranueshme, dhe të vërtetës që është pranuar në aspektin socio-psikologjik.

Një ide e pranuar shkencërisht nuk është e thënë të jetë e pranueshme nga një grup njerëzish, në qoftë se ajo është në kundërshtim me përvojat, interesat dhe nevojat e tyre. Një ide e pasaktë nga ana shkencore mund të pranohet nga një grup njerëzish në qoftë se është në përputhje me përvojat, interesat dhe nevojat e tyre. “Nga njëra anë është një e vërtetë e shenjtë, nga ana tjetër gënjeshtër. Njëri e di saktësisht se ky mendim do të ekzistojë shumë gjatë si një nga çështjet e debatueshme midis njerëzve.”<sup>86</sup> Vërtetësia e idesë nuk është kusht i nevojshëm që ideja të pranohet dhe të përhapet. Interpretimi njohës i idesë ndryshon nga interpretimi funksional apo instrumental. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë një rol të rëndësishëm në histori do të kishin vetëm idetë e vërteta. Përvoja historike tregon se idetë e rreme, të paktën kanë luajtur të njëjtin rol si idetë e vërteta, ndoshta një rol akoma më të madh, sepse gënjeshttra mbillet dhe lulëzon shumë më shpejt se e vërteta.

Në rrafshin socio-psikologjik, sukses nuk kanë vetëm ato ide të cilat e gjejnë rrugën që të ndërlidhen me përvojat, interesat dhe nevojat e grupeve shoqërore. “Të gjitha idetë që ata i miratojnë njëzëri, janë ato të cilat janë tamam për sqimën e tyre, ose iu përgjigjen shpresave të tyre; janë ide shpresëdhënëse dhe pak rëndësi ka nëse janë të qëndrueshme apo jo.”<sup>87</sup> “Në fund të fundit, për çfarë ta vras mendjen unë: se a është e vërtetë ideja apo jo? Mjafton që ajo të më bindë.”<sup>88</sup> “E vërtetë apo gënjeshtër, ajo fjalë e ka arritur efektin e saj.”<sup>89</sup>

<sup>86</sup> Dostojevski, *Mladić*, Rad, Beograd, 1967. f. 211.

<sup>87</sup> A. Frans, *Život u cvetu*, NP, Beograd, 1951, f. 193.

<sup>88</sup> Proust, *U traganju za izgubljenim vremenom* (“Pronadjeno vrijerne”), knjiga 1. Zora, Zagreb, 1965. f. 127.

<sup>89</sup> Proust, *U traganju za izgubljenim vremenom* (Vojvotkinja de Guermantes), knjiga II, f. 235.

“Peshkatarët e shpirttrave njerëzorë” janë të vetëdijshëm edhe për një dallim delikat (ose ndoshta vetëm sa e parandiejnë, por në çdo rast e përdorin): dallimi midis të vërtetës dhe kuptimit. Një dëshmi (apo sistem dëshmish) ka kuptim pavarësisht nga fakti se a është e vërtetë apo është e rreme (shkencërisht). Gënjeshtra nuk është e vërtetë, por ama ka kuptim, sepse nëse nuk do të ekzistonte gënjeshtra, njerëzit nuk do ta përdornin. Përralla nuk është e vërtetë, por ka kuptim, sepse sikur të mos ekzistonin përrallat, atëherë nuk do të kishte kuptim t’ua rrëfenim fëmijëve tanë. Dallimi midis dëshmive shkencore dhe teologjike nuk mund të reduktohet në nivelin e kuptimësisë dhe të pakuptimësisë, sepse dëshmitë teologjike mund të kenë kuptim edhe pse (shkencërisht) nuk janë të vërteta. E pavërteta nuk mund të pësjtjellohet me të pakuptimtën, ashtu sikurse edhe e kuptueshmja nuk mund të përzihet me të sajuarën. Kushtet që duhet të përmbushë një dëshmi që ne ta vlerësojmë si të vërtetë, ndryshojnë nga kushtet që duhet të plotësojë një dëshmi për t’u konsideruar kuptimplotë. Sigurisht që një rrëfim i vërtetë është kuptimplotë, por një rrëfim që ka kuptim nuk duhet të jetë e vërtetë. Rrëfimi i vërtetë duhet të jetë kuptimplotë, ndërsa një rrëfim i sajuar nuk duhet të jetë doemos i vërtetë.

Turma që manipulohet nuk është e vetëdijshme për këto dallime delikate midis të vërtetës dhe kuptimplotës, dhe për këtë arsye ajo shpeshherë pranon dhe ndjek ide që nuk janë të vërteta, por që kanë kuptim, dhe i vlerëson si të vërteta. Mirëpo, “profesorët që bindin” mund të jenë të vetëdijshëm se në profesionin e tyre idetë e humbasin funksionin njohës dhe vlerën, dhe kështu këto ide marrin funksion dhe vlerë manipuluese. Që kjo është e vërtetë shihet edhe te fakti se idetë (simbolet) janë përzgjedhur dhe janë

modeluar sipas rregullit që të kënaqin nënvetëdijen dhe jo vetëdijen.<sup>90</sup>

### **Idetë kanë funksion integrues/çintegrues**

Manipuluesi e di fort mirë se shoqëria është e përçarë dhe, përveç konflikteve klasore, shoqërinë e gërryejnë nga brenda një seri faktorësh: raca, kombësia, fisi, feja, politika, ideologjia etj. A ekziston një opinion publik i unifikuar në një shoqëri të tillë të ndarë? Natyrisht që jo, por ekziston mundësia e krijimit të një opinionit publik, të cilin mund ta quajmë opinion artificial. Po në ç' mënyrë mund të bëhet një gjë e tillë?

Një mënyrë e provuar dhe e suksesshme është që ai grup i cili mban pushtetin të marrë në dorë edhe kujdesin për shëndetin ideor të turmës. Hapi i parë në këtë mes është vënia nën kontroll e mjeteve të fuqishme të informimit masiv, vendosja e monopolit mbi informacionet (idetë) dhe kontrollimi i tyre. Në një shoqëri që ekziston monopoli i informacionit (idesë) me rëndësi të veçantë, nuk ekziston as mundësia për të menduar në mënyrë alternative. Ndërsa fuqia e individit mbi një individ tjetër është krejtësisht e varur nga ekzistenca ose mungesa e alternativës.<sup>91</sup> Është krijuar një lloj i ri varësie: varësia nga ata që kanë informacione (ide).<sup>92</sup> Kështu, monopoli mbi informacionet dhe ma-

<sup>90</sup> Përvoja na thotë se qeniet njerëzore janë të afta që të mësojnë dhe të riprodhojnë një mori dëshmish, që mund të mos i kuptojnë fare. Fillimisht lutja mësohet përmendësh, pastaj kuptohet.

<sup>91</sup> "Për aq sa mund të mendojmë për një alternativë tjetër, atëherë nuk e kemi humbur rrugën..." (E. Fromm, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 338)

<sup>92</sup> "...sepse varësia ka qenë dhe do të jetë gjithmonë burim i përjetimit të hyjnore." (T. Mann, *Legenda o Josipu*, II, f. 1252)

nipulimi i tyre tregohet si një burim i fuqishëm i fuqisë shoqërore.

Përderisa informacionet (idetë) qarkullojnë nga një qendër, shoqëria tregon një nivel më të lartë uniteti, solidariteti dhe mirëkuptimi, që do të thotë se reduktohen mundësitë e konflikteve ideore, ideologjike dhe sociale. Nëse monopoli mbi informacionet prishet, do të rritet numri i qendrave të pavarura prej ku dërgohen informacione, gjë që nënkupton se do të rriten gjasat që informacionet të jenë kundërthënëse. Ndërsa informacionet kundërthënëse nga burime të ndryshme shkaktojnë edhe reagime kontradiktore në shoqëri, dhe kjo nënkupton se rriten mundësitë e konfliktit, tensionit, pasigurisë dhe çorganizimit në shoqëri. “Ku do arrijmë kur secili dëshiron të jetë qendra e botës, duke e vendosur veten si gjykatës, për të dhënë mendimin se ç’është e shenjtë në botë, ç’është e vjetër, kush dhe çfarë meriton respekt dhe çfarë etiketohet si e kaluar? Prandaj, së shpejti nuk do kemi më asgjë të shenjtë.”<sup>93</sup>

Që nga çasti kur një grup i pushtetshëm në shoqëri (për shembull, një parti politike) merr përsipër shpëlarjen e trurit të popullsisë, ai/ajo e shkëput popullin (të gjithë grupet e tjera)<sup>94</sup> nga ekzistenca e vërtetë e opinionit publik, duke e zëvendësuar atë me ideologjinë, e cila paraqet fortësisht interesat e këtij grupi dhe i imponon ato si të vërteta. Kështu

<sup>93</sup> (Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 769); “Po, e di. Unë kam thënë se bota ka shumë pika të rëndësishme, aq sa njerëzit në tokë thonë “unë” për secilën syresh.” (T. Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 749) “Por, ku do arrinim nëse çdo torollak dhe i marrë nga tollovia e madhe do dëshironte që ta paraqiste veten si kërthizë të botës, ngado që shkon dhe kudo që qëndron? Çdo t’i nevojiten atij gjithë këto qendra.” (Mann, po aty).

<sup>94</sup> “Opinionit publik, prej të cilit është përjashtuar një grup *epo ipso*, jo vetëm që nuk është i plotë, por nuk është kurrfarë opinionit.” (Ljubomir Tadić, “Pojam gradjanske javnosti u teoriji Jirgena Habermasa”. Parathënie për librin J. Habermas, *Javnomenje*, Kultura, Beograd 1969, f. IX)

fillon sundimi i interesave mbi të vërtetën. Kur bërtasin interesat nuk mund të dëgjohen idetë.

Në punëtorinë ideologjike të grupit të pushtetshëm prodhohen gjysmë të vërteta të patentuara me paramendim dhe përhapen në atë mënyrë, sa individët dhe grupet në shoqëri nuk duhet ta ndiejnë asnjë presion, madje edhe të besojnë thellë se i kanë zgjedhur me vullnet ato ide. Më pas i kanë formuar si të pavarur dhe i kanë marrë vetë vendimet. Ajo për të cilën ata janë fare pak të vetëdijshëm është se në ç'masë janë larguar nga e vërteta dhe sa është e madhe varfëria shpirtërore e tyre. "Budallai më i madh nuk është ai që nuk di të lexojë, por ai që mendon se gjithçka që lexon është e vërtetë."<sup>95</sup>

### **Audienca shndërrohet në turmë**

Shumë studiues paralajmërojnë për një ndryshim radikal që ka ndodhur në mënyrën e komunikimit midis njerëzve: në qoftë se deri në shfaqjen e mjeteve të komunikimit masiv ka dominuar mënyra e komunikimit *face to face* - "ballë për ballë", sot është dominuese një mënyrë e tërthortë. Pikërisht kjo humbje e komunikimit të drejtpërdrejtë është edhe një prej kushteve që do i mundësojë subjektit të shndërrohet në objekt – publiku masiv<sup>96</sup>, sepse komunikimi i vërtetë, si përcjellje e kuptimit me ndihmën e përdorimit të simboleve, nënkupton dhe kërkon shkëmbimin e përvojave, mendimeve dhe ndjenjave, duke komunikuar sy më sy.

<sup>95</sup>Ivo Andrić, *Travnička hronika*, Prosveta, Beograd, 1962, f. 298.

<sup>96</sup>Për kushtet e tjera shih: H. Blumer "The Mass, The Public and Public Opinion", in *Reader in Public Opinion and Communication*, Eds. B. Berelson and M. Janowitz, The Free Press, Glencoe, Illinois, 1953, pp. 43-49.

Mendoj se C. Wright Mills, më gjerë dhe më depërtueshëm se të tjerët ka vënë në dukje diferencën midis audiencës dhe masës (për kushtet në të cilat publiku është transformuar në një masë), dhe pikërisht për këtë po citoj kriteret e tij:

“Kur bëhet fjalë për publikun, në sensin se si e kuptojmë këtë nocion, (1) njerëzit i shprehin mendimet e tyre për aq sa pranojnë mendimet e huaja; (2) mjetet e komunikimit publik janë të organizuara në mënyrë që të ofrohet një përgjigje e menjëhershme dhe në formë efikase për çdo mendim që do paraqitet në publik. Ai mendim që është formuar përmes një diskutimi të tillë, (3) do të shndërrohet lehtësisht në një veprim efikas, madje edhe kundër sistemit sundues të pushtetit në qoftë se lind nevoja. (4) Institucionet e autoritetit nuk depërtojnë në radhët e audiencës, që pak a shumë është autonome në veprimet e saj.”

“Kur bie fjala për turmën, (1) numri i njerëzve që shprehin mendim është shumë më i vogël se numri që e pranojnë atë, sepse bashkësia e një numri të konsiderueshëm të sektorit publik shndërrohet në një grup abstrakt individësh, të cilët i marrin përshtypjet përmes mjeteve të komunikimit masiv. (2) Sistemi ekzistues i mjeteve të komunikimit është i tillë sa individit i vështirësohet, madje mund ta ketë të pamundur të përgjigjet menjëherë apo në mënyrë efektive. (3) Kalimin e mendimeve në veprim e kontrollon pushteti, i cili organizon dhe mbikëqyr kanalet nëpërmjet të cilave kryhet ky veprim. (4) Turma nuk gëzon autonomi në raport me institucionet; përkundrazi, të autorizuarit e institucioneve të privileguara depërtojnë në turmë duke zvogëluar edhe atë pak autonomi që mund të kishte turma me rastin e formimit të opinionit përmes diskutimit.”<sup>97</sup>

<sup>97</sup> C. Wright Mills, *Elita vlasi*, Kultura, Beograd, 1964. f. 391-2.

Madje edhe në rastet kur grupi në pushtet – siç e paraqet D. Riesman – ofron ndonjë problem për diskutim publik, ai nuk e bën këtë nga nevoja për të mësuar opinionin e turmës (për ta marrë në konsideratë në rastin e vendimeve të rëndësishme), por mbi të gjitha për të verifikuar se sa gjerësisht dhe thellësisht mund të shkojë më tej në arritjen e objektivave të tij.<sup>98</sup> Ky grup sundues e dëgjon me vëmendje zërin e turmës për të zbuluar mendimet e atyre që janë kundër, me qëllim që t'i neutralizojë në mënyrë efikase.

### **Manipulimi dhe struktura e opinionëve në shoqëri/grupe**

Crallë herë ndodh që një grup (shoqëri) të jetë krejtësisht homogjen dhe unik; që çdo individ në atë grup të ketë një qëndrim identik ndaj një grupi tjetër, ndaj një personaliteti, institucioni, vlere etj. Grupi (shoqëria) zakonisht është i përbërë nga (a) ata që bindjet, vlerësimet dhe qëndrimet i kanë identike; vlerat dhe qëndrimet i kanë të njëjta me ato të manipuluesit, dhe potencialisht janë të gatshëm të ndjekin manipuluesin; (b) ata që janë neutralë dhe (c) ata që u kundërvihen këtyre vlerave/bindjeve/qëndrimeve.

Edhe në këtë pikë manipuluesi nisat nga rezultatet e hulumtimit të kohezionit grupor dhe konfliktit në grup: (a) pavarësisht nga lloji, vërtetësia dhe kuptimi i mesazhit që i dërgohet turmës, gjithmonë do gjenden ata që e pranojnë dhe e ndjekin këtë mesazh; (b) mesazhet duhet t'i dërgohen atij grupi për të cilin dihet se nuk ka një qëndrim unik në lidhje me një problem të caktuar grupor ("kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë");(c) shqyrtimi i qëndrimeve ka treguar se nuk është e mundur (ose është shumë e vështirë)

<sup>98</sup> D. Riesman, *Usamljena gomila*, Nolit, Beograd, 1965.

t'i ndryshosh qëndrimet që janë të forta dhe të qëndrueshme (paragjykimet). Kështu, manipuluesi, në përpjekje për të ndikuar mbi këto qëndrime, jo vetëm që nuk mund t'i ndryshojë në favor të tij, por mund t'i forcojë ato edhe më shumë. Prandaj, para çdo orvatjeje për të ndikuar mbi qëndrimet, ai duhet të dijë se cilat janë këto qëndrime kaq të forta dhe afatgjata; pra për cilat qëndrime ia vlen të shpenzosh kohë, mjete dhe energji, sepse nuk ka gjasa që të ndryshohen; dhe cilat qëndrime janë të dobëta e të paqëndrueshme, pra cilat janë ato qëndrime që nuk ekzistojnë, që ai mund t'i ndryshojë në harmoni me qëllimin e tij.

### Funksioni manipulues i gjuhës

Në çdo gjuhë ka shprehje që janë të ngarkuara me përvojën e rëndë socio-psikologjike, që janë simbole të një sundimi të neveritshëm mbi ndjenjat, mendimin dhe sjelljet tona; që janë paralajmërime të ligjit penal dhe të detyrimit shoqëror. Do të ishte mirë sikur të hynim te këto fjalë e të zbërthenim shtresat e kuptimit, të cilat me kohë janë futur brenda këtyre fjalëve dhe kanë dëshmuar se po mjegullohet dhe fshihet diç, dhe pothuajse asgjë nuk është sqaruar. Si rast ilustrues po marrim fjalën “ushtri”. “Por, kjo fjalë ka një kuptim të gjerë për ta, ose e thënë më mirë, një mori kuptimesh. Bazuar në përvojën shekullore, fjala “ushtri” ka të njëjtin kuptim si fjala luftë, dhunë dhe plaçkitje, punë e detyruar dhe uri, përmbytje dhe thatësi, si dhe të gjitha bashkë. Shkurtimisht, të gjitha të këqijat dhe fatkeqësitë, e kundërta e asaj që kë të bëjë me jetën dhe çdo gjëje që është e çmuar për njeriun, e dashur dhe e shenjtë.”<sup>99</sup>

<sup>99</sup> Ivo Andric, *Nemirna godina*, Prosveta, Beograd, 1964, f. 109.

Një fjalë e vetme, ushtri, ruan në vete ngjyra, shije, aromë, ndjenja, bindje, forma, lëvizje, hapësirë, kohë..., me pak fjalë të gjitha shtresat e kuptimeve racionale, aracionale dhe irracionale. “Çdo racë e mallkuar ka vënë shtresën e saj; çdo vuajtje ka lëshuar gurin e vet; çdo zemër i ka dhënë guralecin e vet. Një shumësi shpirtrash të këqij, të ulët apo të zemëruar, që kanë kaluar nëpër jetë dhe kanë humbur në amshim, janë ruajtur aty gati në tërësi dhe në njëfarë forme akoma janë të dukshëm në trajtën e fjalës së shëmtuar.”<sup>100</sup>

Manipuluesi përpiket që shprehjet e përditshmërisë, me kuptim të qartë dhe të saktë, të farkëtuara në procesin e gjatë të përdorimit dhe (shpeshherë) me përvojë të hidhur, t’i zëvendësojë me fjalë që nuk kanë të njëjtën vlerë emocionale, racionale dhe vepruese. Kështu, fjalën “ushtri” manipuluesi kërkon ta heqë dhe ta zëvendësojë me togfjalëshin “mbrojtësit e lirisë sonë”, me qëllim që të zbrazë prej shtresave të pakëndshme të kuptimit fjalën e parë; pasi vetë fenomeni (ushtria), në fakt, ngelet ashtu siç është në të vërtetë. “Kjo kërkesë për ndryshimin e vetëdijes<sup>101</sup> reduktohet në kërkesë; se ajo që ekziston duhet të interpretohet ndryshe, domethënë përmes një interpretimi tjetër; vetë shprehja të bëhet e pranueshme.”<sup>102</sup>

Duke mbetur në gjurmët e mendimit të Marx-it, mund të themi se në jetën publike, gjuha e klasës sunduese është një gjuhë mbizotëruese, dhe kjo gjuhë u jep mundësi anëtarëve të shoqërisë që të emërojnë dhe shprehin përvojat e tyre (në atë mënyrë që i përshtatet manipuluesit). Në të njëjtën kohë ajo parandalon emërimin, përshtatimin apo shpre-

<sup>100</sup> V. Ego, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 952.

<sup>101</sup> “Gjuha është praktike. Për të tjerët është ekzistuese. Edhe për veten time ajo është një vetëdije ekzistuese...” (Marks - Engels, *Nemačka ideologjia*, f. 27)

<sup>102</sup> Po aty, f. 14.

hjen në një mënyrë tjetër të këtyre përvojave. Te kjo gjuhë janë dhënë kufijtë jo vetëm për atë që mund të vërehet, përshkruhet, mendohet apo shprehet, por edhe se si duhet të jetë. Natyrisht që në këtë rast gjuha nuk ka kuptimin e komunikimit të mendimeve dhe ndjenjave, pra funksionin e marrëveshjes, por funksionin e dominimit dhe manipulimit. Në radhë të parë kjo nuk është gjuhë njohurish, por kontrolli – një gjuhë e pushtetit që shfaqet si dije. Në të vërtetë, çdo fjalë zbulon diçka për fenomenin me të cilin ka të bëjë, por njëkohësisht fsheh shtresa të tjera kuptimesh të mundshme më të rëndësishme. “Së pari mund të kujtojmë ato tri deklaratat që konkurrojnë me njëra-tjetrën për të na thënë se ç’është gjuha: e para, vërejtja e përditshme se gjuha ekziston për të shprehur mendimin; më pas vjen thënia tashmë e njohur se gjuha ekziston për të fshehur mendimin; dhe në fund, në vazhdim të kësaj logjike, gjuha përdoret për të fshehur faktin se ne nuk mendojmë fare.”<sup>103</sup>

Në thelb të çdo manipulimi qëndrojnë supozime teorike dhe njohuri shkencore, për ekzistencën e të cilave manipuluesi nuk duhet të jetë fare i vetëdijshëm. Siç dimë të mendojmë logjikisht dhe mendimet tona t’i shprehim në format e drejta të gjuhës, ku nuk kemi asnjë ide për ligjet e mendimit të drejtë ose ligjet shkencore të gjuhës, kështu edhe manipuluesi mund të manipulojë në mënyrë të suksesshme pa i njohur fare tezat teorike dhe njohuritë shkencore mbi të cilat është bazuar manipulimi. Teoricieni i manipulimit i zbulon këto supozime dhe njohuri duke u mbështetur në praktikën e manipuluesit (shpeshherë i udhëhequr nga intuita) dhe te veprimet e tij. Ai u jep formën teorike këtyre veprimeve. Ata që e dinë teorinë, zakonisht nuk

<sup>103</sup> Otto Jespersen, *Čovječanstvo, narod i pojedinac sa lingvističkog stanovišta*. Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo, 1970, f. 13.

dinë të manipulojnë; ata që dinë të manipulojnë, zakonisht nuk e dinë teorinë. Kjo ndarje e teorisë nga praktika tejkalohet me sukses në shoqërinë civile moderne në dy mënyra: (a) njerëzit e praktikës rrethohen nga njerëz të teorive, dhe (b) publikimi i rregullt i njohurive teorike i jep rastin përvojës praktike për të hartuar veprimet e saj.<sup>104</sup>

<sup>104</sup> Shih kapitujt për fushat e zbatimit (reklama, propaganda, indoktrinimi, industria e argëtimit dhe predikimi fetar).

**PJESA E DYTË**  
**Struktura e konceptit**



## MANIPULUESI

*“Unë kam marrë përsipër t’ua vendos juve  
kokën në vendin e vet, ashtu siç duhet.”*

Mann

Edhe ata që flasin vazhdimisht për nevojën e autoritetit, por dhe ata që e refuzojnë vazhdimisht nevojën për autoritet, ndajnë një ndjenjë të përbashkët me njëri-tjetrin: preokupimin e tepruar pas autoritetit. Pavarësisht se si është krijuar autoriteti (dhe pastaj edhe personaliteti autoritar dhe mendimi autoritar) – disa thonë që në këtë rast është varësia vendimtare nga prindërit<sup>105</sup>; disa ia atribuojnë dallimit në fuqi midis individëve<sup>106</sup>; disa të tjerë e shohin si produkt të domosdoshëm të organizimit shoqëror<sup>107</sup> – fakti është se autoriteti sundon<sup>108</sup> bindjet, mendimet dhe sjelljet tona.

Me shprehjen “autoritet” nënkuptojmë çdo burim të pushtetit (fuqisë)<sup>109</sup> të cilit i drejtohen individët apo grupet e dobëta për çfarëdolloj arsyeje – në rastin tonë qoftë ata që dëshirojnë të marrin ndonjë informacion, qoftë ata që janë përpjekur për të verifikuar ndonjë informacion, apo qoftë ata që duan të verifikojnë një informacion të vjetër, nga i cili janë të varur, pa marrë parasysh nëse janë të vetëdijshëm apo të pa-

<sup>105</sup> “Familja dhe fisi, e më vonë shteti-komb apo kisha, marrin ato funksione që kishte dikur nëna në raport me fëmijën.” (Fromm, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 62)

<sup>106</sup> Teoritë biologjike të shoqërisë.

<sup>107</sup> Për shembull, Engelsi në artikullin *Mbi autoritetin*.

<sup>108</sup> Sepse sundimi dhe shfrytëzimi janë shprehje identike (Marks-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb 1953, f. 33).

<sup>109</sup> Autoriteti zakonisht rrezaton nga pozita e hierarkisë shoqërore (dhe është i lidhur me posedimin dhe shfrytëzimin e pushtetit), nga madhësia e numrit (shumica si masë), nga ndonjë aftësi e veçantë trupore apo shpirtërore.

vetëdijshëm për varësinë e tyre. Në këtë kuptim, autoriteti nënkupton shpërndarjen e pabarabartë të fuqisë shoqërore dhe raporte të varshmërisë<sup>110</sup> që rezultojnë nga kjo shpërndarje e pabarabartë. Në rastin tonë, raportet e pabarazisë paraqiten në formën e fuqisë së pabarabartë, për të arritur deri tek informacioni; që midis informacioneve të mundshme të bëhet përzgjedhja, dhe më pas të shfrytëzohen dhe të kontrollohen.

Edhe fusha më e gjerë e komunikimit njerëzor nuk mund të emërohet si njerëzore, nëse njerëzit nuk janë të barabartë dhe kur ekziston nxitja e pabarazisë; sepse manipuluesi ka pushtet (fuqi) dhe e vendos atë mbi pranuesin e mesazhit të tij, sikurse në aspektin e qasjes ndaj informacioneve me rëndësi, ashtu edhe në atë të përzgjedhjes, shpërndarjes, shfrytëzimit dhe kontrollit të informacioneve.

Qëndrimi autoritar nënkupton humbjen e pavarësisë në mendim, bindje dhe sjellje. “Nëse dikush dëshiron të vijë pas meje, le të heqë dorë nga vetja dhe le të marrë kryqin e vet e të më ndjekë.”<sup>111</sup> Në marrëdhëniet autoritare, personaliteti merr pozitën e njëshit (individit), ndërsa njerëzit pozitën e turmës. Vetëm kështu, të ndryshuar, ata janë të prirë që të ndjekin urdhrat e Perëndisë dhe ligjet shoqërore, e jo zërin e ndërjegjes së tyre.

### Dy tipa autoriteti (udhëheqjeje)

Është mirë që të dallojmë së paku dy tipa autoriteti:<sup>112</sup> racional dhe irracional,<sup>113</sup> sepse pothuajse gjithçka që do të flasim në vijim ka të bëjë me autoritetin irracional.

<sup>110</sup> “Sepse varësia ka qenë dhe ka mbetur gjithmonë burim i ndjenjës së hyjnore.” (T. Man, *Legenda a Josipu*, II, 0. Keršovani, Rijeka, 1960, f. 1252)

<sup>111</sup> *Ungjilli sipas Mateut*, kap. 16, parag. 24 (nënvizoi Gj. Sh).

<sup>112</sup> M. Weberi veçon tri tipe të autoritetit: racional, tradicional dh karizmatik, ndërsa autorët tjerë më së shpeshti flasin për dy tipa: (shih: Mihailo Djurić, *Sociologija Maksa Vebera*, Matica Hrvatska, Zagreb 1964, fq. 320-326).

“Shembulli në vijim do të tregojë se për çfarë po mendojmë. Edhe marrëdhëniet midis profesorit dhe studentëve, skllavopronarit dhe skllavit bazohen te superioriteti i njërit mbi tjetrin. Interesat e profesorit dhe nxënësit janë të njëjta. Profesori do të mbetet i kënaqur nëse nxënësi ia del të bëjë përpara. Nëse nxënësi nuk është i suksesshëm, dështimi është si i profesorit ashtu edhe i nxënësit. Nga ana tjetër, skllavopronari kërkon ta shfrytëzojë robin e tij për aq sa është e mundur, për aq sa ai mund të nxjerrë prej tij. Në të vërtetë, sa më të mëdha të jenë rezultatet e këtij shfrytëzimi, aq më shumë i kënaqur do të mbetet skllavopronari. Në të njëjtën kohë, robi synon që t’i mbrojë kërkesat e tij sa më mirë, që të paktën të gëzojë minimumin e lumturisë. Këto interesa janë antagoniste, dhe ajo çfarë i shërben njëres palë, i bën dëm palës tjetër. Në të dyja rastet, superioriteti ka funksione të ndryshme: në të parin është kusht që të ndihmohet personi që është në varësi të autoritetit; në të dytin është kusht për shfrytëzimin e tij.

Dinamika e autoritetit është e ndryshme në të dy rastet: sa më shumë që të mësojë studenti, aq më i vogël bëhet hendeku mes tij dhe profesorit. Me fjalë të tjera, marrëdhënia autoritative racionale synon që të zgjidhë vetveten. Por, kur superioriteti shërben si bazë shfrytëzimi, atëherë ky raport zgjatet, dhe kështu rritet edhe distanca midis shfrytëzuesit dhe të shfrytëzuarit.

Në të dy rastet situata psikologjike është e ndryshme. Në rastin e parë dominojnë elementet e dashurisë, adhurimit dhe falënderimit. Në të njëjtën kohë, autoriteti është një model me të cilin nxënësi dëshiron të identifikohet, pjesërisht ose në tërësi. Në rastin e dytë, paraqitet urrejtja ose ar-

<sup>113</sup> Në të vërtetë, Fromm flet për tre tipa autoriteti: racional, të pafrenuar ose irracional dhe anonim (Shih: *Zdravo društvo*, f. 109).

miqësia ndaj shfrytëzuesit, ndaj të cilit njeriu është nënshtruar, në kundërshtim të interesave të tij.<sup>114</sup>

### Autoriteti dhe e vërteta

Autoriteti racional e përhap të vërtetën me vetëdije. Kurse autoriteti irracional mbjell mashtrime ose gënjen me vetëdije në mënyrë të pandërgjegjshme.<sup>115</sup> Autoriteti racional mbështetet te dija, ai irracional te fuqia. Autoriteti racional vlerësohet në bazë të asaj çfarë thotë; ndërsa ai irracional në bazë të asaj se kush po flet. I pari na mëson, i dyti na frikëson. I pari është i fuqishëm për aq sa na ka bërë të arsyeshëm. I dyti është i fuqishëm për aq sa është e fuqishme brenda nesh frika prej tij.

Janë kuptimplotë fjalët e të atit, që duke shoqëruar të birin drejt shoqërisë së lartë e këshillon duke i thënë se kur njerëzit të kuptojnë se çfarë pozite e lartë të takon ty në shoqëri, fjalët e tua do fitojnë aq shumë peshë, saqë me kalimin e kohës do kesh shumë pak kujdes për fjalët që thua; pra do kesh mundësi të thuash edhe fjalë pa kurrfarë kuptimi, apo gënjeshtër të pakripura, por në veshët dhe shpirtin e dëgjuesve të tu këto fjalë do kumbojnë si risi dhe si fjalë të vërteta, që nuk mund të kontestohen. Për fuqinë që u ke dhënë fjalëve të tua nuk do jesh i vetëdijshëm as ti e as ata që të dëgjojnë. Përpara këtij pushteti kjo botë bie në gjunjë. “Nëse nuk je diçka nuk prish punë pse nuk je asgjë.”<sup>116</sup>

<sup>114</sup> Po aty.

<sup>115</sup> “Edhe vetë ju e dini se unë fërshëllej tek e vërteta.” (Malraux, *Antimemoari*, f. 361)

<sup>116</sup> Igo, *Jadnici*, I, Rad, Beograd, 1960. fq. 55. “Për të gjithë ne Matoja ka qenë autoritet, edhe pse mendimet e tij i kemi vlerësuar shpesh si krejtësisht të zakonshme, mesatare dhe të parëndësishme. Nga ana tjetër, fjalët tona i kemi vlerësuar si të vyera. Por, për çudi, për ne, fjalët e tij kishin një epërsi të garantuar.” (Vladan Desnica, *Proljeća Ivana Galeba*, SKZ, Beograd, 1967, f. 177-8)

Individët dhe grupet vlerësojnë jo vetëm atë çfarë thotë dikush, por edhe kush është ai që e thotë. Kjo nënkupton se ndjenjat, mendimet dhe sjelljet e individëve dhe grupeve ndryshojnë jo vetëm nën ndikimin e përmbajtjes së mesazhit, por edhe në varësi të burimit të mesazhit, që për ta mund të jetë pak apo shumë autoritativ. Vlerësimi i burimit të mesazhit transferohet në vlerësimin e përmbajtjes së mesazhit, në mënyrë që si përfundim, përmbajtja e mesazhit pushon së qenuri e rëndësishme. Përmbajtja e mesazhit konsiderohet e vërtetë, nga vetë fakti që mesazhi vjen nga një burim autoritativ. Pra, individët dhe grupet, shpeshherë nuk janë në gjendje për të ndarë në mënyrë të qartë mesazhin nga burimi i tij, që të shkëpusin kuptimin e mesazhit prej fuqisë së autoritetit. Prandaj, nisur nga fakti se këtë e ka thënë një autoritet i caktuar, e pranojnë mesazhin si të vërtetë.

Dy mesazhe të së njëjtës përmbajtje dhe formë nxisin ndikime të ndryshme, nëse njërin e shpreh autoriteti dhe tjetrin një njeri i zakonshëm.<sup>117</sup> Ndikimi i fuqishëm i mesazhit nuk është i kushtëzuar prej kuptimit të mirë të përmbajtjes së mesazhit, apo me ndonjë dallim tjetër të vetive të turmës (mesazhet mund t'i kumtohen të njëjtit grup ose dy grupeve krejtësisht të barabarta në të gjitha vetitë socio-psikologjike), por i gjithë dallimi buron prej fuqisë së autoritetit apo nga pafuqia e njeriut të zakonshëm.<sup>118</sup> Fjalët e njeriut të zakonshëm, sado të bazuara racionalisht dhe të vërteta të jenë nuk nxisin ndonjë ndikim të fuqishëm te masa, sepse njeriu i zakonshëm nuk zë ndonjë pozitë të lartë shoqërore

<sup>117</sup> Përjashtim prej këtij rregulli bën rasti kur ekziston një mosbesim i gjerë ndaj të vërtetave institucionale, apo kur opinioni i fshehtë, bazuar në vlerën informative, qëndron mbi opinionin publik.

<sup>118</sup> Ja pra pse te reklama dhe propaganda popullariteti i një prodhimi apo i ndonjë ideje lidhet me autoritetin (pushteti/autoriteti) e ndonjë personaliteti. "Këtë parfum e përdor B. B."; "Njerëzit më autoritativë lexojnë *Times*-in."

dhe nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm, që nënkupton njëfarë mase të pushtetit dhe autoritetit shoqëror. Ai nuk i ka kushtet për të qenë udhëheqës.

### **Shtirja e pushtetit të udhëheqësit (autoritetit)**

Ajo çfarë na jep të drejtë për të folur në lidhje me udhëheqësin (autoritetin) është ideja se ekziston stratifikimi në grup (shoqëri). Bass-<sup>119</sup> ka tërhequr vërejtjen se synimi për t'u bërë udhëheqës haset më shumë tek ata individë që zënë pozita të larta në grup ose tek ata të cilët gëzojnë një reputacion më të lartë. Prandaj, sipas rregullit, në grup paraqitet një pakicë aktive, që së shpejti merr kontrollin mbi sjelljen e anëtarëve të tjerë të grupit; pra, krijohet lidhshipi. Ekzistenca e një lidhshipi bëhet burimi i ndjenjës së pabarazisë sociale.

Dikur udhëheqësi e nxirrte autoritetin dhe fuqinë prej personalitetit të tij. Të tjerët e ndiqnin ngaqë ai dëshmonte vazhdimisht pushtetin, aftësinë dhe shkathtësitë për përgjegjësinë e tij. Por, me kalimin e kohës autoriteti ka pushuar së nxjerri pushtetin nga personaliteti i tij, pasi këtë e bën duke u mbështetur te pozita që ka në shkallën e hierarkisë, gjë që nuk varet shumë prej vetive vetjake që ka. Pozita që ka trashëguar apo uzurpuar individi, ose ndonjë formë tjetër, pavarësisht cilësive vetjake, – një pozitë kjo e marrë pre tij – vlerësohet lart nga anëtarët e grupit, sepse në përvojën personale dhe kolektive janë ruajtur edhe ndjenjat e tyre vetjake, fillimisht të lidhura pas udhëheqësit. Ai mund ta shpërblejë apo ta dënojë. Udhëheqësi duhet ndjekur.

<sup>119</sup> B. M. Bass, *Leadership, Psychology and Organisational Behavior*, Harper and Row, New York and Evanston, 1960, p. 326.

Dallimet në pozita brenda grupit kanë domethënien e tyre, pavarësisht nga personalitetet që i gëzojnë këto pozita.<sup>120</sup> Tanimë udhëheqësi nuk ka nevojë të dëshmohet. Ajo që e dallon kryeparin (bajraktarin) e një fisi “primitiv” nga një ministër, është fakti se ministri nuk ka nevojë të dëshmohet. Emërimi formal është vetvetiu burim i fuqisë dhe pushtetit.<sup>121</sup> Prandaj vetë pozita e kompenson nevojën për t’u dëshmuar.

Përvoja historike ofron edhe diçka tjetër: nëse njerëzit e kanë përjetuar një anëtar të grupit si udhëheqës të suksesshëm në një situatë të caktuar, ata janë të prirë ta besojnë atë, se ai do të jetë po aq i suksesshëm në një situatë krejtësisht të re. Për shembull, nëse një politikan na bind se ka një zgjidhje të mirë për një çështje të konsiderueshme shoqërore, ne do të jemi të prirë ta besojmë atë edhe për zgjidhjen e çështjeve të tjera të rëndësishme, duke mos hulumtuar arsyet *pro* ose *kundër* në raport me qëndrimet e tij edhe për çështje të tjera (“ekonomia e mendimit”). Nëse ai ka arritur të na bindë për një gjë, ai e ka përgatitur shtegun për hapin tjetër: që ne ta ndjekim aventurën e tij deri në fund.

Gjithashtu udhëheqësi është i bindur për suksesin e tij, se do të ishte një udhëheqës i suksesshëm në një situatë tjetër, por, me kushtin që situata e re të jetë e ngjashme me atë të mëparshmen, ku ai kish dalë ngadhënjyjes. Në çdo rast, ky është një grup që i përgjithëson aftësitë e udhëheqësit, dhe i zgjeron vetitë e veta edhe në situata të tjera të mundshme; ndërsa individi (udhëheqësi) është shumë më tepër i vetëdijshëm për këto rreziqe. Kështu, për shembull, një

<sup>120</sup> Po aty. f. 434-435; Identike: G. Lenski, *Power and Privilege. A Theory of Social Stratification*, New York, 1966, f. 57.

<sup>121</sup> B. E. Collins and H. Guetzkow, *A Social Psychology of Group Processes for Decision Making*, John Willey, New York, 1964, f. 47.

udhëheqës i pasuksesshëm grupi, në një situatë të mëparshme do të shmangë çdo përpjekje që të imponohet si udhëheqës, nëse situata e re është identike me atë në të cilën ai ka dështuar më parë.<sup>122</sup>

### Udhëheqësi dhe situata

Jeta shoqërore nuk mund të imagjinohet pa organizim. Por, pothuajse çdo organizim nënkupton ndarjen e punës dhe diferencimin e roleve, që janë të ndërlidhura me sasi të ndryshme të fuqisë shoqërore – pabarazisë sociale. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me një lloj të veçantë të konfliktit: ky është një konflikt midis kërkesës së situatës, e cila objektivistisht imponon diferencimin e roleve në grup dhe nevojave psikologjike të personalitetit për statusin e barabartë në grup. Ky konflikt, më së shpeshti zgjidhet në tri mënyra: a) me dorëzimin e plotë të personalitetit (“njeriu i organizatës”)<sup>123</sup>; b) eliminimin e tërësishëm të autoritetit në grup (rreziku i shpërbërjes së grupit); c) lëvizjet në domethënien e simboleve (udhëheqësi si delegat i grupit, autoriteti i zgjedhur, ndryshe nga autoriteti i imponuar).<sup>124</sup>

<sup>122</sup> Më gjerësisht B. M. Bass, f. 452.

<sup>123</sup> Statusi i udhëheqësit mund të forcohet në disa mënyra. Ja disa syresh që praktikohen më shumë: a) përqendrimi i fuqisë në duart e sundimitarit ndihmon që ai të vazhdojë të qëndrojë në pozitë; b) udhëheqësi mund t’i bëjë anëtarët e grupit të varur prej tij; c) udhëheqësi mund të mbjellë te anëtarët e grupit ndjenjën e detyrimit dhe borxhit ndaj tij, për shërbimet që tashmë janë kryer dhe për nevojat e plotësuar të anëtarëve të grupit; d) udhëheqësi mund të qëndrojë në krye të grupit, kështu që ai arrin t’i bëjë indiferentë anëtarët e grupit (për shembull, politikisht indiferentë).

<sup>124</sup> Mundësia që të zgjidhet, të mbahet apo të ndërrohet udhëheqësia perceptohet si kthim i të drejtës për vetëkontroll nga ana e anëtarëve të grupit. Një mundësi e tillë zvogëlon mundësinë e konfliktit midis udhëheqësit si simbol i detyrimit organizativ dhe jobarazisë e nevojës së individëve që të ndjehen të barabartë. (Më

Rasti i fundit e paralajmëron një prej mundësive që me siguri është shfrytëzuar fare pak në përvojën e grupit. Ky është tipi funksional i udhëheqjes (drejtimit). Me drejtimin funksional aludohet për tipin e lidërshiptit që qëndron në lidhje të drejtpërdrejtë me detyrën specifike të grupit. Është e nevojshme që lidërshipti i grupit të zgjidhet duke pasur parasysh situata specifike ku mund të ndodhet grupi, si dhe duke pasur parasysh qëllimet specifike që synon të realizojë grupi. Kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në karakteristikat e grupit ose situata të caktuara, është kurdoherë e nevojshme që të ndryshohet udhëheqja në përputhje me ndryshimet në situatën objektive. Historia është e mbushur plot me shembuj që tregojnë se udhëheqësit me nam, në një situatë të veçantë (luftë, të ilegalitetit) janë krejtësisht të paaftë krahasuar me një situatë më të zakonshme (në paqe, në situatë ligjore). Lloji i situatës kërkon një tip të caktuar udhëheqjeje. Do të ishte një sprovë e madhe që të ruhet një lloj i vjetër udhëheqjeje për situatat e reja.

### Vetitë vetjake të udhëheqësit

Studimet e vetive socio-psikologjike të udhëheqësit tregojnë se udhëheqësi duhet të jetë “i pari midis të barabartëve”, që do të thotë se sipas karakteristikave socio-psikologjike, ai nuk mund të jetë mbi anëtarin mesatar të grupit, sepse në qoftë se udhëheqësi do të ishte i pajisur me aftësi të jashtëzakonshme, dhe do të ishte shumë më lart sesa një anëtar mesatar i grupit, atëherë do të vështirësohej çdo formë e komunikimit. Anëtarët e grupit i vlerësojnë udhëheqësit për aq sa ata janë të ngjashëm me pjesëtarët tjerë të gru-

pit – me aftësitë, interesat dhe qëndrimet e tyre.<sup>125</sup> Ne i admirojmë ata që me vetitë e tyre janë identikë me ne, dhe kur i vërejmë këto veti tek ata i vlerësojmë, sepse ato janë tonat, e jo për faktin se ato veti janë objektivist të vlefshme apo se ato i gëzojnë edhe të tjerët.

Duke qenë se anëtarët e grupit i pranojnë me kënaqësi vetëm ata udhëheqës që me vetitë e tyre janë identikë, ata presin prej udhëheqësit aftësi të larta, të jashtëzakonshme: inteligjencë, dije, origjinalitet, iniciativë, këmbëngulje, pavarësi, përvojë, paanshmëri, përgjegjësi, besnikëri, praktikitet, besueshmëri, çiltërsi etj. Kriteret objektive të grupit nuk lejojnë që udhëheqësi të dallohet nga pjesa më e madhe e grupit. Pritjet subjektive të anëtarëve të grupit kërkojnë vetitë e jashtëzakonshme të udhëheqësit.

Shkurtimisht po përmendim disa veti vetjake të udhëheqësit, që në sytë e anëtarëve të grupit e bëjnë atë tërheqës.

Bindësi që dallohet me aftësi të veçanta intelektuale dhe që ka stil në paraqitjen dhe dëshmimin e qëndrimeve të tij; që e zhvillon mendimin hap pas hapi dhe rrjedhshëm, duke e argumentuar atë me të dhëna dhe fakte logjike, sidoqë të dhënat nuk duhet të jenë të sakta, as faktet nuk duhet të jenë të vërteta, ka më tepër gjasa që të jetë i pranuar si udhëheqës. “Ai foli sikur e kishte parë të vërtetën. Atij i besojnë ata që nuk e kanë kuptuar dhe heshtin ata që e kanë kuptuar.”<sup>126</sup>

<sup>125</sup> Ky fakt sqaron se pse ai që bind duhet të jetë edhe vetë anëtar i grupit (ose ka qenë), sepse anëtarët e grupit janë të pabindur ndaj të tjerëve nga grupet tjera. Punëtorët i bind me sukses punëtori; intelektualët i bind intelektualit, fshatarët – fshatari (plehun artificial nuk duhet ta reklamojë politikani apo muzikanti).

<sup>126</sup> Džordž Merdit, *Iskënjje Ricarda Feverlea*, f. 111. Nëse në turmë ekzistojnë individë që nuk janë të kushtëzuar me fjalët e oratorit, por mbeten gjakftohtë karshi *catch words*, ata nuk mund të ngelin të paprekshëm nga sjelljet e rrethit apo të individëve të tjerë. Demagogët shpeshherë sjellin në turmë grupin e simpatizantëve të

Nuk është e mjaftueshme që bindësi (udhëheqësi real apo potencial) të lërë përshtypjen e njeriut me parime të luhatura dhe me logjikë jo të fortë: është e nevojshme që turma ta konsiderojë atë si njeri me vullnet të fortë; në radhë të parë si njeri veprimtar (“action hero”). Ata të cilët janë të gatshëm që fjalët e tyre t’i kthejnë në vepra – pavarësisht nëse këto fjalë janë të vlefshme për t’u realizuar dhe pavarësisht nëse këta persona e meritojnë respektin në drejtim tjetër – kanë më shumë ndikim mbi turmat. “E shohin njerëzit: njeriu e çmon shumë vetveten, ka besim në vete dhe urdhëron – pra, ai ka të drejtë dhe duhet dëgjuar.”<sup>127</sup> “Po. Jam tërbuar nga ai pasion, nga ajo sëmundje. Ky pasion digjet dhe nxjerr flakë. Ky pasion më këput dhe më thyen nga brenda si dhembje trupore. Dua që me vullnetin tim të lë një shenjë në kohë, siç lë luani kthetrën e tij – kështu.” (Musolini)

Maskarenjtë e ndikimit të madh arrijnë të paraqiten me zhdërvjelltësi si njerëz të cilëve mund t’u besosh, jo vetëm në përditshmëri, por edhe në rastet e nevojës, atëherë kur duhet ndonjë shpëtimtar. Besimi te persona të tillë është pjesërisht i bazuar te fakti se ata kanë diçka të përbashkët me ata të cilët janë subjekte të ndikimit, – të kaluarën, kombësinë, fenë, ideologjinë, profesionin – dhe pjesërisht te kompetencat e nevojave të individit dhe grupit. Këto dy rrethana bëjnë të mundur që njerëzit të besojnë te udhëheqësit më tepër sesa te vetvetja. Edhe pse këta i mbajnë të tërhequr njerëzit në perin e gënjeshtres, deri në atë pikë sa ua sheshojnë keqkuptimet dhe mendjemprehtësinë.

tyre, që brohorasin çdo fjalë të atij që mban fjalim, dhe kështu ndikojnë mbi të tjerët që ta besojnë më lehtë “rrugën e vërtetë” që u tregon oratori.

<sup>127</sup> I. S. Turgenjev, *Dim*, Matica hrvatska, Zagreb, 1963, f. 28. “Sa të dëmshëm për shoqërinë dhe për individët mund të jenë njerëzit, që për shkak të moskufizimit të tyre, besojnë në mendjen e vet deri në pakufi; për vlerën dhe saktësinë e çdo gjykimi dhe përfundimi të tyre.” (Andrić, *Prokleta avlija*, f. 69-70)

Deri më tani nuk njohim ndonjë bindës i cili nuk ka premtuar se do t'i përmbushë deri në fund pritshmëritë e atyre që e ndjekin verbërisht. Logjika është krejtësisht e thjeshtë:

“Ju doni që të përmbushni  $x$  nevojë tuajën – unë do t'ju tregoj se si ta përmbushni. Më ndiqni dhe nevoja juaj do të përmbushet.”<sup>128</sup> “Unë jam alfa dhe omega, fillimi dhe fundi. Unë do t'ia shuaj etjen të eturit pa asnjë interes.”<sup>129</sup> “Unë jam buka që kam zbritur prej qiellit.”<sup>130</sup> Nuk ka bindës të tillë, udhëheqës që do të pyeste vetveten se a kam të drejtë hyjnore dhe njerëzore që t'ua imponoj vullnetin tim të tjerëve, që të vendos për fatin e tyre?!

Është shumë e rëndësishme që bindësi ta paraqesë vetveten në sytë e udhëheqësit si një njeri i cili është i gatshëm që të marrë përgjegjësi individuale në një moment të vështirë. Duke marrë përgjegjësi mbi veten, ai i çliron të gjithë të tjerët nga përgjegjësia, por me kushtin që ata të veprojnë ashtu siç dëshiron ai.<sup>131</sup> Domethënë, të heqin dorë prej lirisë së tyre. Në situata të tensionuara socio-psikologjike, njerëzit e ndjenë nevojën për të pasur udhëheqës dhe janë të prirë që ta transferojnë përgjegjësinë e tyre mbi udhëheqësin.

Ata e çlirojnë vetveten prej mundimit të madh që shfaqen çdo çast me vendime të rëndësishme, dhe në njëfarë mënyre përgjegjësia për pasojat transferohet te dikush jashtë vetes. Nevoja për autoritetin (udhëheqësin) është shprehje e nevojës për shmangien e përgjegjësisë.

<sup>128</sup> Charles U. Larson, *Persuasion*, Wadsworth Publishing Company, Belmont, California, 1973, f. 83.

<sup>129</sup> *Zbulesa e Gjonit*, ka 21, parag. 6; “Përnjëmend, përnjëmend, po ju them: kush e dëgjon dhe e beson fjalën time dhe i beson atij që më ka dërguar mua, ka jetën e amshuar, dhe nuk vjen para gjyqi, por ka kaluar prej vdekjes në jetë.” (*Ungjilli sipas Gjonit*, kap. 5, parag. 24)

<sup>130</sup> *Ungjilli sipas Gjonit*, kap. 6, parag. 41

<sup>131</sup> “Dhe secili që i dëgjon fjalët e mia dhe nuk iu përmbahet, ai do të jetë si i çmenduri që e bën shtëpinë e tij në rërë.” (*Ungjilli sipas Mateut*, kap. 7, parag. 26)

Ne nuk parandiejmë (nëse nuk jemi aktorë) se sa përfiton bindësi jo vetëm me fjalë, por edhe me shenja të tjera – pamje, lëvizje, grimasa, gjeste etj. – e që mesazhin e tij e bëjnë më bindës nga ç’ mund ta bëjnë vetë fjalët, veçanërisht në situata emocionale të ngarkuara. Sytë flasin bashkë me gjuhën, duart sqarojnë, trupi flet (“body language”). “Ndoshta nga ajo që është thënë nuk do të mbetet edhe aq, sikur nga ajo të hiqej shikimi, zëri dhe shprehja e fytyrës, sepse të gjitha këto i përkasin kësaj, ndërsa tek ai (bindësi) këto janë të lidhura me personalen, në një shkallë më të lartë dhe me këtë” – do ta merrja guximin të thosha: e kushtëzuar deri në palcën e së vërtetës, kështu që më në fund, pa premisa dhe përkrahje personale, kjo e vërtetë nuk është më reale.”<sup>132</sup> “A është gjuha e fjalëve e vetmja gjuhë e mendimeve”, – pyeste Marx-i i ri.

Edhe më pak ndiejmë që këto mesazhe të heshtura nuk shërbejnë vetëm për lehtësimin e komunikimit emocional, por edhe për përmbajtje dhe forcim të rendit ekzistues, sepse edhe këto shenja të fuqishme janë të ngjyrosura me kuptimet e statusit dhe pushtetit. Krahas organizmit të fjalëve me kujdes, të cilat robërojnë shpirtin njerëzor, “prijësit magnetikë” (“realë apo potencialë”) pushtojnë zemrat e njerëzve nëpërmjet një planifikimi të shkathët të ndershmërisë dhe spontanitetit. Sa më shumë ta vlerësojnë turmat bindësin (manipuluesin), pavarësisht mesazheve joverbale, aq më shumë do të ketë ndikim mbi turmën mesazhi verbal. Për aq sa bindësi kërkon ndryshim rrënjësor të opinionit, me shumë gjasa ky veprim shkakton efekte më të fuqishme mbi masën, po aq sa kanë qenë të fuqishme mesazhet e heshtura të tij. Shfrytëzimi me mjete joverbale edhe në këtë rast tërheq interesimin se udhëheqësi nuk e çan kokën për t’i shpje-

<sup>132</sup> Mann, *Lora u Vajmaru*, Novo Pokolenje, Beograd, 1953, f. 86. “Në shesh bindja arrihet me shkathësi.” (Nietzsche).

guar diçka turmës, por që ta bindë dhe udhëheqë atë. “Me autoritetin irracional racionalja del nga moda.”<sup>133</sup>

Tanimë e kam theksuar se udhëheqësi duhet të jetë “i pari midis të barabartëve”, dhe se duhet të ketë disa tipare të përbashkëta me turmën. Ai nuk vjen nga institutet shkencore apo shoqatat e artistëve: ai nuk kërkohet gjatë dhe me kujdes; ai gjendet midis atyre që i ngjasojnë atij, të cilët e bëjnë udhëheqës, sepse ai iu nevojitet atyre; ai nuk bie nga lart, atë e ngre turma mbi vetveten që ta kryqëzojë në qiell.<sup>134</sup> Prandaj, për këtë arsye është e mundur që turma të njësohet me prijësin. Masa nuk njësohet me prijësin në mënyrë të pastër racionale; pra, që mbi bazën e kriterëve racionale të ketë adoptuar idetë e saj. Turma njësohet me prijësin edhe në mënyrë të pavetëdijshme; pra duke e futur atë në vetvete.<sup>135</sup> “Turma psikologjike është një grup individësh të cilët të njëjtin person e kanë futur në Superego, dhe që në bazë të kësaj të përbashkëta janë identifikuar midis njëritjetrit me Unin e tyre. Në të vërtetë, kjo formulë vlen vetëm për turmat që kanë udhëheqës.”<sup>136</sup>

“Mësuesit e iluzioneve” zakonisht janë “oratorë me zjarrin e fuqisë dhe forcës sugjестive”, të cilët me vizionet e tyre të zjarrta i pushtojnë me hov shpirtrat. Prandaj, prej gojës së tyre nuk dalin fjalë, por gufojnë shkopinjtë të zjarrtë; njëfarë fuqie personale iu dhuron fjalëve të tyre zjarr dhe lëvizje. Ajri dhe shpirti fërgëllojnë nga këto fjalë. Këto fjalë duhen

<sup>133</sup> Fromm, *Zdravo drustvo*, f. 157-8.

<sup>134</sup> Për këtë shih: R. F. Miler, *Stada i pastiri*. Vođe i buntovnici. Ko i kako narode vodi i zavodi i za čim ludi čovečanstvo. Narodno delo, Beograd, 1934.

<sup>135</sup> “Është i mirënjohur fakti se njeriu mund të njësohet me një individ apo me diçka në mënyrë të pavetëdijshme.” (C. G. Jung, *Çovjek i njegov simboli*, Mladost, Zagreb, 1973, f. 24); Freud, *Nova Predavanja*, Matica srpska, Novi Sad, 1969, f. 152.

<sup>136</sup> Freud, *Nova predavanja*, f. 157. “Ju akoma nuk e kishit kërkuar vetveten, atëherë gjetët mua.” (Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, Mladost, Zagreb, 1975, f. 70.)

besuar; ato nuk mund të mendohen aspak.<sup>137</sup> “Jam bërë i gjithi gojë dhe zhurma e lumit prej shkëmbinjve të lartë. Dua që fjalimi im të rrënohet në greminë.”<sup>138</sup>

Vjen koha e diktatorëve shpirtërorë, të cilët nuk lëshojnë në urdhra, por tashmë ofrojnë këshilla. A do ta nxjerrin revolucionin në pension këta mashtrues shpirtërorë? – pyesin të gjithë ata që duan të dinë se kontrolli nuk do ua ndërrojë lirinë. Përderisa dy të fundit jetojnë në shoqërinë e organizuar në klasa, njëri do të prijë e tjetri do ta ndjekë, me ç’rast i pari do bindë të dytin se ndjekja që është duke bërë është me vend. Shoqëria e organizuar në klasa e ka rrënjosur thellë në mendjen e vetëdijshme dhe në nënvetëdijen e anëtarëve të saj strukturën e saj, saqë mund të themi se pabarazia njerëzore, në njëfarë kuptimi e ka mënjanuar nevojën e natyrshme të njeriut për barazi.<sup>139</sup> Në këtë lloj organizmi shoqëror më parë do vdesë populli se pushteti. Nuk kam dëgjuar akoma për grigjën që nuk ka shkuar pas bariut të vet.<sup>140</sup> Dhe për aq sa bariu i fundit rron akoma, ne mund të presim ta dëgjojmë zërin e tij vendimtar:

“Marr përsipër pastrimin e mendjes suaj.”<sup>141</sup>

<sup>137</sup> Të përmbyesësh – për të kjo nënkupton të dëshmosh. Të mashtrosh – sipas tij do të thotë të bindësh. Ndërsa gjakun e konsideron një prej arsyeve më të mira. (Nietzsche, po aty, f. 46)

<sup>138</sup> Nietzsche, po aty, f. 76.

<sup>139</sup> “Ndjenjën e njeriut për vlerën e tij, lirinë, tanimë duhet zgjuar në gjoksin e tij. Vetëm kjo ndjenjë, që te grekët lindi nga bota, e me të krishterët humbi në kaltërsitë e qiellit, mund të krijohet rishitazi nga shoqëria/ bashkësia për realizmin e qëllimeve të saj më të epërme.” (Marks-Engels, *Rani radovi*, f. 32)

<sup>140</sup> “Me barinjët e tyre në krye, ne jemi gjetur vetëm një herë në shoqërim të lirisë, në ditën e varrimit të saj” (Marks-Engels, *Rani radovi*, f. 74) “Në të vërtetë, dhe këta iu përkisnin deleve” – thotë Niçe.

<sup>141</sup> Igo, *Çovek koji se smeje*, Rad, Beograd 1959, f. 308. “Ekzistojnë dy të këqija: të jesh i pafuqishëm dhe për këtë të jesh në rrezik nga robërimi ose të kesh fuqi dhe për këtë të jesh në rrezik nga dehumanizimi” (Erich Fromm, *Anatomia ljudske destruktivnosti*, II, Naprijed, Zagreb 1975, f. 115). “Në të gjitha shoqëritë e strukturuara

## MESAZHI

*“Fjala është arma jonë e vetme.”*

Anatole France

Kush i sheh fjalët vetëm si një mjet për marrëveshje midis njerëzve, ai i heq vetes mundësinë që të kuptojë se fjalët kanë edhe funksione të tjera që nuk janë më pak të rëndësishme se nevoja për të shprehur mendimet dhe për t’u dhënë kuptim këtyre mendimeve. “Njerëzve iu nevojiten fjalët edhe jashtë kuptimit të tyre.”<sup>142</sup>

### Roli i fjalëve

Roli i parë i fjalëve përbëhet nga emërimi i fenomeneve, dhe vetëm kur ato marrin emër, atëherë ndahen nga bota pa emër (bota misterioze). Për ne fjalët ekzistojnë në një formë të përshtatshme për komunikim.<sup>143</sup> Nuk është për t’u çuditur se pse njerëzit, në radhë të parë, emërojnë ato fenomene që kanë rëndësi jetike për ta, si dhe për faktin se në fjalorin e tyre këto fenomene zënë vendin më të lartë. Komбет që jetojnë me gjueti e kanë jashtëzakonisht të gjatë listën e shprehjeve për të dalluar kafshët. Ndërsa ata që janë të lidhur me punimin e tokës kanë zhvilluar një aftësi të jashtëzakonshme për të vrojtuar dhe emëruar bimë të ndryshme.

me hierarki, dëgjueshmëria ndoshta është vija më thellë e mbjellur. Ajo është e barazuar me virtytin, ndërsa jodëgjueshmëria me mëkatën.” (po aty, f. 32).

<sup>142</sup> V. B. Šklovski, *Uskrsnuće riječi*, Stvarnost, Zagreb, 1969. f. 27.

<sup>143</sup> “Njeriu është i detyruar që për çdo gjë të veprimtari si Adami: të emërtojë diçka dhe që ajo gjë të ekzistojë për të.” (Marks, *Biokratija i javnost*, Vuk Karadžić, Beograd, 1965, f. 54)

Ato kombe që kanë farefisninë si burim sundimi kanë një fjalor të gjerë për farefisninë.<sup>144</sup> Eskimezët, për të cilët bora është gjithçka, kanë tetë fjalë për dëborën, pasi ata nuk kanë një shprehje të gjerë për dëborën. Beduinët kanë njëzet fjalë për devenë. Thomas-i thotë se në gjuhën arabe ekzistojnë rreth gjashtëmijë sinonime që në njëfarë mënyre janë të lidhura me “devenë”.<sup>145</sup> Te fjalët përmbahet dhe shprehet pozita e njerëzve në botën natyrore dhe shoqërore, si dhe këndvështrimi mbi botën që lidhet me këtë pozitë.

Roli i dytë është te përshtatja e qenieve njerëzore me disa sfida të mjedisit natyror dhe socio-ekonomik. Nuk përshtatet vetëm trupi, por edhe shpirti. Çdo ngjarje e rëndësishme që ka të bëjë me jetën dhe vdekjen kërkon që t'i përshtatemi, dhe fjalët janë aty për të na përgatitur jo vetëm se si të jetojmë, por edhe si të vdesim.

“Do të më qetësonte muzikaliteti i fjalëve të njohura, të cilave u besoj, për të cilat madje as nuk mendoj se i mbaj në gjakun tim. Ne nuk jemi të vetëdijshëm për këtë, ndërsa ato na mundësojnë të jetojmë dhe të marrim frymë; na mbajnë drejt, i japin kuptim gjithçkaje. Gjithnjë me ka habitur ajo kolonë fjalësh të bukura për gjërat që di. Në këtë rreth të njohur ku lëviz, ndjehem i sigurt, pa kurthet me të cilat kërcejnë njerëzit dhe bota.”<sup>146</sup>

Ne shohim se roli i fjalëve nuk lidhet vetëm me kuptimin e tyre (me atë që shënjojnë), por edhe me fuqinë<sup>147</sup>, me

<sup>144</sup> *Antropologija danas*, Vuk Karadžić, Beograd, 1972, f. 494; Klod Levi-Stros, *Divija misao*, Nolit, Beograd, 1966.

<sup>145</sup> Shih: D. Kreč, R. S. Kračfeld, I. L. Balaki, *Pojedinac u društvu*, Udžbenik socijalne psihologije, Beograd 1972, f. 279-312; Ranko Bugarski, *Jezik i lingvistika*, Nolit, Beograd, 1972, f. 189.

<sup>146</sup> Meša Selimović, *Deroiš i smrt*, Srpska književna zadruga, Beograd, 1969, f. 41-42.

<sup>147</sup> “Për vetëdijen primitive të indigjenit, sikurse edhe për fëmijën, fjala ka fuqi dhe shërben për të arritur diçka.” (Otto Jespersen, *Čovječanstvo, narod i poedinac sa lingvističkog stanovišta*, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo, 1970, f. 17. “Filli-

atë çfarë nxisin. Pra, tani fjala vështirësohet nga ana e fuqisë së saj për të shkaktuar ndjenja, bindje, mendime dhe vepra, e jo nga këndvështrimi i kuptimit të fjalës në fjali. Kuptimi i fjalëve ndryshon në varësi të kontekstit socio-psikologjik. Një njeri mund ta ndryshojë botën e një njeriu tjetër në atë mënyrë që të fusë në botën e tij fjalë të cilat do e ndryshojnë atë me themel, duke e orientuar ndaj disa vlerave të tjera, për të cilat as që ka menduar më parë. Fjalët janë armët me të cilat ndryshohet bota. “Ai e di se çfarë kam menduar ndërkohë që ti ishe duke folur. Disa njerëz mund të thonë gjithçka që dëshirojnë, dhe mund t’i pranosh apo t’i refuzosh, ose mund të mbetesh i qetë kundruall mendimeve të shprehura. Ndërsa disa të tjerë e fusin veten në një fjalë dhe gjithçka merr zjarr, askush nuk ngelet i qetë. Ndjejmë se diçka e rëndësishme është duke ndodhur. Kjo nuk është më bisedë.”<sup>148</sup> Në atë botë që është e mbushur me një larushi fenomenesh, ne orientohemi nëpërmjet fjalëve. Fjalët nuk na lejojnë që të humbasim rrugën, sepse na e tërheqin vazhdimisht vëmendjen për fenomenet që mund të na atakojnë apo me të cilat mund të bëjmë diçka.<sup>149</sup>

Në këtë rast fjalët nuk na shërbejnë për të pagëzuar fenomenet, por që të na orientojnë se në ç’drejtim mund të veprojmë. Vetë fjalët na çojnë atje ku mundemi, atje ku na duhet të veprojmë. Porsa e dëgjojmë një fjalë, le të themi “gjarpri”, përveç të gjitha anëve që përmban, veçohet ajo

misht fjalët kanë qenë magji, por fjala edhe sot ka ruajtur shumë nga fuqia e dikurshme magjike. Përmes fjalës një njeri mund ta gëzojë ose ta çojë në dëshpërim një tjetër. Mësuesi ua jep dijen nxënësve me fjalë. Po me fjalë oratori entuziazmon dëgjuesit dhe përcakton gjykimet dhe vendimet e tyre. Fjalët shkaktojnë afekte, dhe në përgjithësi janë mjete që njerëzit të ndikojnë mbi njëri-tjetrin.” (Freud, *Uvod u psihoanalizu*, f. 13)

<sup>148</sup> Meša Selimović, *Derviš i smrt*, f. 89.

<sup>149</sup> Shih Fung Ju-Lan, *Istorija kineske filozofije*, Nolit, Beograd, 1971.

anë që na orienton se si duhet të sillemi me gjarprin (ta lëmë të kalojë, ta mbysim etj.).

Nëpërmjet fjalëve mund të sundohen turmat, dhe ato të mos jenë fare në dijeni për këtë; dhe kësisoj, kontrolli i gjuhës ka një domethënie parësore për ata që mbajnë pushtetin. “Nuk po e kupton? Te fjala *patriotizëm* kanë futur të gjitha frazat: etjen e tyre për pushtet, romantikën e tyre dyfytërëshe, marrëzinë e tyre dhe babëzinë tregtare..., dhe pastaj na e kanë paraqitur atë si një ideal të shkëlqyer. Kështu ne kemi besuar se kjo është një thirrje zgjimi për një jetë të re, të fuqishme e të madhe. Nuk po e kupton? Ne kemi luftuar kundër vetvetes pa e ditur. Çdo e shtënë goditi njërin prej nesh. Dëgjo dhe mbaje mend mirë: të rinjtë janë ngritur në këmbë në të gjithë botën, dhe kjo rini mendon se po lufton për lirinë. Në çdo vend kjo rini është mashtruar dhe keqpërdorur. Në çdo vend ajo ka luftuar për interesa dhe jo për ideale. Në çdo vend rinia është vrrarë dhe është shfarosur. Nuk po e kupton? Është vetëm një luftë e vetme: lufta kundër gënjeshtërs, gjysmakes, kompromisit, kundër të vjetrës. Ne ia lejuam vetes që të na mashtrojnë frazat e tyre, dhe në vend që të luftojmë kundër tyre, ne luftuam për ta. Ne mendonim se po luftohej për të ardhmen. E ardhmja jonë është e vdekur, sepse rinia që e mbante atë është e vdekur. Ne jemi vetëm mbeturinat e ngelura pas. Por, ajo tjetra jeton si kurrë më parë; ajo e ngopura dhe e kënaqura. Sepse të pakënaqurit janë kryengritës dhe kanë dhënë jetën për këtë. Imagjino: është shkatërruar një brez i tërë. Një brez përplot me shpresë, besim, vullnet, energji dhe fuqi është hipnotizuar në atë farë mase sa ka vrrarë veten, edhe pse në gjithë botën ka patur të njëjtat objektiva.”<sup>150</sup>

<sup>150</sup> Remarque, *Povratak*, Keršovani, Rijeka, 1966, f. 178.

Fjala bashkon, fjala përçan. Në mungesë të mjeteve të tjera të kohezionit, fjala i lidh individët në bashkësi, dhe ata bëhen vëllezër sipas Krishtit ose Marx-it. “Duke marrë këtë qëndrim ne theksojmë funksionin e gjuhës, që i bashkon dhe i unifikon të gjithë anëtarët e një komuniteti; domethënë, thekson natyrën kombëtare në llogari të individuale.”<sup>151</sup> Por, fjalët mund të jenë edhe tregues të sigurt të largimit (distancës) midis grupeve shoqërore. Fjala tërheq vërejtjen për mbylljen e grupeve shoqërore, për diferencimin kombëtar, klasor dhe për mungesën e komunikimit të vërtetë mes tyre.

Dallimet në kuptimin e fjalëve rriten në mënyrë proporcionale me ndryshimet kombëtare dhe sociale, kështu që nga dallimet e rëndësishme në gjuhën e grupeve të mëdha shoqërore, me një dozë të caktuar sigurie mund të përmbylim distancën socio-psikologjike midis tyre. Prandaj, fjalët kanë rol integrues (i bashkojnë individët në grup), por edhe çintegrues (i largojnë individët e një grupi nga grupi tjetër).

Fjalët na zbulojnë. Fjala ose fjalia e parë e thënë, e jep menjëherë mundësinë që të merret vesh se kush jemi, çfarë jemi dhe çfarë synojmë. Kur themi një hero nga vepra e Balzac-ut ka deklaruar: “Në fund të fundit, unë jam tërhequr në prapavijë dhe këtu i kam hapur gropën vetes, si një zog i vogël”<sup>152</sup>, nuk është e vështirë për të identifikuar atë individ që është shumë i ngjashëm me profesionin e tij. Prej gjuhës që ai flet ne jemi të aftë për të gjetur se cilit grup i përket, apo se çfarë pune bën. Jo rastësisht kam veçuar gjuhën e personazheve të letërsisë. “Ajo (letërsia) mban mbi supe barrën që para çdo mesazhi, në radhë të parë të ofrojë pozitën e drejtpërdrejtë të njerëzve të ndërtuar në gjuhën e klasës së

<sup>151</sup> Otto Jespersen, op. cit., f. 80.

<sup>152</sup> Seljaci, f. 446.

tyre, vendlindjes, fisit të tyre, trashëgimisë apo historisë së tyre.”<sup>153</sup>

Grupet i lidhin njerëzit me forma të veçanta shprehjeje, dhe kur ndjejmë se anëtarët e grupit shprehen në një mënyrë të ngjashme, ne mendojmë se ata identifikohen fuqimisht me grupin të cilit në fakt i përkasin vetë. Nëse kujtojmë se anëtarët e grupeve të veçanta flasin kryesisht me një fjalor identik, ne mendojmë se gjuha e grupeve barazohet dhe, me siguri që shkon puna deri te një krizë identiteti.

Edhe pse fjala e zbulon pa mëshirë atë që shpreh, në anën tjetër, me anë të fjalëve gjërat mund të fshihen me sukses. Fjalët zbulojnë deri na atë pikë, për aq sa motivet e vepërimeve tona përputhen me qëllimet e shprehura gjuhësisht. Por, në çastin që motivet e vërteta i demonstrojmë me fjalët që i shprehim dhe i përshkruajnë ato në mënyrë të tërthortë dhe të shtrembër, fjalët fshehin realitetin. Fjalët e bukura dhe të ngjyera në mjaltë, shpeshherë fshehin punë të ndyra dhe shumë të këqija. “Liria është një fjalë e madhe, por nën flamurin e lirisë, industrinë kanë zhvilluar luftërat më të dëmshme; nën flamurin e lirisë së punës janë plaçkitur punëtorët. Një gënjeshtër e tillë e brendshme fshihet në përdorimin e fjalës së sotme «liria e kritikës».”<sup>154</sup>

Shkëmbimi i ndërsjellë i fjalëve që bartin domethënie të veçanta, nënkupton që njerëzit merren vesh, por jo edhe që pajtohen në tërësi rreth një çështjeje të cilën e shprehin me fjalë. Në të dy rastet, megjithatë, fjala shërben si një mjet për t’u marrë vesh. Dhe, për aq sa në bisedë pajtohen qarqet e kuptimit të fjalëve, të dyja palët merren vesh shumë mirë, por sapo kuptimi i fjalëve lëviz nga kuptimi i tyre i zakonshëm, dalin në pah vështirësitë ose madje edhe ndërprerja e

<sup>153</sup> Barthes, *Književnost, mitologija, semiologija*, Nolit, Beograd, 1971, f. 79.

<sup>154</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, Kultura, Beograd, 1960, f. 229-30.

komunikimit. “Ai që flet depërton në horizontin e dëgjuesit, dhe ndërton rrëfimin e tij në një territor të huaj.”<sup>155</sup>

Nga paraqitja e deritanishme pamë se si ka shërbyer fjala për realizim e qëllimeve të ndryshme dhe se si ka qenë e lidhur me qarqe të ndryshme socio-psikologjike. Në përfundim do tërheqin vëmendjen për mundësinë e fjalëve që të çlirohen prej perandorisë së domosdoshmërisë, dhe që të luajnë në fushën e perandorisë së lirisë. Në të vërtetë, liria nuk nënkupton heqje dorë nga të gjitha rregullat e lojës, por është e rëndësishme që fjala të lirohet prej kontekstit shoqëror dhe të hyjë në lidhje me fjalët e tjera, përmes të cilave ndërtohet një botë e re, një botë e tërë fjalësh, aspak më reale se bota e fjalëve – në botën e letërsisë, ku forma qëndron mbi përmbajtjen. “Në fund të fundit ky nuk është një diskutim vetëm për të bindur dikë për diçka; të sigurojë apo të mos lejojë që ai/ajo të gabojë. Biseda mund të jetë e këndshme, madje më shumë se e nevojshme (për shpirtin) dhe, thjesht pa ndonjë qëllim të fundit, radhitja, alternimi, kundërthënia në mendime, paraqitja e disponimit, ndërrimi i qëndrimeve nuk do e paraqisnin domethënien dhe qëllimin e kësaj bisede. Pra, nuk ndodh radhitja, alternimi, vënia ballë për ballë e temave në një simfoni ngaqë në fund duhet bindur dikush për diçka, por që të dëshmohet diçka para dikujt.”<sup>156</sup>

### Njeriu vdes, fjala jeton

Njeriu i shkolluar i epokës sonë nuk di t’i lexojë fjalët, sepse sikur të shkëputej për një kohë të shkurtër nga vrapi-

<sup>155</sup> Mihail Bahtin, “Reç u poeziji i reç u prozi”, *Treći program*, Jesen, 1972, f.160.

<sup>156</sup> Vladan Desnica, *Proljeća Ivana Galeba*, SKZ, Beograd, 1967, f. 218. “Atë e rrihte ëmbëlsia e fjalëve të tij, sepse ishte i bindur se kishte të drejtë për ëmbëlsinë, prandaj dhe as që u mundua fare që të depëronte në kuptimin e tyre të brendshëm.” (Man, *Legenda o Josipu*, I, f. 537)

mi pas gjërave dhe me gjërat, e ta kthente vëmendjen së paku te një fjalë e vetme nga lumi i fjalëve që rrjedhin çdo ditë nga buzët e tij, nga ajo fjalë do zbulonte një thesar të tërë të jetës dhe shpirtit, për të cilin arsyeja praktike e tij as që kish menduar, dhe do duhej të pranonte: kur është fjala për fjalët mbetem pa fjalë.

Shoqëria, te fjala, si te argjila, e ka skalitur strukturën e saj, feja Perëndinë e vet, filozofia të gjitha dyshimet e saj, ideologjia interesin e vet, politika fuqinë e saj, shkencat të vërtetën e vet, artet shijet e tyre, miti pritjet e tij, morali virtytet e tij, arsyeja e shëndoshë përvojën e vet, natyra ngjyrat e saj, tingujt, aromat...

Fjala është populluar dhe mbipopulluar me shtresa të ndryshme kuptimi<sup>157</sup> dhe pikërisht për këtë, fjala mund të prekë në të gjitha shtresat e qenies sonë: te e vetëdijshmja, e paravetëdijshmja dhe te e pavetëdijshmja.<sup>158</sup>

Fjala është e mbingarkuar dhe njeriu duhet të jetë i mahnitur se sa shumë ngjyra ndodhen në atë krijesë të butë: aroma, shije, ndjenja, besime, mendime, forma, lëvizje, hapësirë, kohë... gjithçka që është vendosur aty në udhëtimin e gjatë të fjalës për të arritur te ne. Njerëzit jetojnë te fjalët e tyre – kjo nuk është një shprehje bosh. Njeriu vdes, ndërsa fjala rron dhe na flet për të. "Sepse, për sa më takon mua, fjala më informon më shumë për dikë sesa vepra, dhe besoj se do të humbja më pak nëse do humbja shikimin; dhe do të humbja më shumë nëse do më linte dëgjimi."<sup>159</sup>

<sup>157</sup> "Kuptimi. Një mori njohurish, ndjenjash dhe tendencash vepruese që shkakton simboli." (Kreč, po aty)

<sup>158</sup> Fjalët: nëna, gjaku, dashuria, vendlindja etj., zgjojnë tek ne me dhjetëra asociime ndjenjash.

<sup>159</sup> Andre Žid, *Kovači lažnog novca*, Prosveta, Beograd, 1961, f. 435. "Shumë prej nesh ka humbur të parit, sepse po e shohim botën me sy të huaj. Pak nga ne kanë

Fjala është si vetëtima në errësirë: ajo ndriçon gjurmët që na çojnë në realitetin natyror dhe shoqëror ku ajo është e zhytur. Në të jeton vetëm ajo që tashmë ka vdekur.

“Shpirti është ai që jep jetë: trupi nuk mund të bëjë asgjë. Fjalët që u thashë janë shpirt, janë jetë.”<sup>160</sup>

Mbetet një mister se si lidhja e njeriut me natyrën dhe marrëdhëniet e tij shoqërore kanë lëvizur në fjalë dhe fjali, dhe se si në mungesë të këtyre marrëdhënieve aktuale ne kuptojmë strukturën e tyre, përmes strukturës së fjalëve dhe fjalive. Sepse, për shembull, çfarë lidhjeje ka një ligj shkencor, i hartuar në formën e një fjalie, me marrëdhëniet ndërmjet gjërave? Dhe, si nga ky ligj, që është i gjithë me fjalë dhe me marrëdhëniet mes tyre, mund të arrijmë deri te marrëdhëniet midis vetë gjërave? Si është e mundur që nga përshkrimi i një katedraleje, të dimë me saktësi se me cilën katedrale kemi të bëjmë? Se si nga një metaforë e zakonshme, “i ka parë të gjithë yjet”, mund të përfundojmë se me të vërtetë dikush qenka goditur keq! Sikur mbi të gjitha marrëdhëniet e vërteta qëndron pezull sozia e tij shpirtërore, që e përshkruan me saktësi atë, dhe nuk është një kopje e tij shpirtërore.

Edhe pse marrëdhënia midis strukturës së fjalëve (apo fjalive) dhe strukturës së vetë realitetit mbetet në errësirë, ajo që pa dyshim ekziston është në faktin se te fjalët është ruajtur struktura e realitetit, dhe se mbi këtë realitet mund të ndikohet me fjalë.

Sepse sikur fjalët të ishin plotësisht të pavarura nga realiteti, ato nuk do mund të vepronin mbi të.

mbetur që mund të dëgjojnë, sepse në vdekje e sipër është zakoni që me të vërtetë ta dëgjojmë atë që na thonë të afërmit.”

<sup>160</sup>Ungjilli sipas Gjonit, kap. 6, parag. 63. “Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë.” (Ungjilli sipas Markut, kap. 13, parag. 31)

## Karakteristikat e mesazhit

1. Përvoja e përditshme konfirmon se nuk është e thjeshtë apo s'ka rëndësi se kush e bën publik një mesazh (lajm, ide, informacion), Perëndia, Papa, komiteti, udhëheqësi, heroi i luftës, një shkrimtar me autoritet, një sportist i dalluar, një yll kinemaje apo televizioni, një gazetar i njohur, analisti apo një qytetar i zakonshëm, mesazhi fiton në bindshmëri nëse ai lidhet me një burim të fuqishëm dhe me autoritet.

Njeriu i beson asaj që dëgjon ose atë që lexon nëpër gazeta, pavarësisht faktit se a e kupton apo jo.<sup>161</sup> Për të gazetat janë autoritet, dhe autoritetit duhet besuar. Pavarësisht nga të gjitha rrethanat e tjera, burimi autoritativ i mesazhit mjafton që t'i shkaktojë këto apo ato ndryshime në ndjenja, bindje, qëndrime dhe të sjelljet e njerëzve. Suksesi i mesazhit nuk varet nga vlera e tij, por nga autoriteti i atij që e lëshon mesazhin në turmë.

Suksesi i mesazhit nuk varet nga vlera (njohëse, morale, artistike etj.). Por, vlera mund të verifikohet edhe me një veprim të kundërt. Në qoftë se një burim me autoritet e përzien të vërtetën me gënjeshtër në mënyrë sistematike, apo mashtron opinionin me gënjeshtër të pastra, ka të ngjarë që në një kohë të përshtatshme, i njëjti opinion t'i kthejë shpinën atij dhe të kërkojë një mjeshtër tjetër për formimin e opinionit publik, të cilin në atë moment nuk e vlerëson si mashtrues. Ndodh që një opinion i tillë i vlerëson si gënjeshtër edhe ato të vërteta që vijnë nga burimet e pabesuesh-

<sup>161</sup> "Shumica e njerëzve beson te Zoti dhe e pranon faktin se Zoti ekziston. Ata që nuk besojnë e pranojnë si fakt mosekzistencën e Tij. Në të dy rastet ky besim pranohet pa ndonjë paramendim. As mosbesimi, as besimi nuk çojnë në netët me ankth, apo të ndonjë shqetësim i caktuar." (From, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 178) Vladeta Jerotić, *Psihoanaliza i kultura*, BIGZ, Beograd, 1974, f. 47.

me, sepse nuk dyshohet më te vlera e atij apo këtij mesazhi, por te besueshmëria e vetë burimit, pra te autoriteti.

Mesazhi vlerësohet si jo i vërtetë për faktin se vjen prej një burimi të pabesueshëm, e jo për faktin se mesazhi është i rremë.

2. Prej dy mesazheve me të njëjtën përmbajtje, domethënë, me vlera të barabarta njohurish, një ndikim më të fuqishëm do të ketë mesazhi që përbëhet nga fjalë që janë të ngjeshura me kuptim emocional (“cat words”).<sup>162</sup> Për aq sa njerëzit dëgjojnë apo lexojnë fjalën e një demagogu të shka-thët, kanë ndjesinë se çdo fjalë ngulitet brenda tyre si thika në zemër. Këto fjalë i ngrenë ata në ato lartësi nga ku ata i bëjnë ballë përditshmërisë dhe konformitetit të përgjithshëm. Ky është zjarri që i ka dhënë Zoti gjuhës<sup>163</sup>; ajo barrë emocionale që përmbajnë disa fjalë; ajo kompaktësi e mbushur me zjarr dhe kuptim që ndjehet menjëherë kur njerëzit largohen nga gjuha e thatë, nga gjuha e mbyllur teknike, nga gjuha e filozofisë dhe e publicistikës së përditshme.

“Qytetarë!

Dje keni parë mizoritë e qeverisë së vetëzgjedhur. Keni parë gjakun që ka rrjedhur rrugëve. Keni parë me qindra luftëtarëve të vrarë për çështjen punëtore. Ju keni parë vdekjen. Ju keni dëgjuar kukamat e grave të plagosura dhe britmat e fëmijëve të pafuqishëm. Me gjakun dhe trurin e punëtorëve është spërkatur kalldrëmi, të cilën e kanë shtruar ata

<sup>162</sup> “Edhe te ne ata thonë dy herë dy bëjnë katër, por te ne kjo thuhet disi më ashpër.” (Turgenjev, *Dim*, Matica hrvatska, Zagreb, 1963, f. 821)

<sup>163</sup> “Edhe gjuha është zjarr, bota është përplot padrejtësi. Kështu edhe gjuha rron midis gjymtyrëve tona, duke infektuar të gjithë trupin dhe duke nderur kohën e jetës sonë; duke u djegur prej ferrit. Gjuhën e njerëzve nuk mund ta fisnikërojë askush, sepse është e keqe, e paqetë, shumë vdekjeprurëse. Me të bekojmë Perëndinë dhe Atin, dhe me të mallkojmë njerëzit, që janë të krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.” (*Qarkorja e Jakovit*, kap. 9, paragr. 5-13)

vetë me duart e tyre. Kush i drejtoi trupat e armatosura, tytat e pushkëve dhe plumbat në zemrat e punëtorëve? Cari, princat e mëdhenj, ministrat, gjeneralët, zuzarët e oborrit...

Ata janë vrasësit! Vdekje për ta! Shokë, rrokni armët!"<sup>164</sup>

Pas fjalëve "kukamat", "zemrat", "vdekja" (në religjionin e dritës dhe errësirës) janë arritur kuptimet e fuqishme emocionale, që do të thotë se kuptimi racional ka marrë një rol dytësor. Roli i fjalëve pushtuese, në radhë të parë nuk është që të sqarojnë diçka, por që të nxisin turmat për veprim.<sup>165</sup>

"Fjalët e para. Ne kemi nevojë për fjalë, për fjalë që guldulisin; për fjalë që do t'i zgjojnë njerëzit e beftë; për fjalë që do t'i shtyjnë të mendojnë për ndryshime; për fjalë prej të cilave ata do bëhen të pakënaqur, që në fakt janë. Këto fjalë do u japin atyre shpresën se do bëhet diçka më shumë. Kemi nevojë për fjalë që do t'i ndihmojë ata të jenë krenarë për atë që mendojnë, e jo të turpërohen. Fjalë që do t'i bëjnë të gjitha këto..."<sup>166</sup>

3. Mesazhi do të ushtrojë një ndikim të ashpër, për aq sa gjuha e tij është përshtatur mirë me gjuhën e grupit të cilit i dedikohet mesazhi.<sup>167</sup> Shpeshherë të njëjtat fjalë, në grupe të ndryshme shoqërore, fitojnë domethënie të ndryshme, në varësi të përvojave grupore, që do të thotë se kuptimi i fjalëve nuk varet vetëm prej strukturës së fjalisë, por edhe nga struktura e shoqërisë. Dallimet në domethënien e fjalëve rriten në mënyrë proporcionale krahas ndarjes së punës dhe specia-

<sup>164</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 4, f. 370 (nënvizoi Gj.Sh). "Shprehja ci-vi-li-zi-mi... është e kuptueshme, e pastër dhe e shndritshme; kurse të gjitha shprehjet tjera, si kombi apo lavdia, të gjitha kanë aromë gjaku. Le të shkojnë me Perëndinë e dashur." (Turgenjev, *Dim*, f. 32)

<sup>165</sup> Mbi reagimin racional te fjalët racionale ("socializmi" dhe "marksizmi"), shih Fromm, *Zdravo društvo*.

<sup>166</sup> F. Pol dhe C. M. Kornblut, *Reklamokratija*, "Jugoslavija", Beograd, 1967, f. 40.

<sup>167</sup> Nëse është fjala për dhënien e drejtpërdrejtë të mesazhit, atëherë edhe mjetet e tjera ndikojnë në efikasitetin e mesazhit: zëri, pamja etj.

lizimit të funksioneve apo largësive proporcionale – shoqërore, kulturore dhe psikologjike – midis grupeve shoqërore.

Ndjenjat, mendimet, qëndrimet, bindjet, opinionet e grupit janë të organizuara në një mënyrë të caktuar, dhe pikërisht këtë mënyrë të caktuar organizimi të këtyre elementeve në tërësi (këndvështrimi mbi botën) ne e quajmë strukturë. Fjalët (simbolet), mesazhet duhet të përzgjidhen dhe të organizohen në fjali (si struktura shpirtërore), në atë mënyrë që ato t'i afrohen sa më tepër strukturës së vërtetë dhe ta shprehin atë në tërësi.

Kështu, për shembull, nëse mesazhi i dërgohet grupit, anëtarët e të cilit janë mjaft të arsimuar dhe njihen si elitë intelektuale e shoqërisë, atëherë mesazhi duhet të jetë i strukturuar në atë mënyrë që dimensionin njohës i tij të ketë një pozicion më të theksuar në raport me dimensionet tjera, si dhe i gjithë mesazhi duhet të shprehet me fjalë (simbole), që janë karakteristike për këtë grup. Nëse mesazhi i dërgohet një grupi anëtarët e të cilit përgjatë gjithë jetës kanë qëndruar mënjanë vendit ku zhvillohet jeta shpirtërore dhe nuk kanë përvojë në çështjet shpirtërore, mesazhi duhet të jetë i strukturuar në mënyrë që dimensionin emocional i mesazheve të dominojë mbi dimensionet e tjera, dhe mesazhi të shprehet me fjalë (simbole) që ndezin ndjenjat<sup>168</sup> dhe nevojat më të ulëta.<sup>169</sup> Nëse mesazhi i dërgohet një grupi më të madh, që ne e quajmë klasë e mesme, e cila është e aftë të

<sup>168</sup> "Ka (fjalë) që nxjerrin ende tym. Disa fjalë do lënë përshtypjen e shpatullës së djegur të ndonjë hajduti. Mendimi pothuaj nuk pranon që të shprehet me emra të tillë robërues. Nganjëherë metafora ka qenë e padukshme, saqë ndjeni se ajo ka qenë e prangosur." (Igo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 350-1)

<sup>169</sup> "Ndonjë fjalë i ngjajn kthetrës, e ndonjë tjetër sikur është ngulfatur në gropën e gjakut. Ndonjë tjetër është shprehje, lëviz si një gaforre. Të gjitha këto jetojnë me atë fuqinë e neveritshme që janë rregulluar në shkatërrimin e tyre." (Hugo, *Jadnici*, 11, f. 346) Mjerimi e ka gjetur gjuhën e vet të luftës, dhe kjo është gjuha e rrugës." (Igo, *Jadnici*, II, f. 348)

vlerësojë vlerën njohëse të mesazhit, por edhe e gatshme të përmbushë nevojat e saj<sup>170</sup>, mesazhi duhet të strukturohet në mënyrë që dimensionet njohëse dhe emocionale të mesazhit të përforcohen në mënyrë reciproke, dhe i gjithë mesazhi të shprehet si në simbolet racionale ashtu edhe në simbolet emocionale. Në rastin e parë, mesazhi mund të trondisë sistemin njohës, në tjetrin strukturën emocionale, dhe në rastin e tretë mesazhi prek dimensionin racional dhe emocional të qëndrimit të individit apo të grupit.

Që fjala të ngulitet në kokë dhe në zemër, ajo duhet të përmbajë logosin dhe patosin. Për logosin dhe patosin duhet gjetur “fjalë me krahë fluturues”, që do godasin të gjitha shtresat e qenies: mendimet, bindjet, opinionet, ndjenjat...

4. Një mbjellje e lehtë e fjalës nuk jep fryte menjëherë. Fjalët nuk bien poshtë si “dekada të tëra e ndajnë mbjelljen prej vjeljes”.<sup>171</sup> “Kur dhe në ç’situatë fillon revolucioni – kjo nuk varet prej vullnetit të asaj apo kësaj klase, por nga puna revolucionare me turmat, që nuk shpërbëhet kurrë pa lënë gjurmë nga pas.”<sup>172</sup>

Vetë paraqitja me fjalë (simbole) nuk premtion shumë se individët dhe grupet do ta orientojnë vëmendjen drejt tyre, dhe se nuk do i miratojnë fjalët si udhëzuese në jetën e tyre të përditshme. Por, duhen pritur ato çaste neveritëse të kri-zës shoqërore, kur njerëzit e humbasin arsyen e shëndoshë dhe kërkojnë zgjidhje, dhe këtu duhet shkrepur një mori fjalësh të njëjta (parulla) për të cilat kemi besuar se janë zhdukur përgjithmonë nga vetëdija e individëve, dhe mjaft-

<sup>170</sup> Ky konflikt (i arsyes dhe nevojave) zgjidhet më së shumti në dobi të nevojave.

<sup>171</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 87. “Ndjeva se nuk kam harruar asgjë nga ajo që më ka ndodhur: këtë e kisha mënjanuar, por tani ato ngjarje u zgjuan si një baticë e papritur në një det të qetë.” (Remark, *Noć u Lisabonu*, Minerva, Subotica, 1975, f. 122)

<sup>172</sup> Lenin, po aty.

ton që të bindemi lehtë se mbjellja nuk ka qenë e kotë dhe në këtë rast këto fjalë bëjnë çudira.<sup>173</sup> Ato çudira për të cilat njerëzit janë të vetëdijsëm janë vetëm një pjesë e vogël e asaj që në një tjetër mënyrë (nënvetëdija) mbahen mend dhe nuk kanë humbur në pakthim, por kthehen dhe dalin në sipërfaqen e njohjes së vetëdijshme, në rrethanat e veçanta psiko-sociale. “Puset duhet të presin gjatë që të dinë se çfarë ka rënë në thellësitë e tyre”, thotë Nietzsche.

Një krizë shoqërore mund të ketë domethënie për aq sa individët dhe grupet marrin pjesë në të. Por, manifestimi kolektiv i këtyre domethënieve mund të jetë unik.

Një fjalë e vetme apo disa fjalë në formën e një parulle shprehin një numër të madh nevojash dhe ankesash. Në sloganin “për liri, vëllezër!”, dikush mund të shohë rastin për t’u çliruar nga zgjedha shtetërore, të tjerët nga zgjedha bashkëshortore, disa nga borxhet, nga obligimet, nga mërzia etj. “Sloganet kanë formuluar atë që e thonë faktet.”<sup>174</sup>

Kështu sloganet paraqiten si plotësim i atmosferës, e cila është përplot elektricitet. Kjo parullë në këtë rast nuk ka “sajuar” asgjë – ajo është vetëm e saktë dhe i ka dhënë formë fluturimit që ka shkuar gjithnjë para e më përpara.<sup>175</sup>

Pra, duhet vlerësuar saktësisht se kur do takohet sloganin me instinkt kolektive e t’i administrojë ato në atë drejtim që korrespondon me qëllimin e atij që i hodhi në turmë.

“Ne nuk mund të jemi të kënaqur që sloganet tona të koloviten pas ngjarjeve duke iu përshtatur atyre, ndërkohë që ato tashmë kanë ndodhur.”<sup>176</sup>

<sup>173</sup> “Duke pranuar fjalën në nevojë të madhe.” (*Selmanikasve, qarkorja e parë*, kap. 1, parag. 6)

<sup>174</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 106.

<sup>175</sup> Po aty, f. 109.

<sup>176</sup> Po aty, f. 135.

5. Suksesi i mesazhit varet prej llojit dhe radhitjes së argumenteve që përmban.

Nëse turma, të cilës i dërgohen mesazhet, mbështetet te manipuluesi, për të është më mirë që të paraqesë vetëm argumentet (të dhënat, dëshmitë) që e vërtetojnë këndvështrimin e tij.<sup>177</sup>

Nëse në turmë ekzistojnë edhe ata që pajtohen me pikëpamjen e manipuluesit, për të është më mirë që të paraqesë argumentet pro dhe kundër, dhe në këtë mënyrë (a) lë përshtypjen e analistit objektiv, e jo të një propaganduesi të njëanshëm. (b) Duke paraqitur arsyet pro dhe kundër, manipuluesi parashikon bisedimet e mundshme dhe u merr atyre fuqinë, në atë mënyrë që kërkesat i formulon shumë më butë sesa po ta bënin të njëjtën gjë ata që nuk pajtohen me të. (c) Duke hedhur argumentet në favor të qëndrimit të tij, por edhe ato argumente që e sfidojnë qëndrimin e tij, manipuluesi kërkon t'u tregojë edhe atyre që nuk pajtohen me të se edhe qëndrimet e tyre nuk janë lënë pas dore, ndërsa turma fiton përshtypjen se është trajtuar si audiencë.<sup>178</sup> (d) Manipuluesi i shkathët mund t'i lejojë vetes bisedën me ata që nuk pajtohen me pikëpamjet e tij, për t'iu dhënë atyre mundësinë që përmes dialogut të lirohen dhe të shkarkohen nga emocionet e rrezikshme për qëndrimet bazë, sepse kjo zbrazje favorizon vetvetiu synimet e tij të mëtejshme.

Mesazhi që përmban arsyet pro dhe kundër, dhe krahas kësaj nuk fsheh fakte kontradiktore (logjikisht konkluzive)

<sup>177</sup> Ph. Zimbardo & B.B. Ebbesen, *Influencing Attitudes and Changing Behavior*, Addison-Wesley, London, 1969, f. 21; M. Kartins and H. I. Abelson, *Persuasion*, Springer, New York, 1970. p. 30. Manipuluesi zakonisht paraqet argumentet që vërtetojnë pikëpamjen e tij edhe në ato raste kur nuk ka konkurrencë, ose atëherë kur ai dëshiron që të arrijë një ndikim të shpejtë, por me rrezikun që ky ndikim do jetë afatshkurtër.

<sup>178</sup> Shih ndryshimin që bën Mills-i mes turmës dhe audiencës.

zionet rrjedhin nga supozimet), do të ketë më shumë jehonë në turmë, sidomos nëse ajo ka një nivel të lartë arsimor. Ky është rasti kur mendimi i turmës është i kushtëzuar drejtpërdrejtë nga bindësi, duke pasur parasysh që, në fakt, turma mendon për mesazhin e tij; pra, kur përmbajtja dhe vlera e vetë mesazhit merren si kritere të atij që bind.

Te mesazhet që përmbajnë si argumente pro ashtu edhe kundër duhet pasur kujdes që t'u kushtohet më shumë hapësirë argumenteve pro.

Mesazhi do arrijë ndikim të thellë nëse argumentet kryesore shkrepen qoftë në fillim qoftë në mbarim, por kurrsesi në mes të parashtrimit.

Nuk ka ujdë midis studiuesve të komunikimit për rradhitjen kohore të argumenteve pro dhe kundër. Disa besojnë se mesazhi shkakton më tepër pasoja nëse si fillim paraqiten argumentet pro dhe më pas ato kundër, sepse në turmë (të paktën në pjesën që është në anën e manipuluesit) tashmë është krijuar një klimë e favorshme për pranimin e mesazhit. Të tjerët besojnë se argumentet kundër duhen paraqitur më herët, sepse kjo do kënaqë opozitën, dhe në këtë mënyrë parandalohen reagimet e ashpra dhe nuk do të ndalojnë hezitimet e atyre që pajtohen me qëndrimet e manipuluesit.

Besueshmëria e mesazhit fuqizohet në qoftë se me mesazhin pajtohen "liderët e mendimit", sepse dihet mirë që anëtarët e një grupi ndjekin prijësit e tyre për çdo gjë, madje edhe në lidhje me mendimet e tyre.

6. Besohet se mesazhet me qëllime të dukshme janë më pak efikase sesa mesazhet ku qëllimi është i fshehur, duke u mbështetur te arsyet objektive dhe te motivet bindëse.<sup>179</sup>

<sup>179</sup> Kjo është baza për dallimin e "propagandës së bardhë", e cila i paraqet hapur qëllimet e veta. Ndërkaq "propaganda e zezë" i fsheh qëllimet.

Mund të ketë kundërshtime për çështjen se a është më pak efikas mesazhi me qëllime të hapura se mesazhi me qëllime të fshehura, por nuk ka dyshim se dy llojet e mesazhit nxisin ndryshime në ndjenja, bindje, qëndrime dhe në sjelljet e individëve dhe grupeve.

Zgjedhja midis këtyre dy rrugëve varet prej turmës në të cilën hidhet mesazhi. Nëse një mesazh i ndërlikuar (me një varg të dhënash, alternativash dhe rrjedhash) transmetohet në turmën e zakonshme (të një niveli të ulët arsimor), dhe me këtë rast qëllimi i manipuluesit nuk është i theksuar qartë, ai ekspozohet karshi rrezikut që ta lërë turmën në hamendje, ose që turma ta nxjerrë vetë konkluzionin nga mesazhi, në vend të asaj që ai priste. Në rrethana të tilla është më mirë që qëllimet të paraqiten në mënyrë të saktë. Nëse në turmë hidhet një mesazh që ka të bëjë me një çështje të zakonshme, dhe si i tillë është i thjeshtë dhe i kapshëm, nuk është nevoja që qëllimi të paraqitet hapur, sepse njerëzit janë të aftë vetë që të kuptojnë domethënien e mesazhit. E njëjta gjë vlen edhe nëse një mesazh i ndërlikuar u jepet njerëzve me nivel të lartë arsimor: për ta mesazhi është i thjeshtë, pasi ata janë në gjendje që t'ia rrokin kuptimin, dhe kështu nuk është e nevojshme që krahas kuptimit që përmban mesazhi (të dhëna, alternativa, arsye) të paraqitet edhe qëllimi i tij.<sup>180</sup>

Me siguri që rritja e nivelit të përgjithshëm arsimor të masave do të ndikojë që qëllimi i mesazhit të jetë gjithnjë e më i fshehur, dhe që “gjuha të detyrohet të gënjejë në shumë mënyra”.<sup>181</sup> Fjalët durojnë që brenda tyre të futet një lloj si gënjeshtër ashtu dhe e vërteta. Fjalët e humbasin fuqinë çlirimtare vetëm pasi një gjë, tipar, marrëdhënie, situatë,

<sup>180</sup> Nëse turma është jo e sigurt, gjithashtu nuk rekomandohet paraqitja e qëllimit.

<sup>181</sup> J. Henry, *Culture Against Man*, Vintage Books, New York, 1965, p. 91.

ngjarje, përjetim, besim, mendim, vlerë etj. të marrë emër, – ato ekzistojnë për ne, i kalojnë kufijtë midis ekzistencës dhe mosekzistencës – dhe fuqia e tyre shfrytëzohet për mbulimin apo fshehjen e motiveve të vërteta që shtrihen prapa tyre. “Në përgjithësi pranohet mendimi se e vërteta për një njeri në radhë të parë është ajo që ai e fsheh.”<sup>182</sup> “Në thelb njeriu është ai që fsheh...”<sup>183</sup>

Për prokurorin e shtetit thuhet se është “interpretues elokuent i drejtësisë së pathyeshme”; për krizën thuhet se është një rast për t’u bërë më mirë; mjerimi quhet “sprovë” e kështu me radhë. Kështu, në të vërtetë, këto fjalë zbulojnë diçka, por megjithatë, me këto shprehje nga realiteti të fjala më shumë fshihet sesa zbulohet.<sup>184</sup>

“Nuk ka asgjë më të çuditshme se këto fjalë që maskojnë dhe rrëfejnë.”<sup>185</sup> “Gjuha që kërkon t’i thotë të gjitha dhe t’i fshehë të gjitha, ka si veti begatinë me figura. Metafora është një kurth që përdoret nga hajduti përpara se të përgatisë vjedhjen, ose si i burgosuri që bën plan për t’u arratisur.”<sup>186</sup> Meqë gjuha përpiqet gjithmonë të fshehë, ajo ndryshon në çastin kur ndjen se të tjerët po e kuptojnë.<sup>187</sup>

Motivet e vërteta të veprimit tonë janë ato që fshehim nga të tjerët, dhe shpeshherë edhe nga vetja. Ne jetojmë një jetë të tjetërsuar dhe nuk është çudi që gjuha e shpreh këtë, dhe kështu ajo paraqitet si një gjuhë e shtrembëruar, çoroditëse, e cila përshkruan vetëm marrëdhënie shoqërore të shtrembëruara, të çoroditura. E thënë më saktë, gjuha reflek-

<sup>182</sup> Andre Malraux, *Antitnemoari*, Naprijed, Zagreb, 1969, f. 13.

<sup>183</sup> Po aty, f. 13.

<sup>184</sup> “...si ilustrim i kësaj, që gjuha i është dhënë njeriut për të fshehur mendimet. T’i japësh boshit formën e mendimit.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 1, f. 140)

<sup>185</sup> Igo, *Jadnici*, II, f. 352.

<sup>186</sup> Igo, *Jadnici*, II, f. 353.

<sup>187</sup> Po aty.

ton marrëdhëniet shoqërore tjetërsuese, dhe për kaq ajo është e saktë. “Kohë e mallkuar e oratorisë ezopiane, e shërbimit letrar, e gjuhës robëruese; gjuhë e parisë ideologjike.”<sup>188</sup>

Mesazhet që futen në turmë (dhe do të futen edhe në të ardhmen) nuk janë të shprehura me një gjuhë ideore, por ideologjike, sepse kjo gjuhë është më e përshtatshme për të fshehur qëllimet e vërteta. “Si peshkatarët e troftave, që nga frika se do trembin peshqit e hedhin grepin shumë larg, dhe më pas, në mënyrë tinëzare e të heshtur, e tërheqin atë kah vetja.”<sup>189</sup>

Atje ku flitet me një gjuhë ideologjike, aty duhet të fshihen disa sekrete të rëndësishme. Këto sekrete i zbuloi Marx-i dhe i pagëzoi me emrin e vërtetë: interesa. Interesat e kanë helmuar gjuhën tonë, dhe ne bëhemi të vetëdijshëm me dhimbje se fjalët tona janë “një lëmsh i mbushur me gjarpërinj”.

Ata që flasin me një gjuhë ideologjike nuk duhet të jenë të vetëdijshëm për zëvendësimin e fjalëve të vërteta me fjalë të shtrembra, sepse shtrembërimi është i kushtëzuar nga motive të nënvetëdijshme, e jo vetëm nga të vetëdijshmet. Përpara sociologëve dhe psikologëve të gjuhës zbulohet një fushë e re kërkimore: kërkimi i gjuhës ideologjike ose i prostitucionit me fjalë. Ndoshta kërkime të tilla do të na ndihmonin për të parë se sa jemi larguar prej gjuhës së heronjve, të cilët e kanë shënuar çdo gjë me fjalët e duhura; si dhe se sa i jemi afruar gjuhës së hajdutëve, që me fjalë të shtrembra shënojnë gjërat e vërteta. Nëse i kthejmë dinjitetin fjalëve tona, atëherë ka gjasa që t'i kthejmë dinjitetin vetvetes.

Kur dëgjojmë për dikë që ka vdekur “se iku në botën tjetër”, atëherë kjo metaforë nuk mund të na mashtrojë – ajo

<sup>188</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 197.

<sup>189</sup> Ž, *Kovači lažnog novca*, f. 155. “Ky është një veprim i mirë në oratori: të mos e zësh në gojë emrin e një çështjeje të caktuar, e në fshehtësi ta kesh me vete, e t’ia përplasësh dikujt në kokë vetëm atëherë kur vjen çasti i duhur.” L. Stern, *Tristram Šendi*, f. 220-1.

është vetëm një mënyrë tjetër për të shënuar të njëjtën gjë – vdekjen. Gjuha jonë ishte e pasur me figura identike, por asnjëra syresh nuk përbënte fshehtësi për askënd – ato janë thjesht forma të padhimbshme të dëshmisë së fatit të dhimbshëm – vdekjes. Për këtë, secila nga këto figura e zëvendëson me sukses shprehjen e vdekjes, duke mos e anashkaluar kuptimin e saj. “Të folurit është një marrëzi e bukur: kështu njeriu hedh valle duke kaluar mbi të gjitha gjërat,” shkruante Nietzsche.

Por, kur fjala “krizë” zëvendësohet me “një mundësi për më mirë”, atëherë prej një fjale hiqen në mënyrë të padukshme shtresat e pakëndshme të kuptimit, dhe “zëvendësohen” me shtresat e kuptimit, që nuk kanë më të njëjtën vlerë racionale, morale dhe psikologjike. Këtu nuk kemi të bëjmë më me zëvendësim. Këtu “mundësia për më mirë” nuk shërben për mëkëmbjen e një realiteti simbolik, por për fshehjen e këtij realiteti. Të kuptuarit e realitetit është mënjënuar në favor të pushtetit mbi të. Dashuria për të vërtetën i lë vendin vullnetit për pushtet. Nuk është e rëndësishme se ç’është realiteti, a ekziston ai në formën e ëndrrës apo zhgjëndrrës. Tani vetëm një gjë është e rëndësishme: që unë të udhëheq sipas vullnetit tim dhe pa ndihmën e të vërtetës.

Pra, shohim se gjuha ideologjike nuk zbulon, por fsheh (gjendjen e vërtetë); nuk sqaron, por e mjegullon; nuk shënon, por shtrembëron; nuk njeh, por përkushton; sepse nuk shpie drejt më kryesores, por tërheq në drejtim të sporadikes.

Predikuesit e mashtrimeve ideologjike (me apo pa vetëdije) e kanë zbrazur gjuhën prej emocioneve kritike, dhe kështu e kanë vrarë atë dhe e kanë bërë të përshtatshme për “rendin e fjetur të gjërave”. Gjuha sunduese ideologjike fut në jetën e përditshme fjali pa flatra në vend të fjalëve me flatra; fut interesin në vend të idealit; riorganizimin në vend të krizës, reformën në vend të revolucionit.

Që nga ky moment, jo vetëm sociologët dhe psikologët e gjuhës, por të gjithë ata që nuk duan të mashtrohen, duhet ta dëgjojnë me kujdes fjalimin ideologjik, dhe te këto fjalë të zbulojnë shtresat e kuptimit, funksioni i të cilave nuk është për të na informuar, por për të na mashtruar.

Analiza më e thellë e fjalëve (simboleve) të përdorura në mesazh mund të na zbulojë jo vetëm atë që gënjeshtari ideologjik ka dashur që ne të dimë, por edhe atë që ai nuk ka dashur që ne ta mësojmë. Njeriu i arsyeshëm u beson shumë pak fjalëve.

7. Pikëpamjet e shprehura në mesazh nuk duhet të jenë në kundërshtim me pikëpamjet e turmave. Në të kundërt, modelimi i mesazhit është i kushtëzuar nga qëndrimet e turmave dhe pikërisht për këtë shkak, mesazhi duhet t'i shprehë qëndrimet në mënyrë edhe më bindëse, e jo t'i mohojë ato. Mesazhi do shkaktojë një ndikim të fortë për atë që i përgjigjet prirjes së turmës, pra për atë që i përshkruan me saktësi ndjenjat e turmës, bindjet, qëndrimet, shpresat dhe vlerat e saj. "Fjalët e tua më mahnisin. Secila syresh është nxjerrë nga çerdhet më të fshehta të dëshirave të robit tënd."<sup>190</sup>

Mesazhi efikas përmbledh një numër të madh nevojash vetjake në një slogan të vetëm. Fuqia e tij është te premtimi<sup>191</sup> (problemi i grupit do zgjidhet), jo tek e vërteta. Prandaj ndodh që ata "ushqehen me përralla, sajesa, me shpirt, pavdekshmëri, me parajsë e yje. Gjëra të tilla përtypin ata. Me këto lyejnë bukën e tyre të thatë. Kush nuk ka asgjë, ka Perëndinë e mirë"<sup>192</sup>.

<sup>190</sup> Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 162.

<sup>191</sup> "Zoti nuk e vonon premtimin, siç mendojnë disa: Ai na duron, sepse nuk do që të vdesë ndonjë, por të gjithë të vijnë për t'u penduar." (*Qarkorja e dytë e Pjetrit*, kap. 3, parag. 8) "Por, ne që jemi bijtë e ditës, të jemi syçelë dhe të gatshëm nën mbrojtësin e fesë dhe të dashurisë, me kapelën mbrojtëse si shpresë të shpëtimit." (*Selmanikasve, Qarkorja e parë*, kap. 5, parag. 8)

<sup>192</sup> Igo, *Jadnici*, I, f. 97.

Pra, manipuluesi paralajmëron se nuk do t'i ndryshojë bindjet, qëndrimet dhe kriteret vlerësuese të njerëzve. Ai vetëm thekson se ajo që po ofron përmbush pikërisht këto bindje, qëndrime dhe standarde. Ai e fsheh qëllimin e tij, kështu që u del përballë nevojave të tyre.

8. Një nga karakteristikat e rëndësishme të mesazhit është edhe thjeshtëzimi, jo vetëm për faktin se mesazhi duhet të kumtohet në një kohë të caktuar apo në një zonë të kufizuar, por edhe ngaqë mesazhi i dërgohet njeriut të kufizuar të turmës. Në thelb, thjeshtëzim do të thotë neglizhencë me vetëdije e shumë anëve të problemit, me të cilin ka të bëjë mesazhi dhe sjellja e një çështjeje të ndërlikuar në nivelin e disa elementeve të thjeshtë, që më pas vendosen në lidhje me qëllimin e manipuluesit. Ai është i detyruar për këtë thjeshtëzim nga vetë fakti se me të njëjtat fjalë (simbole) duhet ta bëjë publik mesazhin, gjë që nënkupton se do bëjë njëfarë përgjithësimi; ndërkohë që një formë e tillë përgjithësimi është vetëm shenjë e sipërfaqësore.<sup>193</sup>

Që mesazhi të mbulojë përvoja të tilla të shumëllojshme dhe nevojat e individëve, dhe në të njëjtën kohë të jetë lehtësisht i kuptueshëm për të gjithë, ai duhet të shpaloset me "gjuhën e vegjëlisë".<sup>194</sup> Ata e përjetojnë mesazhin si një formulë ideale për zgjidhjen e nevojave të tyre. Ata nuk janë të vetëdijshëm se e kanë marrë nga dikush, që nuk u është qasur atyre, që të kënaqë kërkesat e tyre; por, ai ka vendosur interesin e tij mbi të gjitha.

9. Që mesazhi ta tërheqë vëmendjen dhe të jetë i pranuar, ai duhet të përsëritet. Këtu nuk vlen ajo kërkesa e njohur

<sup>193</sup> "Për turmën që ka shumë koka për të pasur një mendim, shumë sy për të pasur një shikim; për turmën që është sipërfaqësore, që mbahet vetëm në sipërfaqe." (Igo, *Çovek koji se smeje*, Rad, Beograd, 1959, f. 264)

<sup>194</sup> "Popullit duhet t'i qasemi pa citate latine, thjesht, kuptueshëm..." (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 10, f. 106)

e Proust-it: “Fjala e përsëritur nuk është kurrë një fjalë e drejtë.” Përsëritja nuk ka të bëjë vetëm me përmbajtjen, por edhe me formën e mesazhit. Mesazhi duhet të përsëritet në të njëjtën mënyrë.<sup>195</sup> Nëse një mesazh i caktuar përsëritet në të njëjtën mënyrë, me siguri që efekti i tij do të jetë më i madh, por duke ruajtur kufirin e veljes. Mesazhi nuk duhet të përsëritet më shumë se pesë-gjashtë herë, për shkak të rrezikut të efektit bumerang (një fjalë apo vepër që kthehet kundër atij që e thotë ose e bën). Nëse përsëritja e mesazhit vazhdon tej kufirit të veljes, ndërkohë që mesazhi e fuqizon edhe më shumë një sjellje të caktuar, ky fuqizim nuk është pasojë e përsëritjes, por një kohezion i caktuar i përmbajtjes dhe formës së mesazhit me motivet e vetëdijshme dhe të nënvetëdijshme të çdo individi apo të nevojave të turmës.

10. Individët janë të prirë që vlerën e mesazhit<sup>196</sup> ta shohin te çështja se sa i eliminon mesazhi zgjedhjet alternative në një situatë të paqartë dhe të tensionuar. Kështu, për shembull, për aq sa mesazhi i eliminon mundësitë për interpretimin e një situatë krize, po aq vlerësohet si i dobishëm.

<sup>195</sup> Që është njëmend kështu, dëshmon gjuha e klisheizuar e politikës, publicistikës ditore, reklamës, propagandës etj.

<sup>196</sup> Jakobson flet për gjashtë funksione të mesazhit:

i. *referencial* – mesazhi kërkon që të shënjojë gjërat reale;

ii. *emotiv* – qëllimi i mesazhit është të nxisë reagime emocionale;

iii. *imperativ* – mesazhi përbën urdhër;

iv. *faktik ose lidhës* – mesazhi ka për qëllim që të verifikojë apo të vërtetojë lidhjen midis bashkëbiseduesve;

v. *metafizik* – lënda e mesazhit është një mesazh tjetër;

vi. *estetik* – mesazhi tërheq vërejtjen e pranuesit me formën e vet. (Cituar nga Umberto Eco, *Kultura, informacioni, komunikacioni*, Nolit, Beograd, 1973, f. 71. “Ndonjë mesazh, vlera njohëse e të cilit është e parëndësishme, mund të ketë vlerë të lartë emocionale, apo vlerën e lidhjes midis bashkëbiseduesve (sloganet ideologjike).” (Eco, po aty, f. 183)

## TURMA

*“Xhuxhmaxhuxhi ka një shans të shkëlqyer për të qenë më i madh se vigani kur i ngjitet atij mbi shpatulla. Është e çuditshme se si ia lejon vigani një gjë të tillë. Por, çudia bëhet marrëzi kur ai i gëzohet madhësisë së xhuxhmaxhuxhit.*

*Ah, naiviteti njerëzor.”*

Victor Hugo

Në literaturën socio-politike, nocioni i turmës zakonisht përdoret për të përcaktuar ato grupe të mëdha shoqërore apo masa që dallojnë prej grupeve të tjera për faktin se u mungon elementi thelbësor i organizimit, por edhe mungesa e ndjenjës së fuqishme të identifikimit. Kjo ndjenjë e përforcuar e bën turmën më të fortë, ndërkaq mungesa e organizimit dhe e vetëdijes për fuqinë i ngjan një vigani pa shikim<sup>197</sup>, i pamundur që ta shndërrojë në veprim forcën e tij të madhe. Së këndejmi, këtij vigani të verbër i afrohen elitat që prijnë, që nënkupton se roli i turmës është reduktuar në “materiale ndërtimi”,<sup>198</sup> në mjete teknike apo materiale për realizimin e qëllimeve të elitës.

Elitat e organizuara mirë formësojnë turmat dhe e orientojnë këtë fuqi vigane në atë drejtim që u përshtatet atyre. “Dhe pasi kjo turmë ka në vetvete fuqinë dhe këtë fuqi mund t’ia japë kujtdo, pra çdonjëra nga dy anët aktive vë në lëvizje të gjitha shkathtësitë për ta bërë turmën për vete;

<sup>197</sup> E thotë mirë Balzac-u: “Është më e lehtë të gësh një njeri të mençur sesa një popull të mençur. Populli nuk ka sy, por zemër; ai ndjen, nuk sheh.”

<sup>198</sup> Lenin, *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960, vëll. 12, f. 469.

për ta tërhequr kah vetja – këto janë si dy shpirtra armiq, që shtyhen me njëri-tjetrin se kush do hyjë në trup për ta vënë atë në lëvizje. Pra, mes tyre nuk pushon gara se kush do i shpërndajë më mirë zërat e përshtatshëm për të ndezur ndjenjat, për orientimin e lëvizjes në dobi të njërit apo tjetrit drejtim; kush do i sajojë të rejtat joshëse për ndezjen e hidhërimit, ose për qetësimin e tij, për nxitjen e shpresës apo frikës; kush do i kujtojë më mirë heroizmat, që sa më shumë të përsëriten e të dëshmoen po aq arrijnë të krijojnë zërin e shumicës për njërën palë ose për tjetrën.”<sup>199</sup>

Pra, me nocion turmë, zakonisht përcaktohet një grup i madh njerëzish të paaftë për të menduar me kokën e tyre; të pazotë për të kontrolluar instinktët e tyre; të paarsimuar për të marrë në dorë punët publike dhe të paorganizuar për të realizuar interesat e tyre. Teoricienët e elitave, sidomos ata të orientimit klasik dhe liberalo-demokratik<sup>200</sup>, e interpretojnë indiferencën e turmës ndaj çështjeve politike si marrëzi të saj; mungesën e mundësive për të administruar çështjet publike, si mungesë të aftësisë; dhe pëlqimin e turmave për të votuar, si refuzim të turmës për të kontrolluar.

### Turmat apo klasat?

Nëse prej studimeve të reja për bindjen e masave mund të mësohet çfarëdo për vetitë e turmës, atëherë pa dyshim që nocioni i turmës duhet përdorur me kujdes, sepse nocioni i vjetër i turmës nuk i përgjigjet të dhënave të nxjerra nga përvoja, dhe ky nocion duhet kufizuar për të shënjuar situata të veçanta shoqërore ku njerëzit me të vërtetë veprojnë si

<sup>199</sup> A. Manzoni, *Verenici*, Prosveta, Beograd, f. 299.

<sup>200</sup> Studimet e Machiavelli-t, V. Pareto-s, G. Mosca-s, O. Y. Gasset-it, R. Michels-it, K. Mannheim-it, J. Schumpeter-it etj.

turmë. Pjesa më e madhe e këtyre studimeve tregon se turma nuk është amorfe (e përbërë nga një njësi individësh pasivë e të pafuqishëm), të cilës mund t'i jepet formë si baltës e të përpunohet si dylli. Turma është një grup i strukturuar që sillet në mënyrë përzgjedhëse ndaj mesazheve, mesazhe të cilat i dërgohen çdo ditë nga anë të ndryshme.

Fakti që disa shtresa nga kjo masë lexojnë vetëm gazetatat e tyre, dëgjojnë vetëm emisionet e radios së tyre dhe shikojnë programet e tyre televizive<sup>201</sup>, dëshmon se nuk është fjala për një turmë të padiferencuar. "Njerëzit përpiqen që të krijojnë diçka të veçantë, dhe në vllugun e madh të mençurisë ata bëhen qesharakë. Çdokush e di se turmat ndahen në klasa."<sup>202</sup>

Analiza strukturore e turmës zbulon se ajo përbëhet prej klasave dhe, sipas rregullit, çdo klasë është e aftë që të gjykojë dhe t'i dënojë në mënyrë kritike mesazhet që vijnë nga burime të ndryshme.<sup>203</sup> Kjo ishte arsyeja që Lenini pat kërkuar një qasje të veçantë në të bindurit ideologjiko-politik për çdo klasë shoqërore në veçanti: "Të shkohet në të gjitha klasat e popullsisë. Ne duhet ta bëjmë këtë si teoricienë, si propagandistë, si agjitorë dhe si organizatorë."<sup>204</sup> "Por, kuptohet, kryesorja është që propagandimi dhe agjitacioni të ushtrohet mbi të gjitha shtresat."<sup>205</sup>

Mirëpo ka çaste në jetën e klasës, shtresave dhe grupeve shoqërore kur dallimet klasore, shtresore dhe dallimet e

<sup>201</sup> "Të tillë janë njerëzit, dëgjojnë dhe mbajnë mend vetëm atë që u pëlqen; gjithçka tjetër ose e kalojnë në heshtje ose e harrojnë." (M. Lalić, *Hajka*, Grafički zavod, Titograd, 1967, f. 239)

<sup>202</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 427-8.

<sup>203</sup> Nëse klasa nuk është e aftë si tërësi, janë të aftë prijësit, të cilët kanë shumë ndikim mbi klasën.

<sup>204</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 293.

<sup>205</sup> Po aty, f. 294.

tjera socio-politike ofrohen edhe kur njerëzit sillen në mënyrë identike. Këto janë ato momentet e rënda të krizave shoqërore, shoqëruesit psikologjikë të cilave janë në një gjendje të tensionuar ankthi dhe frike. Në situatat kur instinktet e të përmbajturit shpërthejnë në sipërfaqe dhe kur fuqitë e gjykimit janë ulur ndjeshëm, shpërbëhen format e zakonshme të sjelljes (karakteristike për shoqërinë në klasa), dhe njerëzit zakonisht e marrin sjelljen e shumicës si kriter për sjelljen e tyre. Çdo krizë çon në barazim, sepse të gjithë janë të rrezikuar në të njëjtën mënyrë dhe të gjithë kërkojnë dalje nga një situatë e pamundur. Për secilin situata është kanosëse dhe nuk mund të zgjidhet sipas një prej mënyrave të zakonshme – për shembull, me shfrytëzimin e statusit vetjak, fuqisë dhe autoritetit. “Gjatë gjithë kohës së krizave, turmat nuk mund të veprojnë drejtpërdrejt. Atyre u nevojitet ndihma e të gjithë grupeve të vogla të forumeve qendrore të partisë.”<sup>206</sup>

Prandaj, kur njerëzit gjenden në një situatë krize, për zgjedhjen e së cilës ata nuk kanë informacione të mjaftueshme, as kanalet adekuate për të shkuar tek informacionet, ata sillen në mënyrë të njëjtë dhe identike, pavarësisht dallimeve në statusin shoqëror, nivelin arsimor, përkatësinë etnike dhe klasore të tyre. Pavarësisht këtyre dallimeve, në mungesë të burimeve të tjera të unitetit shoqëror paraqitet homogjeniteti i perceptimit dhe i përvojës, pra krijohet njëfarë uniteti psikologjik. Në radhë të parë, ky unitet mbëshetet më shumë te përgjigjet e përbashkëta emocionale (te perceptimi identik për situatën<sup>207</sup>), sesa te disa standarde formale të sjelljes.

<sup>206</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 9, f. 406.

<sup>207</sup> Vetë fakti që grupi ndodhet në një situatë krize nuk mjafton: kriza duhet të perceptohet si situatë krize dhe të përkufizohet në këtë mënyrë prej shumicës së anë-

Sjellja e qenieve njerëzore në rrethana të caktuara, si të thuash, resht së varuri prej vetive të tyre individuale dhe grupe, dhe pothuajse është e përcaktuar tërësisht nga rrethanat e jashtme të një situate të caktuar shoqërore. Ky është momenti kur njerëzit me të vërtetë konvertohen në një turmë dhe kur “secili, sipas qejfit të vet, udhëheq një pjesë të turmës duke e çuar atë ku t’i shkrepet”.<sup>208</sup> Në një gjendje të tensionuar emocionale, turma është e hapur për të gjitha sugjerimet e mundshme<sup>209</sup> dhe “asgjë nuk është më lehtë sesa mashtrimi demagogjik i turmës, që më pas vetëm sprovat më të rënda mund ta sigurojnë për gabimin e saj”.<sup>210</sup>

Në raste furtunash shoqërore shpërbëhen *dallimet* në status, arsimim, autoritet etj., dhe njerëzit nuk kërkojnë shpjegime logjike, por kërkojnë *shpëtimtarët*. “Tani njerëzit nuk kërkojnë mendime të arsyeshme. Në vuajtje kërkohet një mendim i përbashkët, identik.”<sup>211</sup> Të gjithë demagogëve të mundshëm u jepet mundësia e papërsëritshme për t’u vënë në krye të turmës; sepse “në shkretëtirë nuk ka kohë për të parë se i kujt është uji që po pi, mjafton që uji të jetë i ftohtë dhe të shuajë etjen”.<sup>212</sup> Aq sa situata objektive është e rëndë ose aq sa është subjektivisht e patolerueshme, po aq do korrrë besim shpëtimtari. Turma do e pranojë si të vërte-

tarëve të grupit. “When is something a political crisis? One answer is when the media say it is.” (C. Seymour Ure, *The Political impact of Marx Media*, Constable. London, 1974, p. 39)

<sup>208</sup> Igo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 411.

<sup>209</sup> “Sugjerimin mund ta përkufizojmë si një dukuri ku pranohet një bindje ose veprohet në një mënyrë të caktuar, nën ndikimin e asaj që thonë apo bëjnë të tjerët; jo në bazë të arsyeve racionale dhe as në bazë të detyrimit nga ana e tjetërkujt.” (Nikola Rot, *Osnovi socijalne psihologije*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Srbije, Beograd, 1973, f. 198)

<sup>210</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 328.

<sup>211</sup> D. Ćosić, *Vreme smrti I*, f. 140.

<sup>212</sup> L. Leonov, *Ruska suma*, Prosveta, Beograd, 1960, f. 117.

të çdo gjë që është e mundur në qoftë se ajo gjendet në një situatë të pamundur. “Sytë e hetojnë lehtë atë me të cilën shpirti është i mbushur plot.”<sup>213</sup>

Lenini e dinte mirë se në rrethana të tilla njerëzit nuk mund të binden sipas mënyrës së vjetër (ku ndaj çdo klase dhe shtrese ndërtohen metoda të veçanta bindjeje), sepse tashmë nuk kemi të bëjmë me klasa dhe me shtresa, por, në kuptimin e plotë të fjalës, kemi të bëjmë me turmën.<sup>214</sup> Ndërsa tani kemi punë me përfaqësuesit tipikë të turmës: ky ndryshim kërkon jo vetëm ndryshimin e metodës së propagandës dhe agjitacionit (nevojën e një popullariteti të madh për qasje ndaj çështjes, aftësi për të shpjeguar të vërtetat bazë të socializmit në mënyrën më të thjeshtë, hapur dhe bindshëm), por edhe të organizimit.<sup>215</sup>

Në çaste krize shfaqet nevoja për udhëheqës (prijës). Ekzistojnë dëshmi të qarta se njerëzit e pranojnë me shumë gatishmëri tipin autoritar të udhëheqësit sapo ndodhen në rrethana të pasigurta apo në rrezik kolektiv. Hertzler-i ka analizuar tridhjetepesë forma historike të diktaturës dhe ka përfunduar se këto lloje kontrolli paraqiten kur ka kriza shoqërore dhe kur ndryshimet e papritura në organizmin shtetëror bëhen të nevojshme.<sup>216</sup>

<sup>213</sup> Ivo Andrić, *Nemirna godina*, f. 53.

<sup>214</sup> Në turmë përfshihen të gjithë ata që janë të pafuqishëm për të kontrolluar elitën. Ata varen nga ajo në çdo kuptim: ekonomik, politik, kulturor etj. Për sa kohë që njerëzit nuk e kanë mundësinë që ta kontrollojnë – verifikojnë, të bëjnë thirrje për përgjegjshmëri publike, të shkarkojnë nga postet – elitën, e cila i ushtron funksionet shoqërore në emër të tyre, atëherë kemi të bëjmë me lojën e demokracisë, ndërsa nocionet e turmës dhe elitës mbeten mjete të forta analitike.

<sup>215</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 190.

<sup>216</sup> Sipas B. M. Bass, *Leadership, Psychology and Organizational Behaviour*, Harper and Row, New York, 1960, p. 499.

Kësisoj kemi rastin të bindemi se jemi në kulmin e pafuqisë sonë: në vend të sundimit të popullit, para syve tanë mbin pushteti absolut i një njeriu në emër të popullit.<sup>217</sup>

### Personaliteti autoritar

Prej kohësh dihet se ka njerëz që janë të prirë të pranojnë në çdo mendim, pavarësisht arsyeve racionale, vetëm nëse ky mendim vjen nga ana e një burimi të fuqishëm (autoritar). Këtë lloj njeriu “e kanë prodhuar dhe përsosur shekujt barbarë”<sup>218</sup>, dhe sot ai njihet si personalitet autoritar. “Ka njerëz që ashtu sikurse janë të lindur të jenë shpinë, prapavijë, ana e prapme... Ata jetojnë vetëm në qoftë se mbështeten te tjetri: emri i tyre është vazhdim dhe shënohet vetëm prapa lidhëzës “i”. Ata nuk kanë një jetë të tyre; ata janë në anën tjetër të fatit, një fat ky që nuk u përket atyre.”<sup>219</sup>

Një personalitet autoritar nuk është vetëm ai që është i varur i tëri nga autoriteti dhe që ka nevojë për autoritet. Personalitet autoritar është ai që ka nevojë për një hierarki të autoritetit, ku edhe ai do ketë përgjegjësi jo vetëm për veten, por do ketë edhe të nënshtruarit e tij etj., mbi të cilët do manifestojë njëfarë forme të pushtetit në raport me të tjerët. Ai e adhuron komandën, por edhe komandimin. Ky personalitet i frikësohet fuqisë, por edhe digjet për ta pasur atë.

<sup>217</sup> “Nuk ka njeri të fuqishëm që nuk shoqërohet... Gjahtarët e së ardhmes lëshohen si bletët te e tashmja e shkëlqyer.” (Igo, *Jadnici*, I, f. 53) “Ky është sistem i vërtetë diellor në lëvizje.” (Po aty, f. 54)

<sup>218</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 1953; Adorno, *The Authoritarian Personality*, Harper and Row, New York, 1950. “Por, shprehjet e robërisë janë rrënjësor thellë në zemrat tona; së shpejti nuk do t’i qërojmë dot hesapet me to. Për gjithçka dhe gjithkund na nevojitet sunduesi.” (Turgenjev, *Dim*, Matica hrvatska, Zagreb, 1963, f. 28)

<sup>219</sup> Igo, *Jadnici*, II, f. 75.

Ai e ndjen nevojën që të jetë i udhëhequr, por ka edhe dëshirën e zjarrtë që të prijë, të kontrollojë të tjerët, të orientojë fatin e tyre, t'i detyrojë ata me një sjellje të caktuar. “Te *Kronika e Travnikut* hasim personalitetin që është jo më i madh se fara e vogël e lulëkuqes karshi atij që sundon, si mali i madh para atyre që varen prej tij. Pas një veprimi të tillë, në një gjendje të fryrë, i skuqur në fytyrë, duke bërëtitur dhe fyer para dikujt i cili është i pamundur, nuk guxon ose nuk di të përgjigjet. Për një çast, ama për një çast të mirë, interpretuesi do të ndjente një kënaqësi të thellë dhe një lumturi të pamatë, që më në fund ka arritur të mposhtë diçka; që ka thyer dhe mposhtur dikë, dhe tani qëndron mbi kundërshtarin e heshtur që përpihet nga toka. Ndërkohë lumturia e madhe e ngre lart mbi krijesat e tokës, por krejt ulët, që ta shohin të gjithë, që të gjithë ta masin e ta ndjejnë lartësinë e tij.”<sup>220</sup>

Aq sa ç’është autoritar një personaliteti, po aq është e sigurt se ai do përpiket që të mos i bashkohet asnjë grupi, për të cilin ai mendon se normat, vlerat dhe ideologjia e tij përputhet me pritjet personale; por, para se gjithash, do afrohet me atë grup që është i pushtetshëm, ose në ato raste kur ai vetë të bëhet i tillë. Duke mos pasur fuqi në vetvete, ai e gjen atë te grupi i pushtetshëm. Personalitetet e dobëta përbëjnë një grup të fortë. “A doni të mbeteni të fuqishëm? Bëhuni të pafuqishëm. Bëhuni asgjë. Gjarpër i fjetur, i mbështjellë kutullaç, që në të njëjtën kohë përbën pafundësi dhe hiç.”<sup>221</sup>

Si mund të shpjegohet ai shkatërrim marramendës dhe i tmerrshëm i njerëzve mbi njerëzit? I atyre njerëzve që nuk

<sup>220</sup> Ivo Andrić, *Travnička hronika*, Prosveta, Beograd, 1962. f. 431. “Kur shpirti i ulët tërhiqet, shpëton prej shtypjes, por edhe vetë shtyp.” (Dostojevski, *Selo Stepančikovo*, Rad, Beograd, 1967, f. 185)

<sup>221</sup> Igo, *Čovek koji se smeje*, Rad, Beograd, 1959, f. 226. “Sa herë që ndonjë fuqi e madhe zhvillohet nga një dobësi e madhe, kjo i shtyn njerëzit të reflektojnë.” (Igo, *Jadnici*, I, f. 321)

janë takuar kurrë me njëri-tjetrin, të cilët nuk kanë pasur rast t'i shkaktojnë dëm njëri-tjetrit – në qoftë se nuk do të ekzistonte në një shkallë masive synimi i verbër për dëgjueshmëri dhe nënshtrim ndaj një lideri i cili ndërton pushtetin e tij mbi dobësitë e këtyre njerëzve?!<sup>222</sup> Ata që janë të aftë të thonë fjalët: “Ju jeni prijës, jeni diell. Unë jam krimbi juaj i vogël!”<sup>223</sup> Apo: “Çfarë do mbetej nga unë sikur të më drejtohej sunduesi!? Do vdisja nga gëzimi!”<sup>224</sup> Sunduesit urdhërojnë bash ata që janë të aftë ta kalojnë jetën duke u zvarritur rreth tyre.

Ata nuk kanë besim te vetja dhe për këtë arsye bien nën ndikimin e të tjerëve; ata nuk e kërkojnë kuptimin e jetës së tyre dhe s'e marrin nga të tjerët, dhe kështu ata jetojnë një jetë të huaj, jo të tyren. Ata shkojnë më me qejf pas fjalëve të të tjerëve sesa pas mendimeve të veta; ata mësohen që të mendojnë me kokën e të tjerëve, ashtu siç mund të mësohen të ecin me këmbë të huaja. Ata nuk kanë ide dhe janë të gatshëm që t'i shërbejnë çdolloj ideje. “Të shërbyerit për një ide publike, ata nuk mund ta konceptojnë ndryshe përpos si shkrimje të tyren me një personalitet, që sipas të kuptuarit të tyre ai manifeston idenë.”<sup>225</sup>

Grupi i pushtetshëm, nga njëra anë dëshirohet që të jetë si mbrojtje nga frika dhe pasiguria individuale, kurse nga ana tjetër si mënyrë që individi të çlirohet nga përgjegjësia individuale. Grupi si autoritet, në veçanti udhëheqësi i grupit si simbol i autoritetit, që barrën e përgjegjësive individuale autentike e merr prej individit, mundëson (grupi) që ky

<sup>222</sup> “Për çudi një ushtri është një kryevepër e kompleksitetit, ku fuqia lind nga një grumbull pa fuqi. Kështu shpjegohet lufta që zhvillon njerëzimi kundër njerëzimit, ndonëse në emër të njerëzimit.” (Igo, *Jadnici*, I, f. 319)

<sup>223</sup> Dostojevski. *Zli dusi*, II, Rad, Beograd, 1967, f. 87.

<sup>224</sup> Tolstoj, *Rat i mir*, I, Prosveta. Beograd, 1965, f. 325.

<sup>225</sup> Dostojevski. *Zli dusi*, II, f. 283.

individ, në njëfarë mënyre, të kthehet në fazën e sjelljes si fëmijë.<sup>226</sup>

Anëtarësimin e tij në grup individi e përjeton si vetëmbrajtje karshi sjelljes së detyruar të vendimeve, të marrjes së përgjegjësisë dhe lënies së rrezikut në dorë të të tjerëve. Që këtej, një grup i madh është edhe një ngushëllim brilant.

Për aq sa grupi (organizata) zmadhohet, po aq bie mundësia e kontrollit individual të anëtarëve të grupit, dhe për pasojë zhvillohen format e kontrollit joindividual<sup>227</sup> të sjelljes. Atje ku mbikëqyrja individuale këmbëhet me rregullin joindividual, grupi (organizata) bëhet më pak efikas(e). Për këtë arsye, çdo organizatë, në veçanti një parti politike, krahas kontrollit joindividual, siguron edhe atë individual; kështu që në çdo pikë të strukturës vertikale të autoritetit vendos njeriun e vet (jo vetëm normën, ligjin apo udhëzimin) që të kontrollojë ekzekutimin e urdhrave.

Deri më tani kemi provuar që të tregojmë se aftësia e bindjes në turmë varet nga tipi i situatës shoqërore. Ne kemi parë se suksesi i madh në të bindur arrihet në rrethanat e krizave shoqërore; por, nga ana tjetër, edhe se si bie në rrethanat e stabilitetit shoqëror.

Më pas kemi tërhequr vërejtjen se struktura autoritare e shoqërisë, domosdo që prodhon personalitetin autoritar, që në një kuptim më të gjerë mund të përftohet si një personalitet që sillet në varësi të rrethanave të jashtme (qendrës së pushtetit, fuqisë, autoritetit, imazhit), e jo në varësi të vlerave matëse të brendshme.

Tani është momenti që të theksojmë se suksesi për të bindur varet nga përvoja individuale, sepse në të njëjtat rre-

<sup>226</sup> Shih më gjerësisht: Ljubomir Tadić, *Tradicija i revolucija*, SKZ, Beograd, 1972.

<sup>227</sup> "Armiku më i rrezikshëm është ai që nuk e njohim." (Mann, *Čarobni breg*, Prosveta, Beograd, 1972, f. 316)

thana shoqërore ka individë që sillen ndryshe nga ato që kërkojnë rrethanat e jashtme; që do të thotë se arsyet e sjelljes së tyre duhen kërkuar te vetitë socio-psikologjike të individit.

\* \* \*

Një shkallë e lartë ndikimi mund të pritet nëse njerëzit janë të paarsimuar dhe të painformuar. Mendohet se bindësi mund të shkojë larg në qëllimet e tij – aq sa ai do – nëse haset me njerëz të cilët nuk dinë gjë fare ose kanë dije të pamjaftueshme për një çështje të caktuar.<sup>228</sup> Sa më shumë të dinë individët për një gjë, dhe sa më e lartë të jetë cilësia e kësaj njohurie (njohuri e verifikuar jo vetëm nga përvojat vetjake, por edhe nga përvojat e tjera), aq më të pakta janë gjasat që ata njerëz të manipulohen. Të dhënat për sjelljen politike, ideologjike dhe religjioze paralajmërojnë se pakica<sup>229</sup> në shoqëri është e arsimuar dhe e informuar mirë dhe është e aftë që të mbrojë qëndrimet e veta. Pak njerëz dinë shumë, shumë njerëz dinë pak ose aspak. Kjo situatë inkurajon çdo bindës, ndërsa te ne mbetet shpresa e ndryshueshme se me rritjen e nivelit të përgjithshëm arsimor do bëhet gjithnjë e më e vështirë për të manipuluar njerëzit. Them shpresë e ndryshueshme, ngaqë arsimimi është një pengesë e dobët për sa i takon të bindurit, që nënkupton se mund të manipulohen jo vetëm injorantët, por edhe të diturit. Kjo arrihet në atë mënyrë që mesazhi të modelohet asisoj që të godasë nevojat individuale dhe grupore, dhe jo

<sup>228</sup> "...u jepej që të organizonin paragjykime dhe padije brenda masave popullore" (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 200) "Popullit i duhet udhëheqësi. Duke qenë se është i paditur, populli është i verbër. A nuk e ka si udhërrëfyes i veribri qenin?" (Igo, *Čovek koji se smeje*, f. 180)

<sup>229</sup> Shih: L. D. Brown, *Ideology*, Penguin, London, 1973, f. 177.

bazën racionale mbi të cilën ndërtohen qëndrimet individuale. Fillimisht mesazhi kumtohet me anë të simboleve emocionale, pastaj me simbole racionale. Nëse kemi dy individë me qëndrime identike, të cilët mbështeten në të njëjtën evidencë dhe në arsyet logjike, edhe pse i janë ekspozuar mesazhit të bindësit, së pari do ndryshojë qëndrimi i atij individi që përputhet me atë që bindësi ofron si plotësim të nevojës.<sup>230</sup>

Në rrethanat e përditshme manipuluesi do ndikojë më lehtë mbi individët me nivel të ulët apo mesatar intelektual, sesa mbi ata që karakterizohen nga një shkallë inteligjence mbi mesataren, apo me një shkallë të jashtëzakonshme inteligjence.<sup>231</sup> Njerëzit me një IQ të lartë, nëse u janë ekspozuar atyre mesazheve që janë të bazuara në supozime të paargumentuara, mbi dëshmi të parëndësishme, të palogjikshme dhe të rreme, vetëm në saje të nivelit të jashtëzakonshëm të gjykimit kritik nuk do i pranojnë kollaj këto mesazhe. Kurse me individët që nuk i kanë të zhvilluara aftësitë kritike, përgjithësisht ndodh e kundërta. Në këtë pikë duhet të jemi të kujdesshëm. Është e vërtetë se njerëzit me aftësi të larta intelektuale do i shqyrtojnë mesazhet me më shumë kujdes për sa u përket pasojave të pranimit apo të mospranimit, por kjo vlen vetëm për mesazhet e llojit verbal, nëse ato janë të orientuara me qëllim ndryshimin e dimensioneve njohëse të qëndrimit. Mesazhet që janë të orientuara kah ndryshimi i dimensioneve emocionale të qëndrimit, do të kenë ndikim të barabartë për të gjithë, pavarësisht IQ-së.

<sup>230</sup> Është tërheqës fakti, se informimi i individit për diçka, shpeshshërë nuk lidhet me nivelin e edukimit profesional, por, në radhë të parë, është i kushtëzuar me motivimin (individët që janë të interesuar për një gjë mbledhin të dhëna për atë gjë parvarësisht nivelit arsimor të tyre).

<sup>231</sup> "Për këtë arsye, nuk është e pazakontë – thotë Lluakaçi – që në sistemin e Stalinit, ata që janë sjellë krejt shpengueshëm si konformistë janë ata që kanë pasur më së paku talent." ("Pismo o staljinizmu", *Naše teme*, Nr. 12, 1952)

Gjithsesi është naiv të besuarit se aftësitë intelektuale qëndrojnë si pengesë që mbrojnë grupin nga manipulimi<sup>232</sup>, “sepse edhe vetë e dini se në çdo tubim ka më shumë të marrë se të mençur, dhe shumica mbizotëron pjesën më të mirë”.<sup>233</sup> Arsyen tjetër e kemi përmendur – ka të bëjë me situatat e krizës, ku njerëzit sillen në mënyra të ngjashme, pavarësisht dallimeve socio-psikologjike. Këtu intelektuali nuk dallon shumë prej njeriut të zakonshëm. Intelektuali ndoshta sheh më shumë alternativa për zgjidhjen e një problemi, dhe pikërisht ngaqë ai nuk i jep përparësi asnjë alternative (pavendosmëria proverbiale intelektuale!), është i prirë që në fund të fundit t’i japë përparësi asaj alternative që mbështetet më shumë nga anëtarët e grupit. Tanimë e kemi theksuar disa herë se kur individët ndodhen para një situatë kur nuk mund të përcaktohen për një zgjedhje të sigurt, atëherë ata mbështeten te zgjedhjet e të tjerëve.

Çdo individ inteligjent synon t’i rregullojë njoftimet që merr nga mjedisi i tij natyror, shoqëror dhe kulturor në një sistem jokundërthënës.<sup>234</sup> Kur ai e plotëson këtë nevojë të brendshme, shkon një hap më tej: përpiqet që sistemin e tij të mendimeve apo këndvështrimin e tij mbi botën (qoftë edhe këndvështrimin për një çështje të dorës së dytë) ta krahasojë me këndvështrimet e të tjerëve dhe, nëse është e mundur, të harmonizojë sistemin e tij me sistemin e tyre<sup>235</sup>,

<sup>232</sup> “It is a fallacy that intellectual awareness of what is happening can always prevent a man from being indoctrinated.” (W. Sargant, *Battle for the Mind*, Pan Books Ltd., London, 1959, p. 210)

<sup>233</sup> Fransoa Rable, *Gargantua i Pantagruel*, Prosveta, Beograd, 1967, f. 214.

<sup>234</sup> Këtu nuk na intereson se a e bën këtë në mënyrë racionale apo të racionalizuar.

<sup>235</sup> “Ne pajtohemi më shumë (racionalisht) me ata, perceptimet dhe interpretimet e të cilëve përputhen me tonat, dhe në këtë mënyrë përjetojmë ndjenjën e vërtetimit dhe të sigurisë në perceptimet dhe mendimet vetjake. Ne bëhemi të pasigurt nëse perceptimet dhe interpretimet e të tjerëve në të njëjtën situatë bien në kundërshtim me perceptimet dhe interpretimet tona. Ndikimi i të tjerëve (shumicës) është

zakonisht me mendimin e grupit kompetent. Ai individ që është në gjendje që t'i lidhë mendimet e tij me një sistem dhe t'i harmonizojë ato me sistemin e mendimeve, grupi (referent) prej të cilit merr përkrahjen psikologjike do të jetë pothuaj një pengesë e pakalueshme për manipuluesin i cili ofron një qëndrim racional të kundërt në rrethana normale socio-psikologjike.<sup>236</sup>

Mendimi ynë për veten, në një pjesë të mirë të tij bazohet te mendimet e të tjerëve për ne. Nëse të tjerët na respektojnë dhe na çmojnë, si dhe na mirëvlerësojnë, ne jemi të prirë që jo vetëm ta vlerësojmë veten, por edhe ta mbivlerësojmë. Nëse të tjerët nuk na çmojnë dhe na vlerësojnë pak, ne jemi të prirë që jo vetëm ta vlerësojmë më pak veten, por edhe ta nënvlerësojmë. Nëse ne i mendojmë të tjerët si më të vyer dhe më të fortë se veten, jemi të gatshëm që t'i ndjekim ata. Nëse ne i mendojmë si më pak të aftë nga vetja apo më pak të fortë, atëherë jemi të gatshëm t'u imponohemi. Një personalitet që ka mendim të lartë për veten, me siguri që do përpiqet të ndikojë mbi të tjerët, përpara se të lejojë që të udhëhiqet apo të jetë nën ndikimin e të tjerëve, apo t'u nënshtrohet atyre.<sup>237</sup>

më i fuqishëm mbi individët më pak inteligjentë. Por, në këtë rast duhen marrë parasysh edhe gjykimet e strukturave të ndryshme psikologjike." (Nikola Rot, "Inteligjencia i uticaj mišljenja većine na uverenost pri sudenju" *Zbornik Filozofskog fakulteta knjiga*, VII-2, Beograd, 1963, f. 103 dhe 106)

<sup>236</sup> Kjo nuk vlen për situatat e krizës.

<sup>237</sup> "Vetëvlerësimi i ulët shpjegohet me atë që personi më pak inteligjent (apo më pak i fuqishëm), në një seri situatash të kaluara, është sjellë në mënyrë jointeligjente, dhe përvoja e tij e fundit nuk i mundëson që në situata të reja apo identike të mbështetet në inteligjencën e vet, por i jepet imitimit të të tjerëve. Një individ me të vërtetë i marrë, tregon shkallën më të lartë të inteligjencës së tij nëse mbështetet te inteligjenca e të tjetërve më të aftë se ai, pra nëse nënshtrohet. Kjo paraqitet si rruga më e mirë për plotësimin e nevojave vetjake. Një anëtar grupi mund ta bindë anëtarin tjetër vetëm me kushtin se tashmë ai e ka shfaqur fuqinë dhe aftësinë e tij për të zgjidhur problemet e anëtarëve të tjerë të grupit." (Krahaso. B. M.

Imazhi që kemi për veten bazohet te pikëpamjet e të tjerëve për ne, prandaj çdo vlerësim që vjen prej të tjerëve përjetohet vetvetiu si pranim, pavarësisht nga mënyra se si është arritur ky vlerësim dhe pavarësisht nga vlerat që janë krijuar. Vlerësohet fakti se pranimi është fituar, dhe ky fakt vihet mbi arsyeën për të cilën ka ardhur vlerësimi.

Individët (dhe grupet) që e shohin veten si më pak të aftë, si më pak të fuqishëm, ose më pak autoritarë, pra individët me vetëvlerësim të ulët, i rezistojnë me vështirësi ndikimit të bindësit, dhe do ta ndjekin atë për aq sa ai të jetë më i aftë, më i fuqishëm dhe më me autoritet në sytë e tyre. Prandaj, të qenurit i prirë ndaj bindjes nuk mund të shpjegohet vetëm në bazë të supozimeve racionale, por në analizë duhet të futet edhe masa racionale e vlerësimit të aftësive vetjake, fuqia dhe autoriteti në raport me aftësinë, pushtetin dhe autoritetin e të tjerëve<sup>238</sup>, ose në raport me një masë vetjake.

Duke u bazuar te puna e shumë studiuesve, kemi tërhequr vëmendjen për lidhje të caktuara midis vetive të personalitetit dhe mundësisë së bindjes. Ata individë që janë të prirë që të binden në të gjitha rrethanat, karakterizohen me autoritarizëm, me informim të dobët, vetëvlerësim të ulët, mungesë të aftësive intelektuale, me nevojën e fortë për siguri, me harmonizim të sjelljes vetjake konform rrethana-

Bass, "Conformity, Deviation and General Theory of Interpersonal Behavior", in *Conformity and Deviation*, ed. by I. A. Berg and B. M. Bass, Harper, New York, 1961, p. 73); P. M. Blau, *Exchange and Power in Social Life*, John Wiley and Sons, Inc., New York, 1964, p. 140.

<sup>238</sup> Individu nuk i vë në dyshim pikëpamjet përderisa nuk i vlerëson qëndrimet e tij me qëndrimet e një tjetri. Por, nëse qëndrimi i e tij nuk përputhet me qëndrimin e një grupi më të vogël apo më të madh, ose me qëndrimin e turmës, ai është i prirë që të dyshojë në saktësinë e pikëpamjeve të tij. (Më gjerësisht: S. B. Asch, *Social Psychology*, New York, Prentice-Hall, 1952. Gjithashtu: B. P. Hollander, *Principles and Methods of Social Psychology*, Oxford University Press, London-Toronto, 1967, p. 70)

ve, devijim të përgjegjësise, me pafuqinë për t'ia dalë në situata të caktuara.

Dhe në fund duhet thënë se suksesi i manipulimit varet nga gjinia dhe mosha. Studimet vërtetojnë se femrat i nënshtrohen më lehtë bindjes krahasuar me meshkujt. Po ashtu, fëmijët janë më të manipulueshëm se të rriturit.

Në historinë e shoqërive klasore, pakica ka shkelur gjithmonë mbi shumicën. Pakica e organizuar qeveris, shumica e paorganizuar nënshtrohet. Udhëheqësit e kësaj pakice udhëheqin me shpirtin e deformuar në teh të frikës dhe të gënjeshtërs shumicën e paformë, duke e çuar atë atje ku ata dëshirojnë.<sup>239</sup> "Gjithashtu, e pranoj se asnjë pakicë që ka marrë ndonjëherë në dorë udhëheqjen nuk ia ka dalë në këtë drejtim, vetëm nëse ka falënderuar aftësitë e veta krijuese dhe magjinë që rrezaton tërheqjen e kësaj fuqie. Madje edhe një udhëheqës me fuqi të dobët, nuk ka arritur kurrë të çlirohet krejtësisht nga elementet e caktuara të forcës, edhe pse gjithashtu është e saktë se anasjelltas, edhe udhëheqja më e fuqishme nuk ka qenë asnjëherë në gjendje që të mbahet vetëm me forcë, pa një nivel minimal të pëlqimit të të nënshtroarve."<sup>240</sup>

<sup>239</sup> "Kontrollohet ai i cili nuk di që t'ia nënshtrohet vetes." (Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 105) "Por, ai që dëgjon, nuk dëgjon vetveten." (Po aty, f. 183)

<sup>240</sup> A. Tojnbi, *Istraživanje istorije*, II, Prosveta, Beograd, 1971, f. 359.

## KUSHTET

*“Asgjë nuk mund të dëshmohet aty;  
kurse të bindësh është e mundur.”*

Dostojevski

Studimi socio-psikologjik i manipulimit është i orientuar në zbulimin e atyre rrethanave socio-psikologjike në të cilat mesazhet e manipuluesit arrijnë të ndikojnë mbi bindjet, qëndrimet dhe vlerat e turmës, ose mbi rrethanat ku ato mesazhe ngelin pa jehonë apo shkaktajnë ndryshime të parëndësishme. Prej këtyre rrethanave, këtu do shqyrtojmë aksionin e përhershëm si mënyrë harrese të “çështjeve të mallkuara”, ndarjen e punës si burim varësie, hezitimin si pasojë të paqartësisë shoqërore, frikën si metodë sundimi, të përshtaturit në paqartësi dhe në mungesë të fuqisë vetjake, mungesën e vertetë të idealit dhe monopolin mbi përkufizimin e realitetit.

### **Vetëharresa në veprim**

Në shoqërinë bashkëkohore, qenia njerëzore të kujton ushtarin e ri që nuk e lë veten të qetë, i cili gjithnjë duhet të bëjë diçka, vëmendja e të cilit është e kthyer përherë nga e jashtëmja. Kjo është mënyrë ku njeriu është i penguar të mendojë për veten. Kjo është një metodë që nuk e lejon njeriun që të veçojë vetveten si të veçantë dhe unike, e ta përjetojë atë ndryshe nga aktiviteti i tij. Njeriu është barazuar me veprimin. Ai është i vetëdijshëm, por nuk është i vetëvetëdijshëm. Atij i mungon vetëndërgjegjësimi, edhe pse ka

vetëdije me bollëk. Ai është i kuptueshëm, por nuk është i mençur. Ai gati e ka harruar veten dhe është afër tradhtisë ndaj saj. “Më duket se mençuria përbëhet nga fakti se duhet të largohemi nga vetvetja, ta harrojmë atë, ose të mendojmë se jemi dikush tjetër e jo konform natyrës dhe rrethanave tona. Të mos dish asgjë për vetveten, ky është rregulli i parë i mençurisë.”<sup>241</sup>

Përderisa njeriu është identifikuar me veprimin dhe nuk e bën dot dallimin midis vetes dhe veprimit, ai sillet si kafshë. Marx-i ka paralajmëruar se “kafsha është drejtpërdrejtë unike me veprimin jetësor. Ajo nuk dallon nga ky veprim. Njeriu e bën vetë veprimtarinë jetësore si qëllim dhe si vetëdije për vetveten. Ky nuk është paradestacioni me të cilin ai shkrihet drejtpërdrejt. Vetëm për këtë, veprimtaria e tij është një veprimtari e lirë”.<sup>242</sup>

Se sa i frikësohet – me apo pa vetëdije – njeriu të vërtetës për veten (fjala vjen, të vërtetës rreth vdekjes), shihet fare mirë në bazë të faktit se sa kohë i kushton të menduarit për të, për veprimet, për marrëdhëniet e tij me natyrën dhe njerëzit. “Por, ka qenë i zënë për ditë të tëra dhe nuk ka pasur kohë për të menduar.”<sup>243</sup> Njeriu është vazhdimisht i zënë dhe i përfshirë në veprim, dhe duket se kjo i përgjigjet atij, sepse vetëm kështu nuk ka as kohë, as forcë dhe as vullnet që të mendojë për veten.<sup>244</sup> Sikur ta kapte veten në dorë dhe të shihte kah humnera e dyshimit të zi dhe e pakuptimit, do mbërthehej nga frika e vdekjes. Sapo të shkëputet prej gjërave të jashtme dhe aksionit të amshuar, do i

<sup>241</sup>Anatole France, *Mali Pjer*, Novo pokolenje, Beograd, 1950, f. 190.

<sup>242</sup>Marks-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zogreb, 1959, f. 202.

<sup>243</sup>Tolstoj, *Rat i mir*, I, Prosveta, Beograd, 1965, f. 561.

<sup>244</sup>“Nuk ka kohë të merret me vetveten; është gjithnjë i zënë.” (Tolstoj, *Krojcerova sonata*, Rad, Beograd, 1964, f. 52.

vinte ndot nga vetja. Veprimi për të është mashtrimi më i dobishëm dhe më i madh, dhe prandaj ia vlen që të ndërmerret; që të harrohen të gjitha pyetjet për kuptimin e jetës dhe vdekjes, të gjithë pyetjet e mallkuara dhe të tmerrshme.

Kjo vetëharresë në veprim, zakonisht konsiderohet si diçka pozitive, dhe njerëzit e quajnë angazhim shoqëror. Por, fakti që një numër i madh njerëzish është në angazhim e sipër, – dhe pothuajse çdo thirrje për angazhim në shoqërinë civile moderne, në fakt është një thirrje për ta mbajtur dhe forcuar këtë shoqëri të tjetërsuar – domethënë numri i atyre që kanë tradhtuar vetveten është kaq i madh, sa që për pasojë nuk e dinë dhe kanë hequr dorë nga liria, duke qenë të sigurt se po luftojnë për të. “Oh, e tmerrshme është kjo botë e vjetër! Këtu njeriu këmbëngul, shkëputet, ngatërrohet; këtu vdes, këtu mësohet.”<sup>245</sup>

Shoqëritë moderne qytetare, me në krye barinj të tyre, i ofrohen njeriut si shoqëri bamirësie, – ato ndajnë harresën e pyetjeve të fundit – duke e çliruar atë nga mundimi për të menduar për kuptimin e asaj që është duke bërë, dhe në të njëjtën kohë duke liruar veten nga energjia e rrezikshme, e cila mund të zhvillohet nga ndërgjegjësimi i pastër për gjendjen e vërtetë të botës ku jetojmë.

Veprimi i përhershëm është mjeti më efektiv me të cilin shoqëria civile pengon reformën e vetëdijes. “Reforma e vetëdijes përbëhet vetëm nga fakti se bota duhet lejuar të njohë vetëdijen e vet; të zgjojë botën nga ëndërrimi për veten; t’i shpjegojmë veprimin e vet. E gjithë kjo detyrë e jona përbëhet vetëm nga veprimi, që vendimet për çështjet religjioze dhe politike të merren në formën e vetëdijshme

<sup>245</sup> Igo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 437.

njerëzore, siç është rasti edhe me kritikën e religjionit të Fojerbachu.”<sup>246</sup>

Veprimi i përhershëm, në vend të ndërgjegjes (vetë-ve-tëdijes) kritike për pasojat e këtij veprimi, është kushti më i favorshëm që njeriu të kthehet nga vetvetja dhe, në fund të fundit, kundër vetvetes – që të manipulohet prej saj.

### Ndarja e punës si burim varësie

Shekulli ynë është shekulli i një specializimi të lartë dhe i njerëzve të vegjël; shekulli i shumë talenteve dhe gjenive të rrallë, shumë të rrallë; shekull pa sintezë dhe pa një pikë-pamje të plotë për botën; shekull në të cilin, personalitetet e fundit i kanë dhënë lamtumirën projekteve të mëdha. Sot, edhe specialisti më i madh, pothuajse në të gjitha fushat jashtë profesionit të vet silltet me injorancë e me naivitet. “Çdo njeri duhet të mbështetet te njohuritë dhe informacionet që ka fituar prej të tjerëve, sepse përmes përvojës së tij njeriu mund të arrijë të njohë vetëm një pjesë të vogël të botës shoqërore, ndikimit të së cilës tanimë ai i është ekspozuar.”<sup>247</sup> Vetëm atëherë kur individit duhet të mbështetet te të tjerët (pothuajse në çdo gjë jashtë profesionit të tij); kur ai ishte i varur dhe i lëndueshëm në të gjithë vendet, përveçse në vendin e tij të punës, vetëm në këtë rast shfaqet mundësia që të manipulohet nga të tjerët, dhe këtë manipulim ta paraqesin si lumturi të tij. Vetëm atëherë kur njeriu nuk mund të vendosë për vetveten, kur këtë ia beson një autoriteti, ai pushon së jetuari jetën e subjektit.<sup>248</sup>

<sup>246</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 99.

<sup>247</sup> R. Mils, *Elita vlasi, Kultura*, Beograd, 1964, f. 417.

<sup>248</sup> “Organizimi aktual i shoqërisë, merret me mend që është shumë më i komplikuar se përbërja e saj antike, dhe ka për pasojë specializimin e aftësive njerëzore.

Qëndrimet për dukuritë periferike të përvojës dhe njohurive tona, mund të ndryshohen shumë më lehtë nën ndikimin e informacionit të ri sesa qëndrimet që janë kristalizuar në lidhje të drejtpërdrejtë me fenomenet, që janë në qendër të përvojës dhe njohurisë sonë. “Falë ndarjes së punës, përvoja jonë e drejtpërdrejtë është relativisht e kufizuar. Pjesa më e madhe e informacioneve tona është fituar në mënyrë të tërthortë, nga librat dhe gazetatat, e jo përmes kontakteve të drejtpërdrejta me faktet. Ne jemi njerëz që kryesisht jetojmë “në mjedisin e letrave”. Midis nesh dhe botës së vërtetë, kudo ka një botë letrash. Ne vrojtojmë dhe gjykojmë për atë që ndodh dhe si ndodh nëpërmjet shtypit që lexojmë. 99,9% e të huajve kurrë nuk kanë parë, prekur, nuhatur apo provuar gjë në lidhje me bolshevizmin dhe fashizmin, as në lidhje me ngjarjet në Kinë. Me të vërtetë asgjë drejtpërdrejtë. Ata dinë vetëm atë që është shkruar nëpër gazeta. Ata i lexojnë këto të dhëna të pjesshme e të bujshme gjithnjë në formë sipërfaqësore; madje shpeshherë pranojnë copëza kundërthënëse informacionesh. Pra, a duhet të habitemi që idetë për këto dukuri janë jashtë përvojës së tyre të drejtpërdrejtë, që shpeshherë është sipërfaqësore dhe absurde? Kjo mund të shpjegojë se pse në shumë raste, qytetari i zakonshëm ka një gjykim më të saktë për ngjarjet sesa shumë intelektualë të shquar, pikëpamjet shpirtërore të

Dikur njerëzve të zakonshëm u është dashur të jenë universalë, dhe paraqiteshin si pishtarë të rrallë të popujt e vjetër. Më vonë, kur ata u specializuan, aftësitë, talenti, megjithatë kishin të bënin me tërësinë. Kështu, njeriu që ishte i lyer me të gjitha vajrat, siç flitej për Luigjin e XI, ia dilte që ta zbatonte dinakërinë e tij mbi të gjithë njerëzit. Por, kjo aftësi sot është e specializuar. Prandaj, ka kaq shumë dinakëri të ndryshme sa çka edhe tituj të ndryshëm. Diplomatin dinak për çështje biznesi në provincë do ta luajë ndonjë avokat mesatar apo katundar. Gazetari më dinak, në çështjet tregtare mund të jetë tejet i krisur.” (Balzac, *Propale iluzije*, Kultura, Zagreb, 1952, f. 666)

të cilave janë drejtuar keq, duke qenë të kufizuara vetëm në “mjedisin e letrave.”<sup>249</sup>

Dhe pikërisht për këtë, që dija jonë nuk është fituar në kontakt të drejtpërdrejtë me realitetin, pra kjo dije nuk është një përvojë vetjake, ne nuk jemi të sigurt për vlerën e dijes sonë; ndërkohë që dihet se është fare e lehtë t’i manipulosh ata njerëz që nuk ndjehen të sigurt për idetë, besimet dhe qëndrimet e tyre. Duke mos pasur besim të plotë të vlera e ideve, bindjeve dhe qëndrimeve të tyre, ata bien nën ndikimin e të tjerëve, të cilët idetë, besimet dhe qëndrimet e tyre dinë t’i paraqesin me shkathtësi si më me vlerë dhe të padyshimta.

Në jetën e përditshme, në njëfarë mënyre nuk kemi rru-gëdalje tjetër përpos se të mbështetemi tek ajo që na kumtojnë të tjerët. Ne nuk mund të dimë asgjë nga përvoja e të tjerëve në qoftë se nuk ushqejmë një shkallë besimi tek ajo që ata thonë, sidoqë shpeshherë e dimë se ata racionalizojnë, ideologjizojnë dhe filozofojnë (në kuptimin e keq të fjalës). Me pak fjalë, shtrembërojnë deklaratat e tyre për gjëra të caktuara. Një nga pasojat e rëndësishme të ndarjes së punës dhe specializimit të funksioneve, është që besimi ynë ndaj asaj që thonë të tjerët rritet në proporcion me mosdijen tonë rreth gjërave për të cilat flet tjetri. “Mosdija është një lugat dhe ne jemi të frikësuar se do shkaktojë tragjedi të tjera.” (Marx)

### Midis dy gurëve të mullirit

Shkenca në lidhje me grupet shoqërore e ka përshkruar mirë pozicionin socio-psikologjik të atij grupi që është ndo-

<sup>249</sup> P. Sorokin, *Social and Cultural Mobility*, The Free Press of Glencoe (paperback), pp. 517-518.

dhur midis dy grupesh të tjera të fuqishme. Ky përshkrim nuk është asgjëkundi më bindës sesa në penën artistit: “Askush nuk e di se ç’do të thotë të lindësh dhe të jetosh në teh, midis dy botëve; të njohësh dhe të kuptosh njëri-tjetrin e të mos kesh mundësi të bësh asgjë që ato botë të sqarohen e të afrohen me njëra-tjetrën; të dashurosh e të urresh si njëren ashtu dhe tjetrën; të hezitosh dhe të shkosh pas dëshirës së tjetrit përgjatë gjithë jetës; të jesh në dy vendlindje pa asnjë të vërtetë; çdokund të jesh në shtëpi e të mbetesh i huaj përgjithmonë. Me pak fjalë, të jetosh i kryqëzuar, por në të njëjtën kohë të jesh viktimë dhe persekutor.”<sup>250</sup>

Manipuluesit e të gjitha llojeve dhe ngjyrave dalin në gjah pas atyre njerëzve, që pa fajin<sup>251</sup> apo meritën e tyre janë gjendur midis dy grupeve që s’lëshojnë pe në kompromis (që kanë akoma interesa dhe qëllime të ndryshme), sepse e dinë mirë se mesazhet e tyre të formuluar me dinakëri do të bien në një tokë të begatë. Bindësit e fshehur i përmbahen faktit shkencor se individët i kundërvihen mesazhit në mënyrë të zjarrtë sa më shumë të jenë të integruar në grup, ose anasjelltas: mesazhi do të shkaktojë ndryshime të dukshme në idetë, bindjet, qëndrimet dhe sjelljet e individëve sa më dobët të identifikohen me grupin (normën grupore). “Këta janë ata. Ata janë një njerëzim i vogël, i veçuar, që gëlon nën mëkatën e dyfishtë të lindjes dhe duhet shpëtuar dhe blerë edhe një herë, ndërkohë askush nuk e vë re se prej kujt ndodh një gjë e tillë. Këta janë njerëz nga kufiri, shpirtërorë dhe truporë; nga vija e zezë dhe e përgjakshme, që si pasojë e ndonjë mosmarrëveshjeje të rëndë dhe absurde

<sup>250</sup> Ivo Andrić, *Travnička hronika*, Prosveta, Beograd, 1962, f. 335.

<sup>251</sup> “Unë nuk e zgjedh atë që kam. Në të vërtetë unë nuk zgjedh asgjë, as lindjen, as familjen, as emrin, as qytetin, as provincën, as kombin, pra gjithçka më është imponuar.” (M. Selimović, *Tordjava*, Svjetlost, Sarajevo, 1970, f. 152)

është tërhequr midis njerëzve, krijesave njerëzore, midis të cilëve nuk mund dhe nuk duhet të ketë kufi. Ky është ai tehu midis detit dhe tokës, i dënuar me lëvizje e jo me qetësi të amshuar. Kjo është bota e tretë në të cilën ka gjetur vend i gjithë mallkimi, si pasojë e ndarjes së tokës në dy botë.”<sup>252</sup>

Këtu janë përmbushur katër kushtet themelore për “futjen e efektshme të tharmit në shpirt”: gjendja e pasigurt sociale, lidhja e dobët me grupin, burimi me autoritet i mesazhit dhe nevojat që përçajnë njerëzit. Atëherë a është çudi që shpëtimtari të shihet te ndonjë demagog që interesohet për nevojat e tyre, i cili shpreh atë që shumica do të dëgjojë; i cili tregon se si duhet dalë prej telasheve; që e legjitimon veten se është pikërisht ai që mund të ofrojë ndihmë; i cili premton (“se i pari do të jetë i fundit dhe i fundit i pari”); që bën thirrje për veprim; i cili imponohet si udhëheqës i vërtetë dhe simbol i një uniteti të ri dhe merr përgjegjësinë për çdo gjë, me kushtin që të ndiqet nga të gjithë.

Si në përpunimin e bazave teorike të propagandës ashtu edhe në përvojën e propagandistit, Lenini paralajmëronte vazhdueshëm: “Të udhëheqësh të luhaturit, të paqenurit – ja çfarë duhet të bëjë proletariati.”<sup>253</sup> Ai ishte i bindur se “kthimi i katundarit të mesëm na anën tonë që i pashmangshëm.”<sup>254</sup> Por, katundari i mesëm nuk është armiku ynë. Ai është i luhatur, luhatet dhe do të vazhdojë të luhatet. Detyra e të ndikuarit mbi të tjerët nuk është njësoj si rrëzimi i shfrytëzuesve dhe ngadhënjimi mbi armikun aktiv”.<sup>255</sup>

<sup>252</sup> Ivo Andrić, *Travnička hronika*, f. 396. Dihet mirë se ata individë që ndodhen në një gjendje depresive apo që nuk janë të pranuar nga mjedisi social, i nënshtrohen më lehtë manipulimit

<sup>253</sup> Lenin, *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960, vëll. 13, f. 283.

<sup>254</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 12, f. 928.

<sup>255</sup> Po aty.

## Frika si mjet sundimi

Mënyra më efektive për manipulimin e njerëzve është që situata e tyre ekzistenciale të behët e pasigurt, e paqartë, e papërcaktuar, e paqëndrueshme, një situatë e re, e dyshimtë, me plot pritje, ankth dhe frikë. Në këto lloje situatash, aftësia kritike e vetëdijes<sup>256</sup> pëson rënie dhe individit merr sjelljen e të tjerëve (të shumicës) si masë të sjelljes së tij.

Sapo një individ ndihet i pasigurt se a e ka përgjigjen e duhur për sfidën e situatës, gjasat që të tjerët të ndikojnë mbi të në gjetjen e zgjidhjes rriten dukshëm, ndërsa ndikimi i tij mbi të tjerët bie në të njëjtën masë. Ky është momenti kur në skenë ngjitet gjuetari dhe ofron dalje nga situata e tensionuar. Një situatë e tillë i përshtatet. Meqë gjendja emocionale është “më afër sipërfaqes”, individit nuk ka kohë të mendohet se a po ofrohet zgjidhja më e mirë e mundshme, por priret të pranojë me lehtësi çdolloj daljeje nga gjendja e padurueshme.<sup>257</sup>

Në jetën e shoqërisë ka situata kur ajo përballet sy më sy me një rrezik të jashtëm. Nuk ka shoqëri (as grup shoqëror) që nuk e njohin e nuk e përdorin këtë përvojë. Kur një rrezik i jashtëm kërcënon shoqërinë (grupin), atëherë sho-

“Tani slogani jonë është: jo luftë kundër tyre, por tërheqja e tyre; ndikimi i organizuar mbi ta; bindja e atyre që luhaten; shfrytëzimi i atyre që janë neutralë...” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 12, f. 329)

<sup>256</sup> Secili prej nesh e njih këtë situatë: kur jemi të shqetësuar shumë nuk mund të marrim vendime të kuptueshme. Në çastin që mendojmë me arsye humbasin ndjenjat e forta.

<sup>257</sup> Të gjitha teknikat e manipulimit e bëjnë llogarinë në bazë të faktit se ekziston një situatë e tensionuar (për shembull, pakënaqësi me *status quo*-në), konfliktet brenda personalitetit (për shembull, mungesa e harmonisë midis vlerës vetjake dhe vendit në listën hierarkike), jokonsekuenca në qëndrime (për shembull, dimensioni njohës i qëndrimit i kundërvihet emocionale), mospërputhja (fjala vjen, midis ideologjisë zyrtare dhe sjelljes së vërtetë të njerëzve).

qëria (grupi) zhvillon proceset mbrojtëse që çojnë në barazim. Brenda shoqërive (grupeve) na ofron heqjen e dallimeve dhe deri edhe sjelljen konformiste të anëtarëve të shoqërisë (grupit). Duke qenë se rreziku i jashtëm ndahet në mënyrë të barabartë, krijohet solidariteti parësor shoqëror (grupor). Pavarësisht dallimeve sociale, vendosen marrëdhëniet më intime midis të gjithë anëtarëve të shoqërisë (grupit); përshejtohet komunikimi, mbështetja fizike dhe emocionale dhe mirëkuptimi pëson rritje të dukshme. Eliminohen mospërputhjet klasore, racore, kulturore etj.; pikëpamjet politike dhe pikëpamjet mbi botën, sikurse edhe të gjitha dallimet e tjera sociale, sepse pavarësisht këtyre mospërputhjeve, të gjithë janë të rrezikuar në të njëjtën mënyrë. Rreziku, humbjet, frika dhe vuajtjet bëhen çështje publike, jo vetëm private. Vëmendja dhe interesi i anëtarëve të shoqërisë (grupit) lëvizin nga sfera individuale dhe private, në drejtim të interesit të përgjithshëm dhe atij publik; të gjitha normat paraprake, zakonet dhe konfliktet brenda shoqërisë (grupit) e humbasin vlerën. Të gjitha qëllimet e ardhshme, vlerat, synimet dhe interesat shtyhen. Të gjitha aftësitë fizike dhe intelektuale përqendrohen te momenti.

Nga këndvështrimi i organizimit të shoqërisë (grupit), rreziku i jashtëm kryesisht vepron si një forcë integruese. Në luftën midis dy shteteve, konfliktet e brendshme në secilin prej tyre pushojnë, me qëllim unifikimin e fuqive për luftë kundër armikut të jashtëm. Në konfliktin midis dy klasave, përçarjet dhe mospajtimet brenda tyre zhduken, për t'i shkaktuar humbje armikut të përbashkët. Në konfliktin mes dy familjeve, shlyhen fyerjet e vjetra në secilën syresh, që të rezistohet kundër abuzuesit të jashtëm në mënyrë vëllazërore. Në situata të tilla, veprimet e njerëzve bëhen më funksionale dhe më produktive (nga

këndvështrimi i sistemit ekzistues), ndërsa sistemi bëhet më i integruar.

Nga këndvështrimi i psikologjisë individuale dhe sociale, rreziku i jashtëm çon në një reagim uniform ndaj situatës së jashtme. Kënaqësia që perceptimi individual i realitetit përkon me perceptimin e të tjerëve, që edhe të tjerët i përgjigjen frikës, rrezikut dhe ankthit në një mënyrë të ngjashme, pavarësisht statusit të mëparshëm në grup, por edhe në përgjithësi në jetë – të gjitha këto ndjenja në veçanti theksohen tek ata njerëz të cilët deri më tani kanë njohur vetëm vetminë; domethënë, privimin dhe nënçmimin.

Ndjenja të tilla uniteti, barazie dhe solidariteti, rrallëherë arrijnë te rrethanat normale të jetës së grupit. Tani askush nuk pyet se ç'përfaqëson individi, por ç' duhet të bëjë ai; çfarë mundet dhe çfarë arrin individi.<sup>258</sup>

Nga këndvështrimi moral, rreziku i jashtëm apo presioni çon deri te konsensusi moral; qenia njerëzore ngrihet mbi intrigat e imëta vetjake dhe vlerat, dhe ky rrezik ose ky presion i jashtëm shpie deri te katarsisi moral. Sa më i egër të jetë konflikti mes shoqërive (grupeve) aq më shumë rritet bashkëpunimi, solidariteti dhe përkrahja brenda çdo shoqërie (grupi). Nevoja i bashkon njerëzit, sepse ajo është njësoj e rrezikshme për të gjithë.

Nga këndvështrimi i sundimit, rreziku i jashtëm është më i përshtatshmi për manifestimin e ndikimit dhe të fuqisë mbi të tjerët. Mundësitë për manipulimin e njerëzve rriten duk-

<sup>258</sup> "Rëndësia e një njeriu nuk mund të kuptohet në asnjë mënyrë tjetër përveçse sipas veprimit të tij në situata vendimtare. Gjithmonë vetëm pasi njeriu të jetë në rrezik, në sipërfaqe dalin fuqitë dhe aftësitë e tij më të fshehta. Të gjitha këto veti, të cilat në temperaturën normale qëndrojnë nën nivelin e maturisë, vetëm këso çastesh kritike përshkruhen në mënyrë plastike." (Zweig, *Magellan*, f. 104).

shëm. Përpjekjet për t'i bindur të tjerët lehtësohen, në kushtet kur shoqëria (grupi) përballet me një rrezik të jashtëm.<sup>259</sup>

Sigurisht që rreziku i jashtëm mund edhe të mos ekzistojë, por për shkak të ruajtjes së unitetit të brendshëm, armiku krijohet/sajohet. Shumë shtete që kërcënohen apo janë të kërcënuar nga forca çintegruese, kanë provokuar konflikte të paqena me shtetet tjera vetëm për të ruajtur unitetin dhe pushtetin e brendshëm. Pra, kur pakënaqësia e brendshme akumulohet deri në atë gjendje që kërcënon me një lëvizje të tillë në formë kryengritjeje ose revolucioni, dhe kur forcat e pushtetshme shoqërore janë të orientuara kah rrëzimi i sistemit ekzistues politik dhe shoqëror, sistemi gjen mjete mbrojtëse për të mbijetuar, duke paralajmëruar apo hyrë në konflikt të hapur me një forcë që është jashtë sistemit.<sup>260</sup> Sipas rregullit, fërkimet e brendshme dhe pakënaqësia, në qoftë se nuk zhduken, shtyhen për më vonë, ose zbrazen në luftën kundër armikut të jashtëm.

Gjithsesi, sistemi ekzistues e ka shtyrë rënien e tij, dhe në rast të një rezultati të favorshëm në konflikt me armikun e jashtëm, ai vetëm sa forcohet.

Nuk përjashtohet që ndarja politike ekzistuese e botës në blloqe nuk e luan rolin e stabilitetit funksional në çdonjërin nga këto blloqe e në çdo shtet në veçanti. Ne jetojmë me një frikë të vazhdueshme.<sup>261</sup> "Sepse armiku është i përher-

<sup>259</sup>Krahaso: B. M. Bass, *Leadership, Psychology, and Organizational Behavior*, Harper and Row, New York and Evanston, 1960, p. 438.

<sup>260</sup> Armiku krijohet brenda sistemit, në atë mënyrë që të vihet jashtë sistemit. Shpeshherë akuzohen apo shpallen armiq publikisht njerëz të pafajshëm. Kështu ata shërbejnë si "qengji i viktimizuar".

<sup>261</sup> "Nëse frika bëhet një metodë e përhershme e pushtetit, atëherë vjen pranimi publik i këtij pushteti dhe institucionalizimi i tij, qoftë në formën e një terrori të hapur, qoftë në formën e manipulimit propagandues, dhe ky pushtet fshin çdo gjurmë të tolerancës racionale, duke u shndërruar përfundimisht në një pushtet terrorist." (Lubomir Tadić, *Tradicija i revolucija*, SKZ, Beograd, 1972, f. 274)

shëm. Ai nuk është në situatat e jashtëzakonshme, por tashmë në gjendjen normale të gjërave. Në kohë paqeje ai kërcënon si në luftë (ndoshta edhe më shumë). Kështu ai futet në sistem si një forcë kohezive.”<sup>262</sup> Pra, edhe armiku bëhet i nevojshëm. Nuk shfrytëzohet vetëm miku, por edhe armiku. Shpeshherë i dilet pa miq, por nganjëherë pa armiq nuk shkohet përpara. Meqë është e pamundur pa armiq, meqë armiku shërben si mjet integrues nuk është aspak e rrallë që armiku të krijohet apo të sajohet qëllimisht.

Mund të mos ketë ujdi rreth faktit se a është më efikase që për qëllime manipulimi të përdoret një frikë e dobët apo e fortë (kërcënimi), por ama nuk ka kurrfarë kundërshtimi se frika është një kusht paraprak për një manipulim sa më efektiv. Në pothuajse çdo mesazh që i jepet turmës në rrethanat e kërcënimit të jashtëm (i vërtetë apo imagjinar), instalohet një masë e vogël apo e madhe frike, pavarësisht faktit nëse frika (kërcënimi) është e hapur apo vetëm sa paralajmërohet.<sup>263</sup>

### Gjuetia bëhet në ujë të turbullt

Ndryshimi i qëllimshëm i rrethanave jetësore të njerëzve, do t'i shtyjë ata që të përcaktojnë raportin e tyre me këto rrethana në një mënyrë të re. Natyrisht që në këto rrethana të reja, manipuluesi do i ndihmojë njerëzit me “zemërgjerësi”. Por, ndryshimi i rrethanave reale nuk është një gjë e thjeshtë, dhe manipuluesi shpeshherë vendos që të zgjedhë

<sup>262</sup> Marcuse, *čovjek jedne dimenzije*, V. Masleša. Sarajevo, 1968, f. 64.

<sup>263</sup> “U desh që t'i shkëpusnin njerëzit nga të menduarit dhe të gjykuarit me të gjitha mjetet e frikësimit; që t'i detyrojnë të shohin atë që nuk ekziston e të dëshmojnë të kundërtën e asaj që duket.” (Pasternak, *Doktor Živago*, Prosveta, Beograd, 1975, II, f. 299)

një rrugë më të lehtë: në vend të ndryshimit të rrethanave reale, ai anon kah ndryshimi i perceptimit të këtyre rrethanave. Ai e bën këtë në atë mënyrë që në grupe të mëdha fut informacione (të dhëna, simbole) që në njëfarë mënyre nuk përputhen me përvojat e anëtarëve të grupit, dhe kështu ai shkakton njëfarë pasigurie në interpretimin e këtyre rrethanave. Pra, qëllimi është që perceptimi i rrethanave dhe i situatës të turbullohet dhe të errësohet, në mënyrë që njerëzit të mos kenë mundësi të shohin një interpretim të qartë të këtyre rrethanave. Në të vërtetë, manipuluesi e ka pritur këtë, dhe tani, duke futur informacione plotësuese, me anë të të cilave strukturon elementet e perceptimit (rrethanave) në një mënyrë të re, si përfundim ai ofron atë interpretim që i shkon për shtat.

Nëse e marrim si të mirëqenë se rrethanat në vetvete nuk janë as të qarta e as të paqarta, por varen nga individit (ose grupi) që i interpreton ato, atëherë prej qartësisë subjektive apo paqartësisë varet se si do interpretohen ato informacione që janë futur aty në mënyrë të pamenduar nga manipuluesi. Rrethanat e paqarta si të tilla nuk janë të përshtatshme për një manipulim të suksesshëm, por në radhë të parë është qëndrimi i paqartë (i papërcaktuar) i individit (grupit) ndaj këtyre rrethanave që krijon kushtet e zënies fill të manipulimit. Manipuluesi e shfrytëzon këtë gjendje për interpretimin e rrethanave dhe njëkohësisht ofron interpretime që u përshtaten interesave të tij. Kjo sepse aq sa individit (grupi) është i pasigurt në interpretimin e rrethanave, po aq është i prirë që të pranojë interpretimet e të tjerëve.<sup>264</sup> Individët janë aq të pasigurt në interpretimin e përvo-

<sup>264</sup> Pushtetmbajtësit përdorin dëndur teknikën e turbullimit dhe, sapo pikasin që njerëzit i interpretojnë rrethanat jetësore në përputhje me përvojën drejtpërdrejtë, ata fusin informacione të reja (shpeshherë këto shprehje kanë një kuptim të

jave të veta, – dhe kjo pasiguri në përgjithësi është e lidhur me ndryshimin e rrethanave shoqërore<sup>265</sup> – saqë interpretimet e tyre i krahasojnë dhe i rregullojnë gjithnjë sipas interpretimit të një autoriteti, për shembull ai mediave masive apo i prijësit të mendimit. “Kur të dëgjoj mendimet e mia nga goja e tij, vetëm atëherë do të besoj.”<sup>266</sup>

### Vdekja e idealit

Një pasiguri e tillë në interpretimin e përvojave vetjake, pjesërisht është pasojë e mungesës së kriterit të brendshëm, që u mundëson njerëzve që edhe në rrethana të ndryshueshme të shkojnë rrugës së tyre. Jeta e njeriut është e komplikuar dhe e ndërlikuar, dhe nëse ajo nuk udhëhiqet nga ideja për të mirën, të bukurën dhe jetën e vërtetë, njeriu barazohet me xhunglën, ku sundojnë ligjet e rendit më të ulët. Të rrosh pa një ide që të prin, kjo do të thotë të zhytesh në lojën e rastësishme të rrethanave, “të endesh me shpirt lart e poshtë është njësoj si të endesh lart e poshtë në këmbë”.<sup>267</sup>

paqartë), që e bëjnë të vështirë për njerëzit interpretimin e qartë të rrethanave. “Ata i turbullojnë ujërat e tyre që të duken më të thella.” (Nietzsche, *Takoje govorio Zaratustra*, f. 118)

<sup>265</sup> Ne shpeshherë krenohemi me ndryshimet në mjedisin tonë natyror dhe shoqëror, sepse ato dëshmojnë për fuqinë e njeriut për të kontrolluar rrethanat e jashtme; por, harrojmë që këto ndryshime e kanë shqetësuar dhe e kanë bërë të pasigurt të brendshmen e njeriut. Ai ka qenë i qëndrueshëm dhe i sigurt për aq sa natyra dhe mjedisi i tij jetësor ka qenë i qëndrueshëm dhe i sigurt. Kur këto kanë filluar të pësojnë ndryshime të mëdha, njeriu ka hetuar se nuk ka një lidhje të fortë as me botën që është jashtë tij e as me vetveten. Duket se ndryshimet e jashtme janë më të shpejta se aftësitë tona për t’iu përshtatur atyre në mënyrë aktive.

<sup>266</sup> Sartre, *Davo i gospod bog*, f. 271.

Disa studime tregojnë se ndjenja e pasigurisë dhe e paaftësisë janë gjendje të përgjithshme, që nënkupton se janë të pavarura nga pozita e individit në strukturën e shoqërisë dhe nga niveli i tij arsimor. (A. M. Guest, “Subjective Powerlessness in the United States: Some Longitudinal Trends”, SSO, no 4, 1974, pp. 827-842)

<sup>267</sup> Igo, *Čovek koji se smeje*, Rad, Beograd, 1959, f. 330.

Në shoqërinë moderne civile, ku e mira është ndërruar me të dobishmen, e bukura me funksionalen dhe e vërteta me të drejtën, raporti me idealin dhe me të ardhmen humbet, sepse e tanishmja përjetohet si i vetmi stacion. “Ekziston vetëm një *tani* e gulçuar dhe ç’të kapësh të takon vetëm ty.”<sup>268</sup> Por, jeta pa ideal, në fakt, është një konfirmim se njerëzit heqin dorë edhe nga e ardhmja.

Njeriu që rron pa një raport me idealin, pra me të ardhmen, tjetërsohet dhe endet poshtë-përperjetë pas atyre gjërave që tërheqin. Ai nxiton<sup>269</sup> që të rrethohet prej gjërave, sepse është tjetërsuar, dhe ndihet i sigurt vetëm në botën e gjërave. Ndjehet i sigurt kur ha, pi, kur blen dhe paguan; ndihet i humbur nëse pyetet për kuptimin e të gjitha veprimeve të lartpërmendura. Njeriu nuk është masa e gjërave; gjërat janë masa e tij.

Sistemi socio-kulturor i jep përparësi gjërave në raport me vlerat. “Jetojmë në kohët e turbullirave të mëdha. Harrohet ajo që duhet ditur dhe mësohet ajo që duhet harruar.”<sup>270</sup>

Ideali është ai që e ngre njeriun mbi natyrën (sepse ai shkon shpesh kundër instinkteve natyrore dhe ndjenjave) dhe mbi shoqërinë (normat shoqërore i rrënon gjithnjë krijuesi), sepse njeriu do dhe mund të veprojë në kundërshtim me instinktet natyrore dhe kërkesat shoqërore, nëse ndjen, di dhe beson se është duke vepruar në bazë të ndërgjegjes dhe idealit të tij, që për të është masa e fundit për vlerësimin e veprimeve.

Pa ideal individi nuk mund të zhvillohet drejt njerëzores. “Njerëzimi akoma nuk ka qëllim. Por, më thoni, o vëlle-

<sup>268</sup> Mihailo Lalić, *Zlo proljece*, f. 396.

<sup>269</sup> “Çështja kryesore nuk është se sa shpejt ecën njeriu, por ku po shkon dhe për çfarë. Prandaj shpejtësia nuk është gjithnjë përparësi.” (Ivo Andrić, *Na Drini Čuprija*, Prosveta, Beograd, 1971, f. 234)

<sup>270</sup> Igo, *Jadnici*, I, f. 162.

zërit e mi, nëse njerëzimit ende i mungon qëllimi, atëherë a nuk mungon edhe vetë njerëzimi?"<sup>271</sup>

### **Monopoli mbi përkufizimin e realitetit**

Ata njerëz të cilët në vetvete dhe pas vetes nuk kanë ndërtuar kritere matëse, me anë të të cilave do të sillleshin me vetëdije në mënyrë kritike ndaj të gjitha fenomeneve në përvojën e tyre, doemos që këto kritere i marrin prej të tjerëve. Këto masa vlerësuese i kanë përcaktuar sipas interesave të tyre. Pra, këta të tjerët, në të shumtën e herëve janë udhëheqës të grupit ("liderë të mendimit") dhe të "mediave masive".

(i) Këto mjete komunikimi e nxjerrin njeriun nga turma për të treguar se cili është. Ato i japin identitet. (ii) Ato i tregojnë njeriut se çfarë dëshiron të jetë; ato zgjojnë aspiratat tek ai. (iii) Ato i tregojnë se në ç'mënyre duhet të arrihet kjo; i japin duart dhe teknikën; (iv) i tregojnë se si mund të fitojë iluzionin, se në gjithë këtë ai ia ka dalë me sukses, madje edhe nëse nuk ka korrur kurrfarë suksesi. Ato i japin atij lejen e kalimit..."<sup>272</sup>

<sup>271</sup> Nietzsche, *Takoje govorio Zaratustra*, f. 54.

<sup>272</sup> S. R. Mils, *Elita vlasi*, f. 404.

## BARTËSIT E MESAZHIT

*“Si shembull për pavetëdijen e mëhershme për veprimet psikike dhe sociale të zgjatimeve të komunikimit, mund të shërbejë pothuajse çdo deklaratë konvencionale për këto veprime.”*

McLuhan

S’ka dyshim se efikasiteti i mesazhit, varet drejtpërdrejtë edhe prej bartësit teknik (transmetuesit) të tij (mediumit, ndërmjetësit, zgjatimit). I njëjti mesazh i bërë publik përmes llojeve të ndryshme të burimeve teknike për transmetim, shkakton efekte të pabarabarta; që do të thotë se fuqia e mesazhit nuk varet vetëm nga përmbajtja e tij, por edhe nga forma dhe struktura e transmetuesit teknik.

Është domethënës fakti se teoricienët e manipulimit i kanë kushtuar një kujdes të veçantë studimit të kuptimit të porosive që transmetohen përmes mjeteve të ndryshme, por shpeshherë kanë lënë mënjanë dy fakte të rëndësishme: a) se forma dhe struktura e zgjatimit, në një masë të madhe përcakton efektet e mesazhit; b) vetë zgjatimi (mjete), në fakt, është mesazhi.

Se sa ndikojnë forma dhe struktura e zgjatimit te efekti i mesazheve, këtë e ka treguar McLuhan-i në studimet e tij të shumta.<sup>273</sup> Teksa analistët e tjerë preokupoheshin me përmbajtjen/kuptimin e zgjatimit, McLuhan-i përqendrohej

<sup>273</sup> Këshillojmë këta tre libra të tij: *Understanding Media: the Extensions of Man*, McGraw Hill Book Company, New York, 1964; *The Gutenberg Galaxy*, University Press, Toronto, 1962; *The Mechanical Bride, Folklore of industrial Man*, Vanguard, New York, 1951.

te forma (struktura) e zgjatimit. Ja një pjesë nga *Instrumentet e komunikimit*, ku duket qartë se çfarë dëshiron të na thotë McLuhan-i: “Le të supozojmë se në vend të yjeve dhe vijave duhet të paraqesim një copë stofi ku janë shkruar fjalët «flamuri amerikan». Edhe pse kuptimi i këtyre simboleve do të ishte i njëjtë, ato do të vepronim në mënyra krejtësisht të ndryshme. Ta shndërrosh mozaikun e pasur të yjeve dhe vijave në fjalë të shkruara, nënkupton që ta privosh atë nga pjesa më e madhe e vetive të tij si një imazh korporativ dhe si përjetim; por, në të vërtetë, lidhja abstrakte, le të themi se do të mbetet e njëjtë. Ndoshta ky shembull do të shërbejë si paralajmërim për ndryshimin që përjeton njeriu tribal gjatë procesit të arsimimit.”<sup>274</sup>

Duke pasur parasysh rëndësinë e simboleve (yjeve dhe fjalëve), nuk do mund të identifikoheshin dallime të rëndësishme; por, duke pasur parasysh veprimet e këtyre simboleve, atëherë është e mundur që të verifikohen dallime të rëndësishme. Teksa me fjalët “flamuri amerikan” përgjithësisht shprehet një shtresë e përvojës së vetëdijshme të një populli, ndërkaq me yjet dhe vijat shprehet jo vetëm kjo shtresë e vetëdijshme, por edhe kolektivja, e nënvetëdijshmja dhe e pavetëdijshmja. Kjo do të thotë se zakonisht, me anë të fjalëve mbulohet një shtresë e përvojës dhe ngelet pa përfshirë një realitet shumë më i gjerë dhe më i thellë. Atëherë është e çuditshme që efekti i yjeve dhe vijave, simbolet që mbulojnë shtresat e vetëdijshme, të nënvetëdijshme dhe të pavetëdijshme të përvojës kolektive, është shumë i fuqishëm. “Marrja me efektin e jo me kuptimin – bash ky është ndryshimi themelor i epokës sonë elektrike, sepse efekti përfshin tërësinë e situatës, e jo ndonjë nivel individual të

<sup>274</sup> McLuhan, *Poznavanje opštita čovekovih proizetaka*, Prosveta, Beograd, 1971, f. 121.

qarkullimit të informacioneve.”<sup>275</sup> Njeriu më shumë përjeton sesa kupton, dhe do të ishte gabim të thuhet se në sjelljet e tij ndikon vetëm ajo që ai kupton, e jo e gjithë ajo që përjeton, edhe pse nuk e kupton racionalisht këtë.

Për aq sa bartësit e mesazheve janë të hapur ndaj të gjitha shtresave të përvojës individuale dhe kolektive, dhe për aq sa janë në gjendje që t’i ndërlidhin dhe t’i shprehin këto përvoja në format përkatëse simbolike (strukturat), është e mundshme që në procesin e bindjes së turmave ata do jenë shumë më të fuqishëm sesa ato media që në bazë të strukturës së tyre nuk mundësojnë depërtimin e gjerë dhe të thellë në të gjitha shtresat e përvojës individuale dhe kolektive. Në qoftë se në media përfshihen të gjitha mjetet për përcjelljen e mesazheve<sup>276</sup>, dhe jo vetëm të ashtuquajturat media masive (shtypi, radioja, televizioni, kinemaja), atëherë është e mundur të bëhet një listë përafërsisht e besueshme për këto media, duke pasur parasysh strukturën e tyre, e cila pak a shumë mundëson shprehjen e përvojave individuale dhe kolektive.

Këtu vlen rregulli themelor: për aq sa bartësi i mesazheve është personal, ai është më efikas në formimin, përcaktimin dhe ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të njerëzve. Kjo do të thotë që, për shembull, biseda e drejtpërdrejtë personale ka më efekt se një fjalim drejtuar një grupi të caktuar. Biseda përmes telefonit<sup>277</sup> është më efikase se të folurit

<sup>275</sup> Po aty, f. 62.

<sup>276</sup> Shih përmbajtjen e librit të McLuhan-it.

<sup>277</sup> “Ish-ministri i ushtrisë gjermane, Albert Shper, në fjalimin e tij në procesin e gjyqimit në Nuremberg, theksoi disa vërjetje të hidhura në llogari të veprimeve të instrumenteve elektrike në rrethanat jetësore në Gjermani. Telefoni, teleprinteri dhe telegrafi kanë bërë të mundur që urdhrat nga pozicionet lokale të përçoheshin deri në nivelet më të ulëta, ku për shkak të autoritetit absolut që qëndronte pas tyre, zbatoheshin në mënyrë jokritike.” (McLuhan, po aty, f. 306)

që xhirohet; se një bisedë është më efikase përmes televizionit sesa përmes radios; se një bisedë (intervistë) e botuar në gazetë, revistë apo libër ka pak gjasa që të prekë në thellësi pjesët e ndjeshme të përvojës së përbashkët.<sup>278</sup>

Fjala e thënë dhe e shkruar (shtypur) – dy skaje në vazhdimësinë e efikasitetit tonë – nuk ndryshojnë duke marrë parasysh kuptimin e tyre, por duke pasur parasysh fuqinë që vë në lëvizje ndjenjat, mendimet dhe veprimet tona. Fjala e thënë nuk varfërohet, siç ndodh me fjalën e shkruar; efektin e saj e ndihmon dhe e rrit lartësia, butësia dhe ngrohësia e të shqiptuarit; lëvizjet e trupit dhe pushimi gjatë të folurit; theksi... Fjala e thënë, secila më vete, është e zakonshme, por kur kjo fjalë është në shoqërinë e fjalëve të tjera, dhe kur përforcohet me forma, zëra, ngjyra e aroma të ndryshme, fiton njëfarë fuqie dhe bukurie të re; si i vetmuari, që i ndarë nga të tjerët (jo në të gjitha rrethanat) nuk është asgjë, por në shoqëri fiton njëfarë fuqie të re. Kështu që, edhe për ata që e njihnin më parë këtë të vetmuar, tashmë ai është pazakonshëm dhe i çuditshëm. Çdo fjalë e thënë është e ngarkuar me përvojë vetjake dhe të përbashkët, me djersë dhe gjak, dhe njeriu ndjen – tekta i dëgjon këto fjalë të valëzuara – se në secilën syresh rreh një zemër e përbashkët. Fjala e shkruar ndahet nga ky bollëk, shpreh atë që mundet, dhe shumë herë lë të pathënë atë që është e parritshme me fjalë, por që është e rëndësishme për jetën. Za-

<sup>278</sup> Kantril dhe Allport, në veprën *Psikologjia e radios*, kanë analizuar mjetet e ndryshme për transmetimin e mesazheve, duke marrë parasysh raportin e drejtpërdrejtë të dërguesit dhe të marrësit të mesazhit:

(Pjesëmarrja më e madhe)

biseda personale, diskutim në grup, mbledhje joformale njerëzish, telefoni, mbledhje formale njerëzish, filmi me zë, televizioni, radioja, telegrafi, korrespondenca personale, forma e letrës, vendi i paraqitjeve të shpalljeve, revistat, gazetat, librat. (Cituar nga Rudi Supek, "Masovne komunikacije i propaganda", në: *Socialna psihologija*, Rad, Beograd, 1972, f. 256.

konisht, fjala e shkruar shpreh atë që është e vetëdijshme në përvojën tonë, dhe shpeshherë i lë të paprekura shtresat e nënvetëdijshme dhe të pavetëdijshme të përvojës.<sup>279</sup>

Në bisedën e drejtpërdrejtë personale, si te dërguesi ashtu edhe te marrësi i mesazhit, aktivizohen pjesë të caktuara të trurit dhe pesë shqisat. Është e kuptueshme që mesazhi prek jo vetëm dimensionet e vetëdijshme dhe sipërfaqësore të përvojës personale dhe kolektive, por edhe telat më të thellë që dridhen në çastin e daljes kolektive nga vetvetja. “Gjithçkaje i kam dhënë vetveten. Kam pranuar në zemër zërin e çdo gjëje... Ia kam hapur shpirtin çdo fenomeni jetësor; kam hapur sytë ndaj çdo trajte të tij. Në çdo prekje nëpër këto fenomene ka mbetur nga një grimcë prej vetes sime.”<sup>280</sup>

Me rastin e leximit të gazetës, revistës dhe librit, në radhë të parë merr pjesë truri dhe syri<sup>281</sup> i lexuesit të vetmuar. Të gjitha format e realitetit objektiv reduktohen në një rrafsh<sup>282</sup>, dhe për këtë arsye është e kuptueshme që mesazhet e gazetave, revistave dhe librave nuk e tërheqin turmën, nuk e emocionojnë. Ky fakt shpjegon se pse fjala e shkruar, që gjithashtu është një medium masiv, nuk mund të bëjë një turmë<sup>283</sup>; përkundrazi, ajo i jep mundësi çdo

<sup>279</sup> “Regjisori dhe aktorët do ta kuptojnë fare lehtë se për çfarë bëhet fjalë. Fjala “mbrëmë” nuk mund të shkruhet në shumë mënyra, por Stanislavski e kish zakon të kërkonte nga aktorët e rinj që ta thoshin këtë fjalë duke e theksuar në pesëdhjetë mënyra të ndryshme, ndërkohë që publiku i përfntonte këto ngjyresa të ndryshme ndjenje dhe kuptimi të theksuar.” (McLuhan, po aty, f. 121)

<sup>280</sup> Vladan Desnica, *Proljeća Ivana Galeba*, f. 404-5.

<sup>281</sup> “Syri është i ftohtë dhe indiferent.” (McLuhan, po aty, f. 205)

<sup>282</sup> “Qytetërimi fillon me arsimin, pasi arsimi shënon përpunimin e njëtrajtshëm të një kulture me ndihmën e një shqise (të parit), që me anë të shkrimit është zgjatur në kohë dhe hapësirë. Në kulturat fisnore, përvoja është rregulluar në bazë të shqisës së dëgjimit, e cila lë mënjanë vlerat e imazheve.” (McLuhan, po aty, 128)

<sup>283</sup> Masmedia është një shprehje e paqëlluar, sepse nënkupton që vetëm prodhimi masiv i një gjëje (për shembull, të dhënat) arrin që prej njerëzve të formojë masën. Shih: McLuhan, “Classroom Without Walls”, in: *Explorations in Communication*, ed.

njeriu që të shprehet në mënyrë unike dhe të papërsëritshme. Këtu, gjithashtu shpjegohet se pse libri, malli i parë i prodhimit masiv<sup>284</sup>, nuk i ka kënaqur ndonjëherë nevojat e turmave, dhe për këtë arsye ka mbetur jetim në botën e pasur të mallrave. Autorët e librave besojnë më kot se libri do shndërrohet në një mjet konsumi masiv.<sup>285</sup> “Unë i njoh veprat e tua. Ti nuk je as i ftohtë e as i ngrohtë. Ah, sikur të ishe i ftohtë dhe i ngrohtë. Kështu i vakët siç je, nuk je as i ftohtë, as i ngrohtë. Prandaj kjo do më bëjë të vjell.”<sup>286</sup>

Duke qenë se gazetat, revistat dhe librat nuk janë mjetet më efikase të bindjes, është e kuptueshme që bindësit u drejtohen mjeteve më të fuqishme, si: filmi, televizioni dhe radioja. Këto mjete, – brenda një sistemi pronësie dhe kontrolli<sup>287</sup> – si për nga forma ashtu edhe për nga struktura e tyre, iu përgjigjen nevojave të këtij sistemi. Sistemi nuk ka nevojë të lexojë e të mendojë, por të shohë e të dëgjojë.

Libri e shtyn njeriun që të mendojë, televizioni e josh<sup>288</sup>; libri e vetmon, filmi dhe televizioni e kthejnë në grup<sup>289</sup>;

by Ed, Carpenter and M. McLuhan, Jonathan Cape, London, 1970, p. 2. Në të njëjtën vepër duhet parë: David Riesman, “The Oral and Written Traditions”, p. 112.

<sup>284</sup> McLuhan, po aty, f. 224.

<sup>285</sup> Hugo shkruan: “Zbulimi i shtypit është ngjarja më e madhe në histori; është nëna e të gjithë revolucioneve. Kjo është mënyrë e manifestimit të njerëzimit, që ndryshon nga themeli; ky është mendimi njerëzor që heq një palë rroba dhe vesh një palë të tjera; ky është ndërrimi i plotë i këmishës simbolike të gjarprit, të cilën e ka shfaqur truri qysh prej kohës së Adamit.” (*Zvonar bagorodične crkve*, Svetlost, Sarajevo, 1961, f. 210).

<sup>286</sup> *Zbulesa e Gjonit*, kap. 3 parag. 15-16.

<sup>287</sup> McLuhan-i dhe shumë autorë të tjerë e anashkalojnë këtë çështje. Kështu, Bannester-i shkruan: “It is immaterial who owns the gun and is licensed to carry it; the question is, who has his finger on the trigger?” (Bannester, E. M., “Socio-dynamics: An Integrating Theorem of Power, Authority, Interinfluence and Love, *American Sociological Review*, 34 (3) 1969, p. 368)

<sup>288</sup> “Shoh shumë në televizion – kjo më bën të mirë, të zbrazur.” (H. Böll, *Mišljenje jednog klovn*, Prosveta, Beograd, 1966, f. 158)

<sup>289</sup> Në veçanti kjo theksohet nga McLuhan-i.

përmbajtja e librit përjetohet në mënyrë individuale, ndërsa përmbajtja e filmit dhe e televizionit është kolektive<sup>290</sup>; leximi kërkon përpjekje intelektuale, shikimi kërkon një vend të rehatshëm; leximi mund të bëhet ngadalë dhe pak nga pak, kurse për të shikuar duhet shpejt dhe shumë; libri mund të rilexohet, ndërsa seriali televiziv është i vështirë për t'u përsëritur; libri është i lirë për t'u prodhuar, por është i rëndësishëm për lexuesin; filmi, televizioni dhe radioja janë të shtrenjtë për t'u prodhuar, por zakonisht të lirë në konsum; libri krijon personalitetin për personalitete të tjerë, serialet televizive prodhojnë grupe për turmën; librat lexohen nga të diturit me përvojë, ndërsa televizionin e shohin konsumatorët e papërvojë dhe me arsim të dobët<sup>291</sup>; libri është zgjatim i intelektit njerëzor, televizioni është zgjatim i trupit të njeriut; libri i ka bërë analfabetët vartës, kurse televizioni u ka kthyer atyre autoritetin e humbur; libri plotëson shijen vetjake, televizioni instinktet masive; libri është pasuri kulturore, seriali televiziv është një mall që harxhohet; libri mund të lexohet atëherë kur dëshiron, televizioni duhet shikuar kur duhet<sup>292</sup>; libri, zakonisht mëson dhe edukon, kurse televizioni zbavit dhe shfrytëzon; libri informon, televizioni manipulon (reklama, propaganda, indoktrinimi); libri kërkon të kuptuarit pa të detyruar që të biesh dakord, ndërsa televizioni nxit pranimin pa detyrimin për të kuptuar; libri mundëson komunikimin e vërtetë, televizioni e pengon komunikimin (numri i atyre që dërgojnë me-

<sup>290</sup> Më gjerësisht: Gilbert Seldes, "Communication Revolution", in *Explorations in communication*, eds. Edmund Carpenter and Marshal McLuhan, Jonathan Cape, London, 1970, p. 196.

<sup>291</sup> Meqë që shikuesit e televizionit janë kryesisht njerëz me arsim formal, ndërkohë që shumica në shoqëri nuk ka shkollim të lartë apo superior, fuqia e televizionit bëhet e dukshme edhe për të verbrin.

<sup>292</sup> Tashmë kjo tregon se në kohën e lirë televizioni nuk luan rolin që pritej.

sazhe në raport me ata që i marrin, për habi është i vogël)<sup>293</sup>; libri është një klasë mësimi pa mure, televizioni është një burg pa rrethim<sup>294</sup>; libri është krijuar për ata që çuditen dhe mendojnë për jetën, kurse televizioni është shpikur për ata që çuditen me ata që mendojnë.<sup>295</sup>

Studimet tregojnë se shumica e njerëzve i hedhin poshtë mesazhet që vijnë përmes një mjeti të paskrupullt, që ata nuk e pëlqejnë apo të cilit nuk i besojnë.<sup>296</sup> Duke qenë se që të gjitha mjetet teknike kanë pak nga vetjakja<sup>297</sup>, ato nuk mund të jenë aq të efektshme në bindje siç mund të jenë personalitetet në kontakt të drejtpërdrejtë me anëtarët e grupeve të tyre. Prandaj, “peshkatarët e shpirtrave njerëzorë” i drejtohen udhëheqësve të këtyre grupeve, dhe nëse arrijnë të ndikojnë në qëndrimet dhe sjelljet e tyre, është e sigurt që tërthorazi do të ndikojnë edhe mbi grupet që shkojnë pas këtyre udhëheqësve. Është e sigurt se mesazhet gjithnjë e më tepër do të formulohen në atë mënyrë që të godasin dhe të shprehin nevojat e udhëheqësit, jo të turmës, meqë udhëheqësit kanë ndikim mbi turmat. Bindësit e the-

<sup>293</sup> Dërguesi dhe marrësi i mesazhit – një dallim teknik që është bërë realitet shoqëror.

<sup>294</sup> “Filmi, radioja dhe televizioni – klasë mësimi pa mure.” (McLuhan, *Poznavanje opština*, f. 346)

Deri te një qëndrim i tillë i gabuar duhet të vijë çdo analist që mediat masive nuk i sheh në një sistem të veçantë pronësie dhe kontrolli socio-politik. Në një sistem totalitar, mediat masive nuk mund të kenë objektiva të pavarura politike, dhe zakonisht janë të inkuorporuara në sistemin e përgjithshëm të kontrollit. Në atë masë që mediat masive janë të varura nga shteti apo partia, në të njëjtën masë shërbejnë si mjete të propagandës ekonomike dhe politike, e jo si mjete për arsimim dhe edukim.

<sup>295</sup> Edhe studiuesit e tjerë theksojnë se televizioni tërheq, narkotizon, vë në gjumë, qetëson, pasivizon, topit.

<sup>296</sup> Njerëzit mësohen të lexojnë mes rreshtash, e jo vetëm rreshtat. Kështu, vlera e fjalës së shkruar po zvogëlohet përherë e më shumë.

<sup>297</sup> Më gjerësisht: *Reader in Public Opinion and Communication*, eds. B. Berelson and M. Janowitz, The Free Press, Glencoe, Illinois, 1953, pp. 43-49.

llë e përdorin nevojën e fshehtë të shumicës që të manifestohen nëpërmjet njëshit.

### Zgjatimi është mesazhi

Nëse me McLuhan-in nuk mund të biem në ujdi rreth kuptimit dhe rëndësisë së mesazhit në strukturën e elementeve të tjerë të komunikimit, – shpesh ai thekson se përmbajtja e mesazhit është çështje sporadike, dhe është e rëndësishme që vëmendja të orientohet te forma dhe struktura e zgjatimeve si të tilla<sup>298</sup> – duhet të pajtohemi me të rreth qëndrimin themelor: se zgjatimi është mesazhi. Përveç kësaj, natyrisht, McLuhan-i e zgjeron nocionin e zgjatimit duke përfshirë në të fjalën e thënë, rrugët, numrat, veshjet, hapësirën e banimit, paratë, orën, shtypin, rrotën, fotografinë, makinën e shtypit, telegrafin, telefonin, fonografin, filmin, radion, televizionin, armët dhe automatizimin. Çdo prodhim nga puna e njeriut është zgjatim i komunikimit, sepse në çdo prodhim është shkruar fjala e njeriut, e cila na informon për origjinën e prodhimit. Prodhimi është një “unë i dytë”, është një “e vërtetë e shënuar njerëzore”, “një ide e mbyllur në send”; është “lapidari i njeriut”, “biografia e njeriut”; është “njeri i tjetërsuar”.

Prandaj, produktet e punës së njeriut mund të shihen si një lloj i veçantë librash.<sup>299</sup> Bota e sendeve është libër, prandaj njeriu mund ta lexojë atë. Njeriu është lexues.<sup>300</sup>

<sup>298</sup> McLuhan-i gabon së paku për dy gjëra të rëndësishme: i) kur forma e zgjatimeve të jetë më e rëndësishme se përmbajtja e tyre, atëherë censura do t’ia kushtojë vëmendjen kryesore zgjatimeve si të tilla, e jo përmbajtjes së tyre; ii) nëse zgjatimi nuk mbron një “këndvështrim”, por vetëm sa është i orientuar në “procesin e pjesëmarrjes”, si mund të ndodhë që njerëzit të zgjedhin edhe zgjatimet, edhe përmbajtjet në përputhje me “këndvështrimet” e tyre!?

<sup>299</sup> “Çdo ndërtesë ishte një mendim.” (Igo, *Zvonar bogorodične crkve*, f. 233)

Ndoshta është mirë që McLuhan-i nuk ecën në këtë rrujë në analizën e zgjatimeve të komunikimit, domethënë të gjurmave për kuptimin e mesazheve që janë futur te mjeti i zgjatimit. Por, ai hulumton pasojat socio-psikologjike të zgjatimeve të njeriut si të tilla. Me të drejtë ai mendon se shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për të gjitha pasojat që shkakton një zgjatim në jetën e tyre, pavarësisht mënyrës së përdorimit<sup>301</sup> të këtyre zgjatimeve, qëllimeve për të cilat shërbejnë këto zgjatime dhe përmbajtjes që transmetojnë.

Çdo zgjatim i ri, para së gjithash përfaqëson qoftë vazhdimin e pjesëve trupore të njeriut, qoftë vazhdimin e pesë shqisave të tij apo të sistemit nervor. Lapsi, çekani dhe rrota janë zgjatime të shuplakave, duarve dhe këmbëve; telefoni është zgjatim i veshit dhe zërit; televizioni është zgjatim i shqisës së prekjes apo bashkëveprimit të shqisave; kompjuterat janë vazhdim teknologjik i vetëdijes.<sup>302</sup>

Së dyti, në njëfarë mënyre njeriu përshtatet (me vetëdije, nënvetëdije, pa vetëdije) ndaj çdo zgjatimi të ri, në vend që zgjatimi t'i përshtatet vetvetes. Shembulli më i mirë në këtë drejtim është adaptimi ndaj orës. "Orës, e jo nevojave organike, do të fillojnë t'i përshtatet jo vetëm puna, por edhe të ngrënit dhe gjumi."<sup>303</sup> "Ju përshtat zgjatimit të vet dhe u bë një sistem i mbyllur."<sup>304</sup>

<sup>300</sup> Për McLuhan-in kjo ide nuk është e panjohur, por ai nuk e vlerëson si të rëndësishme. Kështu ai shkruan se "prodhimi i mallrave po merr gjithnjë e më tepër rolin e informuesit". (*Poznavanje opštita*, f. 74)

<sup>301</sup> "Me përgjigjen tonë konvencionale në të gjithë zgjatimet, – pra është e rëndësishme se si përdoren – mbajmë një qëndrim të pandjeshëm prej idioti teknologjik." (Po aty, f. 53) "Shumë njerëz thonë se kuptimi dhe mesazhi i makinerisë nuk është vetë ajo, por ajo që ka arritur njeriu me anë të saj. Nga pikëpamja e mënyrës se si makineria i ka ndryshuar marrëdhëniet tona me veten dhe me të tjerët, s'ka fare rëndësi nëse një makineri prodhon kokoshka apo Ferrari." (Po aty, f. 41)

<sup>302</sup> *Poznavanje opštita*, f. 41.

<sup>303</sup> Po aty, f. 192, 201, 203 etj.

<sup>304</sup> Po aty, f. 79.

Së treti, çdo zgjatim i ri ndryshon mjedisin tonë jetësor. Togfjalëshi “zgjatimi është mesazh”, nga këndvështrimi i epokës elektronike nënkupton që është krijuar një mjedis krejtësisht i ri.<sup>305</sup> Ne bëhemi të vetëdijshëm shumë ngadalë për mjedisin e ri, zakonisht vetëm atëherë kur shkëputemi nga mjedisi i vjetër. Humbja na bën të vetëdijshëm për atë që kemi humbur. Kështu, të vërtetat themelore për natyrën do të zbulohen vetëm atëherë kur nuk do të ketë më natyrë, sepse vetëm atëherë do të bëhemi të vetëdijshëm për vlerat që kemi humbur. Ndryshimi teknik, jo vetëm që ndryshon mjedisin jetësor, por edhe mënyrën e të menduarit, besimin dhe vlerësimin.

Së katërti, çdo zgjatim i ri shkakton një mori pasojash të tjera: të shkruarit nënkuptonte fuqi, pushtet dhe kontroll në distancë mbi strukturat ushtarake<sup>306</sup>; telefoni, telegrafi, radioja dhe televizioni e bëjnë të parëndësishëm nocionin e hapësirës, dhe kjo fuqi është e pavarur prej përmbajtjes së tyre; drita elektrike ka shfuqizuar ndarjen në ditë dhe natë, në të brendshme dhe të jashtme, nëntokë dhe mbi tokë.<sup>307</sup> Secila nga format e transportit ndryshon dërguesin, marrësin ose vetë mesazhin.<sup>308</sup>

Së pesti, çdo zgjatim i ri nuk shkakton vetëm ndryshime në mjedisin e jashtëm, por edhe në marrëdhëniet midis shqisave tona. “Unë them se zgjatimet si vazhdimësi të shqisave tona vendosin raporte të reja, jo vetëm midis shqisave

<sup>305</sup> Po aty, f. 30.

<sup>306</sup> Po aty, f. 124.

<sup>307</sup> Po aty, f. 171.

“Drita e energjisë elektrike është lajmërim i pastër. Ajo përbën, le të themi, një zgjatim pa mesazh.” (f. 41) “Nuk ka rëndësi a shfrytëzohet (drita elektrike) për një operacion në tru apo për një ndeshje sportive gjatë natës.” (f. 42).

<sup>308</sup> Po aty, f. 131.

private, por edhe mes vetë shqisave, kur veprojnë njëra mbi tjetrën.<sup>309</sup>

Pavarësisht përmbajtjes dhe kuptimit të mesazheve që mund të transmetohen përmes zgjatimeve, vetë prania e zgjatimeve në jetën tonë shkakton një seri pasojash socio-psikologjike, për të cilat shumica e njerëzve as që janë të vetëdijshëm.<sup>310</sup> Orientimi i vëmendjes vetëm te përmbajtja e zgjatimit nënkupton që nga tërësia e veprimit të zgjatimit të veçohet një pjesë, ndoshta më pak e rëndësishmja, dhe në bazë të njohjes së kësaj pjese, të nxirren konkluzione për tërësinë. Ky proces të kujton punën e mjekut, i cili fokusohet te zbulimi i disa sëmundjeve të veçanta dhe te gjetja e ilaçeve specifike për disa sëmundje të izoluar, pa e përqendruar asnjëherë vëmendjen mbi “sindromën e sëmundjes si të tillë”.<sup>311</sup>

Sot bëhemi të vetëdijshëm se mjetet teknike për të përcjellë mesazhe nuk janë ndërmjetës pasivë midis dërguesit dhe marrësit të mesazheve, por, ashtu si të gjithë ndërmjetësit e tjerë, ndryshojnë jo vetëm gjuhën, formën dhe strukturën e mesazhit, por ndikojnë ndjeshëm mbi vetë dërguesin dhe marrësin. Ashtu siç janë të (për)caktuara mundësitë e njeriut për të njohur botën duke u mbështetur te numri, forma dhe struktura e organeve të tij njohëse, gjithashtu njohja e botës nga ana e tij do të varet prej numrit<sup>312</sup>, formës dhe strukturës së këtyre organeve. Por, e njëjta gjë është

<sup>309</sup> Po aty, f. 92.

<sup>310</sup> “Thuhet se në vendin e të verbërve, ai që ka një sy nuk është mbret. Ai konsiderohet si një i marrë që flet përçart.” (Po aty, f. 403)

<sup>311</sup> Po aty, f. 104-105

<sup>312</sup> “Me zgjerimin e një organi dhe zhvillimin e një të riu, ndryshon si bota ashtu dhe nocioni i Zotit. Gëzuar!” (E. M. Remarque, *Crni obelisk*, f. 157)

edhe me formën dhe strukturën e mjeteve teknike (media-ve) që ofrojnë mundësitë, por edhe kufijtë e tyre.<sup>313</sup>

Duke falënderuar McLuhan-in, gradualisht ne kuptojmë se këto mjete teknike janë vetë mesazhe, dhe në mjedisin tonë jetësor, ekonomik, shoqëror dhe kulturor ato shkaktojnë pasoja socio-psikologjike, rëndësia e të cilave vjen duke u rritur sa më pak të vetëdijshëm të jemi për to. Ajo për të cilën jemi të vetëdijshëm - përdorimi i mjeteve, porosive dhe kuptimeve që përcillen - është më pak vendimtare për jetën tonë sesa ajo që mbetet kërcënuese, për të cilën nuk kemi njohuri.

<sup>313</sup> Bash ky fakt shpjegon se pse është e pajustificuar frika, fjala vjen, se televizioni do i largojë arsimtarët prej klasave, apo se do rrezikojë kinemanë etj. Fakti që këto mjete zhvillohen krah për krah, ose më mirë, njëra jeton falë mungesës së tjetrës, flet për atë se mundësitë e tyre plotësohen. Atë që mund të bëjë arsimtari nuk mund ta bëjë libri; atë që mund të bëjë libri nuk mund ta bëjë radioja; atë që mund të bëjë radioja nuk mund ta bëjë televizioni.

## PROBLEMI

*“...dhe të ketë shpirt që arrin te të gjitha  
ato gjëra që nuk i kupton.”*

Marcel Proust

Problemi publik me të cilin ka të bëjë mesazhi, jo vetëm që nuk e ka tërhequr vëmendjen e teoricienëve të manipulimit, por ata as që e kanë përfshirë në strukturën e nocionit të manipulimit. Më duket se ky element në strukturën e konceptit të manipulimit nuk është për t’u nënvleftësuar, prandaj këtu do paraqesim marrëdhëniet e tij me elementet e tjerë të shprehjes.

Gjëja e parë të cilën duhet të paralajmërojmë është lidhja e pamohueshme ndërmjet kompleksitetit të problemit dhe mundësive për të ndikuar në qëndrimin lidhur me të. Nëse është fjala për probleme të zakonshme, të cilat mund të zgjidhen me sukses në bazë të përvojës vetjake dhe logjikës së shëndoshë, atëherë përpjekjet e të tjerëve për të ndikuar mbi qëndrimet e individit janë të kota. Sigurisht që menjëherë ngrihet pyetja se cili është problemi i zakonshëm dhe për kë është i tillë? Këtë pyetje do e përjashtojmë nga diskutimi në vijim, sepse nuk ka rëndësi nëse problemi në vetvete është i thjeshtë, por a e konsideron individi këtë problem si të thjeshtë, ngaqë për të është e thjeshtë gjithçka që ai vetë mund të shpjegojë dhe zgjidhë, pavarësisht kompleksitetit të vërtetë të problemit. Edhe problemin më kompleks, – për shembull, kuptimi i jetës – individi mund ta përkufizojë dhe ta zgjidhë në mënyrën më të thjeshtë: “Pse? Për këtë.” Për një tjetër, pyetja rreth kuptimit të jetës mbetet

një mister i përhershëm. Pra, mund të kemi një qëndrim të zakonshëm për një problem kompleks dhe një qëndrim kompleks për një problem të zakonshëm. Prandaj, përpjekja e pushtuesit të vetëdijes për të ndikuar mbi qëndrimet rreth një problemi të caktuar, përgjithësisht varet nga vetitë e qëndrimit, jo nga vetë problemi.

Nëse është fjala për probleme komplekse apo për probleme që janë shumë larg përvojës vetjake, për zgjidhjen e të cilave logjika mund të ndihmojë shumë pak, ndikimi i të tjerëve (bindësve) mbi qëndrimet tona është më i fortë dhe ne jemi të prirë që t'i ndjekim ata, veçanërisht në qoftë se ata janë në pushtet, me influencë dhe qëndrojnë mbi ne me autoritetin që gëzojnë. Ne nuk i kemi të formuluar me vendosmëri pikëpamjet tona për problemet që janë larg apo që janë përtej përvojave dhe interesave tona.

Probleme të tilla ka gjithnjë e më tepër, sepse njohuritë tona për gjërat janë të kufizuara në një rreth të ngushtë pyetjesh që lidhen me profesionin tonë. Në të gjitha çështjet e tjera ne jemi "ta paditurit universalë", dhe sipas rregullit hezitojmë që të themi diçka në mënyrë publike, edhe pse privatisht mund ta mendojmë. Pothuajse të gjitha problemet jashtë profesionit tonë na duken abstrakte dhe të paqarta. Ne i nënshtrohemi më shumë bindjes kur është fjala për qëndrimet rreth orientimeve filozofike, drejttimeve artistike, besimeve fetare, vlerësimeve ideologjike, dëshmime shkencore dhe abstraksioneve që nuk janë të rrënjësura në përvojën e përditshme. "Përmasat më të cilat veprojmë janë shifrat dhe abstraksionet; ato gjenden shumë larg, përtej kufijve që lejojnë çfarëdo përvoje konkrete, pasi asgjë nuk është konkrete. Faktikisht dhe moralisht çdo gjë është e mundur. Fiksioni shkencor nuk dallon prej faktit shkencor, ankthi dhe ëndrrat nuk ndryshojnë nga ngjarjet e së ardh-

mes. Njeriu është hequr nga një vend i veçantë, prej nga kishte mundësi të mbikëqyrte e të administronte jetën e tij dhe të shoqërisë.<sup>314</sup>

Një tjetër çështje me një rëndësi së veçantë për arkitektët e vetëdijes moderne ka të bëjë me lidhjen dhe harmonizimin e pjesëve themelore të qëndrimit të individit (grupit) me një çështje publike (subjekt, personalitet, grup, institucion, ngjarje, situatë, vlerë, ide etj).

Në marrëdhëniet e përditshmërisë, në bazë të natyrës, mjedisit shoqëror dhe kulturor, individi arrin përvoja, njohuri dhe besime të ndryshme. Këto informacione të larmishme nuk janë pa ndonjë rend të brendshëm<sup>315</sup>, edhe pse do të ishte e tepërt të thoshim se janë të lidhur plotësisht dhe të harmonizuar me njëri-tjetrin; kështu që nuk ka asgjë që nuk mund të vendoset në harmoni me sistemin. Vetëm individët e rrallë e realizojnë harmoninë e dëshiruar, dhe vetëm të rrallët sillen në atë mënyrë që prej çdo mendimi, vlerësimi dhe veprimi që bëjnë të ndjejmë e të njohim atë harmoni. Fjala vjen, i tillë do të ishte një ateist i përbetuar, i cili di të argumentojë mosbesimin e tij në Zot, që nuk është i ndjeshëm ndaj pyetjeve metafizike (“jomuzikal për fenë”) dhe nuk ushtron rite fetare. Të tre këta përbërës të qëndrimit të tij – njohja, ndjeshmëria dhe vullneti<sup>316</sup> – në raport me reli-

<sup>314</sup> Fromm, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 129.

“Të gjithë ne, në pikëpamjen e shkencës, zhvillimit, mendimit, studimit, idealit, dëshirës, liberalizmit, mendjes, përvojës dhe gjithçkaje, ama gjithçkaje, jemi akoma në klasën e parë fillore.” (Dostojevski, *Zločin i kazna*, Rad, Beograd, 1967, f. 219)

<sup>315</sup> “By definition, we do not allow beliefs to exist outside the belief system for the same reason that the astronomer does not allow stars to remain outside the universe.” (M. Rokeach, *Beliefs, Attitudes and Values, A Theory of Organization and Change*, Jossey Bass Inc., San Francisco, 1970, p. 2)

<sup>316</sup> Për këtë arsye njerëzit reagojnë në mënyra të ndryshme për të njëjtin problem: dikush me logjikë, dikush me nderja, dikush me veprim. Për më gjerë: *Readings in*

gjjionin janë të lidhur dhe të harmonizuar, dhe është krejt e sigurt se në të gjitha rastet ai do marrë një qëndrim konsekuent. Në kuptimin e kundërt, mund të ketë besimtar që është i aftë të ofrojë argumente bindëse dhe fakte të provuara për besimin te Zoti. Një i tillë e ndjen Zotin në çdo gjë dhe nuk lë asnjë rast pa e lartësuar Atë. Edhe te ky i fundit, tre përbërësit e qëndrimit – racionalja, emocionalja dhe vepuesja – janë të lidhur dhe të harmonizuar me njëri-tjetrin në raport me religjionin, dhe është e sigurt se do t'i mbetet besnik qëndrimit të tij në çdo rast. Në rastin e parë është fjala për qëndrimin konsekuent negativ; në rastin e dytë për qëndrimin konsekuent pozitiv ndaj religjionit. Në të dy rastet kemi të bëjmë me dy qëndrime të forta ndaj religjionit, dhe është e sigurt se në të dy rastet manipuluesi do të hasë një pengesë të pakapërcyeshme në përpjekjen e tij për të ndikuar qoftë në ndonjë përbërës të qëndrimit, qoftë te qëndrimi në tërësi.

Se sa i reziston ndryshimit një qëndrim ku të gjithë përbërësit janë të lidhur dhe të harmonizuar me njëri-tjetrin, mund ta shohim fare mirë nëse një qëndrim i tillë përballet me njohuritë, ndjenjat dhe besimet e reja. Mënyrat më të shpeshta përmes të cilave individi/grupi e zgjidh këtë situatë të tensionuar që krijohet si rezultat i takimit të qëndrimit të vjetër me përvojën e re, janë: a) kur individi/grupi refuzon çdo njohuri, ndjenjë dhe vullnet të ri që nuk është në përputhje me qëndrimin, dhe kështu e privon veten nga mundësia për t'u njohur me dallimet e shumanshme në situatën objektive; b) njohuria, ndjenja dhe vullneti tjetër pranohen si të mundshme, por nuk kanë asnjë ndikim te qëndrimi; c) njohuritë, ndjenjat dhe motivet e reja apo të tjera

synojnë të rishqyrtohen dhe të harmonizohen në qëndrim, por qëndrimi nuk e ndryshon përmbajtjen themelore, strukturën dhe funksionin e tij; d) njohuritë, bindjet dhe synimet e reja mund të shpallen si “devijim nga rregullat”, si përjashtime të parëndësishme; e) njohuritë, ndjenjat dhe tendencat e reja vepruese mund të ndikojnë në ndryshimin e pjeshëm të qëndrimit, që do të thotë se do shkojë puna deri te ndryshimi i një prej përbërësve të qëndrimit, por qëndrimi mbetet akoma i qëndrueshëm; f) njohuritë, ndjenjat dhe bindjet e tjera apo të reja mund të çojnë në një ri-interpretim radikal të qëndrimit, por pa miratimin se është hequr dorë nga qëndrimi i vjetër (racionalizimi).<sup>317</sup>

Para një vështirësie të madhe do shfaqet bindësi, në përpjekjen e tij për të ndryshuar qëndrimin e individit/grupit, kur qëndrimi i tij është i lidhur dhe i harmonizuar me qëndrimet që kanë të bëjnë me një çështje. Me këtë rast, zakonisht, jo të gjitha qëndrimet kanë të njëjtën rëndësi<sup>318</sup> për individin/grupin; dhe përgjithësisht, qëndrimet individuale dhe të veçanta janë të lidhura e të harmonizuara me një qëndrim të përgjithshëm apo universal, i cili ka një rëndësi qendrore në raport me të gjitha qëndrimet e tjera. Edhe pse nuk duhet të harrojmë se qëndrimet janë të organizuara psikologjikisht e jo logjikisht, këtë lidhje dhe ujdi të qëndrimeve nuk mund ta krahasojmë me një sistem logjik (deduktiv) të atyre qëndrimeve në krye të të cilave ndodhet një qëndrim i përgjithshëm ose universal, nga ku, në mënyrë logjike, vjen një seri qëndrimesh të veçanta dhe individuale. Një

<sup>317</sup> Festinger-i flet për disonancën njohëse, por nuk ka arsye që gjendja e tensionuar mes ndjenjës dhe synimeve vepruese të mos zgjerohet edhe në dy dimensionet e tjera. (Për më gjerë: L. Festinger, *A Theory of Cognitive Disonance*, Stanford University Press, Stanford, California, 1957)

<sup>318</sup> Për këtë shih librin e cituar: M. Rokeach, *Beliefs, Attitudes and Values*, p. 15 etj.

qëndrim në këtë sistem qëndrimesh do të jetë i veçantë në krahasim me ata më "lart", që janë të përgjithshëm në raport me ata që janë "poshtë" tij.

Ndarja në qëndrime të përgjithshme, të veçanta dhe individuale është vetëm një imazh i thjeshtuar i një sistemi shumë të komplikuar qëndrimesh që kanë të bëjnë me një problem publik. Kështu, për shembull, në qoftë se individi mendon se dhuna duhet të hidhet poshtë si një mjet për zgjidhjen e konfliktit (qëndrimi i përgjithshëm), atëherë është e mundshme që ai – edhe nëse grupi i tij konfliktohet me një grup tjetër – të jetë për zgjidhje paqësore të problemit (qëndrimi i veçantë); sikundërse edhe në rastin kur ai vetë konfliktohet me një individ – do përpiqet që ta zgjidhë pa përdorimin e dhunës (qëndrim individual). Ky është një shembull i mirë që tregon jo vetëm për dimensionin racional të qëndrimit, por edhe për atë emocional, si dhe për anën vlerësuese e vepruese të tij.

Individi e di se pse është kundër dhunës. Ai e ndjen dhunën si një mënyrë jonjerëzore për zgjidhjen e konfliktit. Mënyrën e dhunshme e vlerëson si një formë të ulët të komunikimit njerëzor, dhe silltet në atë mënyrë që të shmangë përdorimin e dhunës si mjet për zgjidhjen e konfliktit.<sup>319</sup>

Çdo ndryshim i qëndrimit bazë – këtë qëndrim e quajmë shpesh edhe pikëpamje mbi botën – shkakton ndryshime të forta të qëndrimet e veçanta dhe individuale. Ndërsa ndryshimet të qëndrimet specifike dhe individuale nuk është e thënë të çojnë në ndryshimin e pozicionit fillestar.

<sup>319</sup> "Qëndrimi është organizim afatgjatë i bindjeve të ndërlidhura, të cilat përshkruajnë, vlerësojnë dhe justifikojnë sjelljet tona në raport me një send ose situatë, ku çdo besim ka përbërësit njohës të ndjenjave dhe ata praktikë." (Milton Rokeach, po aty, f. 132) "Perënditë të kanë dhuruar mendimet e bukura dhe të kanë çliruar gjuhën që t'i shprehësh ato, që ato të radhiten dhe të përputhen si në një valle." (Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 1014)

Është e nevojshme të dallohet ndryshimi i qëndrimit prej ndryshimit në qëndrim. Që një dallim i tillë është i domosdoshëm, provohet nga analiza e pjesëve themelore përbërëse të qëndrimit (ana njohëse, emocionale dhe vepruese). Është e mundur që manipuluesi të lëkundë fort përbërësin njohës të qëndrimit, dhe kështu do ofrojë të dhëna të reja, të ndryshme dhe të shumta, miratimi i të cilave (nga ana e individit apo grupit) çon në ndryshimin e përbërësit njohës të qëndrimit, mirëpo përsëri nuk shkon puna deri te ndryshimi i qëndrimit si tërësi, sepse përbërësi emocional i qëndrimit – bashkë me përbërësin veprues – janë mjaft të fuqishme dhe rezistojnë kundër ndryshimit, dhe qëndrimi mbetet i palëkundur. Kjo është ajo situata e mirënjohur kur udhëhiqemi nga ndjenjat dhe zakonet, pavarësisht se çfarë na thotë mendja. Gjithashtu është e mundur që manipuluesi të lëkundë ndjenjat tona në lidhje me një person, vlerë apo ide, por që kriteret tona racionale dhe shprehite jetësore nuk lejojnë që qëndrimi ynë të ndryshohet në tërësi. Kjo është ajo gjendje kur mendja dhe shprehite tona, pavarësisht ndjenjave, nuk na lejojnë të sillemi ndryshe. Dhe në fund, është e mundur që manipuluesi të ketë sukses që të ndryshojë anën vepruese të qëndrimit tonë, ndërkohë që baza njohëse dhe emocionale e qëndrimit mbetet e pandryshuar. Dhe më vonë është ajo gjendja kur sillemi ndryshe nga çfarë na këshillon mendja e na paralajmëron zemra. Në të gjitha këto raste manipuluesi ka arritur që të nxisë ndryshime në qëndrim, por jo ndryshimin e qëndrimit.

Ndryshimet në qëndrim, më pak të dukshme nga jashtë, por jo më pak të vërteta, i zbulojmë me rastin e një analize më të thellë të dimensionit të qëndrimit.

Nëse bindësi i thellë arrin ta zbusë sadopak qëndrimin tonë ekskluzivisht pozitiv ose qëndrimin ekskluzivisht ne-

gativ për një çështje; pra, nëse shkalla e pranimit ose e refuzimit nuk është e njëjtë si para ekspozimit të mesazheve të tij, ai atëherë ka arritur të bëjë ndryshim në qëndrim (pavarësisht se sa i parëndësishëm mund të jetë ky ndryshim), sidoqë nuk ka arritur ta ndryshojë rrënjësisht qëndrimin tonë – nga pozitiv ta bëjë negativ, apo anasjelltas.

Gjithashtu, nëse ai ia del që prej një qëndrimi të matur pozitiv apo të matur negativ të nxjerrë një qëndrim jashtëzakonisht pozitiv ose jashtëzakonisht negativ, ai ka arritur që të ndikojë mbi qëndrimin tonë, pavarësisht se nuk e ka ndryshuar me themel atë. Por, në qoftë se prej një raporti konformist për një çështje të caktuar, ka arritur që të lëvizë individin ose grupin, qoftë në drejtimin pozitiv, qoftë në atë negativ, – në varësi të qëllimit të tij – mund të themi se ai jo vetëm që ka shkaktuar ndryshim në qëndrim, por ka arritur që të ndryshojë edhe qëndrimin, sepse nga një individ konformist e të papërcaktuar, ka nxjerrë një luftëtar të interesuar dhe të përcaktuar.

Nëse manipuluesi i thellë arrin të zbulojë se në një qëndrim kompleks apo në një sistem të tërë qëndrimesh ekzistojnë vende të dobëta, pra në qoftë se të paktën një prej pjesëve përbërëse të qëndrimit – ajo e njohjes, ndjenjës, vullnetit – nuk është e lidhur fort dhe e harmonizuar me pjesët e tjera të tij, dhe ka një mospajtim të vogël apo të madh dhe një gjendje të tensionuar, atëherë manipuluesi do t'i orientojë mesazhet e tij kah ato vende të dijes, ndjenjave, bindjeve dhe sjelljeve që janë të pasigurta. Është e sigurt se ai do i zgjerojë këto të çara me futjen e mesazheve të tij, dhe kështu do nxisë ndryshime në qëndrim apo në sistemin e qëndrimeve, edhe pse vetë qëndrimi ndoshta nuk do të ndryshojë dukshëm.

Gjasat e tij për të shkaktuar ndryshim në qëndrim ose ndryshimin e qëndrimit të individit/grupit janë shumë më të mëdha nëse ai vepron mbi individët/grupet që kanë qëndrime të buta, krahasuar me mesazhet që fut midis individëve (turmës) me pikëpamje ekstreme, sepse ai e di se qëndrimet ekstreme (qofshin pozitive apo negative) do të jenë të lidhura e të harmonizuara më mirë me njëri-tjetrin.

Fuqia me të cilën mbrohet një qëndrim prej ndryshimit varet nga numri dhe cilësia e nevojave që plotëson qëndrimi. Nëse nevojat që plotëson qëndrimi janë të një rëndësie jetike dhe me rëndësi të madhe për individin/grupin, do të jetë më e vështirë për të arritur ndryshimin në qëndrim apo ndryshimin e qëndrimit në përgjithësi. Për aq sa nevojat që përmbush qëndrimi janë dytësore për individin/grupin, atëherë manipuluesi do arrijë të ndikojë te qëndrimi me më pak përpjekje. Gjithsesi individi/grupi do mbrojnë më fort qëndrimin që i plotëson nevojat për ushqim, pije dhe banim, sesa atë qëndrim që nuk është i lidhur me plotësimin e nevojave për dije, identitet apo orientim.<sup>320</sup>

Nëse manipuluesi i thellë ndjen që individi/grupi e ndërton qëndrimin e tij në një fakt të vetëm (përvojë, arsye, ndjenjë, vlerë), ai do përpiqet që të vendosë kundër këtij fakti një mori faktesh të tjera, me qëllim që ta detyrojë individin/grupin që ta krahasojë qëndrimin e tij të njëanshëm me avantazhet e shumta të qëndrimit që ai i ofron.

Nëse manipuluesi ndjen që individi/grupi nuk ka një qëndrim konsekuent në të gjitha rastet, – për shembull, nëse dikush thotë se i dua të gjithë njerëzit, por fqinun e parë nuk e shoh dot gjallë – atëherë është fare e sigurt se kjo jokonse-

<sup>320</sup> Ndonjëherë mbrohet me më shumë forcë ai qëndrim që kënaq shumë nevoja, por kjo vlen për atë shoqëri që është e zhvilluar ekonomikisht dhe për personalitetet me etikë të lartë.

kuencë do të jetë një bazë e mjaftueshme mbi të cilën gjahtari i shpirtrave do ndërtojë strategjinë e tij për arritjen e qëllimit.

Kjo analizë e shkurtër tregon se manipuluesit e thellë, duke i instaluar me durim dhe duke i studiuar mesazhet e tyre, edhe atëherë kur nuk korrin rezultate spektakolare, kur nuk arrijnë ta ndryshojnë menjëherë qëndrimin e individit/grupit në lidhje me një problem publik, megjithatë shkaktajnë ngecje më pak të dukshme, por që me siguri çojnë në ndryshime. Lenini kishte të drejtë kur pohonte se puna revolucionare midis turmave nuk do të humbasë kurrë pa lënë gjurmë, madje edhe atëherë kur kohën e mbjelljes nga ajo e vjeljes e ndajnë dekada të tëra. “Nën ndërtesën shoqërore, nën këtë strukturë të komplikuar që shkapërderdhet ka zgavra të llojeve të ndryshme. Ka mina religjioze, mina filozofike, mina politike, mina ekonomike, mina revolucionare. Dikush gërmon me ide, dikush me numra, dikush me pezëm. Ka thirrje dhe përgjigje nga një katakomb në tjetrin. Utopitë sillen rreth e përçark kanaleve nëntokësore. Ato degëzohen me njëra-tjetrën në të gjitha drejtimet. Ato nganjëherë edhe luftojnë aty. Por, asgjë nuk e ndalon tensionin e këtyre energjive që të ecin drejt destinacionit, dhe aktivitetet e mëdha simultane, të cilat lëvizin kudo, ngjiten, zbresin dhe ngjiten përsëri në këtë errësirë që e shndërron të epërmen në të ulët, të jashtmen në të brendshme. Shoqëria as që e merr me mend këtë shpim, i cili e lë atë në sipërfaqe, duke i ndryshuar kështu brendësinë. Aq sa është numri i kateve nëntokësore, po aq punë të ndryshme e gërmime do ketë. Çfarë del nga të gjitha këto gërmime të thella? E ardhmja.”<sup>321</sup>

<sup>321</sup> Hugo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 125-6.

Këtë problem, ndryshimin e qetë e të ngadalhtë të qëndrimeve, Proust-i e studion në nivel intelektual. “Nuk ka dyshim se ajo (jeta intelektuale) përparon brenda

Kemi thënë se bindësit i është lehtësuar puna në çastin që problemi ndaj të cilit njerëzit duhet të mbajnë qëndrim është i panjohur, larg përvojave të tyre. Në anën tjetër, bindësi i thellë, sipas rregullit, zgjedh atë problem për të cilin njerëzit janë të ndjeshëm; domethënë, që në njëfarë mënyre prek përvojën e tyre, por të paktën jo në bazë të pasojave – kurrsesi. Kjo do të thotë se bindësi duhet të ndërtojë një urë me të cilën do lidhë problemin abstrakt me përvojë konkrete dhe me nevojat e individëve dhe grupeve. Këtë e bën me të vërtetë, pasi ai premtan se do i zgjidhë nevojat e njerëzve, nëse ata pranojnë dhe ndjekin idetë e tij, të cilat nuk është e thënë që t'i kuptojnë.<sup>322</sup> Meqë nuk janë të sigurt për vlerën e ideve, ata nuk janë të sigurt dhe të vetëdijshëm as për vlerën e të mirave që do vijnë nëse ndiqen idetë e bindësit. Nëse nuk i kuptojnë idetë, ata merren vesh për dobinë që vjen prej tyre.

Sipas rregullit, përgjithësisht individët nuk kanë qëndrime të formuara ndaj dukurive të reja (problemeve, vlerave, ideve, personaliteteve). Ata nuk kanë qëndrime të formuara, sepse i marrin nga grupet e tyre vlerësuese (të ashtuquajturat grupe referente), që përcaktojnë raportin ndaj problemit të ri. Përderisa grupi nuk përcakton një qëndrim të tijin ndaj një problem të ri, sipas rregullit individi nuk ka

nesh në një mënyrë të pavërejtur, dhe të vërtetat të cilat na kanë ndryshuar kuptimin dhe formën e kësaj jete intelektuale, të vërtetat që na kanë hapur rrugët e reja, nuk lindin përnjëherë: zbulimin e tyre e përgatisim gjatë, paraprakisht, por kjo ndodh pa dijeninë tonë. Megjithatë, për ne, ato nisin atë ditë dhe atë minutë kur bëhen të dukshme për ne." (Proust, *U traganju a izgubljenim vremenom*, I, Zora, Zagreb, 1965, f. 226)

<sup>322</sup> Ka plot njerëz të cilët më shumë admirojnë gjërat që nuk kuptojnë sesa ato që i kanë të qarta. Nëse një mendim të madh e shpalosni në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, do i zhgënjoni ata që ju dëgjojnë, sepse nuk do e besojnë si të tillë, pikërisht ngaqë e kuptojnë. Ka të drejtë njeriu ynë kur thotë: "Foli disa orë. Do e kisha dëgjuar për ditë të tëra, por nuk do e kuptoja për vite me radhë."

një qëndrim të tijin, ose nuk ka një qëndrim të fortë formal. Në hapësirën kohore nga shfaqja e problemit të ri deri në çastin kur grupi përcakton qëndrimin e tij ndaj problemit, individët janë gjahu më i lehtë për peshkatarët e shpirtave njerëzorë.

Lehtësia me të cilën manipulohen individët në situata të reja dhe të panjohura – kur ata gjenden përpara një problemi të cilin nuk mund ta shpjegojnë dhe ta zgjedhin duke u bazuar në përvojën dhe njohuritë e vjetra – i jep rastin bindësve të shkathët që t'i përdorin ata si mjete materiale për të realizuar qëllimet e tyre. Ja për çfarë orvaten manipuluesit e shkathët, që edhe në ato situata të cilat janë relativisht të thjeshta dhe të kuptueshme, i kthejnë në të komplikuara e të pakuptueshme për shumicën e njerëzve. Për aq sa individ është i sigurt dhe i qëndrueshëm në interpretimin e situatës, mund të ndikohet më pak mbi të. Nga ana tjetër, aq sa individ është i pasigurt dhe më pak i përcaktuar, po aq rritet edhe mundësia e ndikimit. Ndoshta nuk është e nevojshme për t'u vënë në dukje që njeriu modern ndjehet shumë i pasigurt në gjithçka që e tejkalon përvojën e tij. Kjo është koha e ndikimit, sepse është një kohë pasigurie. Qëndrimet e paluhatshme janë të lidhura me kohët e qëndrueshme, me strukturat e përhershme shoqërore dhe me personalitete të qëndrueshëm. Ne sot nuk jetojmë në një kohë të tillë, në rrethana shoqërore të bazuara, si dhe nuk takojmë personalitete të qëndrueshëm.

Gjëja e tretë që shfrytëzojnë me shkathtësi bindësit e thellë është njohuria se individët/grupi nuk e arrijnë dijen e tyre për një problem në varësi të edukimit formal të tyre, por, në radhë të parë, nga motivacioni i tyre. Për një problem të caktuar publik, do të jenë të mirëinformuar ata individë që kanë

interes për problemin, të cilët, pavarësisht nivelit arsimor, janë të motivuar të shkojnë deri tek informacioni.

Dhe së fundi, mashtruesit ideologjiko-politikë përcaktojnë jo vetëm atë që konsiderohet problem i gjerë, por edhe vetë problemet i ndajnë në profesionale dhe politike. Në zgjidhjen e problemeve profesionale nuk ka kuptim të merret mendimi i popullit, sepse në këtë rast gjyqi i ekspertëve është më me vlerë se opinioni publik. Por, kjo logjikë po shtrihet ngadalë edhe në rrafshin e çështjeve politike, kështu që me kalimin e kohës ka përpjekje që të gjitha çështjet politike të paraqiten si çështje ekspertësh. Pra, kjo është një mënyrë e përshtatshme që opinioni publik të përjashtohet – në heshtje dhe pa dhimbje – nga procesi vendimarrës, ndërkohë që kjo lloj vendimarrjeje ka të bëjë me fatin e kombeve.

## NUK KA PAJTIM TË PËRGJITHSHËM PËR PROBLEMIN

*“Më thoni një mendim që i lidh njerëzit me njëri-tjetrin sot, që të paktën ka gjysmën e asaj fuqie që ka pasur dikur në ata shekuj. Dhe mos hezitoni, që pas gjithë kësaj të thoni se me këtë rast nuk janë dobësuar, nuk janë turbulluar burimet jetësore nën këtë “yll”, nën atë rrjetë që ka ngatërruar njerëzit. Dhe mos më frikësoni me mirëqenien tuaj, me pasuritë tuaja, me uri të rrallë e me shpejtësinë e komunikacionit. Pasuri ka më shumë, por fuqi ka më pak. Nuk ekziston më një mendim që i lidh të gjithë; gjithçka është bërë indiferente, gjithçka është tharë e të gjithë janë vyshkur.”*  
 Dostojevski.

Shkenca mbi shoqërinë i njeh mirë ato bashkësi njerëzore ku individit identifikohet aq fort me bashkësinë ku bënte pjesë. Ai nuk kërkonte mjete që ta manifestonte veten si diçka të ndryshme nga bashkësia. Ai dhe bashkësia ishin Një. “Por, jeta e tij, ashtu siç e konsideronte vetë, nuk kishte asnjë kuptim si një jetë e veçantë: kishte kuptim vetëm si një pjesë e vogël e tërësisë, që ai e ndjente vazhdimisht. Fjalët e dhe veprimet rridhnin prej tij si aroma që shpëputet prej lules. Ai nuk e kuptonte dot sipas midesë vetjake as vlerën e as domethënien e një veprimi apo të një fjale.”<sup>323</sup>

Bashkësia përjetohej si e vetmja shtëpi. Anëtarët e bashkësisë konsideroheshin vëllezër. “Lidhjet e tyre farefisnore dhe kontaktet ishin shumë të çuditshme. Ata janë të gjithë

<sup>323</sup> Tolstoj, *Rat i mir*, II, Prosveta, Beograd, 1965, f. 480.

të afërm dhe akraba. Ne konstatuam se asnjë prej tyre nuk ishte as i ati e as e ëma, as vëllai e as motra, as daja e as halla, as kushëriri e as nipi, as dhëndri e as nusja, as kumbara e ndrikulla.”<sup>324</sup>

Bashkësia është një trup i madh dhe i fuqishëm, ndërsa individët janë organet e tij. “Sepse jemi një bukë, një trup; sepse të gjithë bashkë e kemi bashkësinë në një bukë.”<sup>325</sup>

Por, jo gjithçka është te buka. “Madhësia e shoqërisë zvogëlohet atëherë kur në të shihet vetëm një trup i organizuar, me qëllim kryerjen e disa funksioneve të veçanta njerëzore. Në këtë trup jeton një shpirt: një grup idealesh kolektive.”<sup>326</sup>

Meqë individi dhe bashkësia janë Një, atëherë në çdo mendim të veçantë, besim, ndjenjë, veprim etj. pasqyrohet bashkësia. Kjo ndjenjë e pranisë së trupit dhe shpirtit të bashkësisë në trupin dhe shpirtin individual, manifestohet në çdo pikëpamje dhe në çdo moment: individi nuk ndryshon nga bashkësia (nuk ekziston as shprehja “unë”), dhe kështu as mendimet e tij nuk ndryshojnë nga idetë kolektive.<sup>327</sup> Në kokën e çdo individi jeton e njëjta Perëndi.<sup>328</sup> Kur

<sup>324</sup> Rable, *Gargantua i Pantagruel*, Prosveta, Beograd, 1967, f. 480.

<sup>325</sup> *Qarkorja e parë për korinthisit*, kap. 10, parag. 17.

<sup>326</sup> Më gjerësisht: Durkheim, *O podeli društvenog rada*, Prosveta, Beograd, 1972.

<sup>327</sup> “Në këto bashkësi nuk ka poezi lirike apo art dramatik, sepse ato pandehin konflikte dhe ndarje midis individit dhe bashkësisë. Hasim vetëm poezi epike. Sepse me këtë ndarje të Unit individual prej tërësisë substanciale të kombit dhe rrethanave të tij, mënyrës së të menduarit, ngadhënjimeve dhe pësimeve të tij, sikundërse edhe me ndarjen e vetëdijes njerëzore në ndjenja dhe vullnet, them se në vend të poezisë epike ata arrijnë deri te përsosmëria më e pjekur – në njërën anë është lirika, në anën tjetër poezia dramatike.” (Hegel, *Estetika*, III, f. 430)

<sup>328</sup> “Te populli që besonte në një zemër dhe në një shpirt...” (*Veprat apostolike*, kap. 4, parag. 32) “Çdo komb është vetëm komb deri në çastin që ka Perëndinë e vet. Kurse perënditë e tjera i pranon pa kurrëfarë pajtimi, dhe beson se me Perëndinë e tij do jetë ngadhënjimtar, dhe kështu do zhdukë nga bota çdo perëndi tjetër.” (Dostojevski, *Zli dusi*, I, f. 270)

ndahet e njëjta ide dhe e njëjta bindje, rritet ndjenja e të qenurit bashkë dhe harmonia kolektive.<sup>329</sup> Rituale të magjisë dhe ato fetare kanë funksionin e mbajtjes dhe forcimit të ndjenjës së unitetit dhe fatit të përbashkët, që bazohet te besimi i përbashkët. Mendimi për bashkësinë jeton jo vetëm në mendjet e anëtarëve të saj, por ai është i shënuar në çdo gjë (mendimi është inkorporuar në çdo send dhe besim të dukshëm). Çdo devijim nga normat zakonore është i barbartë me thyerjen e ligjeve të natyrës.<sup>330</sup> Anëtari e përjeton bashkësinë si të amshuar kundrejt jetës kalimtare individuale, dhe kështu bashkësia përvijohet si mbështetëse psikologjike.<sup>331</sup>

Në atë bashkësi ku të gjitha forcat janë të orientuara drejt ruajtjes së unitetit shoqëror, simbolet racionale i shër-

<sup>329</sup> "Nëse dikush shpreh një mendim të caktuar përpara nesh, mendim të cilin e kemi edhe ne, shfaqjes që krijojmë i shtohet edhe mendimi ynë, inkorporohet në të, bashkohet me të; i kumton atë që përmban vetë nga jetësorja. Nga bashkimi lind një mendim i ri, i cili përmbledh të mëparshmit, që më pas ka më shumë jetë se çdo mendim i marrë veç e veç syresh. Ja pse në tubimet e shumta një emocion mund ta arrijë një forcë të atillë. Arsyeja është se zjarri me të cilin paraqitet ai emocion, reflektohet në çdo vetëdije dhe në gjithçka tjetër." (Durkheim, *O podeli društvenog rada*, f. 134)

<sup>330</sup> "Për këtë arsye ai e zgjidh me lehtësi problemin e lirisë dhe të domosdoshmërisë së nënshtrimit të synimeve individuale ndaj normave sociale. Për këtë arsye, shkelja e normave sociale është njësoj si shkelja e ligjeve natyrore. Supozohet se njeriu me mendje të shëndoshë nuk do të dëshironte, dhe fizikisht nuk do të jetë në gjendje që t'i shkelë këto norma. Forma përfundimtare e sanksioneve sociale kundër shkelësit në këtë rast bëhet ironia ose tallja që vret, siç do të silleshim ndaj atij që provon të kalojë mbi mur. Duke pasur parasysh faktin se për mendjen primitive gjendja reale sociale është në të njëjtin kuptim si e natyrshme, mungon synimi për çdo ndryshim të përshtatshëm në organizmin social. Me më shumë dëshirë preferohet përdorimi i modeleve të formuara tradicionale." (Zilberman, "Ličnost i kultura u antropologiji Pola Radina", *Kultura*, Nr. 16, 1972, f. 104-5)

<sup>331</sup> "Grupi nuk është vetëm pushtet moral, që administron jetën e anëtarëve të vet, por njëkohësisht edhe burim jete *sui generis*. Prej grupit buron një energji e caktuar që i ngroh dhe i frymëzon zemrat, i hap rrugën simpativë, zbut egoizmin." (Durkheim, *po aty*, f. 72)

bejnë të njëjtit qëllim. Me ndihmën e këtyre simboleve përmbliidhen dhe manifestohen ndjenjat pozitive kolektive të idealet kolektive; kështu që rendi simbolik plotëson fuqinë e rendit shoqëror. Gjithçka është e lidhur me simbolin. Simbolet janë çimentoja më e lirë shoqërore. Përveç mjeteve të tjera të integritit, simboli i lidh përgjithmonë ata që ndajnë të njëjtat ndjenja dhe bindje. "Të gjitha vetëdijet fërgëllojnë në harmoni."<sup>332</sup>

Andriqi e ka përshkruar shumë mirë këtë lloj shoqërie në romanin *Kronika e Travnikut*, ku të gjithë janë të lidhur me të gjithë dhe çdo gjë është e lidhur me të gjitha:

"Në këto mjedise gjithçka është e lidhur, e ngulitur fort njëra në tjetrën; gjithçka përmbahet dhe mbikëqyret mes veti; çdonjëri kujdeset për tërësinë dhe tërësia kujdeset për çdonjërin. Shtëpia vështron shtëpinë, rruga monitoron rrugën, sepse secili përgjigjet për secilin, dhe të gjithë për të gjitha, dhe sekush është i lidhur tërësisht me fatin jo vetëm të farefisit dhe të afërmeve të tij, por me fatin e fqinjit, bashkëmendimtarëve dhe bashkëqytetarëve të tij. Këtu qëndron edhe fuqia e robërisë së kësaj bote. Jeta e individit është e mundur vetëm në këtë bashkësi dhe në jetën e tërësisë, nën një marrëveshje të tillë. Kush del nga ky rend duke dëgjuar kokën e tij, instinktet, ai është njësoj si i vetëvrari, dhe herët a vonë do shkatërrohet në mënyrë të pashmangshme. Ky është ligji i këtyre mjedisëve, i cili përmendet qysh në Besëlidhjen e Vjetër. Ky ishte ligji edhe i botës antike."<sup>333</sup>

Në një bashkësi homogjene, e izoluar nga ndikimi i jashtëm, pa ndarje klasore, ku çdo individ ndjek një model

<sup>332</sup> Po aty.

<sup>333</sup> Andrić, *Travnička hronika*, Prosveta, Beograd, 1962, f. 164-5.

sjelljeje që është ndërtuar nga përvoja e gjatë e bashkësisë<sup>334</sup>, ekzistonte mundësia që të formohej një sistem unik idesh, besimesh dhe vlerash. Mjedisi natyror, që edhe vetë ndryshon shumë ngadalë, nuk ka shkakuar dot ndryshime në organizimin shoqëror. Një organizim shoqëror i cili është krijuar njëherë, që është përshtatur mirë ndaj rrethanave natyrore, do mbetet (gjatë) i pandryshuar. Kjo do të thotë se vetëm nga vetë mjedisi shoqëror mund të rrymojnë stimulumet për ndryshimet shoqërore. Ndarja shoqërore e punës dhe specializimi i funksioneve ishin ato forca shoqërore që çuan në rrënimin e unitetit të bashkësisë, e kështu edhe në rrënimin e vetëdijes së përbashkët. Procesi i papërmbajtshëm i diferencimit shoqëror që nisi, hap pas hapi filloi ta shpërbënte bashkësinë si të vetmen mënyrë jetese, e më pas edhe vetëdijen e përbashkët. Bashkësia shndërrohet në shoqëri, interesi i përbashkët shndërrohet në interes grupor (klasor), ndërsa vetëdija e bashkësisë shndërrohet në vetëdije klasore. Vuajtja për bashkësinë do mbetet përcjellësi i përhershëm i diferencimit shoqëror dhe ideor.

Natyrisht që vetëdija e përbashkët nuk humbet kaq shpejt dhe kaq lehtë. Ajo ndërthuret dhe zgjerohet akoma nga idetë, bindjet dhe vlerat që përmbajnë shenja (klasore, grupe) të një pozite të veçantë, si dhe interesa për përpjekje individuale. Por, synimi që e përgjithshmjia dhe e përbashkëta të zmbropsin të veçantën dhe individualen nuk mund të mohohet.

<sup>334</sup> "Njeriu nuk lind në një skenë të zbrazur, por aty ku tashmë janë vendosur prapaskenat, dhe shfaqja ka nisur prej kohësh. Kur e shtyjnë në skenë, ai nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse të riprodhojë tekstin e dhënë dhe t'i përgjigjet pëshpëritjes. Ai ka në dorë shumë pak dhe mbase aspak që të ndryshojë rrjedhën e shfaqjes. Edhe nëse më vonë largohet nga skena, ai do të identifikohet gjithnjë me shkollën dhe traditën teatrore nga e cila ka dalë." (Vera Erlich, *U društvu s čovjekom*, Naprijed, Zagreb, 1968, f. 131)

Vetëm atëherë kur shoqëria bëhet shoqëri e shtresuar, çahet edhe vetëdija e përbashkët, dhe së këndejmi çdo klasë/grup ka të vërtetën e vet. Tërësia është rrënuar dhe idenë e përbashkët e zëvendësojnë ideologjitë e veçanta. Në vijim, pajtueshmëria e përgjithshme për një problem të caktuar shoqëror, thjesht nuk mund të arrihet, sepse interesat e ndryshme tërheqin në kahe të kundërt.<sup>335</sup> Duke qenë se në shoqërinë e ndarë në klasa nuk mund të flitet për ujdi të përgjithshme, një problem i rëndësishëm shoqëror duhet të zgjidhet në një mënyrë tjetër. Manipulimi shpërfaqet si e vetmja mënyrë për të arritur ujdi (pa dhimbje) për ato çështje rreth të cilave nuk ka pajtueshmëri të përgjithshme.

Veprimi është mirënjohur: një klasë e caktuar racionalizon interesin e vet klasor dhe e paraqet (imponon) si të vërtetën e vetme. Vetvetiu të gjitha të vërtetat e tjera hidhen poshtë si mashtrime e gënjeshtër.<sup>336</sup> Nën maskën e luftës ideologjike, thyhen shigjetat rreth interesave të ndejshme. Kjo duket qartë në çastin që vëmendja adresohet te motivet e këtyre diskutimeve, te vlerat rreth të cilave zhvillohet lufta dhe te pasojat e saj.

Menjëherë bëhet e qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me konflikte ideore, por ideologjike. Në konfliktet ideore interesi i vetëm është arritja tek e vërteta, ndërsa në konfliktet

<sup>335</sup> "Kush nuk është me mua, është kundër meje; dhe kush nuk mbledh me mua, shpërndan." (*Ungjilli sipas Mateut*, kap. 12, parag. 30)

<sup>336</sup> "Katër fe jetojnë në këtë pjesë të ngushtë toke, me brigje dhe e varfër. Secila është ekskluzive dhe e ndarë rreptësisht nga tjetra. Të gjithë jetojnë nën një qiell dhe nga e njëjta tokë, por secila syresh e ka qendrën e jetës së vet shpirtërore shumë larg, në një botë të huaj: Romë, Moskë, Konstantinopojë, Mekë, Jerusalem, dhe vetëm Zoti e di se ku tjetër, por jo vetëm aty ku lind e vdes. Çdonjëra beson se e mira dhe përfitimet e saj janë të kushtëzuara me dëmin dhe prapambetjen e tre besimeve të tjera. Kurse zhvillimi i tyre mund të jetë vetëm në dëm të saj. Secila syresh, mosdurimin e tjetrit e ka kthyer në virtytin më të lartë, dhe shpëtimin e pret nga diku jashtë." (Andrić, *Travnička hronika*, f. 305-6)

ideologjike që të plotësohet një interes i kufizuar (klasor/grupor). Në konfliktet ideore, zakonisht bëhet fjalë për vlera të përgjithshme/universale, ndërsa në konfliktet ideologjike kemi të bëjmë me vlera të pjesshme. Sipas rregullit, nga konflikti ideor palët dalin të pasura me njohuri të reja, ndërsa nga konfliktet ideologjike, të paktën për një alternativë, ato dalin më të varfra. Konfliktet ideore janë takime të frytshme idesh të ndryshme, nga të cilat zakonisht lindin ide të reja; ndërkaq konfliktet ideologjike, në fakt, janë konflikte për interesat e klasave të ndryshme shoqërore, kinse në formë ideore, dhe përgjithësisht lindin drama shoqërore.<sup>337</sup>

Ideologjitë paraqiten gjithnjë si ide; domethënë, ato aspirojnë universalitetin, flasin në emër të të gjithëve dhe veçanërisht në emër të popullit. Në fakt, kjo është mënyra e vetme që të dëgjohen nga populli, që të pranohen dhe të ndiqen. Populli bëhet i vetëdijshëm se qenqërkësh bërë fjalë për ideologji, jo për ide – por, vetëm pasi ka rënë pre e mashtrimit, pra kur një grup i shkathët njerëzish të fuqishëm e ka përdorur dhe e ka shfrytëzuar atë si mjet material/teknik për të arritur qëllime të caktuara.

Më parë pohuam se ideologjitë shfaqen gjithmonë si ide, sepse vetëm kështu ka të ngjarë të pranohen nga të gjithë. Kjo shpjegon faktin se pse ideologjitë, në themelet e të cilave qëndrojnë interesa të ndryshme, madje edhe përjash-tuese ndaj njëra-tjetrës, janë kaq të njëjta apo pothuajse identike. Pikërisht për këtë, Marx-i ka tërhequr vërejtjen se në analizën e një klase duhet bërë dallimi mes asaj që thotë klasa dhe asaj çfarë ajo bën realisht. “Ndryshe nga shitësi i zakonshëm, i cili di ta dallojë në mënyrë të shkëlqyer atë

<sup>337</sup> “Në këtë mëngjes ndjej se kam oreks që të ha ca mushkëri aristokratike dhe t’i lag me një gotë verë të bardhë.” (Anatol Frans, *Bogovi su žedni*, Kultura, Beograd, 1952, f. 211)

çfarë mund të pohojë dikush se është nga ajo që është në realitet, historiografia jonë akoma nuk ka arritur ta bëjë këtë njohje triviale. Ajo i beson fjalëve të çdo epoke, se ç' thotë ajo epokë për veten dhe çfarë supozon realisht."<sup>338</sup>

Në jetën e bashkësisë, ideja i lidhte të gjithë anëtarët në një vëllazëri të madhe. Në jetën e shoqërisë klasore, ideologjia kryesisht i bashkon anëtarët e një klase/grupi në një lidhje klasore; kurse në raport me pjesëtarët e klasave/grupeve të tjera, pothuajse e vetmja gjë që ia vlen është lufta. "Çështja jonë është që të kujdesemi të gjithë që këta ishuj të vegjël të derdhen në një ishull më të madh, me qëllim që të ndriçohen nga lëvizja stihike, duke dhjetëfishuar fuqinë e tyre, dritën e të vetëdijshmes, dritën e programit tonë revolucionar, të drejtpërdrejtë, të qartë e të saktë, si dhe detyrave tona më të afërta."<sup>339</sup>

Aq sa është e rëndësishme që individët të binden prej grupeve të tjera në saktësinë dhe vlerën e ideologjisë, po aq e rëndësishme është që anëtarët e grupit të ruajnë unitetin brenda grupit.<sup>340</sup> Në këtë drejtim, udhëheqësit e grupeve ia dalin në tri mënyra bazë:

<sup>338</sup>Rani radovi, f. 316.

"Kështu edhe ju: së jashtmi u paraqiteni njerëzve si të drejtë, ndërsa përbrenda jeni plot dyfytërsi dhe mosrespektues të ligjit." (*Ungjilli sipas Mateut*, kap. 23, paragraf. 28)

<sup>339</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 149.

"(...) Kohë më parë, një punëtor na pyeti me anë të një letre se pse të mos irritohej mes prostitutave." (Lenin, po aty, f. 58)

<sup>340</sup> Këtë lloj porosie e hasim qysh me Shkrimet e Shenjta: "Si mendoni për dikë që ka njëqind dele, dhe njëra syresh humb, a nuk i lë ai nëntëdhjetë e nëntë të tjerat dhe del në mal për të kërkuar atë që ka humbur? Dhe nëse ndodh që e gjen, ju them me të vërtetë, se asaj i gëzohet më tepër se nëntëdhjetë e nëntë të tjerave që nuk i kanë humbur." (*Ungjilli sipas Mateut*, kap. 18, paragraf. 12, 13) "Kosheres ku je ti, po i çoj një bletë të cilën e kam gjetur në një rrugë të humbur pa lule. E kam mbajtur në dorë dhe e kam ngrohur me frymën time. Po ta fal ty." (A. Frans, *Taida*, Rad, Beograd, 1956, f. 117)

i. Me bindjen konstante ideologjike të anëtarësisë për saktësinë dhe vlerën e qëndrimeve ideologjike të grupit, ku është e sigurt se udhëheqësi nuk flet ngaqë atë që ai di duhet ta mësojë edhe ai të cilit po i flet, sepse udhëheqësi është i bindur se bashkëbiseduesi i tij ka të njëjtat njohuri rreth çështjes në fjalë – ai i flet atij me qëllim që me anë të fjalës të forcojë afërsinë ideologjike, që të bashkohet me të; që të nisen në aksion për arritjen e interesit të përbashkët. Këtu fjala nuk ka funksion që të shpjegojë diçka, por të ofrojë e të unifikojë<sup>341</sup>.

ii. Kështu që ndryshon puna me mbledhjet e përhershme apo të përkohshme, ku në trajtë ceremonish të caktuara lavdërohen udhëheqësit dhe përmenden rezultatet e arritura. “Ja pse individët që kanë interesa të përbashkëta bashkohen; ata nuk e bëjnë këtë vetëm për të mbrojtur interesat, por që të mos ndihen humbës përballë kundërshtarëve; që të kenë kënaqësinë e një familjarizimi shpirtëror; që numrin e tyre të madh ta bëjnë një. Pra, me një fjalë, që të gjithë bashkë të bëjnë një jetë morale identike<sup>342</sup>.

iii. Me konfliktet e kohëpaskohshme me një grup tjetër apo me konfliktet brenda grupit – në këtë pikë është e pranishme një kontradiktë: që të ruhet uniteti brenda grupit duhet që herë pas here grupi të hyjë në konflikt me një grup tjetër, sepse zakonisht çdo konflikt me armikun e jashtëm ka efekt integrues te grupi. Nga ana tjetër, grupi synon që

<sup>341</sup> “Nuk ka parti socialiste të fuqishme pa një teori revolucionare që i bashkon të gjithë socialistët, që i ushqen të gjitha bindjet, që zbatohet në mënyrat e tyre të luftës dhe të vepruarit.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 199)

<sup>342</sup> Durkheim, po aty, f. 69.

“Kështu, varret, lapidarët dhe kulti i të vdekurve i bashkojnë njerëzit; prandaj, edhe ata që nuk kanë vendbanime të përhershme apo pasuri, paraqesin vendtubime, vende të shenjta, që i mbrojnë dhe nuk lejojnë askënd t’ua marrë.” (Hegeli, *Estetika III*, f. 45)

ideologjinë e tij ta pranojnë edhe grupet e tjera, dhe për këtë arsye nuk mund të sillen në mënyrë agresive. Kjo kontradiktë i shtyn udhëheqësit e grupeve që të shkaktojnë konflikt brenda grupit, dhe ky mekanizëm është i njohur si kërkimi i viktimës ose “qengji i sakrificës”.<sup>343</sup>

Për qëllime thjesht analitike, këtu kam përfshirë dallimin midis dy (idealeve) llojeve të jetës shoqërore: bashkësia, që është aq e gjallë me çdo anëtar, sa pothuajse mbulon jetën e ndjenjave; si dhe mendimet dhe vlerat e shoqërisë klasore, e cila i ka shkaktuar që në themel këto ndjenja, sikurse edhe unitetin shpirtëror, dhe përpiqet me çdo mjet ta rivendosë këtë unitet. Meqë nuk mund ta vendosë në mënyrë të natyrshme këtë unitet, ajo provon me mënyra artificiale – me bindjen se ideologjia e një klase (zakonisht e klasës që është në pushtet) është e njëjtë, siç është ideja e bashkësisë.

Në lidhje me çështjet për të cilat ka ujdi të përgjithshme, nuk ka kuptim që të diskutohen. Manipulimi është i mundur vetëm atëherë kur nuk ka një ujdi të përgjithshme. Me fjalë të tjera, manipulohet atje ku ekziston mundësia e përzgjedhjes. Filozofët do të thoshin se manipulimi nuk do të ishte fare i mundur nëse nuk do ekzistonte liria (vullneti), dhe asnjë njeri i arsyeshëm nuk flet për manipulimin në një sistem të rreptë determinist apo fatalist.<sup>344</sup>

Peshkatarët e shpirtave njerëzorë, me apo pa vetëdije, e hedhin poshtë idenë se modelet e sjelljeve janë të lindura,

<sup>343</sup> “A duhet të jenë heretikët midis jush, që të paraqiten si të ndershmit në gjirin tuaj?” (*Qarkorja e parë Korintasve*, kap. 11, parag. 19)

<sup>344</sup> “Për shembull, a mund të reagohet për fyerjen që na ka bërë njeriu i aksionit, nëse jemi të vetëdijshëm se ai na ka ofenduar, le të themi, sipas ligjeve të natyrës? Filozofi i nëndheshëm fillon menjëherë të analizojë fyerjen, dhe përfundon duke thënë se kjo fyerje është si fati, si dhimbja e dhëmbit, si muri, pra diçka e kushtëzuar dhe e pashmangshme. Dhe ç’mund të bëhet kundër diçkaje që është e pashmangshme si muri?” (Nikola Milošević, *Antropološki eseji*, Nolit, Beograd, 1964. f. 13)

sepse kjo ide nuk i lejon të ndikojnë mbi sjelljet (ndryshimi i instinkteve është i pamundur). Ata e pranojnë dhe e shfrytëzojnë më me dëshirë idenë e ndryshueshmërisë në natyrën njerëzore, mbi të cilën mund të veprohet nëpërmjet ndryshimit të rrethanave të jashtme.

## MOTIVIMI

*“Nëpërmjet silogjizmave mund të përpilohet çdo lloj plani abstrakt, por ai do t’ju tërheqë drejt një barrikade; prandaj janë të nevojshme arsye dhe nxitje të veçanta, si: dëshpërimi, hidhërimi, uria dhe pezmi i madh.”*

L. Leonov

Nëse dy grupeve që, për aq as është e mundur, janë të njëta në të gjitha drejtimet: në gjini, moshë, racë, kombësi, fe, përgatitje shkollore, të ardhura, profesion, gjendje civile, inteligjencë, bindje juridike/politike/ideologjike/etike, vlera estetike, temperament, ndjeshmëri, në të ushqyer, banim, shpenzime, këmbime, shpërndarje, prodhim, stilin jetësor dhe botëkuptim – u dërgohet i njëjti mesazh, përveç motivimit apo interesimit për mesazhet e manipuluesit, do të nxisë një ndikim të pabarabartë. Kjo do të thotë se anëtarët e këtyre dy grupeve do të sillen në dy mënyra të ndryshme.

Ai grup që ka anëtarë të cilit nuk janë të interesuar për mesazhet e manipuluesit, jo vetëm që nuk do t’i pranojë mesazhet e tij dhe do sillen konform qëllimit, – që në mesazhe është i fshehur ose i theksuar – por me siguri që nuk do i kushtojë as vëmendje përmbajtjes dhe formës së mesazhit. Kjo është ajo situata e mirënjohur që klasikët e marksizmit e kanë përkufizuar si “hedhja e fjalëve në erë”<sup>345</sup>, “të shtëna me revolet të zbrazur”<sup>346</sup> dhe “klithmë e thatë”.<sup>347</sup> “Kur një

<sup>345</sup> Lenin, *Sabrana dela*, vëll. 8, Kultura, Beograd, 1960, f. 17.

<sup>346</sup> K. Marx, *Kapital*, II, Kultura, 1947, f. 295.

<sup>347</sup> Lenin, po aty, vëll. 5, f. 418.

seri e tërë thirrjesh sistematike nuk gjen përgjigje në turmë.”<sup>348</sup> Idetë (mesazhet, simbolet) nuk mund të realizohen nëse nuk lidhen me interesa, me nevoja dhe ndjenja individuale/kolektive. Idetë e pastra kanë qenë gjithmonë të pafuqishme dhe të tepërta kur janë ndodhur përballë atij realiteti me të cilin nuk janë marrë, për të cilin nuk janë shprehur shprehur, që nuk e kanë sajuar. Është dashur që idetë të bënë një aleancë me realitetin, ose të rrezikonin të ishin të anashkaluara, deri dhe të shkatërroheshin nga i njëjti realitet. “Por, e gjithë kjo luftë as nuk mund të imagjinohet e as të shkaktohet vetëm me një thirrje (kushtrim). Edhe kur një seri e tërë thirrjesh drejtuar në luftë, që i kemi provuar në raste shumë të drejtpërdrejta, tregohen të pafrytshme, ne duhet të kërkojmë arsyet serioze për “shpalljen e sloganit që është i pakuptimtë, që ndodhet jashtë rrethanave të realizimit të thirrjes për luftë.”<sup>349</sup>

Lenini paralajmëronte se “kush dëshiron të bindë për korrektësinë, nuk duhet lejuar që të dalldiset vetëm nga zëri i fjalëve, që në kohën e tij kanë luajtur një rol të madh dhe revolucionar. Ai duhet të thellohet në kushtet objektive të zbatimit të një parulle të tillë dhe të kuptojë se të hedhësh parullën, tanimë tërthorazi, do të thotë se ekzistojnë rrethanat e lëvizjes së gjerë, e lëvizjes së përgjithshme revolucionare”.<sup>350</sup>

Nëse anëtarët e një grupi janë të interesuar për mesazhet e bindësit, jo vetëm që do e përqendrojnë vëmendjen<sup>351</sup> te mesazhet, por me siguri që do i pranojnë dhe do sillen

<sup>348</sup> Po aty.

“Wean Marx sagt, die Idee habe sich immer blarmert, wen sic nicht mit nteressen verbunden sein.” (O. Negt, A. Kiuge, *Offentlichkeit und Erfahrung*, S. 274)

<sup>349</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 418.

<sup>350</sup> Lenin, po aty, f. 418-9.

<sup>351</sup> “Sepse po fut diçka të re në veshët tanë; pra duam të shohim se ç’është kjo.” (*Veprat apostolike*, kap. 17, parag. 20)

konform rekomandimeve të bindësit. Me përmbajtjen, formën dhe momentin<sup>352</sup> kur një mesazh bëhet i ditur, ai shkrihet në gjendjet më të ndryshme individuale dhe shoqërore, të cilat manifestohen në të njëjtën mënyrë. Gjithkund ekziston një material që merr flakë, i cili përbëhet nga<sup>353</sup> “bindjet e pezmatuara, mahnitjet e zemëruara, instinktet e shtypura luftarake, nga guximi i dalldisur rinor, kureshtja, dashuria ndaj ndryshimit, nga etja për të papriturën, ndjenja e mirë kur lexohet një shpallje teatrore dhe kur dëgjohet fishkëllima e punëtorit të teatrit; nga urrejtjet e papërcaktuara, dëshpërimet, nga çdo sqimë që pandeh se është çorientuar nga fati; nga të gjithë ata që ushqejnë shpresa të rreme dhe nuk ndihen mirë, që me ambiciet e tyre shkojnë buzë greminës; nga kushdo që pret diçka nga rrënimi”.<sup>354</sup>

Thjesht është e pabesueshme se si një fjalë e vetme (parullë apo ide) që shkrepet në turmë mund të mbulojë aq shumë interesa, të godasë dëshirat më të fshehura; të përshkruajë lëvizjet padukshme të kaq shumë shpirttrave; të shprehë një det të tërë me pakënaqësi të ndryshme; të drejtojë vullnetin gjigant që të imagjinojë një jetë boshe... Ky është çasti kur ideja arrin “të ndezë turmat me zjarrin revolucionar”.<sup>355</sup>

<sup>352</sup> “Sepse shpejtësia është pjesë përbërëse e mesazhit; sepse lepuri nuk vjen për së dyti para tytës. Më së shumti për faktin se vendimi historik është i lidhur në mënyrë të pandashme me çastin që është ndërmarrë.” (Malraux, *Antimemoari*, Naprijed, Zagreb, 1969, f. 146)

<sup>353</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 129.

<sup>354</sup> Igo, *Jadnici*, II, Rad, Beograd, 1960, f. 400.

Lenini ka theksuar se duhen “shfrytëzuar të gjitha manifestimet e mundshme të pakënaqësisë; duhen mbledhur dhe përpunuar të gjitha grimcat e protestës, qoftë edhe në fillimin saj”. (*Izabrana dela*, vëll. 3, f. 298) “A është e mundur të gjendet të paktën një klasë e popullsisë e cila nuk ka njerëz, grupe dhe qarqe të pakënaqurish, të shtypurish, dhe për këtë nevojiten fjalët e qasshme të socialdemokratit, që do të ishte si një interpretues i nevojave të ngutshme demokratike.” (*Izabrana dela*, vëll. 3, f. 298)

<sup>355</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 106.

“Vëllezërit e mi, këtu është vendi i mbledhjes së atyre që mendojnë dhe vuajnë; kjo barrikadë nuk është ngritur as prej gurëve e as prej drurëve, as prej hekurave – ajo është bërë nga dy grumbuj: grumbulli i ideve dhe ai i vuajtjeve. Këtu mjerimi përballet me idealin. Këtu nata përqafton ditën dhe i thotë: unë do vdes me ty, e ti prapë do të lindësh me mua. Nga ky shtrëngim dëshpërimesh lind besimi. Këtu vuajtjet sjellin agoninë e tyre; idetë pavdekshmërinë. Kjo agoni, kjo pavdekshmëri do bashkohen dhe do bëjnë vdekjen tonë. Vëllezër, kush vdes këtu, vdes në shkëlqimin e së ardhmes. Të gjithë do hyjmë në një varr ku errësira çahet nga drita e agut të mëngjesit”.<sup>356</sup>

Njerëzit e mjerë që nuk kanë burime jetese, që nuk kanë zgjidhje në jetë, janë të prirë ta pranojnë thirrjen e bindësit me një besim të tepruar: ai do i zgjidhë problemet jetësore të tyre, dhe do i drejtojë ata në atë rrugë e cila i nxjerr nga varfëria materiale dhe shpirtërore njëherë e përgjithmonë. “A nuk është e natyrshme që miliona njerëz që nisin luftën, që kanë jetuar në një errësi të egër prej shekujsh, në mjerim, varfëri, papastërti, në shtypje, t’i rrisin dhjetëfish frytet e fitores së mundshme?”<sup>357</sup> Tani madje është e qartë se premtimet e tepruara, të përmbledhura në mesazh, janë në relacion me pritjet e tepruara të turmës.

Aq sa është e vështirë jeta në këtë luginë lotësh, ose në vendin e vuajtjes së dënimit, po aq është e sigurt se idetë më të pamundura (të bindësit) do arrijnë të gjejnë mbështetësit e tyre. “Gjithë ky rrëfim, pak i paqartë dhe disi absurd, i cili nuk duhet kuptuar, por duhet besuar me përrulje, sepse do e kemi pranë me fjalë të caktuara aso çastesh kur na

<sup>356</sup> Igo, *Jadnici*, II, f. 516-17.

<sup>357</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 143.

mbërthejnë vuajtjet e fundit. Me të vërtetë?"<sup>358</sup> Më tej nuk pyetet se a është e vërtetë apo e rreme një ide – por, ajo që është e rëndësishme është që ideja të gjejë një mënyrë për të përmbushur pritshmëritë e turmës. Turmës i duhet gënjeshtër po aq sa i duhet edhe e vërteta, madje (ndoshta) akoma më tepër. Për turmën ideja është abstrakte dhe e mërzitshme. Ajo do ketë kuptim dhe vlerë vetëm nëse vepron faqe turmës. Ndërsa gënjeshtër vepron më bindshëm se e vërteta. Individë të caktuar i shpallin idetë e tyre sikur të ishin e vërteta, ashtu sikundërse edhe klasa politike shpall interesat e saj si të vërtetat e vetme reale. Për ta nuk ka rëndësi që bindësi po u zbraz kokat, përderisa u premtan mbushjen e barkut.

Në shumë raste Lenini pat theksuar nevojën e njohjes së kërkesave të nënvetëdijes dhe jo vetëdijes të disa grupe: "Domethënë, lipset përcaktuar saktë entuziazmi i turmës, synimet reale të saj, nevojat dhe mendimet, pa asnjë grimë idealizmi të rremë; të përcaktohet shkalla e vetëdijes së saj dhe forcës së ndikimit të atyre apo këtyre paragjykimeve dhe trashëgimisë nga e kaluara; të gjendet metoda e duhur që të fitohet besimi i pakufishëm i turmës, duke mbajtur raport shoqëror me të. Nevojat e turmës duhen përmbushur me një kujdes të veçantë."<sup>359</sup> "Pra, duhet ruajtur dhe duhet ofruar çdo lloj ndihme për njerëzit që dinë të shfaqin një entuziazëm të tillë të turmave; që dinë të shkaktojnë në turmë një entuziazëm identik (shpeshherë të kotur, pa vetëdije, të pazgjuar)."<sup>360</sup>

<sup>358</sup> Mann, *Budenbrokovi*, II, Svtjetlost, Sarajevo, 1961, f. 246.

<sup>359</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 14, f. 446.

<sup>360</sup> Lenjin, *Izabrana dela*, vëll. 19, f. 465.

Sot kjo kërkesë realizohet masivisht dhe dihet që studiuesit e motiveve janë njerëzit më të paguar nëpër agjensitë e reklamave.

Në psikologjinë sociale dihet mirë se bindësi nuk ka shans për shitjen e mallit. Ndërsa ne do shohim se çfarë janë realisht qëndrimet ideologjiko-politike dhe idetë, nëse nuk lidhen me nevoja konkrete dhe me entuziazmin e individëve dhe grupeve. Kjo ngaqë më shpejt dhe më lehtë pikasen, mbahen mend dhe miratohen ato ide (informacione) të cilat plotësojnë interesat, dëshirat dhe nevojat; ndërsa më të vështira dhe më të zorshme për t'u pikasur, për t'u mbajtur mend dhe për t'u miratuar janë ato ide (informacione) të cilat nuk i plotësojnë interesat, dëshirat dhe nevojat e individëve dhe grupeve. (Në rastet kur nevojat aktuale nuk ekzistojnë, duhen bërë përpjekje që të krijohen; dhe kështu, këto nevoja artificiale – Marx-i i ka quajtur nevoja të panatyrshme, të rafinuara, jonjerëzore<sup>361</sup> – të krijohet edhe mundësia e ndikimit.)

Këto informacione vërehen shpejt dhe lehtë, mbahen mend dhe miratohen nga bota e jashtme, që është e lidhur me interesat tona. Do të ishte i gabuar mendimi se informacionet e tjera asgjësohen. Përmes eksperimenteve të shumta është provuar se çdo gjë që u drejtohet pesë shqisave tona gjatë rrjedhës së jetës, në një mënyrë apo në një tjetër ruhet në shtresat e paravetëdijes dhe nënvetëdijes së qenies sonë.<sup>362</sup> Për shembull, psikologët francezë, duke ndikuar me një veprim të veçantë mbi trurin e një gruaje gjysmë të shkolluar, e kanë shtyrë të recitojë për orë të tëra vargje nga

<sup>361</sup>Rani radovi, f. 238.

“Sociologu e sheh mirë se, “së pari, është më efikase të nxitet nevoja ose frika prej diçkaje, e më pas të gjenden mjetet me të cilat mund të plotësohet nevoja apo të bëhen të njohura ato masa dhe mjete që do të kontribuojnë për të shmangur pasojat negative.” (Nikola Rot, *Osnovi socijalne psihologije*, Beograd, 1972, f. 343)

<sup>362</sup> Disa mesazhe transmetohen qëllimisht fare të shkurtër, në mënyrë që njerëzit të mos i vënë re me vetëdije, dhe kështu të depërtojnë në paravetëdije dhe te nënvetëdija, që në rastet e volitshme të shfaqen me një veprim të caktuar të ardhjes në vete.

poezia e lashtë greke, kuptimin e të cilëve ajo nuk e dinte, por i kujtonte vetëm ngaqë dikur, shumë vite më parë, një gjimnazist i zellshëm i kish mësuar përmendësh këto vargje në praninë e saj.<sup>363</sup>

Faktet të kësaj natyre çojnë jo vetëm në mundësinë që qenia njerëzore të mbajë mend apo të dijë diçka në nënvetëdije apo pavetëdije, – edhe pse mund të mos kuptojë gjë – por edhe drejt mundësisë që ndjenjat, mendimet dhe sjelljet të ndikohen relativisht në mënyrë të pavarur prej motiveve të vetëdijshme të qenies.

### Llojet e motiveve

Pavarësisht nëse individi është i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm për motivet që e shtyjnë atë në lëvizje, si dhe pavarësisht nëse këto motive janë të lindura apo të fituara, mesazhet e bindësit janë dërguar te këto motive dhe pranimi apo refuzimi i tyre varet shumë prej natyrës së motiveve. Duke pasur parasysh këtë, është e domosdoshme që të thuhet më e rëndësishmja për llojin dhe natyrën e motiveve njerëzore.

1. Motivi njohës ose motivi për arritjen e njohurive të reja është i një rëndësie madhore për jetën njerëzore, megjithëse shpeshherë është i orientuar drejt tyre, që po ashtu nuk duhet të jenë në funksion të nevojave të tjera njerëzore.

<sup>363</sup> E. V. Iljenkov, *O idolima i idealima*, Školska knjiga, Zagreb, 1975, f. 109.

Jung-u thoshte: "Por ne të gjithë dëgjojmë, shohim, marrim erë dhe provojmë shumë gjëra që nuk i vërejmë fare, ngaqë vëmendja jonë ka qenë e orientuar diku tjetër ose ngaqë shqisa ndijore është e dobët që të lërë përshtypje të vetëdijshme. Megjithatë këto veprime janë regjistruar në mënyrë të pavetëdijshme, dhe si perceptime të zbrazëta luajnë një rol të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme. Ato ndikojnë, por nga mënyra jonë e reagimit ndaj ngjarjeve dhe njerëzve nuk e hetojmë dot këtë. (*Çovjek i nje govni simboli*, f. 34)

Njeriu është kurioz që të fitojë njohuri rreth botës, pavarësisht nëse këto njohuri do kenë dobi praktike për të.

Ndonjëherë njeriu “e gjen të gjithë lumturinë te synimi për të njohur fatkeqësinë”.<sup>364</sup> Vlen të themi se motivi njohës, përgjithësisht është i lidhur me ekzistencën e një problemi në jetën praktike dhe teorike. Përderisa individët dhe grupet mund t’i zgjidhin problemet e tyre vetjake dhe kolektive në atë mënyrë që është përcaktuar nga zakonet dhe tradita, ata nuk e ndjejnë nevojën e ideve dhe teorive të reja – për njohuri të reja. Por, sapo problemi paraqitet, pra kur individët ballafaqohen me një situatë të paqartë, të papërcaktuar dhe kërcënuese, që ata nuk mund ta zgjidhin me një prej mënyrave të kahershme dhe të njohura, grupet dhe individët janë të prirë që të bëjnë pyetje të tjera dhe të japin (ose të pranojnë) përgjigje të tjera. Një bindës i shkathët, zakonisht e përdor situatën e disonancës njohëse<sup>365</sup> duke futur simbolet e tij (informacionet) dhe duke ofruar një shpjegim të problemit, që në fakt është në linjën e interesit të tij.

2. Njeriu nuk mund të jetojë pa një sistem koordinues, që e lejon atë të organizojë përvojat e shpërndara dhe të larmishme në një tërësi kuptimore, që ai i fiton çdo ditë në marrëdhëniet e tij me të tjerët, me gjërat dhe kulturat e ndryshme. Në këtë rast, fjalët, konceptet, hipotezat, teoritë – me pak fjalë, idetë, nuk na shërbejnë që të përshkruajmë dhe shpjegojmë formalisht ndonjë situatë konfuze, por na orientojnë se në ç’drejtim duhet vepruar. Idetë juridike, morale, ideologjike, religjioze etj., të shprehura në formën e norma-

<sup>364</sup> “Ndërsa athinasit dhe të gjithë udhëtarët e vendeve të tjera nuk ishin për asgjë tjetër vetëm se të thoshin e të dëgjonin diçka të re.” (*Veprat apostolike*, kap. 17, parag. 21)

<sup>365</sup> L. Festinger, *A Theory of Cognitive Dissonance*, Stanford University Press, Stanford, California, 1957.

ve ligjore, imperativëve moralë, udhëzimeve ideologjike dhe urdhëresave fetare, shërbejnë si udhëzues për të gjithë ata të cilët mund ta humbasin rrugën në një botë të paqartë, të papërcaktuar dhe plot me mundësi të ndryshme. "Nevoja për orientim ka dy kuptime: nevoja themelore është që njeriu të ketë një kornizë të caktuar orientimi, pavarësisht nëse ajo është e vërtetë apo e rreme. Për sa kohë që njeriu nuk ka një kornizë orientuese (subjektive dhe të kënaqshme), ai nuk mund të jetë mentalisht i shëndetshëm. Ndërsa në kuptimin e dytë, kjo nevojë konsiston që njeriu duhet të mbetet në kontakt me realitetin, duke u mbështetur te ndihma e arsyes; pra, ta kuptojë botën objektivisht. Por, domosdoshmëria që njeriu të zhvillojë intelektin e tij nuk është e drejtpërdrejtë, siç është domosdoshmëria e zhvillimit të një kornizë të caktuar orientimi."<sup>366</sup> Pikërisht ngaqë individët dhe grupet kanë një motiv të fortë për kornizën e orientimit, ata janë të prirë që në mungesë të saj të miratojnë kornizën që u ofron bindësi, pavarësisht nëse kjo është e vërtetë apo e rreme.<sup>367</sup>

3. Dikur njeriu nuk ishte i ndarë nga universi, pasi ai nuk ishte i vetëdijshëm për vetveten në lidhje me çfarë kishte përreth; domethënë, i mungonte vetëdija për njohjen e dallimeve në këtë univers, duke përfshirë të gjitha qeniet në të, sepse ai e ndjente veten te secila syresh. Ngaqë njeriu është vetëm një pjesë e tërësisë, me siguri që ndjenja e parë

<sup>366</sup> Fromm, *Zdravo društvo*, f. 82.

<sup>367</sup> "Por, edhe pse korniza e orientimit të njeriut është krejtësisht iluzive, ajo e kënaq nevojën e tij për një imazh që ka kuptim për të." (Fromm, po aty, f. 81) Fromm-i thekson se për njeriun nuk është problem nëse sillet në mënyrë të paarsyeshme; ama do të vdiste nëse nuk do ta justifikonte këtë sjellje të paarsyeshme në raport me motivet e tij. (po aty, f. 83) Korniza e orientimit kërkohet dhe pranohet në veçanti në rrethana kur individët dhe grupet ndodhen në ndonjë situatë krize objektive, ose atëherë kur situata e tyre është e turbulluar nga informacionet e reja, saqë nuk shohin ndonjë rrugëdalje.

për veten ka qenë paralajmërimi i parë i humbjes së unitetit dhe konfliktit të përhershëm.

Me kalimin e kohës, ky unitet origjinal filloi të harrohej, por nevoja që duhet të përkasë diku (më së shumti e nënvetëdijshme) ka mbetur. Por, tanimë, nevoja për të qenë pjesë e një tërësie më të madhe nuk është më autentike – ajo është zëvendësuar me nevojën e mundshme për të qenë pjesë e ndonjë tërësie më të vogël (bashkësia), e cila zëvendëson identifikimin e braktisur me universin. Vetëdija për dallimin midis qenieve i ka imponuar njeriut idenë se në rendin e qenieve vendi i tij është shumë i veçantë dhe, në të njëjtën kohë, uniteti origjinal është rrënuar në mënyrë të papërmirësueshme. Duket se filozofitë e natyrës dhe të gjitha filozofitë sociale, në një mënyrë apo në një tjetër përpiqen që të arrijnë gjendjen e *nirvanës* – “rënia në harresë”, “dalja në bregun tjetër”, “heqja e të gjitha dallimeve”. Kjo duhet interpretuar si një përpjekje për bashkim konceptor me universin; e thënë ndryshe, asgjësimi i dallimeve.

Në historinë e shoqërive njerëzore ndeshemi me raste ku individët identifikohen aq fort me bashkësinë (për shembull, me fisin), sa që nuk janë të vetëdijshëm për dallimin midis vetes dhe bashkësisë; madje në gjuhë e tyre nuk ekzistojnë fjalë si “unë”, por vetëm “ne”.

Kur arrihet njohja e një anëtarit të bashkësisë dhe mënyra e tij e besimit, mendimit, vlerësimit dhe ajo e sjelljes, mund të themi se automatikisht janë njohur të gjithë anëtarët e tjerë. Prandaj, studiuesit nuk i mbetet tjetër veçse t’i gëzohet suksesit të tij me përfundim induktiv. Individu është i shkrirë me bashkësinë, si një pikë uji në një det të tërë, dhe mund të themi se jo vetëm që ai jeton në bashkësi, por edhe bashkësia jeton në të. Ai e ka humbur ndjenjën e identitetit me universin, ama ka fituar ndjenjën e re të iden-

titetit me bashkësinë. “Zëri i kopesë do vazhdojë të jehojë në ty”, paralajmëronte Nietzsche.

Vetëm në bashkësinë shoqërore, nën veprimin e fortë të ndarjes së punës dhe specializimit të funksioneve, individit ia ka dalë ta përjetojë grupin jo vetëm si diçka të ndryshëm nga universi, por edhe si diçka që ndryshon nga shoqëria, dhe kësaj ka arritur një vetëdije të qartë për këtë ndryshim. Vetëm zhvillimi i mëvonshëm, i shtyrë nga ndarja e punës, ka sjellë individualizimin dhe vetëdijen për veten në raport me të tjerët.

“Është vetëm një gjë e vetme dhe e pakompensueshme në univers: uni. Me të vërtetë, në të gjithë universin ekziston vetëm një “unë” dhe, në të njëjtën kohë (rast i çuditshëm), ky unë është i vetmi entitet në univers që ekziston vetëm në një kopje të vetme. Çudi, vërtet çudi! Megjithatë kjo është e vërtetë.”<sup>368</sup>

Qysh kur ka shkëputur ndjenjën e tij për identitetin në univers dhe bashkësi, njeriu nuk pushon së kërkuari për identitetin e vet. Pa përgjigje për pyetjen se kush jam unë dhe cili është vendi im në botën natyrore dhe shoqërore, njeriu nuk mund të jetë mirë. Miti, feja, filozofia, arti, politika, ligji, etika, shkenca e kështu me radhë janë vetëm përpjekje simbolike për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Kërkimet socio-psikologjike të identitetit tregojnë se (a) individit e identifikon veten me grupin tek i cili bën pjesë, (b) me grupin tek i cili synon të kalojë, (c) me statusin në grup, (d) me atë që të tjerët mendojnë për të dhe (e) me atë që mendon

<sup>368</sup> Vladan Desnica, *Proljeçe Ivana Galjeba*, f. 100. “Foshnja nuk e dallon dot unin nga bota e jashtme si burimin e ndjenjave që e rrëmbejnë. Këtë e mëson hap pas hapi duke iu përgjigjur ctyjeve të ndryshme.” (Freud, *Iz kulture i umetnosti*, f. 266) “Ndenja e sotme e Unit tonë ka atrofizuar mbetjen e një ndenje më të gjerë, aq më tepër një ndenje që i përgjigjet lidhjes së ngushtë të Unit me botën përreth.” (Poaty, f. 267)

për veten. Nëse e përjashtojmë këtë të fundit dhe njëherësh si rastin më të rrallë, – si dhe në qoftë se mendojmë se ndjenja e identitetit të universi ka humbur plotësisht nga vetëdija e njeriut – atëherë do shohim se kriteret e grupit janë të palëkundura, se individi pothuajse nuk mund ta imagjinojë veten jashtë grupit.

“Nuk jam më një copëz e jetës, që dridhet vetmitare në errësirë. Unë i përkas atyre dhe ata më përkasin mua. Të gjithë ndjejmë të njëjtën frikë dhe kemi të njëjtën jetë, por që kjo jetë tashmë është lidhur në një mënyrë të thjeshtë dhe të fuqishme.” (Remark)

Prandaj, me apo pa vetëdije, individi kërkon identitetin e tij, edhe pse ky lloj kërkimi është shumë i pasigurt. Por, është e qartë se përgjatë rrugës i ofrohen shfaqje të ndryshme në lidhje me çështjen se kush është dhe cili është vendi i tij i vërtetë në botë. Aq sa individi është i pasigurt se a e ka fituar identitetin e tij apo jo, po aq është i prirë që ta marrë atë prej ndonjë arkitekti të shkathët të mendimit modern.

4. Motivi për t’u bashkuar (për të përkitur të një grup/motivi afiliativ) është një nga motivet më të forta universale. Vetëm në bashkësi me të tjerët është e mundur që të përmbushen (a) nevojat biologjike, (b) të gjitha nevojat e tjera shoqërore, (c) nevojat psikologjike (ku më e rëndësishmja është çlirimi nga frika) dhe (d) nevojat njohëse (kur perceptimi dhe interpretimi i situatës përputhet me perceptimin dhe interpretimin e të tjerëve në grup – ky është burim i sigurisë dhe i mënjanimin të situatës së tensionuar). Se sa e madhe është nevoja për t’u bashkuar me të tjerët, shihet në bazë të gatshmërisë së individit: sa është i gatshëm që “të paguajë” te grupi vetëm për të arritur tejkalimin e vetmisë apo pafuqinë e vet. Çmimi më i lartë që paguan individi për t’u ndjerë pjesë e dikujt apo e diçkaje që është më e madhe

dhe më e fuqishme se ai, është heqja dorë nga liria.<sup>369</sup> “Nuk ka brengë më të vazhdueshme e më të mundimshme për njeriun sesa të qenurit i lirë. Prandaj, sapo ai e arrin këtë, menjëherë nis të kërkojë dikë që t’i nënshtrohet. Por njeriu kërkon t’i nënshtrohet atij që është i pakontestueshëm, aq i pakontestueshëm sa të gjithë njerëzit pajtohen përnjëherë që t’i nënshtrohen; sepse shqetësimi i këtyre krijesave të mjera nuk është vetëm se duhet gjetur ai përballë të cilit unë apo dikush tjetër duhet të nënshtrohemi, por të gjendet dikush/diçka që e besojnë të gjithë se meriton nënshttrim. Ja, pra, nevoja për nënshttrim të përbashkët është edhe pështjellimi më i madh i çdo njeriu, sikurse edhe i mbarë njerëzimit që në ag të shekujve.”<sup>370</sup>

Nevoja për të sunduar të tjerët (dominimi) është vetëm ana tjetër e nevojës për të nënshtuar dikë. “Që të dy personat për të cilët është fjala e kanë humbur integritetin dhe lirinë e tyre; ata jetojnë për llogari të tjetrit dhe nga njëri-tjetri, duke plotësuar synimin për afrim, por njëkohësisht duke vuajtur prej mungesës së forcës së brendshme dhe vetëbesimit – një forcë kjo që do kërkonte lirinë dhe pavarësinë; aq më tepër të munduar vazhdimisht me armiqtësinë e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, e cila buron në mënyrë të pashmangshme nga marrëdhëniet simbolike.”<sup>371</sup>

<sup>369</sup> “Kjo është fuqia e nevojës njerëzore për t’iu nënshtuar dikujt.” (Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 67)

<sup>370</sup> Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, Rad, Beograd 1967, f. 315-16. “Dhe njerëzit u gëzuan që i konsideruan sërish si kope, dhe që më në fund, prej zemrave të tyre do hiqet dhuntia e tmerrshme që u solli kaq shumë mundime.” (Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, f. 319)

<sup>371</sup> Fromm, *Zdravo društvo*, f. 53. “Si njerëzit e dobët, që janë gjithnjë të dehur kur gjejnë formulën e përbashkët, e cila u premtom realizimin e nevojave dhe instinkteve në llogari të fatkeqësisë dhe shkatërrimit të tjetrit; dhe njëkohësisht i çliron ata nga brerja e ndërgjegjes dhe nga përgjegjësia.” (Ivo Andrić, *Travnička hronika*, f. 85)

Në radhë të parë, manipuluesi u dërgon mesazhe atyre individëve që ndihen të pafuqishëm dhe të vetmuar (nuk i përkasin një grupi të pushtetshëm, ose në qoftë se i përkasin, statusi dhe reputacioni i tyre në grup është i pasigurt dhe i dobët), duke u ofruar mënyrën se si të përmbushin nevojën e përkatësisë në grup. “Të gjithë ju që jeni të lodhur dhe të ngarkuar, ejani tek unë! Unë do t’ju freskoj.”<sup>372</sup> Në të njëjtën mënyrë grupi kënaq dëshirën për pushtet të disa individëve, sikurse edhe nevojën për të përkitur te shumica.

5. Përvoja na mëson se nevoja për të fituar (motivi për të arritur)<sup>373</sup> është e rrënjosur aq fort te shumica e njerëzve, saqë drejton të gjithë jetën e tyre, dhe pothuajse asnjëherë nuk mund të përmbushet deri në fund. Kjo nevojë e fuqishme për arritje (për të fituar) interpretohet si përpjekje e individit për të shtrirë unin e tij mbi një numër më të madh njerëzish, gjërash apo idesh. Kështu, njerëzit, gjërat dhe idetë bëhen pjesë e “unit të zgjeruar”, për të cilin ka shkruar edhe William James-i: “Është e vështirë të bësh dallimin midis asaj që njeriu quan Unë dhe e asaj që thjesht e etiketon si “e imja”. Në kuptimin më të gjerë të mundshëm, Uni i njeriut përbëhet nga shumica e gjithë asaj që ai mund të etiketojë si të tijën, jo vetëm nga trupi dhe fuqia e tij fizike, por edhe nga rrobat, shtëpia, bashkëshortja, fëmijët, paraardhësit, miqtë, reputacioni, puna, vendi, krahina, anija dhe llogaria bankare e tij. Të gjitha këto shkaktojnë tek ai të njëjtat ndjenja. Nëse këto rriten dhe zhvillohen, ai ndjehet ngadhënjimtar; nëse bien, ai ndjehet i mposhtur – jo medoemos në të njëjtën shkallë për çdo gjë, por gjithmonë në të njëjtën mënyrë për të gjitha.”<sup>374</sup>

<sup>372</sup> Ungjilli sipas Mateut, kap. 12, parag. 28.

<sup>373</sup> Për më gjerë: Nikola Rot, po aty, f. 247.

<sup>374</sup> Cituar nga D. Kreč, *Pojedinac u društvo*, Beograd, 1972, f. 96-7.

Në shoqëritë e organizuara sipas parimit të ekonomisë së tregut, nevoja për të kapur radhën e parë paraqitet si një nevojë për zotërimin e parasë, kjo “hyjni e madhe”, me anë të së cilës mund të blihen njerëzit, gjërat dhe idetë, dhe në këtë mënyrë Uni zgjerohet drejt atyre kufijve ku shtrihet fuqia e parasë. Gjithsesi, në mesazhet e tij bindësi paralajmëron mundësinë që individë dhe grupe, nëse pranojnë mesazhet e tij, mund ta përmbushin nevojën e arritjes, dhe kështu të zgjerojnë kufijtë e Unit të tyre.

6. Në lidhje me nevojën për arritje, ekziston edhe nevoja për reputacion, që në disa raste mund të jetë aq e fuqishme, saqë i nënshtrohen nevojat për të arritje apo nevoja për pushtet<sup>375</sup>, edhe pse sipas rregullit, në shoqëritë e organizuara në klasa, reputacioni i lartë lidhet për pozitën e lartë shoqërore (që nuk do të thotë se një individ pa ndonjë reputacion të caktuar nuk mund të zërë një pozitë të lartë shoqërore). Megjithatë pozitat në të njëjtin nivel të hierarkisë vlerësohen ndryshe nga ana e anëtarëve të shoqërisë. Të njëjtat pozita formale gëzojnë reputacion të ndryshëm joformal, domethënë pasiguria në vlerësimin e reputacionit, sipas rregullit, është më e madhe se në vlerësimin e pozicionit, pasi reputacioni i individit shpeshherë mbështetet te vlerësimi dhe ndjenja individuale, te dallimet individuale në të perceptuarit e tij, te informacionet “ka dëgjuar”/“ka thënë”, ndërsa pozita mbështetet në bazë të dokumenteve të shkruara, te pranimi publik dhe tek ajo që manifestohet në mënyrë të dukshme dhe simbolike. Nëse manipuluesi i dërgon

<sup>375</sup> Kështu, Bass vlerëson se ushtarët nuk dezertojnë prej ushtrisë për shkakun se llogarisin për reputacionin e tyre dhe reputacionin e familjeve, miqve dhe fqinjëve të tyre (frika nga përbuzja), por jo edhe për shkak të arsyeve patriotike apo prej frikës nga ndëshkimi (B. M. Bass, *Leadership ..*, p. 243 dhe më tutje predikuesit; P. M. Blau, *Exchange and Power*, p. 49)..

mesazhet e tij midis njerëzve, dhe ata janë mjaft të ndjeshëm rreth çështjeve që lidhen me reputacionin e tyre shoqëror, ka më shumë gjasa që të ndikojë në sjelljen e tyre sesa në rastin kur këto mesazhe i shpërmdan mes atyre me nivel të ulët motivues në drejtim të reputacionit.

7. Dhe më në fund, le të tërheqim vëmendjen për ekzistencën e një motivi të fortë, i cili te disa njerëz shfaqet me rastin e shkakut të vogël (motivi i rrënimit). Krahas njeriut që krijon, jeton njeriu që rrënon: njëri është në gjendje që në një vend ku nuk ka ekzistuar asgjë të bëjë të duket diçka; tjetri është i aftë që në një vend ku është parë diçka të bëjë të zhbëhet e tëra; njëri krijon jetën, tjetri e shkatërron; njëri konfirmohet me realizim, tjetri me shkatërrim; i pari është i mirë si Perëndia, tjetri është i keq si Djalli: fati i të parit është harresa, i të dytit çudia deri në amshim.

Ekzistenca e instinktit për shkatërrim bëhet më e rëndësishme se shpjegimi i vetë këtij fakti. Disa përkrahin qëndrimin se instinkti për shkatërrim është i lindur, të tjerët thonë se ai fitohet gjatë jetës; siç ka të atillë që thonë se është pjesërisht i lindur, pjesërisht i fituar. Grupi i fundit mendon se ky instinkt i fuqishëm është vetëm ana tjetër e të njëjtës nevojë për të kaluar... Dostojevski ka ofruar një shpjegim që është shumë më i thellë se të gjithë ata që njoh deri më tani: "Është e padiskutueshme që njeriu do të ndërtojë dhe të hapë rrugë të reja. Por, nga ana tjetër, po ashtu ai kërkon rrënimin dhe kaosin. Pse? Ma thoni ju. Për këtë dua të them disa fjalë. Mos ndoshta dhënia e tij pas rrënimit dhe kaosit (kjo është e pamohueshme: nganjëherë e tepërt) është rrjedhojë e frikës instinktive që lidhet me arritjen te caku dhe me përfundimin e ngrehinës që po ndërtohet?" <sup>376</sup>

<sup>376</sup>Zapisi iz podzemlja, f. 338.

Manipuluesi u dërgon mesazhe individëve (dhe grupeve) te të cilët instinkti agresiv dhe rrënues është shumë i pranishëm, qoftë ngaqë e kanë të lindur, qoftë për faktin se përgjatë jetës së tyre kanë akumuluar emocione agresive sa herë që synimet e tyre kanë qenë të penguar nga ana e normave shoqërore, morale apo kulturore, ose nga ana e institucioneve apo e individëve.

Manipuluesi i fuqishëm, autoritar dhe i shkathët nuk i dërgon mesazhet e tij kuturu<sup>377</sup>, por përpiqet t'u japë atë formë që ato të godasin në të gjitha llojet e motiveve të njerëzve: te motivi njohës, te motivi për kornizën e orientimit, motivi për identitet, motivi për të qenë pjesë e një grupi (qoftë në formën e nevojës për t'u nënshtruar, qoftë në formën për të sunduar), motivi për të arritur, motivi për prestigj dhe motivi për shkatërrim. Të gjitha këto motive janë të pranishme tek individët, ndonëse ata mund të jenë të pavetëdijshëm për ekzistencën e tyre.

Që silogjizmi logjik të shndërrohet në lëvizje praktike, është e nevojshme të takojë atë mendje që e kupton, shpresën që brendh, vullnetin që fiket, ndjenjën që ndahet, zemrën që dridhet, dëshirën që digjet, mjerimin që shkatërron. Vetëm kështu fara e mbjellë do të çelë frytin që do sjellë aq shumë të mira, saqë mendja e shëndoshë nuk mund ta imagjinojë.<sup>378</sup>

<sup>377</sup> "Por, atë që peshkon atje ku nuk ka peshq, unë nuk e konsideroj as si sipërfaqësor." (Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 167). "Unë flas këtu, por askush nuk i ka veshët e mi. Kam dëshirë të bërtas jashtë, atje ku fryjnë të gjitha erërat." (po aty, f. 157). "Nëse edhe fjalët më të fuqishme nuk godasin mbi materialin djegës, – instinktet, emocionet, interesat, nevojat, dëshirat – zjarri i tyre fiket dhe madhështia e tyre rrëzohet. Nuk ka më as forcë e as famë tek ato fjalë që dikur ishin të fuqishme." (C. G. Jung, *Çovjek i njeqovi simboli*, f. 95)

<sup>378</sup> Këtu kam folur vetëm për disa motive sociale, dhe kjo nuk do të thotë se lista e tyre ka mbaruar. Listën e gjatë me njëzet motive e hasim te: H. A Murray, *An Exploration in Personality*, Oxford University Press. London, 1938, pp. 80-83. Klasifiki-

## PASOJAT

*“Fjala ka rënë, dhe kur fjala bie njëherë,  
ajo më nuk ndalet, por shkon tutje:  
rrugës zmadhohet dhe ndryshon.”*

Ivo Andriq

Përpara shfaqjes së medieve masive, gjithçka që njeriu bënte apo thoshte, bazuar në pasojat e shkaktuara nga veprimet, mund të themi se nuk i tejkalonte kornizat e familjes, kufijtë e një rrethi të vogël miqsh ose të njohurish, ose caqet e grupeve të punës, fshatit, qytetit, klasës. Të gjitha ato që bën apo nuk bën njeriu sot, gjithçka që ai thotë nëpërmjet mediave masive, këtyre gojëve të mëdha e të pushtetshme, nuk është më e kufizuar në një rreth të tillë të ngushtë, por tashmë veprimet dhe fjalët arrijnë te miliona dëgjues e shikues. Kur numri i njerëzve rritet, është e sigurt se pasojat janë më të mëdha dhe, në disa rrethana, ato mund të arrijnë përmasa të paimagjinueshme.

Kur një ide e caktuar (informacion, simbol) shpërndahehet në botën e sotme, kur fillon të lidhet me rrjetën e nevojave të ndryshme, interesave dhe ideve të tjera, ajo i shmanget kontrollit të krijuesit të saj dhe fillon një jetë të pavarur nga nismëtari i saj, duke u larguar nga qëllimi parësor. Dhe me të vërtetë, njeriu nuk mund të parashikojë se në cilat rrethana shoqërore, ideologjike dhe kontekste ideore mund të ndërlihet një ide (informacion) dhe se si do interpretohet ajo nga perspektiva e këtyre fuqive. “Një fjalë e vetme, e

cila shmanget në mënyrë të pakujdesshme dhe të cilën e fusin nën kontroll dhëmbëzoret e panjohura, mund t'ju tërheqë duke ju hedhur në çfarëdo rrotash."<sup>379</sup>

Fjala është e juaja, por pasojat e saj nuk ju përkasin ju. Edhe atëherë kur fjala thuhet me qëllimin më të mirë, shpeshherë, pas një kohë të caktuar, ajo kthehet e shtrembëruar, e shëmtuar, bash si në rastin kur nxirrni në jetë/botë një qenie të re e të shëndetshme, dhe më vonë ajo kthehet e lodhur, e sëmurë, e kështu ju nuk e njihni më. "Të gjitha gjërat e mira kthehen të shtrembëruara afër qëllimit të tyre." (Nietzsche)

Atë që mund të bëjë bota me një ide nuk mund të parashikohet me saktësi<sup>380</sup>, dhe nuk është mençuri kur krijuesin e kësaj ideje e akuzojmë për pasojat e shkaktuara nga ideja e tij; sepse krijuesi i ideve është i vetëdijshëm vetëm për ndonjë pasojë që mund të shkaktojë ideja në jetën publike, por jo për çdo pasojë të saj. Pasojat e shkaktuara nga ideja, për të cilat krijuesi nuk është në dijeni, duhet të ndahen në mënyrë analitike nga pasojat për të cilat ai është i vetëdijshëm. Së këndejmi rezulton se vlera e ideve mund të vlerësohet në varësi të atyre ideve origjinale që ka futur krijuesi në mesazh, duke pasur parasysh pasojat që shkaktojnë ato, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në qëllimin përfundimtar.

Krijuesi i idesë është përgjegjës për pasojat që ka planifikuar. Ai nuk mund të jetë përgjegjës për pasojat që mund të ketë ideja kur hidhet në jetën publike. "Unë vetëm sa kam pohuar se shtrembërimi i ideve dhe i shprehjeve ndodh shpesh; dhe sot, për fat të keq, është më shumë një dukuri e përgjithshme sesa e veçantë. Nëse ky shtrembërim

<sup>379</sup> Igo, *Čovek koji se smeje*, Rad, Beograd, 1959, f. 416.

<sup>380</sup> "Ndikimi i ideve të socializmit mbi masat e proletariatit do marrë rrugë të atilla që ne shpeshherë nuk i ndjekim dot." (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, Kultura, Beograd, 1960, f. 192)

nuk do të ishte një fenomen kaq i përgjithshëm, atëherë ndoshta nuk do të kishte as krime të paimagjineshme..."<sup>381</sup>

Marrësi i mesazhit mund të shtrembërojë kuptimin e mesazhit, por edhe mund t'i japë një kuptim të ri, dhe kështu e pasuron atë. Mjafton që të ndryshojë diçka në situatën socio-psikologjike të marrësit, duke futur një kuptim të ri të mesazhi, dhe nga ky kuptim mesazhi fiton një funksion të ri, duke shënuar kështu një vlerë të re. "Mesazhi si formë simbolesh shfaqet si trajtë e zbratur dhe mund t'i atribuohen kuptime nga më të ndryshmet."<sup>382</sup>

Mesazhin nuk e bën vetëm teksti. Nënteksti i jep një forcë bindëse mesazhit po aq sa vetë teksti. Sa më e gjerë të jetë gama e kuptimeve konotative të mesazhit, aq më shumë do të ndryshojë kuptimi, funksioni dhe vlera e vetë mesazhit, mbështetur në kontekstin socio-psikologjik ku është ndërthurur mesazhi.

Umberto Eco ka nxjerrë disa përfundime me vend në këtë drejtim:

- konteksti ndryshon kuptimin e mesazhit;
- konteksti ndryshon funksionin e mesazhit;
- konteksti ndryshon kuotën informative të mesazhit.<sup>383</sup>

Mesazhi popullohet nga kuptime të cilat i atribuohen nga individët dhe grupet. Nëse mesazhi përbëhet nga fjalët, atëherë numri i kuptimeve që mund të marrë mesazhi është shumë më i madh se arsyet të thjeshta, pasi fjala ka shumë

<sup>381</sup> Dostojevski, *Idiot*, II, Rad, Beograd, 1967, f. 25.

Shtrembërimi i ideve dhe qëllimeve parësore shpie gjerë në atë pikë që krijuesit e tyre të heqin dorë edhe nga ajo që kanë pohuar vetë. "Kam parë shumë njerëz të cilët menjëherë pas bucelës së parë të ujit të ftohtë, jo vetëm që heqin dorë prej qëllimeve të tyre, por madje heqin dorë edhe nga idetë e tyre, dhe fillojnë të përqeshin atë që e konsideronin të shenjtë. Ah, sa me lehtësi e bëjnë këtë." (Dostojevski, *Mladić*, Rad, Beograd, 1967, f. 160)

<sup>382</sup> Umberto Eco, *Kultura, informacija, komunikacija*, Nolit, Beograd, 1973, f. 65.

<sup>383</sup> Po aty, f. 63.

kuptime. Nëse supozojmë se disa individë përdorin vetëm 500 fjalë në jetën e tyre të përditshme, atëherë mund të provohet se këto 500 fjalë kanë mbi 14 000 kuptime.<sup>384</sup> Ky rast tregon qartë për faktin se është e vështirë që fjalët të ngërthejnë bash atë kuptim që ka mbjellë në to peshkatari i shpirtave njerëzorë. Kuptimi i fjalëve e shmang qëllimin deri në masën se sa është e shtresuar shoqëria në bazë të shumë boshteve të diferencimit social.

Vetëm me zhvillimin e medias masive bëhemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë e madhe; për të gjithë atë që shkon drejt masave përmes këtyre mjeteve. Duke gjykuar në bazë të argumenteve se kush i bën publike këto mesazhe, si na i paraqet dhe çfarë na ofron nëpërmjet tyre, nuk mund të thuhet se na trajton si njerëz të pjekur, të arsyeshëm dhe personalitete të përgjegjshme.<sup>385</sup> Edhe Lenini kishte shtruar pyetjen: “A duhet të merren si seriozë ata njerëz të cilët nuk janë të aftë që t’i kuptojnë seriozisht problemet serioze?”

As arkitekti i vetëdijes moderne nuk është në gjendje të parashikojë të gjitha pasojat që mund të shkaktojnë mesazhet e tij.<sup>386</sup> Megjithatë ai është në gjendje që të parashikojë disa pasoja, të cilat përputhen në mënyrë të shkëlqyer me qëllimet e tij bazë. Parashikim i pasojave do të jetë i suksesshëm për aq sa është autoritar sistemi shoqëror. Në këtë sistem manipuluesi ka monopolin mbi idetë (informacionet), në bazë të të cilit individët/grupet, në varësi të qëllimeve të tyre, mund të krijojnë vetëm qëndrime pozitive ose negati-

<sup>384</sup> Më gjerë: Rom J. Markin, Jr., *Consumer Behavior*, Macmillan Publishing Co., Inc., New York, 1974, p. 536.

<sup>385</sup> “Ti je vetëm një çupë e vogël që nuk di si ta shohësh botën, dhe për këtë arsye duhet të mbështetet në sytë e atyre që i duan të mirën”. (Mann, *Budenbrokovi*, I, Svjetlost, Sarajevo. 1961, f. 97)

<sup>386</sup> Për këtë dëshmon fare shkoqur i ashtuquajtur “efekti bumerang”.

ve ndaj një fenomeni. Manipuluesi pret që me një inkorporim të mirë të paramenduar të mesazheve të tij, të nxisë ndryshimet e dëshiruara (pasojat):

- në nivelin e vetëdijes dhe sjelljes;
- në nivelin e qëndrimeve dhe sjelljeve të grupit;
- në nivelin e sistemit si tërësi.

Nëse njëshja njerëzore “nga djepi gjer në varr” pranon dhe miraton disa ide të caktuara (informacione) nga burime të caktuara autoritative, të cilat janë nën kontrollin e grupit qeverisës në shoqëri, – pavarësisht faktit nëse këto ide i përzgjedh kjo njëshe njerëzore apo përzgjedhjen e bën dora e tij e zgjatur: i organizon, i shpërndan dhe i kontrollon ato – ka të ngjarë që kjo njëshe njerëzore të mendojë vetëm brenda disa kufijve të caktuar, brenda të cilëve është mësuar të mendojë. Pra, kjo njëshe njerëzore, mendon në kufijtë e një sistemi të menduari, dhe hap pas hapi është e sigurt se do përfundojë te humbja e aftësisë, që të mendojë krejtësisht në mënyrë tjetër. Kjo njëshe i është nënshtruar ndikimit të një sistemi të menduari, dhe kështu ka humbur mundësinë që të mendojë ndryshe.<sup>387</sup> Psikologët kanë provuar se bëhet fjalë për mbylljen e trurit (*closed-mindedness*), që është një veçori e përgjithshme e personalitetit, dhe që qëndron lidhur pas aftësisë për edukim të sistemit njohës.<sup>388</sup>

Përderisa sistemi i të menduarit është i mbyllur, individi është i paaftë të hetojë vetitë e shumëfishta dhe të ndryshme dhe mundësitë në raportet e përditshme ndaj natyrës së tij, mjedisit shoqëror dhe kulturor. Ai individi që i anashkalon me apo pa vetëdije përvojat dhe faktet e reja, apo që

<sup>387</sup> “Vetë të kam krijuar, dhe të pëshpëris se çfarë duhet të mendosh.” (Sartre, *Davo i gospod bog*, f. 59)

<sup>388</sup> Shih: M. Rokeach, *Beliefs, Attitudes and Values*, Jossey-Bass Inc., San Francisco, 1970; D. Kreč ... *Pojedinac u društvo*, Beograd, 1972, f. 48.

këto përvoja dhe fakte i vendos tashmë nën shprehje të gatshme<sup>389</sup> dhe skema, gropos tokën mbi të cilën qëndron vetë, sepse me siguri që një ditë do të vihet në pozitë, deri aty sa përmes shprehjeve të mësuara dhe të vjetruara nuk do të arrijë të zgjidh një problem të ri. Ai do ndjehet i humbur në çdo situatë që nuk është e ngjashme me një situatë të mëparshme, e cila është bërë e mundur falë sistemit tashmë të miratuar. Sjellja uniforme ndaj realitetit, që pëson gjithnjë ndryshime, nënkupton vetë-firmosjen e aktgjykimit vetjak, pikërisht për faktin se individi do të ndihet si i huaj në çdo situatë që përmban momente të reja dhe origjinale – ai prapë do i drejtohet për ndihmë të njëjtit burim autoritar, i cili e ka paaftësuar këtë individ që të mendojë në mënyrë të zhdërvjellët dhe të gjithanshme, dhe për këtë arsye ai nuk ka qenë fare i vetëdijshëm; domethënë, që të mendojë në mënyrë të pavarur.<sup>390</sup>

E thotë shumë mirë R. B. Peri: “Whoever determines what alternatives shall be made known to man controls what that man shall choose from. He is deprived of freedom in proportion as he is denied access to any ideas, or is confined to any range of ideas short of the totality of relevant possibilities.”<sup>391</sup>

Atëherë kur të gjitha mundësitë njohëse janë të bllokua për llogarinë e një njësije të vetme, është e sigurt që

<sup>389</sup> “...ashtu si shumica e njerëzve, që i paaftë që t’i ndryshonte përfundimet e tij në bazë të përvojave të reja, dhe mbahej fort pas mendimit që kish arritur dhe shprehjeve që kishte pranuar më parë.” (Anatol Frans, *Život u coetu*, Beograd, NP, 1951, f. 22)

<sup>390</sup> “...megjithatë ai dëshironte të paraqitej si ekzekutues i një ideje të huaj, sesa si dikush që ka mendjen e vet...” (Dostojevski, *Idiot*, I, f. 24)

<sup>391</sup> R. Barton Perry, cituar nga B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 88.

mundësitë e sjelljes praktike janë shumë të ngushtuara.<sup>392</sup> Individët që janë mësuar të mendojë me kokën e tjetrit nuk e kanë të vështirë që të sillen ashtu siç i urdhëron ajo kokë, veçanërisht nëse kjo kokë është e pushtetshme dhe autoritare. “Adhuroni udhëheqësit tuaj. Përlununi para atyre deri në pafundësi. Mirëbërja në vetvete përmban edhe kushtin e heshtur të pranimit të vlerës suaj të ulët. Ata kërkojnë nga ju që të silleni si të mjerë, ndërsa ju t’i konsideroni ata si përrëndi. Ata lartësohen falë përluljes suaj dhe drejtohen falë lakueshmërisë suaj.”<sup>393</sup>

Ekziston njëfarë pajtimi dhe pëlqimi mes tipit të sistemit shoqëroro-politik dhe atij të personalitetit. Jo vetëm që personalitetet autoritarë i nevojiten sistemit autoritar, por këtij sistemi i nevojiten personalitete të tillë. Ata plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke. Personalitetet autoritarë e gjejnë sistemin (pjesërisht) në veten e tyre, por ai krijohet edhe përmes proceseve të socializimit dhe manipulimit. Ky është një fakt që teoricienët e manipulimit ose nuk e vënë re fare ose e anashkalojnë duke argumentuar se me veprimin manipulues arrihet vetëm forcimi i qëndrimeve ekzistuese<sup>394</sup>, dhe rrallëherë ndryshimi rrënjësor i qëndrimeve të mëparshme dhe krijimi i qëndrimeve të reja. E vërteta është se marrëdhënia manipuluese ka si rezultat përforcimin e qëndrimeve tek ata individë që me apo pa vetëdije anojnë kah pranimi i këtyre qëndrimeve; kështu që manipuluesi arrin të shprehë atë që ata ndjejnë dhe dëshirojnë të bëjnë.

<sup>392</sup> “...sepse pa gëzuar mundësinë njeriu nuk qaset dot as deri tek ajri...” (Kierkegard, *Bolest na smrt*, botim i veçantë i revistës “Ideje”, Beograd, 1974, f. 30)

<sup>393</sup> Igo, *Čovek koji se smeje*, f. 237.

<sup>394</sup> Vallë, as ky fakt nuk flet për fuqinë e manipulimit? Meqë manipuluesi nuk ia del dot të ndryshojë qëndrimet ekzistuese, kjo nuk do të thotë se mesazhet e tij nuk kanë pasur efekt. Fakti që ai përforcon qëndrimet ekzistuese tregon se mesazhet e tij kanë pasur efekt.

Por, kur thuhet që manipuluesi nuk mund t'i ndryshojë (krijojë) qëndrimet, por vetëm të forcojë qëndrimet ekzistuese, atëherë gjithnjë pandehet se ekzistojnë disa qëndrime të gatshme. Ky supozim është pjesërisht i saktë dhe nuk mund të përmbahet kur është fjala për individët (ose turmën), të cilët ose nuk kanë kurrfarë qëndrimi, ose tashmë i formojnë qëndrimet e tyre për një problem të caktuar publik. Çfarë qëndrimesh të gatshme mund të kenë djemtë apo vajzat që hyjnë në klasat e mësimit? A mund t'i llogarisim qëndrimet e gatshme kur është fjala për brezin e ri? Është fare e qartë se në të dyja rastet tanimë duhen formuar qëndrimet, dhe manipuluesi e shfrytëzon këtë rrethanë pozitive, në mënyrë që të ndikojë nëpërmjet mesazheve në krijimin e atyre qëndrimeve që përputhen me qëllimet e tij.

Pak më lart thamë se sistemi autoritar u nevojitet personaliteteve autoritare, sikundërse personalitetet autoritare i nevojiten sistemit autoritar. Çdo sistem autoritar i paraqet kërkesat e sistemit si vlera, dhe kështu i bën ato tërheqëse për anëtarët e shoqërisë. Nëse sistemi ka nevojë për njerëz të guximshëm, kur i kanoset një rrezik nga armiku i jashtëm, trimëria – në njëfarë mënyre – do kthehet në vlerë. Nëse sistemi çalon vazhdimisht në sigurimin e të mirave materiale, pra kur anëtarët e sistemit i kërcënon uria dhe pasiguria ekzistenciale, puna mund të shpallet si një vlerë kryesore dhe si masë për vlerësimin e njeriut.<sup>395</sup> Nëse sistemi

<sup>395</sup> "Gazetat kryesore, në radhë të parë "Izvestija" dhe "Pravda", duhet që (a) të zvogëlojnë hapsirën që i kushtojnë politikës, duke rritur rubrikën e propagandës së prodhimit; (b) të ndikojnë në punën e përgjithshme të partisë dhe institucioneve sovjetike, në kuptimin e një angazhimi më të gjerë në propagandën prodhuese; (c) të përpiqen që çështja e propagandës prodhuese të vendoset në mënyrë sistematike në përmasa të përgjithshme shtetërore, të përpunohen masat për zhvillimin e saj, përmirësimin, dhe në veçanti për verifikimin e suksesit të saj real, pra sukseseve që realizohen në praktikë." (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 14, Kultura, Beograd, 1960, f. 93)

ndjen nevojën e shitjes së të mirave materiale, sepse kur bie prodhimi është e sigurt se do të ketë krizë të prodhimit, të mirat materiale do të shpallen si vlera pa të cilat jeta nuk ka kuptim. Nëse sistemi ndjen nevojën për nënshtrim, ngaqë i kanoset një përçarje e brendshme, besnikëria kundrejt tij do të shpallet si një veti e dëshirueshme e individit. Nevojat elementare të sistemit përkthehen në vlera të çdo individi të shoqërisë, ndërsa vlera e çdo individi përkthehet në kërkesa të sistemit. “Në zonat më të përparuara të shoqërisë moderne, përkthimi i nevojave shoqërore në nevoja individuale kryhet në mënyrë aq efikase, saqë dallimi midis tyre duket se është vetëm teorik.”<sup>396</sup>

Nëse sistemi veçon disa vlera të caktuara si vlera supreme, atëherë në të njëjtën kohë ai i nxit individët që t’i rrisin këto vlera, sepse ata do e vlerësojnë vetveten në varësi të posedimit të vlerave që ka përkufizuar sistemi. Çdo vlerësim që vjen nga maja e sistemit, përthyeret në mendjet e individëve si qëllimi i jetës së tyre. Vlerat që ka përkufizuar një autoritet kaq i pushtetshëm (sistemi) bëhen kritere të vlerësimit dhe sjelljes individuale.

Në nivelin e qëndrimeve të grupit dhe sjelljeve, manipuluesi synon zbutjen, madje edhe mënjanimin e konflikteve ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Nga njëra anë, manipuluesi e pranon si gjendje normale (dhe si bazë të ekzistencës së tij) pabarazinë shoqërore, ndërsa ana tjetër nuk do që ta pranojë pasojën e domosdoshme të pabarazisë – konfliktet shoqërore. Për këtë arsye ai anon kah ato ide (simbole) që i tejkalojnë interesat e kufizuara të grupeve (klasave), dhe i unifikon ato në nivelin e vetëdijes së përbashkët. Ideja e klasës braktiset në favor të idesë së turmës.

<sup>396</sup> Marcuse, *Çovjek jedne dimenzije*, V. Masleša, Sarajevo, 1968, f. 27.

Në këtë pikë të diskutimit është e udhës të përmenden disa prej ideve më të shfrytëzuara dhe më të rëndësishme, ku me manipulimin e tyre tejkalohen me sukses konfliktet jo vetëm në nivel të vetëdijes grupore, por edhe të sjelljes.<sup>397</sup> “Mjeti i parë është zbatuar më së shumti në epokat parakapitaliste, në veçanti gjatë periudhës feudale, dhe ky mjet ishte religjioni. Me ndihmën e religjionit – siç e kemi parë nga analizat e mëparshme, feja ka qenë tharmi i tradicionalizmit konservator – është arritur uniteti “universal” i “botës perëndimore”. Një tjetër mjet modern ka qenë kombi, më saktë vetëdija kombëtare. Ky mjet është zbatuar në shekullin e kaluar si dhe në këtë shekull<sup>398</sup>.

Vetëdija kombëtare ka shërbyer herë si mbulesë e çlirimit nacional, herë si një mjet tipik për neutralizimin, eliminimin dhe injorimin e dallimeve klasore dhe të interesave brenda një kombi.

Së fundi, kemi mjetin modern, të ashtuquajturin opinion publik, që me anë të një manipulimi të shumëfishtë mund të kontrollohen njerëz dhe të arrihet një shkallë e lartë homogjeniteti në këndvështrimin e vendimeve politike, në mënyrë plotësisht të pavarur nga miratimi apo pjesëmarrja e vërtetë e qytetarëve.

Përfaqësuesit e sociologjisë moderne konservatore, gjithashtu duan që përmes shkencës dhe teknikës, pra me ftesën për objektivitetin e tyre, të arrijnë një nivel të lartë homogjeniteti shoqëror dhe të përjashtojnë nga politika konfliktet për interesa të ndryshme. Pikërisht në këtë drejtim duhet kuptuar ngulmimi i tyre i pandërprerë për deideologjizimin dhe depolitizimin e vetëdijes qytetare dhe jetës po-

<sup>397</sup> Të mos harrojmë se konflikti shpërthen vetëm atëherë kur njerëzit i kuptojnë dhe i përkufizojnë interesat e tyre si të papajtueshme.

<sup>398</sup> Shek. XX.

litike, si një prej fakteve të kohës moderne. Teza teknokratike e sociologjisë konservatore, se shkenca dhe teknologjia objektivisht e bëjnë të tepërt ideologjinë dhe politikën, në të vërtetë nënkupton vetëm vendosjen e shkencës dhe teknikës si ideologji dhe politikë, që është një lëvizje e thjeshtë e parashenjës ideologjike/politike, dhe kurrsesi heqje e ideologjisë si vetëdije e rreme, dhe as eliminim i politikës si tjetërsim i fuqisë shoqërore.<sup>399</sup>

Manipulimi, gjithsesi është një nga teknikat më delikate për eliminimin e konflikteve në shoqëri. Manipulimi do ketë sukses për aq sa interesat e grupeve janë më pak kundërtënëse, si dhe për aq sa qëndrimet e grupeve janë më pak të fuqishme.

Pasoja më e vështirë e manipulimit në nivel të sistemit socio-politik është heqja dorë nga një mori mundësish dhe të reduktuarit e këtyre mundësive në një mundësi të vetme. Në vend të shoqërisë, që si detyrim të përhershëm të vetin vendos ushtrimin e lirisë, domethënë sprovën e mundësisë racionale dhe njerëzore, ne jemi të dënuar që të jetojmë në shoqëri, ku interesi sundues e ka shpallur veten si të vetmen alternativë të arsyeshme dhe të mundur. Në nivelin e jetës ideore dhe ideologjike mund të hasen ende qëndrime të ndryshme dhe të kundërta, kurse në nivelin e jetës praktike realizohet vetëm një mundësi. Privatisht, akoma mund të ndjehet dhe të mendohet ndryshe; publikisht duhet të sillemi ashtu siç e kërkon sistemi. Dallimi midis njeriut privat dhe atij publik nënkupton që institucionet publike shoqërore (sistemi), në radhë të parë janë të interesuara për manifestimin publik (të jashtëm) të individit dhe grupeve, dhe pastaj për qenien e tyre të fshehtë (të brendshme) –

<sup>399</sup> Ljubomir Tadić, *Tradicija i revolucija*, SKZ, Beograd, 1972, f. 182.

ndjenjat, besimet dhe qëndrimet. Nëse njerëzit sillen publikisht ashtu siç e kërkojnë normat institucionale dhe ideologjia, atëherë për grupin në pushtet nuk ka asnjë kuptim mendimi privat/sekret i qytetarëve.<sup>400</sup> Rendi funksionon shumë lehtë, madje edhe në rrethanat kur shumica (në intimitet) ndjehet e tjetërsuar nga kjo mënyrë jetese. Kështu është gjetur formula ideale për funksionimin e sistemit, dhe autonomia e personalitetit të jetë pjesërisht e ruajtur.

“Futja në masën e bindjes”,<sup>401</sup> që është në linjë të intereseve të klasës udhëheqëse, ka pasur për pasojë forcimin e *status quo*-së. “Pra, ia vlen të nënshtrohemi jo vetëm nga frika, por edhe në bazë të ndërgjegjes.”<sup>402</sup>

Këtu kam tërhequr vërejtjen për pasojat themelore të manipulimit, për të cilat vetë manipuluesi është shumë shpesh i vetëdijshëm. Natyrisht që ai nuk duhet të jetë i vetëdijshëm për shumë pasoja të tjera, dhe studimi i këtyre pasojave është një prej detyrave të rëndësishme të sociologjisë së manipulimit. Nën pasojë këtu nënkuptohet çdo ndryshim në ndjenja, bindje, qëndrime dhe sjellje të individëve dhe grupeve, që është shkaktuar nën ndikimin e mesazheve të bindësit dhe është matur pas një intervali kohor të shkurtër apo të gjatë.

<sup>400</sup> Një burokrat mund t’u përmbahet në mënyrë të rreptë normave të institucionale në praktikën e përditshme, por privatisht mund t’i konsiderojë ato si të pakuptimta. Individit mund t’i përmbahet ritualeve fetare, por privatisht të ketë një tjetër bindje për vlerën dhe kuptimin e tyre. Të gjitha shenjat tregojnë se e vërteta ka kaluar në jetën private, dhe në qoftë se ekziston akoma, atëherë ajo është atje. Meqë publikisht sillemi në të njëjtën mënyrë, atëherë studimi i sjelljes së jashtme është i panevojshëm. Interesimi për jetën e brendshme mbetet e vetmja alternativë, sepse në këtë fushë mund të zbulohen dallimet.

<sup>401</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 421. “...ne duhet t’i fusim idetë në turmë.” (Lenin, po aty, f. 422)

<sup>402</sup> *Qarkorja për Romakët*, kap. 13, parag. 5.

Pasojat e manipulimit maten në raport me qëllimin e manipulimit.<sup>403</sup>

Nëse qëllimi i manipulimit është që të shitet sa më tepër një mall i caktuar, nëpërmjet një reklamimi të shkathët (manipulimi merr formën e propagandës ekonomike), atëherë me një krahasim të thjeshtë të gjendjes në shitje para reklamimit me gjendjen pas reklamimit, mund të verifikohet me saktësi se a po e rrit reklamimi konsumin e tij, si dhe për sa është duke ndodhur kjo (kushtet e tjera janë të njëjta).

Nëse qëllimi i manipulimit është shndërrimi i një ideje politike në ideologji udhëheqëse (manipulimi merr formën e propagandës politike), atëherë me metodën e analizës së përmbajtjes mund të masim përafërsisht se në ç'masë ka hyrë në vetëdijen e grupit shoqëror kjo ide. Ndërsa me vëzhgimin ekstensiv mund të verifikohet se në çfarë mase e ka ndryshuar sjelljen e vërtetë të anëtarëve të grupit kjo ide.

Nëse qëllimi i manipulimit është që vlerën e *status quo*-së ta imponojë pa rënë në sy si një ideal demokratik, atëherë me një numër intervistash të orientuara (të thella) me anëtarët e grupit, të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj mesazheve në një periudhë të caktuar, mund të mësohet se sa ka arritur sistemi ekzistues që t'i inkorporojë vlerat e tij si ideale te çdo individ.

Nëse qëllimi i manipulimit është të tërheqë vëmendjen e një grupi nga problemet reale drejt atyre dytësore, ose drejt problemeve të sajara shoqërore (për shembull, problemet e revolucionit social të zëvendësohen me problemet e revolucionit seksual), atëherë mund të dëshmohet me rrugë eksperimentale – kështu që merren dy grupe të barabarta, prej të cilëve njëri nuk ka qenë i ekspozuar ndaj mesazheve

<sup>403</sup> Për matjen e efekteve më së shumti përdoren këto metoda: a) vrojtimi, b) analiza e përmbajtjes, c) intervista e thellë, d) eksperimenti dhe (e) shkallëzimi.

të manipuluesit ndërsa tjetri po – se sa kanë ndikuar këto mesazhe te anëtarët e grupit për të orientuar vëmendjen e tyre te problemet sporadike ose të sajuara, ose problemet e vërteta t'i shtyjnë në plan të dytë në vetëdijen e tyre.<sup>404</sup>

Nëse qëllimi i manipulimit është të shtyjë një grup njerëzish të pranojnë si të vërtetë atë që është konsideruar e rreme<sup>405</sup>, dhe si të rreme atë që e kanë konsideruar si të vërtetë, atëherë me veprime të caktuara krahasuese mes situatës para dhe pas<sup>406</sup> mesazheve mund të shihet suksesi ose dështimi i manipulimit.

Nëse qëllimi i manipulimit është krijimi i një opinionit të vetëm publik (në një shoqëri të ndarë në klasa) në lidhje me një personalitet, grup, institucion, vlerë, ide e kështu me radhë, atëherë me veprime të caktuara teknike mund të verifikohet më saktësi se sa të suksesshme apo të pasuksesshme kanë qenë mesazhet e manipuluesit. Nëse, për shembull, verifikohet se krahas mendimit publik për një çështje ekziston edhe një opinion i fshehur, kjo është një shenjë se manipulimi ka një fushëveprim të kufizuar, se manipuluesi ka dështuar në çrrënjosjen e alternativave në mendim, vlerësim dhe sjellje.

Nëse qëllimi i manipulimit është arritja e një shkalle më të lartë stabiliteti, atëherë me anë të një mënyre të përshtat-

<sup>404</sup> Në këtë rast matja mund të bëhet edhe me metodën e shkallëzimit. (Shih: Đuro Šušnjic, *Kritika sociološke metode*, Gradina, Niš, 1973, f. 293-305)

<sup>405</sup> "E vërtetë dhe e rreme, ajo që flitet për njerëzit shpeshherë ka aq vlerë për jetën e tyre, në veçanti për fatin e tyre, pikërisht sa vetë ajo që ata bëjnë." (Igo, *Jadnici, I, Rad*, Beograd, 1960, f. 13.)

<sup>406</sup> Ndikimi i mesazhit te anëtarët e grupit mund të matet menjëherë pasi mesazhi është bërë i ditur ose pas një kohë të shkurtër apo të gjatë (pas disa ditësh, muajsh). Studiuësit theksojnë të ashtëquajturin "sleeper effect": ndodh që ndikimi i mesazhit, i matur pas një kohe të gjatë, të jetë më i madh se pasi anëtari ka qenë i ekspozuar ndaj mesazhit, ngaqë ndërkohë harresa ka qenë më e madhe. (Shih: M. Karlins and H. I. Abelson, *Persuasion*, Springe New York, 1970, p. 77)

shme matjeje mund të përcaktohet se sa ka arritur sistemi t'i kthejë në bashkëpunëtorë kundërshtarët e tij, si dhe sa ka arritur që qytetarët indiferentë t'i kthejë në mbrojtës të flaktë të *status quo*-së.

Pa hyrë në çështje tërheqëse teorike dhe praktike, si: (a) manipulimi përmes ideve mund të jetë një kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm për ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve, pra kur mesazhet e manipuluesit shkaktajnë pasoja të qëllimshme; (b) manipulimi i ideve nuk mund të jetë kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm i ndryshimit, domethënë ndryshimi do të ndodhë edhe pa veprimin e mesazhit, por me siguri që nuk do kish ndodhur pikërisht në këtë kohë dhe pikërisht në këtë mënyrë; (c) manipulimi i ideve mund të jetë një kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, pra mesazhi i manipuluesit është vetëm pjesë e një pakete kushtesh, që të marra në tërësi shkaktajnë ndryshimin e qëndrimeve apo të sjelljeve; (d) manipulimi nëpërmjet ideve mund të jetë kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, pra mesazhet e manipuluesit mund të shkaktajnë ndryshim në qëndrime ose sjellje, por të njëjtin ndryshim mund të shkaktajnë edhe kushtet e tjera<sup>407</sup> – mund të themi se manipulimi kontribuon për krijimin e mendimit njëdimensional<sup>408</sup> dhe autoritar të sjelljes së njëanshme dhe autoritare; për ndryshimin e strukturave të nevojave; për afrimin e turmës me sistemin vlerësues të manipuluesit; për largimin e konflikteve, për heqjen dorë nga liria në jetën

<sup>407</sup> Shih: C. Seymour-Ure, *The Political Impact of Mass Media*, Constable, London, 1974.

<sup>408</sup> Që mediat masive nuk ndikojnë në homogenizimin dhe në pasivizimin e masave, por në krijimin e një identiteti të ri, këtë e pohon Benjamin D. Singer, në vepërën "Mass Society, Mass Media and Minority Identity", in *The British Journal of Sociology*, no 2, 1973, pp. 140-148.

publike<sup>409</sup>, për përmbajtjen dhe forcimin e *status quo*-së, për efikasitetin e kontrollit shoqëror etj.

Prej të gjitha pasojave për të cilat jemi të vetëdijshëm sot, të cilat i shkakton transmetimi i vazhdueshëm i simboleve të mirëpërzgjedhura nga qendrat e fuqisë ekonomike dhe politike, me siguri që më e rënda është ajo që godet mendimin dhe vullnetin njerëzor. Në veprën *Studimi i historisë*, Toynbee tërheq vëmendjen pikërisht për këtë pasojë: “Qëllimi i «konformizmit» është përpjekja që qeniet njerëzore të heqin dorë një herë e mirë nga ajo që mendojnë dhe pretendojnë, duke qenë se kjo aftësi është bash ajo që na bën njerëz, për mirë apo për keq qoftë. Kurse “të përshtaturit” është orvatje për të shkatërruar natyrën njerëzore.”

Ashtu si rrezet e dritës, që prej një distance të largët nga yjet mbërrijnë me vonesë në sytë e vëzhguesit, asohere kur yjet janë zhdukur dhe ndoshta rrezet e dritës janë shuar në gjerësinë e yjeve, po ashtu edhe mesazhi i mashtruesve shpirtërorë, sidoqë ata mund të kenë vdekur, sillet vërdallë nëpër hapësirën shoqërore duke u ngjitur e duke vepruar mbi zemrat dhe shpirtat e njerëzve, jashtë kornizave të parashikuara prej tyre. Mesazhet e tyre jetojnë edhe pse ata mund të kenë vdekur prej kohësh. Ata janë akoma të aftë që të kryejnë vrasjen shpirtërore të qenieve të pafajshme.

Nëse do të ishte e mundur që grupi në pushtet të kontrollonte dhe manipulonte botën shpirtërore të njeriut në mënyrë të suksesshme, siç e bën këtë me botën materiale, atëherë me të vërtetë që do i afroshim atij vizionit të keq

<sup>409</sup> Nëse manipuluesi arrin të ndryshojë qëndrimin e pesë vetëve në një grup prej njëqind vetësh, ne themi se ka ushtruar një ndikim parësor; por, zakonisht harrojmë se këta pesë njerëz do përpiqen që ta përhapin qëndrimin e ri edhe mbi të tjerët, dhe kështu të shkaktojnë efekte dytësore, që në analizat e deritashme janë anashkaluar.

për shoqërinë që ka paralajmëruar Huxley në veprën *Brave New World*: “Njerëzit qëndrojnë në radhët e gjata duke pritur racionin e tyre me tru dhe mend. Ata e marrin atë nga duart e pushtetit, njëri pas tjetrit, dhe të mbuluar me mirëqenie e të lumtur largohen nga radha. Askush nuk shtron pyetje, askush nuk rebelohet.”

Një pamje më të errët e njëkohësisht edhe shpresë jep për njeriun J. Zamjatin në romanin *Ne*: “Dje u mbajt Dita e Unanimitetit, një ditë që e prisnin të gjithë me padurim. Për të dyzetetetën herë u zgjodh njëzëri ai, i njëjti, Bamirësi, i cili e ka provuar shumë herë mençurinë e tij të paluhatshme. Kremtimi u shoqërua me njëfarë tollovie, të cilën e shkaktuan armiqtë e fatit, të cilët në mënyrë të natyrshme i hoqën vetes të drejtën për t’u bërë tulla në themelet e Shtetit Unik, i cili u rinovua dje. Për çdokënd është e qartë se marrja parasysh e votave të tyre do të ishte gjithashtu e pakuptimtë, sikurse do të merrej si pjesë e simfonisë heroike kollitja e të sëmurit, i cili ndodhet rastësisht në sallën e koncertit...”



**PJESA E TRETË**  
**Fushat dhe zbatimi**



## VETITË E SHOQËRISË CIVILE

Puna që synon të jetë një analizë e ngjeshur socio-psikologjike e shfaqjes së manipulimit, nuk mund të analizohet vetëm teorikisht, por duhen gjurmuar lidhjet empirike midis shfaqjes dhe rrethanave socio-psikologjike ku paraqitet manipulimi. Kjo do të thotë që vështrimi mbi shfaqjen e manipulimit është një vështrim i drejtpërdrejtë mbi tipin e shoqërisë ku manipulimi mund të praktikohet përgjithësisht si formë raportesh shoqërore. Me fjalë të tjera, *kritika e manipulimit duhet të shtrihet edhe në kritikën e asaj shoqërie ku është i mundur manipulimi i njerëzve.*

Shoqëria civile moderne, i rrënjos vetitë e saj në atë që ndjejmë, mendojmë dhe si mendojmë; në atë që themi dhe që nuk themi; në atë që besojmë dhe atë që nuk e besojmë; në atë që bëjmë dhe në atë që nuk bëjmë. Pikërisht për këtë, një analizë e shkurtër e vetive bazë të shoqërisë moderne civile është e pashmangshme.

Shoqëria civile moderne është një shoqëri e ekonomisë së tregut, dhe në këtë shoqëri vlerat materiale janë në një nivel më të lartë se ato shpirtërore, pasi të parat prodhohen falë këtyre të fundit. Në këtë shoqëri gjithçka prodhohet dhe gjithçka blihet, duke filluar që nga kanoçet e deri te njëqind llojet e “qeshjeve të konservuara”.<sup>410</sup> Në treg mund të ofrohen të gjitha: që nga trupi deri te shpirti.<sup>411</sup> Në konkurrencën e pakursyer, i dobëti humb, ndërkaq i forti fiton

<sup>410</sup> Vans Pakard, *Industrija svesti*, Skriveni ubedjivači, Sedma sila, Beograd, 1967, f. 182.

<sup>411</sup> Fromm, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 161.

(profiti). Ai që fiton si tregtar, humb si njeri, sepse fuqinë dhe lumturinë e tij e ngre mbi pafuqinë dhe paaftësinë e tjetrit.

Pra, çfarë është lumturia për njeriun bashkëkohor? Pikërisht fuqia për të blerë dhe për të shpenzuar, që gjithnjë “të ketë diçka të re, që njeriu të rrojë vazhdimisht me gojën hapur”.<sup>412</sup> Paraja dhe suksesi – këto janë simbolet e lumturisë, të cilat që “nga djepi e gjer në varr” mbillen në mënyrë sistematike te njeriu modern.

Që masa mall-para ka depërtuar në çdo raport njerëzor nuk është fare e nevojshme të provohet.<sup>413</sup> Mjafton të veçojmë vetëm një detaj nga fushatat parazgjedhore, ku një kryetar partie politike flet për kandidatin e vet si një prodhim që duhet shitur, ngaqë e kërkon tregu! “Të mësuar që të cytin popullin për të blerë gjithçka që i mjaftojnë paratë, po një-lloj mendojnë edhe për idetë politike dhe për liderët politikë. Ata shfrytëzojnë televizionin për t’i bërë reklamë personalitetet politike, ashtu siç reklamojnë edhe sapunin. Ajo që është e rëndësishme, në të vërtetë është pasojë, si në shitje ashtu edhe në votim, e jo racionaliteti apo dobia e asaj që afrohet.”<sup>414</sup> “Për shumicën e njerëzve, trëndafil nuk është më trëndafil, por një lule me një çmim të caktuar që blihet në rrethana të caktuara sociale. Madje edhe lulja më e bukur, edhe në qoftë e egër, që nuk kushton asgjë, nuk përjetohet si një lule e bukur në krahasim me trëndafilin, pasi ajo nuk ka një vlerë monetare në qarkullim.”<sup>415</sup>

<sup>412</sup> Po aty, f. 142-3.

<sup>413</sup> Shih analizat e shkëlqyera të Marx-it, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 255-260.

<sup>414</sup> Fromm, po aty, f. 186.

<sup>415</sup> Po aty, f. 125.

“Kjo është vënë si bazë e tjetërsimit, ku çdo sferë vendos për mua një masë tjetër e të kundërt, dhe secila syresh fikson një rrjet të veçantë veprimi për tjetërsimin e qenies; secila sillet në mënyrë tjetërsuese ndaj një tjetërsimi tjetër.” (Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 242)

Vlera e tregut është masë vlerësimi për çdo rast: kur është fjala për të bindur masat për vlerën e njeriut (politika); kur është fjala për të bindur masën për vlerën e gjërave (reklama); kur është fjala për të bindur masën për vlerën e idesë (indoktrinimi); kur bëhet fjalë për bindjen e masës në lidhje me vlerën e besimit (predikimi fetar). Në një formë apo në një tjetër, ideja e tjetërsimit është vendosur në themel të botës qytetare. Ajo është e pranishme në të gjitha fushat e jetës.

Në një lidhje të ngushtë me karakteristikën e parë të shoqërisë moderne civile është edhe vetia e dytë: shoqëria e ndarjes së pabarabartë të pasurisë, pushtetit, autoritetit, dijes etj. Në një shoqëri ku vlerat shoqërore ndahen në mënyrë të pabarabartë nuk mund të ketë një kod pajtues për çështjet bazë të jetës sociale, dhe për këtë arsye, konfliktet sociale (manifestive apo latente) janë shoqërueset e përherëshme të jetës së përditshme.<sup>416</sup>

Shoqëria nuk ka pasur asnjëherë kaq shumë pasuri, pushtet dhe dije siç ka sot. Por, si kurrë më parë, shoqërinë e kanë përçarë dyshimet e thella në pikëpamjen e ndarjes së kësaj pasurie, pushteti dhe dijeje.

Përderisa këto dyshime nuk zgjidhen me praktikën historike (në teori kryesisht janë të zgjidhura), ne do vazhdojmë të hasim shoqëri që zhvillojnë procesin e centralizimit të fuqisë ekonomike, politike, ushtarake dhe profesionale.<sup>417</sup>

<sup>416</sup> Pjesëtarët e shoqërisë, edhe pse politikisht dhe para drejtësisë janë të barabartë e të lirë, nuk kanë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në sjelljen, zbatimin dhe kontrollin e vendimeve politike (as të ligjet), që do të thotë se elita sunduese e bën politikën dhe të drejtën në harmoni me interesat e saj.

<sup>417</sup> "Çod hap para i shkencës dhe teknikës minon pashmangshëm bazat e prodhimit të vogël në shoqërinë kapitaliste." (Lenin, *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960, vëll. 6, f. 394)

Nëse kësaj i shtohet edhe *monopoli mbi informacionet me rëndësi* si burim bazë i fuqisë shoqërore, atëherë kemi përmendur edhe cilësinë e tretë të shoqërisë civile moderne.

Në numërimin e vetive bazë të shoqërisë civile moderne nuk mund të anashkalohet fakti se kjo *shoqëri ka një shkençë mjaft të zhvilluar (teknologjia), e cila ka arritur të krijojë një shprehje të racionalitetit, domethënë racionalitetin funksional.*

Racionale është gjithçka që ndihmon përmbajtjen, zhvillimin dhe stabilizimin e sistemit ekzistues. Për shembull, informacionet që emetohen në masë rrallëherë vlerësohen nga këndvështrimi i përmbajtjes së tyre; pra, nuk është e rëndësishme se a janë të vërteta apo gënjeshtër, morale apo të pamoralshme, të vyera apo pa vlerë – ato vlerësohen vetëm sipas pasojave që shkaktojnë (në masë). Nëse këto pasoja janë në përputhje me interesat e grupit të pushtetshëm, ky është një justifikim i mjaftueshëm që informacionet janë në rregull. Kjo “lojë me të vërtetën”<sup>418</sup> bën qesharake çdo pyetje se ç’është e vërteta. Pyetja serioze është: “Çfarë arrijmë nëse këtë apo atë e pranojmë si të vërtetë?”<sup>419</sup> “Mashtrimi që na glorifikon”<sup>420</sup> na sjell më tepër dobi se çdo e vërtetë tjetër.

Shoqëria civile moderne nuk do të ishte e tillë siç është sot nëse mediat masive nuk do të impononin format e reja të frekuentimit. Ballafaqimet e drejtpërdrejta “sy më sy” ndërrohen me to në distancë, dhe njerëzit e humbasin ndjenjën për të komunikuar me personalitete, dhe nga ana tjetër fitojnë ndjenjën se po komunikojnë me statuset dhe funksionet.

<sup>418</sup> Lenin, po aty, vëll. 9, f. 88.

<sup>419</sup> Krahaso: L. Kolakovski, *Filozofija pozitivizma*, Prosveta, Beograd, 1972.

<sup>420</sup> Lenin, po aty, vëll. 8, f. 326; J. Henry, *Culture Against Man*, Vintage Books, New York, 1965.

Edhe në raport me mediat masive, vlen ligji bazik i shoqërisë – ai i xhunglës. Ai grup shoqëror që zë pozitën më të lartë në pushtet dhe privilegje do ketë më shumë ndikim në të ashtuquajturat mjete të informimit masiv; kështu që, nëpërmjet tyre, ky grup do i imponojë pjesës tjetër të shoqërisë përkufizimet edhe shpjegimet për zgjidhjen e problemeve politiko-sociale. Nuk është e vërtetë që mediat masive kanë pushtet në përzgjedhje, bashkim, përhapje dhe kontroll mbi botën e simboleve (informacioneve): sipas rregullit, mediat masive janë nën kontrollin e elitave sunduese, të cilat përzgjedhin, përhapin dhe kontrollojnë simbolet dhe pasojat e tyre.<sup>421</sup> Bie dakord me vlerësimin e një teoricieni të mediave: “The meaning system of the dominant group provides the dominant meaning system for the society as a whole.”<sup>422</sup> Mediat masive krijojnë vlera dhe në të njëjtën kohë pengojnë krijimin dhe përhapjen e atyre vlerave të cilat bien në kundërshtim me ato të klasës sunduese. Mendimi sundues cek dhe përsërit mendimin se interesat e shoqërisë janë mbi interesat e kufizuara të grupit, dhe kështu fshihet fakti se është po ky që e imponon interesin e kufizuar si të vërtetën e vetme.

Ajo që nuk u është shmangur studiuesve të shoqërisë civile moderne është karakteristika në vijim: kjo është një

<sup>421</sup> Mediat masive duhet të shihen në kuadër të sistemit të përgjithshëm ekonomik dhe politik, nëse duam të kemi të qartë vendin dhe rolin e tyre në këtë sistem. Është e qartë se pasojat sociale të mediave masive varen, fjala vjen, prej sistemit të pronësisë dhe kontrollit (a është i ligjshëm dhe politik kontrolli? a bëhet nëpërmjet ligjit, censurimit apo është vetëm ekonomik?, që do të thotë se janë pronarët ata që e përcaktojnë përmbajtjen dhe masën e mesazhit, ose siç është rasti i rrallë: mediat masive kanë status shoqëror). Mediat janë gjithnjë e më pak autonome dhe gjithnjë e më shumë të varura.

<sup>422</sup> G. Murdock, “Mass Communication and the Construction of Meaning”, in *Reconstructing Social Psychology*, ed. by N. Armistead, Penguin, 1974, p. 206.

shoqëri që e ka zhvilluar shumë ndarjen e punës dhe specializimin e funksioneve, dhe kjo ndarje përsëri shkaktohet nga një mori pasojash të rëndësishme sociale. Për çështjen me të cilën po merremi këtu na duhet të përmendim vetëm varësinë e specialistit nga autoritetet e tjera, mungesën e përvojës vetjake në fushat jashtë profesionit dhe këmbimin e kësaj përvoje me simbolet abstrakte, rënien e interesit për të kuptuar tërësinë dhe rënien e interesit për të qenë i përgjegjshëm (pasi edhe përgjegjshmëria ndahet).

Nën ndikimin e ndarjes së punës dhe specializimit të funksioneve, zhvillohet një proces i fuqishëm i dinamikës shoqërore, si horizontal ashtu edhe vertikal. Kjo karakteristike e shoqërisë civile moderne interpretohej si shenjë e demokratizimit të shoqërisë, por një analizë më e thellë tregon se transparenca e strukturave shoqërore nuk ka kurrfarë lidhjeje me shkallën e demokracisë së sistemit. Sistemi duhet të plotësojë një numër të madh rolesh dhe funksioneve, nëse mendon se është duke funksionuar në mënyrë efikase; por këto plotësime nuk e ndryshojnë karakterin e sistemit, sepse dinamika e lartë shoqërore është vënë re si te sistemet demokratike, ashtu edhe tek ato jodemokratike.

Si përfundim mund të themi se shoqëria civile moderne i ka rrënjësuar botëkuptimet e saj në karakteret e anëtarëve të saj. "Anëtarët e shoqërisë, klasat apo shtresat e ndryshme në këtë botë moderne, duhet të sillen në atë mënyrë që kërkon sistemi shoqëror. Funkzioni i karakterit shoqëror është të rregullojë energjinë e anëtarëve të shoqërisë, që sjelljet e tyre të mos jenë rezultate të një sjelljeje të vetëdijshme për faktin se a duhet të ndjekin apo të e mos e ndjekin modelin shoqëror, por që çështja e dëshirës të veprojë, ashtu siç edhe duhet të veprojë, e në të njëjtën kohë ata të gjejnë kënaqësi-

në duke vepruar sipas kërkesave të kulturës. Me fjalë të tjera, karakteri shoqëror ka funksion t'i japë formë dhe ta kanalizojë energjinë njerëzore në kuadër të një shoqërie të caktuar, me qëllim funksionimin e pandërprerë të shoqërisë.

U desh që njeriu të formohej si personalitet, duke shpenzuar energjinë e tij në punë, për të arritur disiplinë, e në veçanti i është dashur vënia e rregullit dhe saktësia, deri në një shkallë të panjohur për kulturat e mëparshme. Domosdoshmëria e punës, saktësia dhe rregulli duhet të shndërrohen në impuls të brendshëm për të arritur caqe të reja. Kjo do të thotë se shoqëria duhet të prodhojë një karakter të atillë social, te i cili ky impuls do të ishte i lindur (i natyrshëm).<sup>423</sup>

Ajo shoqëri që mbështetet te këto parime – parimi i ekonomisë së tregut, parimi i pabarazisë shoqërore (jo juridike), parimi i racionalitetit funksional, parimi i informimit masiv, parimi i zhvilluar i ndarjes së punës dhe specializimit të funksioneve, parimi i dinamikës së fuqishme shoqërore dhe parimi i përshtatshmërisë – duhet t'i zhvillojë të gjitha raportet e saj, që domosdoshmërisht burojnë prej parimeve të lartpërmendura, dhe duhet të bëjë llogari për pasojat që ka çdo individ i kësaj shoqërie.

Tani është koha të tregojmë se si manifestohen praktikisht në pesë fusha të jetës parimet ku mbështetet shoqëria civile moderne<sup>424</sup>: në fushën *ekonomike*, ku manipulimi (i

<sup>423</sup> E. Fromm, po aty, f. 95.

<sup>424</sup> "Shoqëria civile përfshin të gjithë lëvizjen materiale të individit, brenda një niveli të caktuar të zhvillimit të fuqive prodhuese. Ajo përfshin një jetë të tërë tregtaro-industriale të një shkalle të caktuar, që i tejkalon kufijtë e shtetit dhe kombit, edhe pse në anën tjetër, parë nga jashtë, kjo shoqëri duhet të theksojë anën kombëtare. Ndërkaq nga brenda duhet të organizohet si shtet-komb. Termi "shoqëri civile" u shfaq në shekullin e tetëmbëdhjetë, atëherë kur marrëdhëniet tashmë ishin tërhequr prej bashkësisë antike dhe mesjetare. Shoqëria civile si e tillë, së

konsumatorëve) merr formën e reklamës; në fushën *politike*, ku manipulimi (i votuesit) merr formën e propagandës; në fushën *pedagogjike*, ku manipulimi (i nxënësit dhe studentit) merr formën e indoktrinimit; në fushën *e kohës së lirë*, ku manipulimi (i shijeve) merr formën e industrisë së argëtimit dhe të realizimit të ëndrrave; si dhe në fushën *e jetës religjioze*, ku manipulimi (i besimtarëve) merr formën e predikimeve fetare.

Këto janë ato fusha ku të vërtetat për njeriun kthehen kundër tij.

## REKLAMA<sup>425</sup>

*“Historianët dhe arkeologët, një ditë do zbulojnë se shpalljet e kohës sonë janë manifestimet më të pasura dhe më të besueshme që mund të bëjë një shoqëri. Në këtë drejtim, hieroglifet egjiptiane mbeten shumë prapa.”*

Marshall McLuhan

Ekspertët e reklamave (ose të propagandës ekonomike) janë të mendimit se çdokujt mund t'i shitet gjithçka, me kushtin që prodhimet të reklamohen në një mënyrë të rreptë shkencore. Suksesi në shitjen e prodhimit nuk ka një lidhje të rëndësishme me vetitë e prodhimit – ky është thjesht një truk psikologjik i shfrytëzuar me shkathtësi.<sup>426</sup>

Kur të shkruhet libri i historisë së ekonomisë së shekullit XX, një kapitull më vete i duhet kushtuar qasjes psikologjike në treg. Ekspertët modernë të tregut, sot japin shembujt bazë që duhet të ndjekin ekspertët e së ardhmes.<sup>427</sup>

### **Kontrolli i tregut nëpërmjet kontrollit të nevojave të konsumatorit**

Reklamata shpërndahen gjithkund, madje kësaj flame nuk i ka shpëtuar as qielli. Atyre që nuk besojnë te fuqia e

<sup>425</sup> Termi “reklamë” vjen nga fjala latine *reclamare*, që do të thotë të bërtasësh, të thërrasësh (blerësit), që të thurësh lavde në publik (për mallin). Shih: M. Vujaklija, *Leksikon stranih reči i izraza*, Prosveta, Beograd, 1970.

<sup>426</sup> McLuhan-i e ka pikasur mirë: “Fama nuk është rrjedhim i faktit se dikush bën diçka, por thjesht vetëm të dihet se ai është shumë i njohur.” (*Poznavanje opštita*, f. 325)

<sup>427</sup> Vans Pakard, *Industrija svesti*, Sedma sila, Beograd, 1967, f. 191.

reklamës, që ajo zgjeron tregun, shet më tepër mallra dhe rrit fitimin, u duhet provuar praktikisht se pa reklamim, duke i lënë gjërat në varësi të nevojave dhe shijeve të konsumatorëve, shitja do të ishte më e pakët.

Megjithatë, që reklama nuk është më shumë se “një marrëzi që kushton”<sup>428</sup>, e provojnë praktikisht ata që shpenzojnë shumë për reklamimin e prodhimeve të tyre, që rrethohen nga ekspertë të paguar mirë, të cilët, sapo verifikojnë se ecuria e shitjeve është në rënie, e këshillojnë prodhuesin që të ndryshojë diçka te vetitë dytësore të prodhimit (formën, ngjyrën, paketimin etj.), ose të ndryshojë mënyrën e reklamimit.

A fshihet në këtë mes fakti i zakonshëm se prodhimet reklamohen më shumë se ç’mund t’i shohë një “mendje e shëndoshë”?

Ai që reklamon mallin nuk na e thotë hapur që të blejmë prodhimet e tij, sepse kjo është një mënyrë e sigurt e pasurimit të tij, por vetëm sa na bind që prodhimet e tij janë të domosdoshme për ne për të plotësuar nevojat. S’ka asnjë dyshim se ai e vendos në plan të parë interesin e tij, por fillimisht na bind se është duke punuar për interesin tonë. Ai rrotullon radhën e interesave. Ky rrotullim arrin kulmin me deklaratat populiste, të cilat i kanë marrë si të vërteta edhe disa mendimtarë seriozë – “heroin e prodhimit e zëvendëson heroi i konsumit”; “prodhimi nuk është më i rëndësishëm se konsumi”; “kapitalizmi është i vdekur – konsumatori është mbret”; “Bota është vend i volitshëm për blerje”.<sup>429</sup>

Njëmend që bota është një vend i volitshëm për blerje – iluzionesh. Konsumatori blen dhe kënaqet me iluzionin e bukur se është heroi i epokës sonë, se prej nevojave dhe shi-

<sup>428</sup> “Reklamimi shpaguehet për aq sa rritet përfitimi.” (J. K. Galbraith, *Economics and the Public Purpose*, A Signet Book, New York, 1975, p. 135)

<sup>429</sup> Hemingway, *Sunce se ponovo rađja*, Matica srpska, Novi Sad, 1967, f. 163.

jes së tij varet ajo që do prodhohet; si do duken prodhimet dhe në ç'mënyrë do konsumohen. Heroi ynë mendon se prodhimi i nënshtrohet konsumit. Heroi ynë nuk sheh se ç'fsheh fakti i thjeshtë që prodhimet reklamohen, dhe kjo ngaqë prodhuesit shpenzojnë një sasi të madhe të kapitalit për imponimin e vullnetit të tyre ndaj konsumatorëve, pra nëpërmjet reklamës. Reklamimi i prodhimeve përputhet me qëllimet bazë të sistemit të kontrollit të tregut. Duke kontrolluar nevojat e konsumatorëve, – përmes shumë njësiveve për studimin e tregut dhe njohjes së nevojave – prodhuesit bëjnë kontrollin specifik të tregut duke kontrolluar nevojat e konsumatorëve. “Vertrauten ist gut, Kontrolle is besser!” “Kështu fut hundët një i treti dhe i rrafshon vendimet tona në mënyrë të padukshme.”<sup>430</sup>

### **Nga plotësimi i nevojave drejt krijimit dhe shfrytëzimit të tyre**

Njerëzit janë mësuar të mendojnë se çdo gjë (e re) ka si qëllim kryesor të kënaqë një prej nevojave të tyre. Ata nuk janë mësuar të mendojnë siç mendon ai që reklamon: për reklamuesin, gjëja e re e ka një qëllim, që është shitja, pavarësisht plotësimit apo jo të një nevoje njerëzore. Nëse një artikull i ri nuk i përgjigjet nevojës, nuk ka ardhur akoma çasti që të mendohet për ndërprerjen e prodhimit të tij, por kalohet në shpikjen e nevojës që ai mund të plotësojë. “Thuhet se gjërat e domosdoshme janë ato të cilat shpeshherë janë të tepërta.”<sup>431</sup>

<sup>430</sup> Vladan Desnica, *Proljeće Ivana Galeba*, SKZ, Beograd, 1967, f. 172. Për kontrollin e tregut shih: O. Negt und A. Kluge, *Öffentlichkeit und Erfahrung. Zur Organisationsanalyse von bürgerlicher und proletarischer Öffentlichkeit*, Suhrkamp, Frankfurt am Main, 1972, f. 216-17.

<sup>431</sup> Günter Grass, *Lokalna anestezija*, f. 239.

Meqë në vazhdim nuk prodhohet për nevojat e duhura, por vetëm për të shitur, – “një konsum që nuk mbulon nevojat e njerëzve, por të kapitalit”<sup>432</sup> – është e nevojshme që të gjenden blerës të aftë kudoqoftë e sidoqoftë, sepse nëse produkti prodhohet më shpejt seç konsumohet, sigurisht që do ketë çrregullime (kriza). Që të shmangen çrregullimet, sistemi duhet t’u rrisë qiradhënien punëtorëve (në fakt, të gjithë të punësuarve), tek të cilët sheh blerësit e sigurt të prodhimit. Nëse më përpara sistemi ua rriste qiradhënien punëtorëve ngaqë ushtronin një presion të pandërprerë, – presion ekonomik në formë greve, politik përmes sindikatës, moral përmes ideologëve të tyre, psikik përmes opinionit publik – sot, me logjikën e brendshme të zhvillimit (“prodhimi për nevoja i lë vendin prodhimit për të shitur”<sup>433</sup>), sistemi është detyruar ta rrisë sërish qiradhënien për të punësuarit meqë tek ata gjen masën e blerësve. “Kundërtitë në mënyrën kapitaliste të prodhimit: punëtorët janë blerësit më të rëndësishëm të mallit në treg. Por, si shitës të mallit të tyre, – fuqisë së tyre punëtore – shoqëria kapitaliste ka prirjen t’i kufizojë ata në minimumin e çmimit të tyre.”<sup>434</sup>

Duke qenë se prodhimi i mallit është i orientuar te shitja si qëllim kryesor, dhe jo për përmbushjen e nevojave reale, prodhimi llogarit blerësit e mundshëm, jo të varfrit.<sup>435</sup>

Sistemi vendos që punëtorët t’i shndërrojë në konsumatorë, në mënyrë që aq sa ia rrit qiradhënien, në varësi të

<sup>432</sup> Lenin, *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960, vëll. 3, f. 15.

“Shitja është një praktikë tjetërsuese.” (Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 71)

<sup>433</sup> Po aty.

<sup>434</sup> Marx, *Kapital*, II, Kultura, 1947, f. 271 (nënvizim i Gj. Sh.).

<sup>435</sup> “...ndërkaq shitja e mallit, realizimi i kapitalit, pra edhe teprica e prodhimit janë më shumë të kufizuara nga nevojat e konsumatorëve në përgjithësi sesa nga nevojat e konsumatorëve të një shoqërie të caktuar, shumica e së cilës ka qenë përherë e varfër dhe duhet të ngelet e tillë.” (Marx, po aty)

nevojave të sistemit duhet të bëhet edhe shitja e mallit. Kjo sepse “gjithçka që blen klasa punëtore është e barabartë me shumën e qiradhënies, baras me shumën e kapitalit të ndryshuar, të dhënë më parë si qiradhënie mbarë klasës kapitaliste. Këto para i kthehen klasës punëtore me shitjen e prodhimeve, që në fakt janë prodhime të vetë punëtorëve”.<sup>436</sup>

Me rritjen e qiradhënies rritet prodhimi jo vetëm i atij malli që përmbush nevojat reale të punëtorëve, por edhe ai që konsiderohet mall luksi.<sup>437</sup> Që nga ky çast, shitja e prodhimeve nuk varet vetëm prej nevojave të domosdoshme<sup>438</sup>, por edhe nga ato artificiale apo të luksit.

Tani do marrim disa raste dhe me anë të tyre do zhvillojmë bazën socio-psikologjike të reklamës.

“Makinën e vogël e blen njeriu i vogël.” Çfarë synohet me këtë reklamë dhe ç’mund të lexohet tek ajo?

Fjala “blen” shpie drejt marrëdhënies mall-para, që është karakteristike e një organizimi të veçantë shoqëror, ashtu si këmisha e mbrojtur në mënyrë speciale mund të tregojë për një tip të veçantë shoqërie (feudale).

<sup>436</sup> Po aty, f. 301.

“Se çmimi është i lidhur disi me vlerën, që jomoraliteti i tregtimit të mos dalë fort në sipërfaqe.” (Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 98)

<sup>437</sup> “Te konsumi i punëtorëve, më shumë se kurrë më parë hyn prodhimi luksoz.” (Marx, *Kapital*, II, f. 294) “Punëtori këtu vepron si shitës i mallit të vet, fuqisë punëtore, ndërsa kapitalisti si blerësi i këtij malli. Nga ana tjetër, te shitja e mallit është përfshirë edhe blerja e tij nga ana e klasës punëtore, pra konsumi individual. Në këtë rast klasa punëtore ka pozicionin e blerësit, ndërsa kapitalistët janë si prodhuesit e mallit, një mall ky që i dedikohet punëtorëve.” (Po aty, f. 305)

<sup>438</sup> “Në kulturat e pazhvilluara, si rregull, nuk prodhohet diçka që është e panevojshme: gjësendet prodhohen kur janë të nevojshëm. Ka përputhshmëri ose komplementarizëm midis asaj që prodhohet dhe asaj që dëshirohet, madje edhe nga pikëpamja e kohës. Kjo kontribuon edhe për stabilitetin e madh të kulturës së pazhvilluar. Këtu mjeshtri prodhon për tregun konkret që ai njih, pa synuar ta zgjerojë prodhimin dhe të krijojë dëshira të reja, me ndonjë formë reklamimi apo me shkathësi tregtare. Në kulturën e pazhvilluar merret e mirëqenë që dëshirat dhe prodhimi nuk do ndryshojnë.” (J. Henry, *Culture Against Man*, Vintage Books, New York, 1965, p. 8-9)

Fjalët si “njeriu i vogël” nuk kanë të bëjnë kurrsesi me rritjen natyrore të njeriut, por me gjendjen sociale që ka në hierarkinë shoqërore. Shprehje të tilla çojnë drejt një gjendjeje të dobët shoqërore dhe një distance socio-politike ndaj “njeriut të madh”.

Shprehja është e padukshme, e megjithatë shënjon mundësinë që “njeriu i madh blen makinë të madhe”. Pothuajse askush nuk ka dëshirë të tregojë se është “njeri i vogël”, prandaj dhe përpiqet që të dëshmojë se nuk është i tillë. Kurse me argumentin për blerjen e makinave të mëdha është gjetur “karremin psikologjik”.

Makina flet se kush jemi dhe çfarë synojmë të jemi. Ajo është simboli lëvizës i personalitetit dhe pozitës sonë sociale; është forma më e thjeshtë për të shfaqur me saktësi pozicionin tonë social.<sup>439</sup>

Më e rëndësishmja në gjithë këtë është se vetitë e gjërave janë të lidhura në mënyrë mizore me vetitë sociale dhe psikologjike të personalitetit. Kënaqësia më e madhe me rastin e blerjes së një makine të shtrenjtë është se ajo i jep blerësit “ndjenjën e ripërtërirë të pushtetit, duke i rikonfirmuar edhe burrërinë, dhe kjo është një nevojë emocionale, që një makinë e lirë nuk është në gjendje ta përmbushë.<sup>440</sup> Nëse për ndonjë tip të veçantë makine thuhet se është e dalë mode, ekscentrike, e keqe, e vogël etj., për pasojë të gjitha këtotribute të makinës i kalojnë edhe pronarit të saj, dhe kështu ai ndjen presionin e opinionit publik, duke pritur me padurim blerjen një makinë të re e të shtrenjtë. Fraza “makinë e vogël” ka të bëjë me gjërat, por ato kalojnë edhe te njeriu.

Gjuha e reklamës kurorëzon dy gjëra (idetë, paraqitjet, ndjenjat, vetitë) të cilat mund të ngelen përherë të panjohu-

<sup>439</sup> V. Pakard, po aty, f. 50.

<sup>440</sup> Po aty, f. 75.

ra për njëra-tjetrën. Ideali i lirisë lidhet me konsumin e Pepsit: “Ky është popull i Pepsit, që ndjehet i lirë, i lirë...” Ndjenja e patriotizmit, në mënyrë ta papritur, vendos marrëdhënien prekëse me prodhimin e duhanit te reklama “Tym krenar. Prodhim i një vend krenar. Duhan.” Gjithashtu, kjo është krenari e traditës amerikane, ashtu si Statuja e Lirisë. Ndërmarrjet Liggett dhe Mayers kanë nxjerrë nga duhani cigaren që është pjesë e kësaj tradite. Festimi i dyqind-vjetorit të Amerikës nuk mund të kalojë pa u shfrytëzuar prej botës afariste. “Kontributi ynë në frymën e 1776-s (reklamon zgarën e një pronari energjik të një restoranti të vogël): ne i kushtojmë qoftet e shijshme dyqind-vjetorit të Amerikës. Vetëm shtatëdhjetë qindarka, pa tatim.”<sup>441</sup>

Këto nuk janë lajmërimi të thjeshta për atë çfarë synohet të shitet. Shitja e këtij malli justifikohet me idealet më të larta shoqërore, që kanë depërtuar brenda nesh – pavarësisht se si – me vetëdije, nënvetëdije apo pavetëdije. Ju nuk duhet të blini një artikull për të cilin nuk keni nevojë. Por, ai artikull që manifeston frymën patriotike është diçka tjetër. Nëse ju nuk e blini një artikull apo mall të tillë, atëherë njerëzit mund të mendojnë se nuk jeni patriot. Por, ti je patriot. Pra, le të blejmë, vëllezër! Nëse nuk kemi arsye tjetër, atëherë le të blejmë për patriotizëm! “Çdo ofertë që gjen pranim përbën një dramatizim të fortë të përvojës së përbashkët.” “Përmes reklamimit, prodhimi paraqitet gjithnjë si pjesë e qëllimeve integrale dhe të larta shoqërore.”<sup>442</sup>

Nëse këtyre reklamave u qasemi nga pikëpamja logjike, – nga ana psikike janë për të ardhur keq – atëherë duhet t’u thurim lavde. Analiza logjike nuk mund t’i zbërthejë shtre-

<sup>441</sup> Këto tri reklama i kam cituar nga: Juri Gustinčić, *Reklama kao patriotski čin*, “Politika”, 18. 1. 1976, f. 5.

<sup>442</sup> M. Makluan, *Poznavanje opštita*, f. 286 dhe 284.

sat në thellësi<sup>443</sup> (të pavetëdijshmet dhe nënvetëdijshmet) të reklamës, sepse reklamimi nuk i është dedikuar kuptimit, por epsheve dhe ndjenjave. Reklama nuk mund të përkapet logjikisht, e megjithatë, nga ana psikike mund të jetë bindëse. Reklama ndikon fare pak në pjesën e vetëdijshme të jetës sonë shpirtërore. Veprimi apo ndikimi të saj i janë nënshtuar më shumë shtresat tona psikike të nënvetëdijshme dhe pavetëdijshme, të cilat nuk i bëjnë rezistencë, siç bën rojtari ynë i vetëdijshëm brenda nesh – kultura. Kultura i maturon epshet, ndërsa reklama i çliron, dhe kështu ajo shpërfaqet si anti-kulturë.

Le të kthehemi te reklama e parë.

Pak a shumë, reklama vë në shënjestër varësinë e njerëzve nga gjësendet, ose e thënë më ndryshe, siguria vetjake dhe sociale manifestohen përmes posedimit të këtyre gjësendeve. “Siguria është shprehja më e lartë e shoqërisë civile. Me vokacionin e sigurisë, shoqëria civile nuk ngrihet dot mbi egoizmin e saj; përkundrazi, siguria është sigurim i egoizmit të shoqërisë civile.”<sup>444</sup>

Struktura klasore e shoqërisë projektohet në botën e gjërave, dhe gjërat fillojnë të shihen në optikën e marrëdhënieve klasore. Gjithsesi kjo është pasojë e strukturës klasore, që reflektohet në qëndrimet e individit dhe grupit. Është e sigurt se njeriu i sheh dhe vështron gjërat në varësi të qëndrimeve të tij, e për rrjedhojë, ajo që ai vëren nuk varet vetëm prej gjësendeve, por para së gjithash prej strukturës së qëndrimeve të tij. Në botën e gjësendeve futen karakteristi-

<sup>443</sup> “Njerëzit e ditur nuk i atakojnë asnjëherë mesazhet e vetëdijshme e të thella të ofertave, sepse nuk janë të aftë të hetojnë dhe të analizojnë format joverbale të renditjes dhe kuptimit. Ata nuk kanë shkathtësinë e nevojshme për të komunikuar me pamjet.” (M. Makluan, po aty, f. 289)

<sup>444</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 289.

kat e raporteve sociale, kështu që marrëdhëniet midis gjësedeve shihen siç shihen raportet midis njerëzve. Mënyra se si i ka organizuar shoqëria gjësendet apo artikujt, i përgjigjet mënyrës me të cilën ajo ka rregulluar raportet e saj. Gjërat fshehin marrëdhëniet midis njerëzve, dhe nga mënyra se si janë organizuar gjërat mund të mësohet edhe mënyra se si është e organizuar një shoqëri.

Çdo shprehje e reklamës është e menduar mirë, dhe çdo fjalë godet brenda njeriut, një botë kjo që është studiuar me kujdes paraprakisht. Çdo fjalë ngjitet pas motiveve të vetëdijshme, të nënvetëdijshme dhe të paravetëdijshme, madje edhe pas motiveve të pavetëdijshme, si dhe pas dëshirave dhe pritshmërive të individit dhe grupit. “Pesë fjalë të goditura mjaftojnë për ta ndryshuar për disa javë apo muaj mënyrën e jetesës të gjysmë milioni konsumatorësh. Kjo është fuqi, madje absolute. A e di anekdotën e vjetër: fuqia të ngre, kurse fuqia absolute të ngre në formë absolute.”<sup>445</sup>

Vendi i fjalëve në fjali nuk është i rastësishëm: radha e fjalëve është formuar duke u bazuar te parimi i nxitjes së efekteve socio-psikologjike, e jo sipas kërkesave gjuhësore. Përfundimi i reklamës me “njeriu i vogël” godet më shumë, pikërisht për faktin se kjo frazë qëndron në fund të fjalisë, dhe nga psikologjia ne dimë se fjalët që rrinë më shumë në memorien tonë janë ato që thuhet në fillim dhe në fund. (Përpos radhitjes së fjalëve, nuk duhet harruar edhe theksi i paramenduar mbi disa fjalë, me qëllim nxitjen e një mbrese të fortë.) Reklama është dëshmi e gjallë e një gjuhe të veçantë, vlera (vërtetësia) e së cilës provohet se sa arrin të bindë konsumatorin për domosdoshmërinë e blerjes.

<sup>445</sup> F. Pol dhe Kornblut, *Reklamokratija*, Izdavački zavod Jugoslavije, Beograd 1967, fq. 38.

Nëpërmjet sendit/mallit sugjerohet pranimi i një filozofie për jetën, e cila mund të manifestohet me dy fjalë: para dhe sukses. Të gjitha qëllimet (vlerat) e tjera të jetës ose janë lënë mënjanë ose janë zhvendosur në një botë joreale. “Kam kuptuar se pikërisht reklama është duke e çuar përpara Amerikën. Disa torollakëve si unë kjo na jep rastin të kemi ndonjë qëllim, na shtyn të dëshirojmë diçka. Ndërsa për botën është më mirë nëse ne lajthitim ca më shumë. Pra, në Amerikë, pikërisht për faktin se ka qark shumë reklama, ka po aq njerëz të suksesshëm. Kaq shumë gjëra që mund të dëshirohen, gjëra për të cilat duhet punuar.”<sup>446</sup> Suksesi dhe para-ja bëhen imperativi moral dhe provojnë se kategoritë ekonomike kanë zënë vendin e kategorive morale. (Kështu, nga një mjet i thjeshtë për këmbim dhe masë, para-ja bëhet qëllim.)

Dhe në fund, kuptimi i fshehur i kësaj reklame (dhe i çdo reklame tjetër) nuk është që të shtyjë njeriun e vogël të blejë një makinë të madhe, por për të blerë një përfytyrim të madh, për të blerë simbolin që dëshmon gjendjen dhe autoritetin shoqëror, që në fakt lidhet me të. Kur fshatari ynë blen një televizor apo frigorifer, pavarësisht se në fshat mungon elektrifikimi, ai në fakt nuk blen televizor apo frigorifer, por prestigjin shoqëror, pasi as televizori e as frigoriferi nuk përmbushin ndonjë nevojë reale, vetëm sa kënaqin nevojën për prestigj, që gjithashtu është një nevojë vetjake dhe shoqërore. Njeriu i gjësendeve e manifeston qenien e tij në një mënyrë më depërtuese nëpërmjet vetë gjësendeve.

Kemi tre supozime filozofike (më saktë pothuaj filozofike) mbi të cilat mbështetet reklama:

i. Në radhë të parë, qenia njerëzore nuk është një qenie e vetëdijshme; motivet e saj të nënvetëdijshme dhe të pave-

<sup>446</sup> *Komunikacija i jezik*, Vuk Karadžić, Beograd 1968, fq. 293.

të dijshe pothuajse përcaktojnë sjelljen e saj. "For if people were careful thinkers it would be difficult to sell anything..."<sup>447</sup> "If we were all logicians, the economy could not survive, and herein lies a terrifying paradox, for in order to exist economically as we are we must try by might and main to remain stupid."<sup>448</sup> "Sa më pak mend, aq më shumë shitje."<sup>449</sup>

ii. Logjikisht, prej supozimit të parë vjen i dyti: qenia njerëzore nuk e njeh vetveten, pra nuk është e vetëdijshe për nevojat e saj. Qenia është e vetëdijshe për nevojat e domosdoshme, por jo edhe për nevojat e mundshme; prandaj duhet bërë e mundur që pesë shqisat të ndajnë mungesën për nevoja të reja. "Çdo njeri spekulon me qëllim që t'i krijojë tjetrit një nevojë të re, që ta detyrojë atë të bëhet një viktimë e re; që t'i shkaktojë një varësi të re, dhe kështu ta mashtrijë me një mënyrë të re argëtimi, e për pasojë ta çojë drejt shkatërrimit ekonomik. Çdo prodhim i ri është një potencial i ri mashtrimi dhe plaçkitjeje reciproke."<sup>450</sup> "Çdo prodhim, në fakt, është vetëm kurth, me të cilin synohet mashtrimi i tjetrit, paraja e tij, çdo mundësi reale apo e mundshme e dobësisë së tij, që ta shtyjë mizën të ngjitet pas pallaskës."<sup>451</sup>

iii. Nocioni i lumturisë së njeriut të qytetëruar përsillet rreth posedimit të gjërave. Atij i duhet tërhequr vëmendja për këto gjëra, që t'i ketë, me qëllim që të ndjehet i kënaqur. "Askush nuk e do makinën deri në çastin që ajo shfaqet, dhe askujt nuk i intereson televizioni për aq sa nuk trans-

<sup>447</sup> J. Henry, *ibid.* P. 48

<sup>448</sup> Po aty.

<sup>449</sup> F. Pol, *Reklamokratija*, f. 91.

<sup>450</sup> Marx-Engels, *Randi radovi*, f. 238.

<sup>451</sup> Po aty, f. 239.

metohet një program i caktuar. Ky pushtet i teknologjisë për të krijuar botën e vet të konsumit, nuk është i varur nga vetë teknologjia, para së gjithash si zgjatim i vetë trupit dhe shqisave tona”, shkruan McLuhan-i.

Duke qenë se pjesa dërrmuese e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për nevojat e tyre (të paktën për nevojat e mundshme), dhe duke qenë se nevojat e tyre të shumta janë të mbyllura dobët në zonat e paravetëdijshme dhe nënvetëdijshme, madje edhe tek ato të pavetëdijshme, është e nevojshme njëfarë nxitjeje e jashtme, që këto nevoja, nga shtresat e thella të qenies njerëzore të çlirohen e të dalin në sipërfaqen e njohjes së vetëdijshme. Kjo është baza ku do e ndërtojnë suksesin e tyre “manipuluesit e thellësisë”.<sup>452</sup> Mbi sjelljen e njeriut mund të veprohet me anë të disa simboleve të caktuara (fjalë, vizatime, pamje, zëra), dhe ai të mos jetë i vetëdijshëm për këtë.

“Forma më e lartë e shkathtësisë sonë është që konsumatori të bindet për diçka dhe të mos jetë i vetëdijshëm që ne po e bindim.”<sup>453</sup> Simbolet nuk i dërgohen shtresës së vetëdijshme të qenies, – vetëdija këtu është vetëm ndërmjetëse – dhe kështu atij nuk i mbetet tjetër përveçse t’i interpretojë ato në mënyrë racionale. Por, para së gjithash ato janë të orientuara të ndikojnë mbi motivet e paravetëdijes dhe nënvetëdijes. “Ata ndejnë përpara se të mendojnë. Ata vërejnë përpara se të shohin. Ata blejnë bazuar në pasione e jo në vetëdije. Ata e bëjnë këtë më tepër nga inspirimi sesa sipas planit.”<sup>454</sup> Pas çdo reklame fshihet bihejviorizmi, psikanali-

<sup>452</sup> Kjo frazë është marrë nga libri *Industria sieti*, f. 13.

<sup>453</sup> F. Pol, *Reklamokratija*, f. 55.

Lajmërimi në gazetë synon njeriun racional, të vetëdijshëm; pllakati apo simbolet muzikore janë të orientuara për të vënë në lëvizje emocionet. Pllakati pëlqehet siç pëlqehet një lule, dhe nuk ka kurrfarë kuptimi të pyesim se pse është e bukur lulja.

<sup>454</sup> J. Henry, *Culture Against Man*, p. 60.

za dhe sociologjia. Nga bihejviorizmi janë marrë parimet e kushtëzimit (principles of conditioning), nga psikanaliza janë marrë rregullat e asocimit (laws of association), ndërsa nga sociologjia janë marrë rregullat e jetës në grup (laws of group life).<sup>455</sup>

“Manipuluesit e thellë” e hedhin poshtë përgjigjen racionaliste (në fakt, kjo përbën mashtrim për ta), që, sipas rregullit, qeniet njerëzore reagojnë me vetëdije (në mënyrë racionale) karshi sfidave të ndryshme të natyrës së tyre, mjedisit jetësor dhe kulturor.

Pjesa më e madhe e jetës së njeriut zhvillohet pa pjesëmarrjen e kontrollit të vetëdijshëm, sipas parimit “maksimumi i efikasitetit me minimumin e zgjuarsisë”. “Përpjekjet e bindësit për të hulumtuar sjelljet tona të përditshme dhe që të zbulojë tek ato domethëniet e fshehura, shpeshherë janë interesante vetëm ngaqë këto përpjekje na zbulojnë një pjesë tonën.”<sup>456</sup>

Premtimi është shpirti dhe zemra e çdo reklame. Reklama nuk u shet ilaçin të sëmurëve, por shpresën për t’u shëruar; ajo nuk u shet femrave vajra, por dëshirën për të qenë përjetësisht të bukura; ajo nuk u shet fëmijëve avionë, por u jep shpresë që të fluturojnë.<sup>457</sup> Reklama nuk shet mallin, por

<sup>455</sup> Krahaso: Milton Rokeach, *Beliefs, Attitudes, And Values*, Jossey – Bass Inc, Publishers, San Francisco, 1970, p. 184.

<sup>456</sup> V. Pakard, po aty, f. 10.

<sup>457</sup> “Tanimë është thënë se një reklamë e mprehtë lidh vetitë e prodhimit me vetitë psikologjike dhe shoqërore të vetive të personalitetit. Ajo studion me një kujdes të madh nevojat dhe bindjet e individit dhe grupit, duke marrë parasysh gjininë (femrat janë blerëse më të mira se meshkujt), moshën (fëmijët janë blerësit më të mirë), pozitën shoqërore, profesionin, të ardhurat, dendësinë e popullësisë (sa më shumë njerëz, aq më tepër shitje), bindjet ideologjike, ideore dhe religjioze, zakonet, shpresat, frikën, pritshmëritë. Pasi është bërë një studim i mirë se për çfarë mund të bindet blerësi, me ç’mjetë dhe me çfarë çmimi, fillon procesi i shfrytëzimit të nevojave. “Prodhimtaria nuk është domosdoshmërisht e madhe atje ku edhe nevoja është e

besimin se pronarët e mallit të sapoblerë do të bëhen njerëz. Pra, nëpërmjet një shkence të mprehtë, reklama arrin të vendosë lidhjen e papritur midis idealeve më të larta dhe interesave më të ulëta tregtare.<sup>458</sup> Reklama shfrytëzon dhembjen, frikën dhe dëshirën, ashtu siç shfrytëzohet çdo burim tjetër që sjell përfitim ekonomik. Reklama nuk i shfrytëzon edhe aq anët e fuqishme të prodhimeve të saj, sesa anët e dobëta të konsumatorëve që e ndjekin. Mangësitë e konsumatorëve janë një burim i madh i dobisë ekonomike, sepse mangësitë janë më të mëdha se virtytet e shumta të prodhimeve. “Makineria reklamuese i përshtatet dobësisë së njeriut, që nga njeriu i dobët të nxjerrë makinën”, shkruante Marx-i kur ishte i ri.

### Drejt konsumit iracional

Marx-i na ka mësuar se mënyra e prodhimit përcakton llojin e shoqërisë. Prodhimi mund të bëhet për treg ose për nevoja. Në rastin e parë motivi për të prodhuar (vlerave në qarkullim) është përfitimi, kurse në rastin e dytë (vlerave përdoruese) është plotësimi i nevojave të anëtarëve të shoqërisë. Propaganda ekonomike (reklama) synon që ky dallim të mos vihet re edhe aq qartë. Kjo përpjekje lexohet në gjuhën e reklamës. “Të prodhosh për të përfituar do të thotë të prodhosh për të shitur. Ndërsa të prodhosh për të shitur do të thotë të kujdesesh për nevojat dhe kërkesat e njerëzve.” Nëse nuk gabojmë, atëherë këtë gjuhë ideologji-

madhe; ajo mund të jetë e madhe atje ku aftësia e kontrollit të sjelljes së blerësit është e madhe.” (J. K. Galbraith, *Economics and the Public Purpose*, p. 140)

<sup>458</sup> Një lidhje e tillë e fenomeneve që qëndrojnë larg njëri-tjetrit është një dukuri logjike e pasojës së supozimit teorik se gjithçka është e lidhur me gjithçka në një sistem funksional.

ke duhet ta kthejmë në një gjuhë të ndershme, dhe duhet thënë hapur se ju nuk do të flisni për dobinë tuaj, – që në fakt është një qëllim që u përket vetëm ju – por për nevojat tona. Ju as që e çani kokën për to. Motivi juaj bazë, për të na shitur sapunin apo ëndrrën, nuk është përmbushja e nevojave tona, por plotësimi i egoizmit tuaj.

Prodhimit për shitje (për treg) duhet t'i lëshojë vendin prodhimit për nevoja.

Ekonomistët me orientim human përmendin arsyet, dhe pikërisht anashkalimi i tyre do të ishte i pakuptimtë dhe fatkeq.

Prodhimi për treg, motivi i të cilit është përfitimi, nuk njihet kufij. Kufiri i vetëm i këtij prodhimi mund të jetë mungesa e resurseve natyrore. Shpenzimi i pakuptimtë i resurseve natyrore, duke kujtuar këtu se shpenzimi shpejtohet sa më shumë mall jocalësor të prodhohet, me qëllim që malli i ri të blihet sa më shpejt – të gjitha këto janë të lidhura me ndotjen e ambientit jetësor.

Prodhimi për treg (përfitim) është i pakuptimtë jo vetëm për shkak të shpenzimit të pakuptueshëm të burimeve natyrore, por duke pasur parasysh edhe shfrytëzimin e pakuptimtë të fuqisë punëtore.

Për reklamimin e prodhimeve shpenzohen mjete fantastike<sup>459</sup>, që në një sistem tjetër prodhimi mund të përdoren për qëllime humane apo racionale.

Të prodhuarit për nevoja është çelësi i vetëm për rregullimin logjik të konsumit. Nëse prodhohet aq sa mjafton për përmbushjen e kërkesave, atëherë shmanget mundësia për

<sup>459</sup> Çdo përmbledhje me shpallje bëhet me përpjekje të mëdha, me kujdes, me verifikime të ndryshme dhe falë shkathtësisë së shumë njerëzve. Çdo shpallje e theksuar në një gazetë apo revistë bëhet me më shumë imagjinatë dhe kujdes sesa shkrimi i editorialëve dhe rubrikave të ndryshme. (McLuhan, po aty, f. 286).

shpenzimin shkel e shko, dhe në këtë mënyrë kursehen edhe resurset natyrore. Në të njëjtën kohë mjedisi jetësor nuk ndotet kaq shpejt.

Të prodhuarit për nevoja, në të njëjtën kohë nënkupton shpenzim logjik të punës së njeriut, si anën fizike ashtu edhe atë mendore.

Përderisa sjelljet e njerëzve janë të diktuar nga motivet e përfitimit, atëherë merret me mend se sjellja e tyre përbën mohim të vlerave morale dhe estetike në një masë të madhe. Individët pasurohen shpejt, por zhvillohen ngadalë në personalitete të pasura.<sup>460</sup> Për këtë arsye, në një shoqëri të pasur, mund të korrin sukses ata personalitete që shpirtërisht janë të varfër; sikurse në një shoqëri të varfër mund të zhvillohen personalitete të pasur nga ana shpirtërore. Sa më të zhvilluara të jenë nevojat shpirtërore të një personaliteti, aq më i vëmendshëm është për shpenzimin e të mirave materiale.<sup>461</sup> Kjo është krejtësisht e kuptueshme përderisa dihet që një personalitet orientohet drejt shpenzimit jomaterial apo material që ka pranë dhe pa pagesë. “Për teoricienët e konsumit është i panjohur fakti se personaliteti me preokupime intelektuale dhe artistike, ndonjëherë i plotëson nevojat – gjithsesi ato të një shkalle të lartë – me një masë të vogël mjetesh materiale. Këto personalitete sillen në mënyrë racionale si konsumatorë.

Nëse në dritën e këtyre konstatimeve vështrohet edhe zhvillimi ekonomik, atëherë në një shoqëri me personalitete

<sup>460</sup> Kosta Mihailoviq godet në shenjë: “Edhe shtetet më të zhvilluara mund të klasifikohen si shtete të pazhvilluara nëse vlerësohen për nga numri i personaliteteve të zhvilluar.” (Për më gjerë, konsulto: “Disa aspekte të zhvillimit afatgjatë të Jugosllavisë”, në Zbornik pete medjunarodne konferencije “Nauka i drustvo”: *Naučni, tehnoški i društveni razvoj*, II, Beograd, 1974, f. 13)

<sup>461</sup> “Sidoqoftë shkrimtari duhet të fitojë që të jetojë, por kurrsesi nuk mund të jetojë e të shkruajë me qëllim përfitimin.” (Marx, *Birokratija i javnost*, f. 110)

të zhvilluar, madje edhe nëse kjo shoqëri ka një shkallë të ulët zhvillimi, prodhimet duhet të arrijnë një efekt shumë të madh nga këndvështrimi i plotësimi të nevojave. Në lidhje me këtë, tani kemi të bëjmë me çështjen e racionalizmit në ekonomi. Në fakt, ç'nënkupton racionaliteti në ekonomi?" – shtron pyetjen Kosta Mihailloviq.

Atyre që çdo energji të veten e kanë orientuar drejt rritjes së efikasitetit në prodhim, duhet t'u tërhiqet vëmendja për pasojat e përpjekjeve që po bëjnë, si dhe duhet t'u hapim sytë për ato çështje që zakonisht nuk shtrohen në ekonomi.<sup>462</sup>

Kjo analizë e shkurtër e bazës socio-psikologjike dhe filozofike të reklamës na zbulon rrugën zhvillimore dhe funksionin e saj në shoqërinë civile: pak a shumë na çon drejt shpjegimit të kujdesshëm të prodhimeve të reja, te kontrolli i nevojave ekzistuese njerëzore dhe në fund te krijimi i nevojave artificiale dhe shfrytëzimi i tyre. Nëse në kryeherë reklama i përshtatet turpshëm nevojave njerëzore, në fund ajo i modelon ato në atë mënyrë që ato t'i përgjigjen kërkesave të saj dhe shitjes.

Midis njeriut dhe prodhimit futet një simbol i pushtetshëm, i cili e shtyn njeriun që të bëhet një konsumues dhe prodhues mallrash. Simboli ndërmjetëson midis nevojave të konsumatorit dhe të kapitalit në dobi të këtij të fundit. Reklama është bërë një kategori e rëndësishme e ekonomisë kombëtare duke dhënë kontributin e saj që kjo ekonomi të reduktohet në një "sistem të ligjshëm mashtrimi dhe në një shkencë pasurimi".<sup>463</sup>

Konsumatorit të kohës sonë, reklama si një formë e vetëdijes ideologjike, i ofron përgjigje për pyetjen se çfarë mund të posedojë; por, ajo nuk mund t'i japë përgjigje nje-

<sup>462</sup> Kosta Mihailiović: "Ekonomija se sama sobom ne da objasniti."

<sup>463</sup> Engels, *Rani radovi*, f. 89.

riut modern për çështjen se si është e mundur që të bëjë një jetë të logjikshme dhe humane.

Kritika e ekonomisë politike borgjeze duhet të provohet si një kritikë e ideologjisë borgjeze, ku një formë e veçantë e saj është ekonomia politike.<sup>464</sup>

<sup>464</sup> Marx-i e konsideronte ekonominë politike si një formë të vetëdijes ideologjike, që nuk është e nevojshme të provohet. (Shih: *Rani radovi*, f. 293; krahaso: Habermas, *Science and Technology as Ideology*.)

## PROPAGANDA<sup>465</sup>

*“...që në botën e shpirtit të fusë oligarkinë.”*

Marx

Nisur nga fakti që në shoqërinë moderne propaganda praktikohet masivisht, mund të pohojmë se ideologjia dhe qëndrimet që propagandohen nuk janë të pranuar dhe të përvetësuar si një sistem i përgjithshëm mendimi dhe veprimi, dhe për këtë arsye ato duhen imponuar, me qëllim që shoqëria e ndarë në klasa, “me zhdërvjelltësinë e të menduarit” të arrijë unitetin për të parandaluar ndryshimet dhe konfliktet shoqërore.

“Triumfi më i madh i propagandës nuk është arritur ngaqë është bërë diçka, por ngaqë ajo është përmbajtur së vepruari. E vërteta është e madhe, por është edhe më e madhe heshtja për të vërtetën, kur kjo e fundit shihet nga këndvështrimi praktik.”<sup>466</sup>

### Nga akti deri te mendimi për aktin

Vëmendja e studiuesve është përqendruar kryesisht në pikën se çfarë bën propaganda me idetë, qëndrimet dhe

<sup>465</sup> Fjalën “propagandë”, që shpeshherë përdoret si sinonim i manipulimit, e hasim për herë të parë në vitin 1623, ndër shprehjet e Këshillit të Kardinalëve, i themeluar nga Papa Urbani VIII në Romë, me qëllim mbikëqyrjen e punës së misionarëve të Kishës. Fraza latine CONGREGATIO DE PROPAGANDA FIDE, e përkthyer literalisht do të thotë KËSHILLË PËR PËRHAPJEN E BESIMIT. Prandaj termi propagandë do të thotë të përhapësh, shpërndash, të punosh për të shumuar. (*Worterbuch der Sociologie*, hrsg. von Wilhelm Bernsdorf, Ferdinand Enke, Verlag, Stuttgart, 1969, s. 851-853; shih edhe *Komunikacija i jezik*, Vuk Karadžić, Beograd, 1968, f. 298; Milan Vujaklija, *Leksikon stranih reči i izraza*, Prosveta, Beograd, 1970, f. 779.

<sup>466</sup> Fromm, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 219-20.

sjelljet tona; por, në të vërtetë, çështja kryesore është se çfarë nuk lejon të bëhet; si i pengon propaganda ndryshimet shoqërore dhe si e mbron *status quo*-në dhe në emër të cilave interesave lë mënjanë ca interesa të tjera, që të mos bëhen publike? Studiuesi i sferës ideore të mediave masive – nëpërmjet të cilit bëhet propaganda – nuk e ka të orientuar vëmendjen vetëm te fakti se çfarë thuhet përmes propagandës, por edhe se çfarë nuk thuhet (ndoshta ajo që lihet në heshtje është edhe më e rëndësishme). Mediat masive publikojnë çdo ditë interesat e grupit sundues, si të vërtetat e vetme të shoqërisë, duke lënë në heshtje me kokëfortësi shumë çështje kritike që kanë të bëjnë me strukturën dhe pozitën shoqërore të njerëzve. Zhvendosja në mënyrë të zhdërvjellët e vëmendjes së opinionit publik prej çështjeve të ndjeshme shoqërore – siç është çështja e ndarjes së pasurisë shoqërore, pushtetit, autoritetit, dijes, sigurisë etj. – është njëmend e suksesshme deri në çastin kur shpërthen ndonjë krizë sociale dhe i nxjerr të palarat sheshit.<sup>467</sup> Pikërisht këto janë çështjet që janë anashkaluar apo hedhur poshtë në mënyrë sistematike nëpërmjet mediave masive. Falë krizës, individët dhe grupet bëhen të vetëdijshëm për problemet e vërteta të shoqërisë, ndërkohë që këto probleme, nga ana tjetër, janë pasqyruar në media si çështje të rreme. “Për depërtimin e së vërtetës mund të thuhet se vendosin rastet e volitshme, e jo vetë e vërteta si e tillë. Dhe, në fund, si e vërtetë paraqitet ajo që në fakt nuk është paralajmëruar fare.”<sup>468</sup>

Njeriun e shoqërisë civile moderne e rrahin çdo ditë valë informacionesh të ndryshme, që ai i dëgjon, i lexon apo i

<sup>467</sup> “Sepse rëndësia e madhe e krizave është zbulimi i të fshehtave.” (Lenin, *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960, f. 477, vëll. 10)

<sup>468</sup> Jaspers, *Filozofija egzistencije*, Prosveta, Beograd, 1967, f. 60.

sheh, si gjatë kohë kur është i zënë ashtu edhe kur është lirë, saqë nuk i mbetet as kohë, as fuqi e as vullnet për të bërë diçka tjetër. “Në fakt ai është i interesuar; po ashtu edhe i informuar. Ai ka ide të ndryshme për çështjen se çfarë duhet të bëjë. Por, pasi ka drekuar e ka dëgjuar radio, ka lexuar gazetën, më në fund vjen koha e gjumit.”<sup>469</sup> Pavarësisht qëllimit të tyre, mediat masive i imponojnë njeriut një mori informacionesh të ndryshme, duke ia shterur kësisoj fuqitë, dhe ai bëhet gjithnjë e më tepër një qenie që di por që vepëron krejt pak (racionale dhe humane).<sup>470</sup>

Në fakt, e gjithë dija e tij është për t’u vënë seriozisht në pikëpyetje. Pa dyshim që njeriu modern lexon, dëgjon dhe shikon më shumë, por duket shkoqur se dyshon gjithnjë e më pak. Kur sytë dhe veshët stërngarkohen, mendja nuk ka as kohë, as fuqi e as vullnet për të vështruar dhe gjykuar në mënyrë kritike.

### **Idetë dhe qëndrimet politike si mallra**

Një mendje e shëndoshë mund të imagjinojë fare kollaj prodhues, shpërndarës, tregtarë dhe konsumatorë mallrash të ndryshëm, por e ka të vështirë të imagjinojë prodhues<sup>471</sup>, shpërndarës<sup>472</sup>, tregtarë<sup>473</sup> dhe konsumatorë idesh dhe ideo-

<sup>469</sup> P. F. Lazarsfeld and R. K. Merton, “Mass communication, popular taste and organized social action,” in L. Bryson (ed.), “Mass Communication of Ideas”, New York, Harper, 1948, p. 106.

Fromm-i gjithsesi ka të drejtë kur pohon se propaganda nuk do të ishte aq efikase nëse individët dhe grupet nuk do të ishin aq të përshtatshëm për t’u bindur për mënyrën e tyre të përgjithshme të tjetërsimit. (*Zdravo društvo*, f. 317)

<sup>470</sup> Intelektuali është modeli tipik i njeriut që konsumohet duke mësuar dhe menduar, për të cilin besohet se nuk është i aftë të veprojë konkretisht.

<sup>471</sup> Engels-i flet drejtpërdrejt për prodhimin e vetëdijes (ideve).

<sup>472</sup> Marx-i dhe Engels-i shfrytëzojnë frazën “shpërndarja e mendimeve”.

<sup>473</sup> Në zjarrin e vet polemizues, Marx-i përdor frazën “tregtarë mendimesh”.

logjish të ndryshme, që në tregun e ideve dhe ideologjive shiten dhe blihen sikurse çdo mall tjetër.

Dhe, siç ndodh rëndom, në treg ecin më shumë mallrat e lirë e të dobët, krahasuar me mallrat e shtrenjtë e cilësorë. Idetë, ideologjitë dhe qëndrimet e thjeshta e të lira, shpeshherë gjejnë më shpejt blerës sesa idetë e rëndësishme.

Edhe në tregun e ideve politike dhe ideologjive vlen rregulli bazë: ai që ka më shumë para, fuqi dhe shkathtësi për t'i propaganduar ato, ai mund të shpresojë se idetë dhe ideologjia e tij do gjejnë pranimin institucional, dhe në jetën e përditshme politike do të bëhen sistem i përgjithshëm interpretimi dhe veprimi. "Të gjitha partitë borgjeze, pra ato që ruajnë privilegjet ekonomike të kapitalistëve, i bëjnë reklamë partive të tyre ashtu siç i bëjnë reklamë disa kapitalistë prodhimeve të tyre. Shikoni me kujdes lajmërimet tregtare në cilëndo gazetë, dhe do vini re se kapitalistët gjejnë emrat më efektivë që bien në sy; emrat më modernë për mallrat e tyre, dhe i ngrejnë lart në mënyrë mitike, duke mos e çarë kokën për gënjeshtër e sajesa të ndryshme.

Publiku është mësuar prej kohësh me reklamat e tregjeve dhe vlerën e tyre, të paktën në qytetet e mëdha apo në qendrat tregtare. Për fat të keq, reklama politike e çorienton shumë më tepër popullin – demaskimi i saj është i vështirë dhe mashtrimi i kësaj reklame mbrohet me shumë devotshmëri. Emra si "parti", – në Europë dhe te ne – shpeshherë përcaktohen drejtpërdrejt me qëllim reklamimin e "programeve" të partive politike, që nganjëherë shkruhen vetëm për të mashtruar publikun. Sa më e madhe të jetë liria politike në vendet kapitaliste, aq më e pacipë bëhet reklama partiake.<sup>474</sup>

<sup>474</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 88.

Ndodh shumë shpesh që në zgjedhje të fitojë ajo parti e cila ka më tepër mundësi materiale për të paguar propagandimin e ideve të saj; ajo që ka më tepër fuqi për të ndikuar mbi mediat masive; që ka më tepër shkathtësi në bindjen e masave se kandidati i saj është pikërisht ai i cili do të zgjidhë problemet e shoqërisë. Ajo parti që nuk i ka të gjithë këto kapacitete, por që ka një program më të mirë dhe ka zgjidhje më të qëlluara për problemet e shoqërisë, duhet të presë ndonjë gabim fatal nga ana e kundërshtarit ose ditë më të mira, derisa të jetë në gjendje të ndërtojë vetë “departamentin e zhurmës”.

Kështu, partitë luftojnë më shumë për një numër sa më të madh votuesish sesa për verifikimin e vlerave që përmbajnë idetë e tyre. Në fakt, nuk luftojnë dy parti politike, por dy agjensi reklamash.<sup>475</sup>

Dy agjensi reklamash luftojnë për *monopolization of attention*<sup>476</sup> siç luftojnë dy prodhues mallrash për monopol në treg. “Imagjinoj votuesin në vendin e votimit, që hamendet se kujt t’ia japë votën, si një konsumator që hamendet në supermarket se ç’pastë dhëmbësh të zgjedhë. Ajo firmë që ka bërë një depërtim më të thellë në trurin e tij, do pasqyrojë edhe përzgjedhjen e tij.”<sup>477</sup> Kështu edhe politika: është bërë mall konsumi, dhe përfundimisht e ka humbur kuptimin e epërm që i patën dhënë grekët e vjetër.

Sikurse e dimë, në thelb, prodhimet industriale janë të njëjta si dy vezë, nuk kanë asnjë dallim objektiv – ja pse reklama përpiqet të krijojë ndjenjën subjektive të dallimit, dhe ia del gjithnjë për aq sa blerësi është në dilemë, duke u preokupuar me vetitë e njëmendta të prodhimit. E njëjta gjë ndodh

<sup>475</sup> Për më shumë: V. Pakard, *Industrija svesti*, f. 170.

<sup>476</sup> Marrë nga P. Lazarsfeld dhe R. Merton, po aty, p. 117.

<sup>477</sup> V. Pakard, po aty, f. 172.

edhe me programet politike: gjithnjë e më pak dallojnë nga njëri-tjetri, dhe si pasojë votuesit e kanë përherë e më të vështirë të vendosin se cilën parti të besojnë, dhe këtë vendim nuk e ndërmarrin duke u bazuar në një përzgjedhje të vetëdijshme, të mbështetur mbi njohjen e dallimeve, por nën ndikimin e asaj që ka imponuar propaganda politike në nënvetëdijen e tyre; në varësi të faktit se cila propagandë ka qenë më e fortë e më e mprehtë.<sup>478</sup> “Në fakt, njerëzit dëgjojnë dhe shohin më shumë pa vetëdije sesa me vetëdije, dhe pikërisht ajo çfarë ata dëgjojnë dhe shohin, për të cilën ata nuk janë të vetëdijshëm, regjistrohët në nënvetëdijen e tyre dhe mund t’u ndikojë në mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e vetëdijshme.”<sup>479</sup>

Në këtë mënyrë propaganda mund të na shesë një njeri të sëmurë, i cili do na udhëheqë me një ideologji mashtruese, që kërkon të justifikojë veprat e pakuptimta dhe një lëvizje masive të kotë, e cila mund të na çojë drejt varrit. Kjo sepse, parë nga këndvështrimi i propagandës, njohuritë teorike të vlerës së ideve (dhe ideologjive) nuk janë të rëndësishme – ajo që është e rëndësishme është fuqia e tyre praktike për të orientuar, integruar dhe kontrolluar sjelljen e klasave. Kush i vlerëson idetë vetëm nga këndvështrimi i përdorimit praktik, ai i heq të drejtën vetes që t’i kuptojë ato nga këndvështrimi i së vërtetës.

### **Mendimi zyrtar dhe opinionimi publik**

Kur një parti politike merr pushtetin lufton me të gjitha mjetet që ka në dispozicion që ta mbajë atë, dhe një luftë e

<sup>478</sup> Lenini ka theksuar se duhet të merremi me të luhaturit dhe të papërcaktuarit, sepse ata janë më të shumtë në numër e më të përshtatshëm për t’u bindur. (*Izabrana dela*, vëll. 12, f. 329)

<sup>479</sup> Huxley, *Brave New World Revisited*, Harper and Row, New York, 1965, p. 78.

tillë shpeshherë është më e rëndë se në kohën e marrjes së pushtetit.<sup>480</sup> Kur një parti vjen në pushtet, hapi i parë që bën është të bëjë dominuese idetë, ideologjinë dhe qëndrimet e veta. Çdo pushtetar synon të luftojë me qëllimin se ka vetëm një qeveri (ajo e tija), dhe vetëm një mënyrë të menduari (ajo e tija).

Çdo qeveri pandeh “se ajo është e vetmja qeveri e mirë, e vërtetë dhe e drejtë për t’i shërbyer shtetit. Shpëtimi i saj, autoriteti, fuqia e saj është kriteri i moralit. Bukur fort! Në këtë mënyrë dyert janë të hapura për çdo krim, dhe e vërteta njerëzore, drejtësia individuale, demokracia, le të shohin se çfarë...”<sup>481</sup> “Veprimi i shtetit është ushtrimi i dhunës, dhe këtë e quan drejtësi. Ndërsa dhunën që ushtron individi e quan shkelje të ligjit.”<sup>482</sup> “Sikur unë të isha Shteti, atëherë do të duhej të burgosesha.”<sup>483</sup>

Kemi thënë se, tashmë shteti ka hequr dorë nga metodat e vrazhda të udhëheqjes së turmave, metoda të cilat i ka këmbyer me teknikat dinake të imponimit të vullnetit, duke përdorur me shkathtësi simbolet, me anë të të cilëve mbështillen interesat. Kjo nuk përbën kurrsesi dobësim të fuqisë shtetërore, sepse edhe kësaj shkaktohen pasoja që përputhen me interesat e grupit në pushtet, dhe në të njëjtën kohë u ndërpritet rruga atyre pasojave që pengojnë realizmin e vullnetit të këtij grupi. Kontrolli i dukshëm këmbëhet me të

<sup>480</sup> “Në një epokë kur kriza është e acaruar, mund të ngadhënjejhet politikisht për disa javë. Në luftë mund të fitohet për disa muaj. Ndërsa në planin kulturor nuk mund të triumfohet për një afat të tillë: bash në këtë rast kemi të bëjmë me thelbin e çështjes, sepse duhet më shumë kohë, dhe përgjatë kësaj kohe nevojitet adoptim: duke bërë planin e punës, duke treguar këmbëngulje të madhe, qëndrueshmëri dhe angazhim sistematik.”

<sup>481</sup> Mann, *Carobni breg*, Prosveta, Beograd, 1972, f. 503.

<sup>482</sup> Shih: Marx-Engels, *Nemačka ideologjia*, Kultura, Beograd, 1964, f. 47.

<sup>483</sup> Gide, *Podrumi Vatikana*, Kosmos, Beograd, f. 185.

padukshmin, dhe kështu vijon të jetë në fuqi. Shteti “zotëron aftësinë e manipulimit të njerëzve, kështu që ai i udhëheq ata. Por, në fakt, ata nuk e dinë se si ndodh e gjithë kjo”.<sup>484</sup> “A është e mundur të imagjinohet një regjim diktatorial i cili nuk vihet re dhe që përdor forma demokratike për të qëndruar në pushtet?”<sup>485</sup>

Grupi në pushtet, përveç të tjerash, ka në dispozicion edhe mjetet e informimit, nëpërmjet të cilave e ushqen turmën me simbole (ide) të zgjedhur në mënyrë sistematike, të organizuar, të orientuar, pasojat e të cilëve i kontrollon po vetë. Në të njëjtën kohë, ky grup censuron të gjithë simbolet që pengojnë shndërrimin e vullnetit të tij në të vërtetë zyrtare. (Kështu, mediat masive, të cilat janë krijuar për komunikim, kthehen në mjete të padukshme që imponojnë roberinë politike dhe zhbërjen e komunikimit të qenësishëm.)

Qeveria është mbrojtëse e së vërtetës (së saj). Këtej e tutje secili duhet të ketë kujdes për atë që do thotë, sepse qeveria kontrollon çdo gjë që thuhet.

Me institucionalizimin e ideologjisë së tij, grupi në pushtet përpiqet të paralizojë opinionin publik, duke e barazuar atë me mendimin zyrtar (të institucionalizuar), ose i bie shkurt: e zhbën. Shpeshherë opinionin publik ka kuptimin e qëndrimit opozitar ndaj mendimit zyrtar/sundues, dhe opinionin publik do ekzistojë për aq sa do ekzistojnë klasat josunduese. Edhe kur klasa në pushtet e sheh me dashamirësi studimin e opinionit publik, në fakt, përmes tij më-

<sup>484</sup> Fung Ju-Lan, *Istoriya kineske filozofije*, Nolit, Beograd, 1971, f. 188.

<sup>485</sup> K. Boulding, cituar në: V. Pakard, *Industrija svesti*, f. 160.

“Shteti absolut ka treguar se politika është e aftë ta shfrytëzojë vështrimin e saj për botën si një armë. Politika nuk është vetëm një luftë për pushtet, por kuptimin e saj themelor e arrin atëherë kur qëllimet e saj i plotëson me filozofi politike, me pikëpamjen politike mbi botën.” (K. Manhajm, *Ideologjia i utopija*, Nolit, Beograd, 1968, f. 30)

son se në ç'masë është bërë sunduese ideologjia e saj<sup>486</sup>, apo se sa është arritur paralizimi i mendimit kritik.

“Unë tanimë e di që ti gënjen kur bën pyetje.”<sup>487</sup>

### Nga vetëdija drejt nënvetëdijes

Fuqia e ideologjisë në pushtet nuk qëndron te forca e saj njohëse, – e ç'vlerë njohjeje mund të presim prej disa frazave dhe parullave të përgjithshme, tërësia e të cilave u jep mundësi të zbatohen gati në të gjitha situatat pa shpjeguar asnjë situatë – por te aftësia për të nxitur e ndezur anët e errëta të natyrës njerëzore.<sup>488</sup> Në radhë të parë, mesazhet ideologjike – racionalizimi i interesave të grupit në pushtet, bërë sipas rregullit të përmbylljes racionale – nuk i drejtohen intelektit. “Kurrë mos i besoni intelektit. Ne e kemi përjashtuar me kohë nga profesioni ynë dhe nuk kemi vajtuar asnjëherë për atë.”<sup>489</sup>

Ndryshimet në qasje janë të qarta: nuk shtrohet më pyetja se cilat janë pasojat socio-psikologjike që shkakton

<sup>486</sup> “Qeveria dëgjon zërin e vet. Ajo di të dëgjojë vetëm zërin e vet. Megjithatë ajo këmbëngul te mashtrimi se dëgjon vetëm zërin e popullit, dhe vazhdon t'i kërkojë popullit që ta përkrahë në këtë mashtrim.” (Marx, *Birokratija i javnost*, f. 103)

<sup>487</sup> Mann, *Legenda o Josipu*, I, O. Keršovani, Rijeka, 1960, f. 592.

<sup>488</sup> “Menjëherë pasi ideologjia të institucionalizohet, edhe kjo shtresë kuptimore në të që ka provokuar kryeneçësi, përderisa ka bërë thirrje për të ardhmen, fiket dhe humbet shpejt në procesin e përshtatjes nëpër institucionet ekzistuese dhe në qëllimet e tyre. Për këtë arsye, ideologjia në pushtet, me kalimin e kohës, nxit shumë pak dhe vjen duke u bërë përherë e më e mërzitshme. Risitë nuk vlejnë më për të përmirësuar mendimet, por për lajka.” Honore de Balzac, *Propale iluzije*, Kultura, Zagreb, 1952, f. 349.

<sup>489</sup> F. Pol, *Reklamokratija*, f. 85.

“Pra, ç'është njeriu sot dhe ç'i nevojitet truri? Vetëm që të kuptojë më lehtë se është një zero.” (Mihailo Lalić, *Lelejska gora*, Grafički zavod, Titograd, 1973, f. 206)

dërgimi i mesazheve racionale<sup>490</sup> në turmë, por, pyetja e vërtetë është se cilët janë motivet e nënvetëdijsëm dhe të pavetëdijsëm që shtyjnë turmën të pikasë mesazhet, t'i pranojë e t'i ndjekë ato. Mesazhet racionale mund ta gjejnë shumë rrallë rrugën për të vënë në lëvizje motivet, pritshmëritë dhe emocionet. "Ai apo ajo që kërkon t'i bëjë për vete turmat duhet të ketë çelësin që hap zemrat e pjesëmarrësve në turmë, ose nënvetëdijen e tyre."<sup>491</sup> Një lider i vetëdijsëm arrin të kontrollojë fuqitë e nënvetëdijes së nënshtetasve të tij, dhe kështu provon se mund t'i udhëheqë ata. Në fakt, ajo që ai kontrollon është nënvetëdija e tyre.

Nëse dilet në përfundimin se të bindurit ideologjiko-politik është joefikas dhe forcon qëndrimet ekzistuese të individëve dhe grupeve, atëherë nuk është e qartë (me kusht që të gjitha kushtet e tjera të jenë të njëjta) se si është e mundur që një parti politike, nëse është e vogël në numër, ekonomikisht më e dobët se të tjerat, të mos vijë fare në pushtet; ose si është e mundur të humbasin përkrahësit e tyre partitë e konsoliduara. Pra, të bindurit ideologjiko-politik duhet shpëguar. E nëse ky realitet nuk do të ishte i tillë prej kohësh, organizatat politike (etj.) do hiqnin dorë prej kësaj metode udhëheqjeje. Udhëheq më lehtë ajo qeveri që udhëheq më pak, sepse i lë qytetarët të udhëhiqen ashtu siç pret vetë qeveria që ata të udhëhiqen. "Ata le të ta kumtojnë vullnetin tënd."<sup>492</sup>

Të bindurit nuk duhet të fillojë me dëshmitë, pasi bindja e individëve dhe e grupeve është e gabuar dhe e dëmsh-

<sup>490</sup> Kombet e Bashkuara shpenzojnë shuma marramendëse për informimin objektiv të njerëzve për paragjykimet racore, por nuk është dija ajo që i zvogëlon paragjykimet. (Ph. Zimbardo and . E. B. Ebbesen, *Influencing Attitudes and Changing Behavior*, Addison-Wesely, 1969)

<sup>491</sup> Huxley, *Brave New World Revisited*, p. 42.

<sup>492</sup> Mann, *Legenda o Josipu*, II, f. 156.

me, ngaqë një mënyrë e tillë vetëm sa do të rriste rezistencën ndaj ndryshimit të bindjes (njerëzve nuk u vjen mirë kur u thuhet se nuk e keni seriozisht). Ajo që bën një manipulues i zoti qëndron në faktin se ai duhet të shfrytëzojë bindjet ekzistuese duke pranuar vlerën e tyre, dhe t'i bindë njerëzit të veprojnë konform bindjeve të tyre. "Në fund të fundit, administrimi nuk nënkupton t'i imponosh turmës ide apo metoda që pak a shumë janë të bazuara, por që ideve të pasakta apo të mira të këtyre turmave t'u shtohet një drejtim i dobishëm, i cili do t'i bënte këto turma të përputheshin me të mirën e përgjithshme."<sup>493</sup> "Ne nuk i imponojmë popullit kurrfarë risish. Ne vetëm sa marrim përsipër realizimin e asaj pa të cilën – sipas mendimit të përgjithshëm e të njëzëshëm – nuk mund të jetohet në Rusi."<sup>494</sup>

Një bindës i kujdesshëm përpiqet të krijojë dhe të mbajë gjallë ndjenjën se ato vendime politike që me të vërtetë aprovohen dhe zbatohen, pavarësisht se janë kundër vullnetit të njerëzve, përbëjnë manifestim të kërkesave të tyre. Bindësi e shpërfaq veten si një gojë përmes së cilës populli shpreh lëvizjet e fshehta të instinkteve, të mendimeve dhe kërkesave.

Ai i zbulon turmës atë që tanimë ishte në gjirin e saj, dhe ajo nuk ishte e vetëdijshme për këtë. Me fjalë të gjetura ai shpreh atë që tashmë ka nisur të zgjohet në nënvetëdijen e turmës. "Ju që përmes teknikave të ndryshme të gojëtarisë drejtoni këtë botë të pushtetshme dhe punët e saj të mëdha! Ju që e ngrohni dhe e ftohni, që e zbusni dhe e egërsoni, e më

<sup>493</sup> Për këtë temë është e nevojshme të lexohet *Komedia njerëzore*: "Ju doni të sundoni mbarë botën, apo jo? Në radhë të parë ju duhet t'i nëshetroheni botës dhe ta studioni mirë atë. Të diturit studiojnë librat, politikanët studiojnë njerëzit, interesat e tyre, shkaqet e veprimit të tyre." (Balzac, *Propale iluzije*, f. 711)

<sup>494</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 184.

pas e ngurtësoni rishmi këtë botë sipas qejfit tuaj! Ju që ndizni instinktët nëpërmjet këtij çikriku të madh! Prandaj, pasi e keni bërë këtë, i degdisni aty ku doni këta të nënshtruar.”<sup>495</sup>

Në të shumtën e rasteve stabiliteti politik sigurohet me forcë; pjesërisht me forcë por pa dhunë, si dhe me bindje pa dhembje. Partia në pushtet zbraz çdo ditë breshëri “silurash ideologjike” mbi turmat, që interesin e partisë ta pranojnë si një të vërtetë të shoqërisë.<sup>496</sup> Dhe në fund, që ky sistem përpjekësh për krijimin e një stabiliteti artificial të plotësohet, është përzgjedhur një ushqim shpirtëror me kujdesin më të madh, që ka qenë i lejuar për popullin, dhe i është dhënë në dozat më të vogla të mundshme.<sup>497</sup>

A do u përshtatet peshkatarëve të shpirttrave njerëzorë që të shlyejnë prej shpirtit tonë mendimet për lirinë, barazimin dhe humanizmin, e në vend të tyre të endin mendime të reja: dëgjueshmërinë, hierarkinë dhe autoritetin?<sup>498</sup> Një gjë është e sigurt: ata kanë mundësi që ta mbjellin farën e tyre; ata kanë shpresë që fara e tyre do mbijë, më shumë nga çkanë shkencëtarët, filozofët dhe artistët humanë. Këta të fundit nuk flasin me “gjuhën e vegjëlisë”, nuk zbresin ndër turma, nuk premtojnë asgjë; e vetmja gjë që mund ta ofrojnë ata është e vërteta që turma nuk e kupton, madje ka frikë prej saj. “Ata nuk më kuptojnë. Unë nuk kam gojë për ata veshë.”<sup>499</sup>

<sup>495</sup> L. Stern, *Tristam Šendi*, f. 404.

<sup>496</sup> Marx-i flet për “atë parti, kufizimi i së cilës është i shenjtë”. (*Birokratija i javnost*, f. 120)

<sup>497</sup> Marx-Engels, *O vaspitanju i obrazovanju*, Beograd, 1948, f. 62.

<sup>498</sup> Po aty, R. F. Miler, *Stada i pastiri*, Narodno delo, Beograd, 1934, f. 418.

“Vallë, a nuk i shkon për shtat dinjitetit të qeverisë që shpirtit të popullit të vet t'i shtrijë jo vetëm njërën dorë, por të dyja?” (Marx, *Birokratija i javnost*, f. 71)

<sup>499</sup> Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 15.

“Kaloj mes këtij populli dhe them ndonjë fjalë; por ai nuk di të pranojë apo të mbajë gjë.” (Po aty, f. 156) “Kjo ngaqë edhe vetë turma do komoditet, nuk kërkon

Shpeshherë turma nuk mund t'i bëjë ballë shtrëngatës së simboleve hireplotë. Këto simbole nuk duhet të jenë të vërtetë, dhe si të tillë ata prekin telat më të ndjeshëm të nevojave dhe pasioneve, në veçanti kur turma gjendet nëpër situata të mëdha pasigurie dhe frike. "Në ato ditë frike dhe neverie, abstraksioni kurorëzohet me fuqitë më të errëta të epsheve, kurse fuqitë e shpirtit njerëzor me instinktët e passionit, dëshirave dhe makutërisë."<sup>500</sup> Në këso ditësh dashuria për të afërmin shkëmbehet me bindjen ndaj organizatës.

më shumë sesa një arsye për shpjegim; nuk i do interpretimet e gjata shkencore; ajo kërkon zgjidhje të thjeshta dhe probleme të zgjidhura."

<sup>500</sup> R. F. Miler, *Stada i pastiri*, f. 158.

## INDOKTRINIMI<sup>501</sup>

*“Njëherë shpirti ishte Zot, më pas u bë njeri,  
dhe tani do shndërrohet edhe në zgjyrë!”*

Nietzsche

Nga dita në ditë konsumojmë shumë simbole, siç konsumojmë produkte të cilat nuk i prodhojmë vetë. Ne notojmë në një det simbolesh. Siç lagemi nga uji i detit, ashtu lagemi edhe nga një mori e pafund simbolesh (informacionesh). Të përzgjedhësh nga ky det informacionesh ato që na përgjigjen ne për qëllime racionale dhe humane, nuk është një proces aspak i lehtë e i pamundimshëm kur e përqasim pikërisht me krijimin e këtyre simboleve. *Ndoshta sot njeri krijues duhet të quhet secili nga ata njerëz që është në gjendje të njohë një simbol të vërtetë në detin e simboleve të sajua, sepse bota jonë e simboleve është më e ndotur se bota jonë materiale.*

### Mbështetja te besimi

Shfaqjet dhe njohuritë tona për botën (si dhe për veten) nuk i arrijmë nëpërmjet përvojës së drejtpërdrejt, por kryesisht i marrim nga të tjerët. “Rregulli i parë për të kuptuar qëndrimin e njeriut është se njerëzit jetojnë në botët e dorës së dytë...

<sup>501</sup> Kjo fjalë vjen nga latinishtja, *doctrinare*, që nënkupton “jap mësim”, para së gjithash për fenë e krishterë, e më pas edhe në fusha të tjera. “A person indoctrinates P (a proposition or a set of propositions) if he teaches with intention that the pupil or pupils believe P regardless the evidence.” (I. A. Snook, *Indoctrination and Education*, Routledge and Kegan paul, London, 1972, p. 47) “Indoctrination is the teaching of any subject matter with the intention it be believed regardless the evidence.” (op. cit., p. 75)

Pamjet për botën dhe për vetveten ua ofrojnë masat me dëshmitarë që ata nuk i kanë njohur kurrë, dhe as do t'i njohin ndonjëherë. Por, megjithatë, për çdo njeri, këto shfaqje/imazhe, me të cilat furnizohet nga të huajt dhe të vdekurit, në fakt përbëjnë vetë bazën e qenies së tij njerëzore.”<sup>502</sup>

Atë çfarë ne e quajmë përvojë të drejtpërdrejtë, me sa duket është një iluzion i pastër, sepse ne nuk kemi një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me botën, në kuptimin që mund ta vëzhgojmë, ta përjetojmë, *pavarësisht nga përvojat sociale*, konceptet, teoritë, klasifikimet, instrumentet matëse, kriteret, gjuha, problemet dhe sistemet e vlerave. Mes nesh dhe të ashtuquajturës botë reale qëndron një mori *ndërmjetësish*, kështu që ne e shohim, e përjetojmë dhe e shpjegojmë botën përmes modeleve eksperimentale dhe teorike, që nuk i kemi krijuar ne, që na janë imponuar në një formë të pakapshme përgjatë procesit të socializimit. “Dy të tretat e mendjes së njeriut përbëhet nga mendime të gatshme, besime, zakone dhe ambicie të huaja, që janë shndërruar në një pronë publike, si një rrugë apo park; kështu që njeriu nuk e vëren kurrë se çfarë i përket atij dhe çfarë ka marrë nga e përgjithshmja dhe gjithçkaja.”<sup>503</sup>

Është e pakontestueshme që, sidomos fëmijët, dinë më shumë për ato gjëra me të cilat nuk kanë pasur një *përvojë të drejtpërdrejtë* sesa për ato gjëra, vetitë e të cilave i kanë njohur vetë. Për shembull, njohuritë e tyre rreth historisë mund të jenë të gjera, pavarësisht se nuk e kanë përjetuar drejtpërdrejtë asnjë ngjarje historike. Kjo ndodh edhe me fushat e tjera të dijes. Në mungesë të përvojës së tyre, fëmijët janë të detyruar të mbështeten te përvoja e të rriturve, *për t’iu besuar atyre*.

<sup>502</sup> Rajt Mills *Znanje i moć*, Vuk Karadžić, Beograd, 1966, f. 134.

<sup>503</sup> Jovan Dučić *Jutra sa Leutara*, Svjetlost, Sarajevë, 1969, f. 94.

Me zemra të hapura dhe me mendje të virgjëra, djemtë dhe vajzat janë të prirë të *besojnë* gjithçka që u thotë (autori-teti) i rrituri, pasi ata nuk i kanë të zhvilluara fuqitë *kritike* për të gjykuar dhe kërkuar prova racionale. Fëmijët janë të varur nga të rriturit në çdo drejtim, duke përfshirë këtu edhe “pikëpamjen mbi botën”, që ata e marrin po prej tyre. “Ka çaste kur shpirti, sidomos gjatë viteve të rinisë, është plot me frymëzim, saqë mjafton vetëm një përpjekje e vogël për t’u arritur e gjitha... Si një lule që sapo ka çelur, që mbështetet me dashuri pas trupit të vet të brishtë, dhe është e gatshme t’ia dhurojë aromën kujtdo që sillet rreth saj. Këto çaste, përpara të cilave duhet të përulemi me një respekt të përkorë, zhdërvjelltësia e gjallë është e gatshme t’i qëllonte dhe, në fluturim e sipër, i pushton me synimin për të farkëtuar mbi to një vullnet i cili nuk di të mbrohet.”<sup>504</sup>

### **Breza të formuar sipas porosisë**

Nga fakti që të besuarit, të menduarit dhe sjellja (në situata të ndryshme) janë produkte të të mësuarit, rezulton se qenia njerëzore mund të mësojë të besojë e të veprojë në atë mënyrë që kërkon sistemi. Njerëzit që ushtrojnë pushtetin kanë në dispozicion instrumente të caktuara, nëpërmjet të cilave mund t’i bindin të rinjtë se ajo që synojnë pushtetarët (të fuqishmit) përputhet me synimet e të gjithë të rinjve. Prej këtyre instrumenteve do veçojmë vetëm shfrytëzimin e sistemit shkollor për qëllime manipuluese.

Funksioni i parë i shkollës është që të *transmetojë* trashëgiminë kulturore apo traditën te brezi i ri. Pjesë e traditës është çdo gjë që bazohet në kritere të caktuara, që është për-

<sup>504</sup> Manzoni *Verenici*, Prosveta, Beograd, 1966, f. 176.

zgjedhur nga tërësia e historisë. Kriteret zyrtare të përzgjedhjes i cakton elita e pushtetit, që do të thotë se nga historia do të merren vetëm ato ide (simbole) që vërtetojnë, fuqizojnë dhe zhvillojnë *ideologjinë* në pushtet. Nëse këtë e kërkon interesi i grupit sundues, e gjithë historia do i nënshtrohet riinterpretimit, në mënyrë që të vërtetat “e vjetruara”<sup>505</sup> të shkencës së historisë të harmonizohen me mendimet ideologjike të klasës në pushtet. Mendimet ideologjike të klasës në pushtet, që janë bazuar në interesa të kufizuara, doemos që do jenë të kufizuara, duke pasur parasysh edhe mendësinë e tyre. Kjo nuk i pengon ata që, falë mekanizmeve të tjerë shtrëngues, t’i shtyjnë në ndërdije apo drejt harrësës të gjitha ato ide që – duke pasur parasysh interesin dhe mendimin e atyre që i shprehin – janë më të gjera dhe më njerëzore. Kështu, interesi i pushtetit, duke i privuar brezat e rinj që të njohin idetë racionale dhe humane (simbole), siguron mbifuqinë me ideologjinë e vet, funksioni i së cilës nuk është të shpjegojë diçka, por vetëm të stabilizojë rendin ekzistues të gjërave.

“Rrobaqepësit e shpirtrave”, përmes sistemit shkollor përpiqen të krijojnë “robotë të frymëzuar” te brezi i ri<sup>506</sup>, duke injektuar në “vetëdijen fatlume” të tyre vetëm ato ide (simbole) që garantojnë një funksionim më të mirë të rendit ekzistues. Këta “censurë që i përçojnë mendimet në zinxhir”,

<sup>505</sup> Nevoja për rikompozimin e përhershëm të historisë, duket dyfish e kushtëzuar: teorikisht dhe praktikisht. Ngjarja historike mund të interpretohet rishmi duke u mbështetur në ndonjë teori të re ose në ndonjë evidencë të rizbuluar. Janë të shpeshta rastet kur ngjarjet historike interpretohen asisoj që interpretimi i tyre të jetë konform ideologjisë së elitës pushtetmbajtëse.

<sup>506</sup> Edukimi i të rinjve i fsheh anët e këqija të jetës njerëzore, dhe kështu i lë ata të papërgatitur për befasishtë. “Edukimi e përgatit rininë për një jetë me orientim jo të saktë psikologjik, dhe vepron si një një ekspeditë polare që vesh rroba verore... Në këtë edukim vërehet dukshëm keqëpërdorimi masiv i disa qëndrimeve etike.” (Freud, *Iz kulture i umetnosti*, f. 344-45)

përzgjedhin nga historia vetëm ato simbole në të cilët është shuar çdo zjarr dhe janë çliruar nga ana e tyre kryegrintëse; kështu që nuk ka asnjë rrezik që në kokat e të rinjve dhe të rejave të shkrepin vendime të egra e shpërthyesë. *Teknologjia e sjelljes*<sup>507</sup> e ka gjetur mënyrën që ata të thyhen, natyrisht pa u shkaktuar dhembje.”<sup>508</sup>

Një funksion tjetër i shkollimit shihet në përgatitjen e qenies së re për të marrë një rol ekzistues shoqërore (vepruese). Që një funksion i caktuar të ushtrohet në mënyrë efikase, nuk është e nevojshme të njohësh ndonjë *ide historike*, ndonjë besim apo praktikë, madje as ndonjë lloj tradite edukimi human. Ajo që kërkohet në kryeherë prej edukimit është formimi i profesionistit, tek i cili, cilësitë teknike, në njëfarë mënyre janë më të rëndësishme se ato humane. “Profesionisti, jo njeriu i kulturuar (apo hero), është ideali i edukativ i epokës burokratike. Kriteret e suksesit në sistemin burokratik, në radhë të parë janë teknike e më pas humane.”<sup>509</sup>

<sup>507</sup> “Technology of behavior” (B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 5 and p. 100)

<sup>508</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, Kultura, Beograd, 1960, f. 141.

“Vikitma e manipulimit nuk e di që është viktimë. Atij i janë mbyllur muret e burgut dhe beson se është i lirë. Që ai nuk është i lirë, kjo është e qartë vetëm për dikë tjetër.” (Huxley, *Brave New World Revisited*, Harper and Row, New York, 1965, p. 109)

<sup>509</sup> Në ç’masë është joracionale dhe johumane përgatitja e qenies së re njerëzore që të marrë vetëm një rol institucional në shoqëri? Në kohën tonë duket një mprehtësi e thellë. Dihet se të gjitha dijet tona, madje edhe ato shkencore, mplaken shumë shpejt dhe, ajo që ne e mësojmë sot si fjalën e fundit të shkencës dhe teknikës, mjafton të kalojnë disa vite dhe bëhet e papërdorshme, shpeshherë e tepërt. Pra, ashtu siç ndryshon me shpejtësi dija, edhe të vërtetat shkencore vjetrohen shpejt. Kjo është joafatgjatë dhe me vlerë, që mund t’ia ofrojmë brezit të ri (shkencëtarit): t’i formojmë ata si *shpirtra të hapur dhe kritikë*, të cilët do të jenë në gjendje të pozicionohen sa më mirë në rrethanat e ndryshueshme të mjedisit të tyre jetësor. Të paktën kjo nënkupton një mohim të pjesshëm të mënyrës tradicionale të edukimit dhe arsimimit, për të marrë një rol që do ushtrohet në të ardhmen. Në fillim të shekullit të ardhshëm, sipas disa parashikimeve, rreth gjysma e të punësuarve do të merren me ato punë që sot nuk klasifikohen si profesione.

Dikush mund të pyesë, nëse shkolla përgatit specialistë të pastër, atëherë pse duhet folur për indoktrinimin? Përgjigjja mund të jetë kjo:

Pas kërkesave që shkolla të integrohet në sistemin ekzistues, si një nënsistem funksional i veçantë, në fakt fshihen interesat tekniko-burokratike të strukturave të pushtetit (të elitave), që janë të interesuara për eliminimin e vetëdijes kritike të rendit ekzistues të gjërave, ose (që është e njëjta gjë) për asgjësimin e vetëdijes për t'u hapur rrugë mundësive të izoluara nga mënyra ekzistuese e organizimit shoqëror. Më konkretisht: kërkesa për integrimin e shkencës në sistem nuk është asgjë më shumë se një kërkesë për heqjen dorë nga roli i saj kritik (human) në shoqëri. Se sa ka hequr dorë prej këtij funksioni kritik në shoqëri kjo e ashtuquajtur shkencë pozitive, ilustrohet shkëlqyeshëm nga fakti se ajo është pranuar me dëshirë nga fuqitë politike dhe ushtarake. Shkenca e pavarur në aspekt të vlerave i shërben çdo sistemi, si më të mirit ashtu edhe më të keqit. Por, gjendja shoqërore e profesorit në shoqërinë borgjeze është e atillë që për ushtrimin këtij profesioni lejohen vetëm ata që shesin dijen për t'i shërbyer interesave të kapitalit.<sup>510</sup>

Detyra e tretë e shkollës haset te formimi i vetëdijes vlerësuese (vetëvetëdijes) të anëtarëve të shoqërisë. Përsëri është interesi në pushtet ai që e shtron çështjen:

Mjaft me ata që na bëjnë profesionistë të fortë e personalitete të dobët! Nuk duam një shoqëri të zhvilluar teknologjikisht dhe personalitete të pazhvilluar moralisht! Pasuria e shoqërisë nuk matet me të ardhura në dollarëve për frymë, por me numrin e frymëve morale të zhvilluara! A nuk nënkupton ruajtjen e nderit termi “edukim”?

<sup>510</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 323.

Grupi udhëheqës në shoqëri, që nëpërmjet sistemit shkollor përpiket të formojë një vetëdije unike vlerësuese në një shoqëri të përçarë në klasa<sup>511</sup>, synon të fusë ideologjinë e vet në programet arsimore dhe edukative, dhe më pas, “punëtorët intelektualë”, “mësuesit e rinisë të vendosur prej shtetit” (Engelsi), në mënyrë të planifikuar dhe sistematike e fusin atë në jetën e fëmijëve, duke helmuar shpirta të pafajshëm e duke i çuar ata drejt humnerës. *Institucionet për edukimin e të rinjve, në të njëjtën kohë shërbejnë edhe si institucione të pushtetit mbi të rinjtë.*<sup>512</sup>

Vallë, a është shkolla vendi ku qeniet e njoma mësojnë përgjigjet që ka dhënë njeriu? Apo është vendi ku njeriu ofron përgjigje për sfidat reale dhe të mundshme, – individuale për raportin e tij me natyrën dhe shoqërinë – të cilat duhen kaluar në mënyrë kritike nga brezi në brez? Mos ndofta është pikërisht vendi ku bëhet “degradimi i organizuar i personalitetit”?<sup>513</sup>

Për faktin që të rinjtë njohin vetëm idetë e së kaluarës, që i përzgjedh interesi i kufizuar në pushtet për të forcuar pozitat e tij, shtresa qeverisëse bëhet pengesë që të rinjtë të mësojnë rreth alternativave që kanë pasur në dispozicion brezat paraardhës, me justifikimin se ata duhet të marrin përshtypjen se e ardhmja është e përcaktuar nga e kaluara; pra, sistemi aktual është e vetmja alternativë e mundur. Klasa qeverisëse përpiket që të rinjtë “t’i harrojnë ato forma lufte dhe organizimi, ato ide e slogane që ka shkaktuar epoka revolucionare në atë shumicë e në atë larmi”.<sup>514</sup>

<sup>511</sup> “Në ato shoqëri ku kundërthëniet klasore janë të mëdha, nuk mund të ketë kurrë ideologji jashtëklasore apo mbiklasore.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 256)

<sup>512</sup> “Sepse ne, në linjën e punës edukative, nuk mund të jemi me qëndrimin e vjetër për një edukim apolitik; nuk mund ta vendosim punën edukative jashtë politikës.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 14, f. 60)

<sup>513</sup> Malraux, *Antimemoari*, f. 550.

<sup>514</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 420.

Për të rinjtë, e kaluara e vërtetë mund të jetë një “fushë e së pavetëdijshmes”, dhe për këtë arsye, siç ka thënë Lenini, ata duhet të kujtojnë sloganet revolucionare, që ideologjia sunduese kërkon t’i mënjanojë për t’i çrrënjosur. “Ne kemi nevojë të kujdesemi – e përveç nesh askush nuk ka pse brengoset – që populli të mësojë në mënyrë shumë të hollësishme e të detajuar për këto ditë plot jetë, të pasura me përmbajtje dhe të mëdha për shkak të domethënies dhe rrjedhëve të tyre, e kështu s’ka ç’të mësojë për ata muajt mbytës “kushtetues” të prosperitetit; për qëndrimin mëshirues pasiv të Stolipinit dhe shpurës së tij me censorë e xhandarë, ngjarje të cilat trumbetohen me hidhërim prej organeve të shtypit “demokratik, partiako-liberal dhe jashtë-partiak”.”<sup>515</sup>

Sot “horrat me ndikim të madh”, i ndalojnë, i kontrollojnë dhe i censurojnë idetë me të gjitha mënyrat e mundshme, që si për nga interesi që qëndron pas tyre, si për nga kuptimi dhe thellësia e ideologjisë sunduese, pengojnë drejtpërdrejt zhvillimin e mundësive intelektuale, morale dhe kulturore të të rinjve, duke i reduktuar këto mundësi në kornizat e rendit ekzistues me ndihmën e shkencës së bindjes. “Kjo pjellë e mbrapshtë, që e pi padrejtësinë si ujë, ka kohë që meriton përmbytje, pa arkën e shpëtimit.”<sup>516</sup>

Për faktin se vëmendjen e të rinjve e largon në mënyrë sistematike nga problemet reale drejt atyre imagjinare, – me përzgjedhje dinake, me organizim dhe shpërndarje simbolësh, që përmes vetëdijes veprojnë mbi nënvetëdijen, dhe kështu i orientojnë ndjenjat, mendimet dhe sjelljet në një drejtim tjetër – grupi qeverisës i shmang me dinakëri pyetjet e pakëndshme që kanë të bëjnë me thelbin dhe *sigurohet*

<sup>515</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 422.

<sup>516</sup> Mann, *Legenda o Josipu*, I, f. 602.

*nga kritika.* Duke qenë se ky grup u *premt*on një të ardhme më të mirë të rinjve, e *sund*on lehtë të tanishmen. (Të rinjve u lë ëndrrën, për vete zgjedh realitetin.) “Nga të gjitha pasuritë që ka bota, e ardhmja është më e rëndësishmja dhe më e besueshmja.”<sup>517</sup>

Njerëzit nuk janë plotësisht të vetëdijshëm<sup>518</sup> se sa shfrytëzohet sistemi shkollor si mjet indoktrinues, në vend që të shfrytëzohet si një mjet për përhapjen e vlerave universale kulturore, artistike, morale e shoqërore.

A do të jetë sistemi shkollor një mjet për fuqizim ideologjik të interesave në pushtet apo një mënyrë për zhvillimin e mundësive intelektuale, morale dhe shoqërore të njerëzve? Përgjigjja për këtë pyetje thelbësore në njëjtën kohë është edhe përgjigje për çështjen se ç’soj njeriu duam dhe ç’mund të presim prej tij.

### Djerrina mendore

Mësuesve të rinisë të emëruar prej shtetit<sup>519</sup> u është besuar timoni i shpirtit.<sup>520</sup> “Mos ndoshta pas këtyre mësuesve, pas fjalëve të tyre të errëta, të mërzitshme, të mëdha, mund të jetë fshehur revolucioni?”<sup>521</sup>

Djerrina mendore<sup>522</sup>, e prodhuar artificialisht me anë të manipulimit të mendjes së fëmijëve<sup>523</sup>, një djerrinë që duhet

<sup>517</sup> Balzac, *Slike iz seoskog života*, O. Keršovani, Rijeka, 1960, f. 138.

<sup>518</sup> “Njerëzit kanë qenë dhe do të jenë gjithnjë viktima mesquine të mashtrimit dhe vetëmashtrimit në politikë, përderisa nuk mësojnë se pas çdo fraze shkencore, fetare, sociale apo politike; pas çdo deklarate dhe premtimi kërkohet përmbushja e interesave të një klase të caktuar.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 173)

<sup>519</sup> Engels, *Ludvig Fojerbah i kraj klasične nemačke filozofije*, Kultura, Beograd, 1947, f. 9.

<sup>520</sup> Marx, *Birokratija i javnost*, f. 63.

<sup>521</sup> Engels, po aty.

<sup>522</sup> Marx, *Kapital I*, Kultura, Beograd, 1947, f. 322.

<sup>523</sup> Po aty, f. 416.

të dallohet qartë nga mosdija e natyrshme, që truri e lë të papërpunuar, duke mos cenuar aftësitë e veta për zhvillim, pllëshmërinë natyrore, është një e metë që Marx-i e ka theksuar shumë, kundër së cilës ai ka luftuar ashpër. Le të kujtojmë: “Ju e konsideroni despotizëm kur një njeriu të lirë i priten flokët kundër vullnetit të tij, por krijesave shpirtërore, censura e përditshme u pret copat e mishit dhe u jep lejekalim si të rregullt vetëm trupave që nuk kanë shpirt, që nuk reagojnë, trupave të nënshtruar.”<sup>524</sup>

A është e mundur të zhvillohet ndryshe intelekti/shpirti përveçse duke rezistuar kundër fuqive që e zvogëlojnë?<sup>525</sup> “A jemi ne përgjegjës që shteti na ka besuar të bëjmë “zmalltin fisnik të së vërtetës”.<sup>526</sup> Pra, përgjegjës para shtetit apo para të vërtetës? A jemi të vetëdijshëm për aktin më të përgjegjshëm që mund të imagjinohet – edukimin dhe shkollimin e brezit të ri?

Nëse ne që kemi vendosur me vullnetin tonë të mblehim, hulumtojmë, të përhapim dhe të krijojmë thesarin ideor të shoqërisë, të përhapim “zjarrin e ideve”<sup>527</sup>, që në sipërfaqe dhe poshtë interesave politiko-ideologjike ka filluar të fiket, nëse ne nuk do të kujdeseshim për shëndetin ideor të të rinjve, pyes se kush do ta bëjë këtë në vendin tonë? Mos do e bëjë grupi elegant i të marrëve, për të cilët Marx-i me të drejtë ka thënë se “opinionin shkencor nuk i njeh, kurse qeveri po”?<sup>528</sup>

<sup>524</sup> Marx, *Birokratija i javnost*, f. 89.

<sup>525</sup> “Gjermania është zhvilluar shpirtërisht jo falë censurës, por duke e luftuar atë.” (po aty, f. 70)

“Kjo është një lloj sikur një titan të detyrohet të rrojë në shtëpinë e një pigmeu.” (po aty, f. 109)

<sup>526</sup> “A nuk kuptohet vetvetiu se kufiri i jashtëm i një jete shpirtërore nuk bie në karakterin e brendshëm të kësaj jete, se ky kufi nuk e vërteton këtë jetë, por e mohon atë?” (po aty, f. 91)

<sup>527</sup> Sërish një frazë e Marx-it.

<sup>528</sup> Po aty, f. 58.

Njerëzit e ditur e kanë për detyrë që t'i ndriçojnë shpirtat e rinj me entuziazmin e tyre kërkues, dhe me gjuhën e kritikës t'i inkurajojnë ata për një aventurë shpirtërore<sup>529</sup>:

Në qoftë se në mendjen tuaj zgjohet interesi për të kërkuar të vërtetën; në qoftë se në syrin tuaj keni gjakimin për të bukurën; në qoftë se brenda zemrës suaj ndjeni nevojën për të bërë vepra të mira, atëherë kujdesuni për këtë farë të shkëlqyer, se prej saj do çelin lule që nuk njohin vyshkje.

Këto janë fjalët e një njeriu të brengosur, i cili u drejtohet të shqetësuarve, mendja dhe zemra e të cilit punon në frekuenca të larta, ndryshe nga ritmi i përditshmërisë dhe indiferencës së përgjithshme. E di që fjalët e mia nganjëherë tingëllojnë si një rrëfim vetjak, por për ç'arsye do e privonim shkencën nga ndjenjat, të cilat janë të rëndësishme për fatin e të gjithëve? Nëse këto ndjenja dhe ide do manifestonin vetëm ankthin dhe shqetësimin tim, nëse nuk kanë të bëjnë me të gjithë ne, atëherë as unë nuk do i bëja publike<sup>530</sup>, dhe kështu ato do ishin thjesht ca dëshmi pa vlera të mëdha. Por, duke mos qenë të tilla, madje për shkak të synimeve të tyre, kam frikë se do na duhet t'i shqyrtojmë me seriozitet, duke dëshmuar se të paktën kemi menduar si njerëz, pavarësisht se nuk ditëm të jetonim njerëzisht. Deri në frymën time të fundit do luftoj që punonjësit pedagogjikë të mos zëvendësohen nga policia pedagogjike. Le të mos reshtë "lufta e parimeve pa forcë me forcën pa parime"<sup>531</sup>.

<sup>529</sup> "Frikë nga dashi, frikë nga jashtëqitja, por kur do rrojë xhanëm?" (Mesha Selimović, *Turdava*)

<sup>530</sup> "Unë fola publikisht dhe nuk thashë gjë fshehurazi... (*Ungjilli sipas Gjonit*, kap. 18. parag. 20)

<sup>531</sup> Marx-i e shpjegon në mënyrë të shkëlqyer: "Ju flisni pa mësuar, filozofia flet pas të mësuarit; ju premtori tokën dhe qiellin, ajo nuk premtori asgjë veç së vërtetës; ju kërkoni që të besohet bindja juaj, ndërsa ajo nuk kërkoni të besohen rezultatet e saj – kërkoni vetëm të studiohet ajo që është e dyshimtë. Ju frikësoni, ajo qetëson..." (po aty, f. 130)

## INDUSTRIA E ARGËTIMIT<sup>532</sup>

*“...komplimente të ulëta për lakminë.”*

Marx

Çdo individ, çdo grup dhe çdo shoqëri kanë bindje, qëndrime dhe kërkesa të ndryshme<sup>533</sup>, dhe secilën nga këto kërkesa, bindje dhe qëndrime përpiqen që ta njohin, ta orientojnë (ta forcojnë ose ta ndryshojnë) dhe ta shfrytëzojnë një lloj i veçantë ekspertësh: eksperti i reklamës njih, orienton dhe shfrytëzon bindjet, qëndrimet dhe nevojat, duke pasur parasysh interesin e tij material; propaganduesi politik, duke pasur parasysh forcimin dhe mbajtjen e pushtetit të tij politik; indoktrinuesi, duke pasur parësore bindjen e tij ideologjike; eksperti i argëtimit, duke pretenduar përfitimin; predikuesi fetar, duke dashur të forcojë autoritetin e tij.

### **Shfrytëzimi i instinkteve, nevojave...**

Brenda një sistemi të përgjithshëm shrytëzimi është e logjikshme të shfrytëzohen bindjet, dëshirat dhe shijet tona, ashtu siç shfrytëzohen gurthyesit, minierat dhe fushat e naftës. Shrytëzohet e vetëdijshmja, e ndërtdijshmja dhe e pavetëdijshmja, që do të thotë se motivi i përfitimit jo vetëm që ka depërtuar në vetëdije dhe ndërtdije, por edhe në shtre-

<sup>532</sup> Më vjen më për mbarë të përdor frazën “industria e argëtimit” sesa “industria e vetëdijes” (Bewusstseinsindustrie, Illusionsindustrie), pasi më shumë manifestohet shfrytëzimi i epsheve sesa propagandimi i ideve.

<sup>533</sup> Për më gjerë: M. Rokeach, *Beliefs, Attitudes and Values*, Jossey-Bass Inc., San Francisco, 1970, pp. 181-182.

sat më të thella të jetës sonë psikike. Ne mësohemi me institucionet për studimin e tregut, – dhe ky treg nuk është asgjë tjetër përveçse vetëdija dhe ndërdija jonë, që ia vlen të shfrytëzohet – për studimin e motivit, për spiunazh ekonomik, për difuzionin e njohurive psikanalitike, për antropologjinë industriale, për psikologjinë e turmave etj., ashtu si në të gjitha institucionet e tjera shoqërore. Ne jemi të rrethuar nga institucione të ndryshme që garojnë për të përmeshur epshet tona – në mënyrë që t’i shfrytëzojnë<sup>534</sup> deri në palcë – e jo nevojat tona intelektuale, morale dhe kulturore, apo kërkesat shoqërore. Madje edhe edukimi dhe arsimimi po kuptohen më pak si njohje me idetë, bindjet dhe vlerat që duhen ditur, por gjithnjë e më shumë si aftësi për të blerë, shitur, argëtuar apo për t’u kënaqur...<sup>535</sup>

Çdo mesazh i ri (ide, simbol) në këto fusha, si: reklami, propaganda, indoktrinimi, argëtimi, predikimi, nuk duhet vlerësuar me masa njohëse apo morale, sepse, në fakt, mesazhi nuk ka vlere informative. *Funksioni i tij themelor nuk është informimi, por shfrytëzimi.* Në një shoqëri me klasa ndryshohet vetëm fusha dhe forma e shfrytëzimit, por shfrytëzimi si i tillë mbetet i pandryshuar. “Njerëzit e aftë përpara këtij populli të ndershëm njohin shumë mënyra për t’u shtirur, ashtu siç mund t’u vijë për hosh vetë atyre.”<sup>536</sup>

Ne jemi mësuar që kategoritë e shfrytëzimit, përfitimit, tregut dhe konsumit t’i përdorim në analizat e punës së tje-

<sup>534</sup> “Nuk ka dyshim që reklama lidhet me një prej emocioneve themelore të shpirtit njerëzor, dhe mund të ndikojë më tepër, ndryshe nga shitja e thjeshtë e mallit: ajo forcon epshin, duke e ndihmuar që të dalë në sipërfaqe; i ofron cakun e duhur. Në këtë mënyrë, nga viti në vit, kemi siguruar një numër të caktuar klientësh, që është baza themelore për zgjerimin e aktiviteteve tona.” (F. Pol, *Reklamokratija*, Izdavački zavod Jugoslavije, Beograd, 1967, f. 79)

<sup>535</sup> J. Henry, *Culture Against Man*, p. 81.

<sup>536</sup> Igo, *Jadnici*, I, Rad, Beograd, 1960, f. 46.

tërsuar dhe orarit të punës. Por, me zhvillimin e marrëdhënieve mall-para, mësohemi që në analizat e kohës së lirë të shfrytëzojmë të njëjtat kategori. Këto kategori, domosdo që kalojnë nga orari i punës në kohën e lirë, që në të vërtetë resht së qenuri e lirë, sepse edhe ajo i nënshtrohet mbretërisë së kapitalit.

Krëfimi për kohën e lirë vlen vetëm si kujtim, sepse për të mund të flitet vetëm me kushtin që ajo të jetë e organizuar sipas parimit që për nga cilësia të jetë e larmishme, madje edhe në kundërshtim me racionalitetin përfitues. Është vështirë të imagjinohet që shtresat e gjera, të cilat punojnë përgjatë gjithë jetës, do dinë ta organizojnë kohën e tyre të lirë ndryshe përveçse sipas modelit të orarit të punës. Çfarë mund të pritet?

Nëse njeriu punon pa interes për atë që bën, nëse ai e blen dhe e shpenzon një artikull në mënyrë abstrakte dhe të tjetërsueshme, atëherë si mund ta shfrytëzojë ai kohën e lirë në mënyrë aktive dhe përmbajtjesore. Ai do mbetet gjithnjë një konsumator i tjetërsueshëm dhe pasiv. Ai konsumon "futbollin", filmat, gazetatat dhe revistat, librat, ligjëratat, bukuritë natyrore, mbledhjet sociale etj., në të njëjtën formë abstrakte dhe të tjetërsueshme siç konsumon një artikull/-produkt të caktuar që blen. Ai nuk merr pjesë aktive; ai do të "marrë" gjithçka që mund të merret dhe të përjetojë më shumë kënaqësi, kulturë etj. Në të vërtetë, ai nuk është i lirë që të shfrytëzojë "kohën e tij të lirë". *Shfrytëzimin e kohës së tij të lirë e kushtëzon industria*, sikurse dhe mallin që ai blen. Shijet e tij komandohen nga të tjerët. Ai ka dëshirë të dëgjojë dhe të shohë atë që është e predestinuar për të. Argëtimi është një industri si të gjitha industritë e tjera. Blerësi është i kushtëzuar të blejë të njëjtin argëtim siç blen rroba e këpu-

cë. Vlera e argëtimit është e caktuar nga sukcesi i tij në treg, e jo nga diç që mund të matet me kritere njerëzore.<sup>537</sup>

Për aq sa nuk arrihet ky qëllim (shkëmbimi i të mirave materiale të mos jetë një shkëmbim i njëjtë malli), *shfrytëzimi i punës gjatë orarit të punës do i përgjigjet shfrytëzimit të shijes në kohën e lirë*. Nuk ka fushë ku nuk sundon ky kapital. “Kapitali është një njeri krejt i humbur.”<sup>538</sup>

### Argëtimi dhe hallet

Industria e argëtimit dhe ëndërrimit, zakonisht merret si rast kur manipuluesi nuk ka qëllim të ushtrrojë ndikimin ideologjik dhe politik mbi qëndrimet, bindjet dhe vlerat tona<sup>539</sup>, por vetëm t’i shfrytëzojë ato në bazë të parimit: sa më shumë të shihet, ndihet, merret erë, provohet, preket, ndjehet, aq më shumë dëshirohet, blihet, konsumohet, zbatohet, ëndërrohet, krijohen kënaqësi. Një lum i madh i prir-

<sup>537</sup> From, *Zdravo društvo...*, f. 143.

“Ky efekti i padëshiruar, para së gjithash duhej pritur, për faktin se edhe shpirtave më të talentuar u është nevojitur gjithnjë njëfarë kohe që të mësojnë se si ta përdorin vyer një dhunti të re, jo se koha e lirë ka qenë një dhuratë për ta – si gjithnjë, pavarësisht aftësisë së pranuesit për ta përdorur këtë kohë. Margaritarët, që tani i janë shpërndarë shumicës, po shkelen me këmbë prej tyre, pasi vetëm këtë di të bëjë ky lloj xhinsi me sjellje prej derri. Ata duhej të mbeteshin monopol i pakicës, e cila përbëhej ekskluzivisht prej njohurive.” (Shën Mateu, VII, 6)

“Keqpërdorimi i kohës së lirë nga shumica, që në fakt e kishte në dispozicion këtë kohë, nuk është ndonjë gjë e re. Në ditët kur koha e lirë ishte monopol i pakicës, shumica e kësaj pakice e keqpërdorte vazhdimisht këtë kohë.” (Tojnbi, *Istraživanje istorije*, II, Prosveta, Beograd, 1971, f. 281)

Disa studiues të kohës së lirë mendojnë se brezi i parë përpiqet ta vrasë kohën e lirë me çdo mënyrë. Brezi i dytë është i zënë me sport, me udhëtime pa kuptim e me kënaqësitë që ofron materia. Vetëm brezi i tretë paraqet interes që ta shfrytëzojë kohën e lirë për zhvillimin e nevojave kulturore.

<sup>538</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 211.

<sup>539</sup> Për më gjerë: M. Rokeach, po aty.

jes njerëzore për përmbushje rrjedh në drejtim të joshjes.<sup>540</sup> Lenini e kishte të qartë se pas industrisë së argëtimit dhe ëndërrimit fshiheshin qëllime politike. “Risitë pikante, të fabrikua çdo ditë nga ana e gazetave të mëdha borgjeze, të cilat merren edhe me këtë, që të shesin sa më shumë lajme të “freskëta” dhe “top” lajme, janë të dedikuara paraprakisht që të tërheqin vëmendjen e opinionit nga ato çështje që kanë vërtet rëndësi, pra nga baza e vërtetë e politikës “së lartë”.”<sup>541</sup> Ajo që është tërheqëse mënjanon atë që është e rëndësishme.

Industria e argëtimit dhe e ëndërrimit, shpeshherë është paralajmëruese e rreziqeve dhe krizave të thella sociale, që si shoqëruese psikologjike ka ndjenjën e mëdyshjes dhe pasigurisë.<sup>542</sup>

Të mos harrojmë se midis turmave që argëtohen ka shumë nga ata që me vetëdije apo pa vetëdije ikin nga vetvetja dhe kërkojnë të harrojnë realitetin. Gënjehemi nëse mendojmë se turmat zbaviten thjesht për shkak të nevojës për t’u kënaqur. Kjo është vetëm një shajni. Nëse shohim nën sipërfaqen e sjelljes së dukshme, do zbulojmë se nevoja për t’u argëtuar është manifestim i nevojës së thellë për t’u arratisur nga vetvetja, nga realiteti që na rrethon. Kjo është nevoja për të jetuar jetën e një Uni tjetër, i cili tashmë rron në çastet e harresës së Unit të përditshmërisë. Njeriu nuk mund të mendojë për hallet dhe varfërinë e tij kur është i preokupuar me argëtim. Kur ai vrapon pas topit, nuk mendon për detyrimet. Kur në ekran sheh lëvizjet e trupit të një

<sup>540</sup> Shih, Marx, *Kapital* II, f. 278.

<sup>541</sup> Lenjin, *Rani radovi*, vëll. 8, f. 179 (nënvizoi Gj. Sh.).

<sup>542</sup> Tolstoj, *Rat i mir* II, Prosveta, Beograd, 1965, f. 190.

“Siguria është piku më i lartë social i shoqërisë civile.” (Marx-Engles, *Rani radovi*, f. 60)

femre të bukur, aty për aty i ikën robërisë bashkëshortore. Kur gjuan sorkadhen nuk mendon për vdekjen e tij, por atë të sorkadhes. “E vetmja gjë që na ngushëllon në mizorinë tonë është argëtimi, që është një prej mizorive tona më të mëdha; sepse argëtimi është ai që na pengon që të mendojmë për veten, që na shkatërron tinëzisht. Sikur të mos ekzistonte argëtimi, do të neveriteshim; dhe kjo neveri do na shtynte në kërkimin e një mjeti më të besueshëm për ta hequr atë. Por, argëtimi na mashtron dhe na shpie drejt vdekjes pa e hetuar fare.”<sup>543</sup>

Sa më shumë halle e mëdyshje të ketë, aq më e madhe është nevoja për argëtim.

Njerëzit i frikësohen vetvetes, prandaj dhe nuk mund të argëtohen vetëm, por në turmë, ku fitojnë *siguri psikologjike* dhe *një fat të barabartë*. Madje asnjë nuk argëtohet në mënyrën e vet, por të gjithë njësoj, gjë që përbën një rast të veçantë të identifikimit në rrethanat kur turma rrezikohet në çfarëdo mënyre. (“Në melodinë e dalldisë së gëzimit, dëgjohet fare lehtë melodia e vdekjes”, shruan Sorel-i.)

Edhe sfera e argëtimit është bërë një hapësirë tjetërsimi, sepse të harrosh aty për aty vuajtjet dhe vdekjen nuk nënkupton se u ke dhënë karar këtyre çështjeve, të cilat në çastin më të parë pas argëtimit apo në ditët në vijim, kthehen sërish në vetëdijen tonë fatkeqe, madje e përkeqësojnë edhe më shumë gjendjen tonë të ndjekur nga dyshimet dhe bren gat e errëta.

<sup>543</sup> Paskal, *Misli*, Beograd, 1965, f. 83.

“Është më lehtë të përballosh vdekjen sesa mendimin për vdekjen, edhe atëherë kur ajo nuk na kërcënon.” (Paskal, po aty, f. 82) “Meqë njerëzit nuk ia dolën mbanë që të shëroheshin prej vdekjes, varfërisë, padijes, vranë mendjen për të qenë më të lumtur, që të mos mendojnë për të.” (Pascal, po aty)

Prodhimi i produktit më magjik, i ëndrrave, ka të bëjë me dëshirat e thella të njeriut, të shtypura në shoqërinë civile.<sup>544</sup> Kur dikush blen me para ëndrra të huaja, plotëson në mënyrë joreale nevojat e tij reale. Tregtarët e ëndrrave kënaqin egoizmin e tij nën vellon e plotësimit të dëshirave. Ëndrrat kanë një rëndësi madhore për kapitalin.

David Risman ka të drejtë kur thotë se ne dimë fare pak rreth argëtimit, dhe kështu kjo dije është e varfër dhe pjesërisht pasojë e një përkufizimi kulturor që i jep përparësi punës.<sup>545</sup> Ja pse ndodh që idetë e fituara në punë (të tjetërsuara) transferohen në mënyrë të pavetëdijshme në fushën e argëtimit. Nëse individit nuk mund të prodhojë vetë, por duhet të bashkohet me të tjerët, ai nuk di të argëtohet vetëm, por bashkë me të tjerët, në turmë. Nëse është i përfshirë në një sistem prodhimi masiv, ai nuk mund ta kultivojë stilin e tij në konsum. Fuqia e prodhimit masiv konsiston të prodhojë njësoj, derisa vetia e konsumit masiv ta shpenzojë në të njëjtën mënyrë atë që është prodhuar. Një sistemi të prodhimit masiv i përgjigjet konsumatori masiv, i privuar nga shija dhe prirja vetjake. Valës së standardizimit nuk i është nënshtuar vetëm prodhimi, por edhe konsumi, sepse njerëzit nuk mund të konsumojnë asgjë tjetër përpos asaj që prodhohet. Mënyra e prodhimit përcakton mënyrën e konsumit. Marx-i ishte largpamës kur shkruante: “Një nevojë e caktuar e individit shkon përtej formave të prodhimit, sepse me prodhimin nuk prodhohen vetëm mjetet e konsumit (me vlerë përdorimi), por edhe mënyra e tyre e konsumit, deri edhe shfaqja e dëshirës për këto prodhime.”<sup>546</sup>

<sup>544</sup> “Ëndrra është maska e plotësimit të një dëshire.” (Frojd, *Autobiografia*, f. 48)

<sup>545</sup> Risman, *Usamljena gomila*, Nolit, Beograd, 1965, f. 337.

<sup>546</sup> Hyrje nga viti 1857, f. 157, cituar nga Althusser-i, *Kako čitati Kapital*, Zagreb, 1975, f. 172.

Ashtu sikurse mënyra e prodhimit të të mirave materia-  
le përcakton edhe mënyrën e konsumit, po ashtu edhe pro-  
dhimi i të mirave kulturore përcakton mënyrën e konsumi-  
mit të tyre. Njerëzit nuk mund ta shfrytëzojnë në mënyrë  
masive një kulturë të huaj, përveç asaj që prodhohet në sho-  
qërinë civile, kulturën e konfeksionit. McLuhan-i bën një  
vlerësim të qëlluar kur thotë se është qesharake të thuhet se  
çfarë kërkon publiku që të shfaqet mbi nervat e tyre.<sup>547</sup> “Du-  
ke qenë se shqisat dhe sistemin tonë nervor ua kemi lënë në  
përdorim atyre që synojnë të nxjerrin fitime me qiradhënien  
e syve, veshëve dhe nervave tona, në fakt, nuk na ka ngelur  
asnjë e drejtë. T’i japësh sytë, veshët dhe nervat me qira për  
qëllime tregtare, është njësoj sikur t’i dorëzosh një bisedë të  
përbashkët një korporate private, ose sikur t’i japësh një  
kompanie monopolin mbi atmosferën e Tokës.”<sup>548</sup>

### “Mendja lavire”

Shoqëria civile është një shoqëri *repressive* në qenësinë e  
saj. Me normat e saj juridike, zakonore, religjioze dhe mo-  
rale, ajo i ka përcaktuar çdo pjesëtari se çfarë i lejohet dhe  
çfarë i ndalohet, çfarë i duhet dhe çfarë nuk i duhet, çfarë  
është e shenjtë dhe çfarë është laike. Me sistemin e vet të  
edukimit, kjo shoqëri inkurajon më shumë *nënshtrimin* ndaj  
këtyre normave sesa manifestimin e mundësive vetjake. Kjo  
lloj shoqërie nuk mund të quhet “shoqëri e shëndoshë”,  
sepse ajo e ngatërron njeriun në çdo hap të vetërealizmit të

“Çdo bashkësi që dëshiron të përshpejtojë dhe të rrisë shkëmbimin e të mirave  
dhe shërbimeve, thjesht duhet të homogjenizojë jetën e vet shoqërore.” (Makluan,  
*Poznavanje opština*, f. 287)

<sup>547</sup> Makluan, po aty, f. 110.

<sup>548</sup> Po aty, f. 109.

tij. Pasojë e këtij ngatërrimi, siç na e tërheq vërejtjen psikanaliza, është neuroza. “Kemi vërtetuar se njeriu bëhet neurotik ngaqë nuk mund të përballojë pengesat e panumërta që i ka imponuar shoqëria për shkak të idealeve të saj kulturore.”<sup>549</sup>

Si duket, njeriu perëndimor është i ngopur me vetëdije, që për të është simboli i kontrollit, jo vetëm mbi realitetin fizik, por edhe mbi atë psikik. Prandaj, herë pas here ai përpiqet t’i (ç)lirojë kontrollet mbi intelektin në një mënyrë të pakuptimtë. “Njeriu konstaton se ç’kënaqësi e lartë është që, qoftë edhe përkohësisht, të çlirohesh nga intelektu dhe t’i dorëzohesh sprovave të pakuptimita.”<sup>550</sup> Drejt kësaj e shtyjnë me vrull shitësit e lumturisë, që me disa simbole të mirë-programuara aktivizojnë emocione të caktuara që flejnë thellë qenies. Këso çastesh “e gjithë hapësira tokësore afrohet si një kopësht kënaqësie; kurse kufijtë midis të mirës dhe të keqes, të shenjtës dhe laikes, të vërtetës dhe gënjeshtërisë, zhbëhen. Vrojtuesi në qoshk thjesht e shikon këtë dalje të rrezikshme të njeriut nga vetvetja drejt fushës së errët të irracionales”.<sup>551</sup>

<sup>549</sup> Frojd, *Iz kulture i umetnosti*, Matica srpska, Novi Sad, 1969, f. 291.

“Pavarësisht se sa krenohemi me arritjet tona kulturore, ne kemi pranuar se nuk e kemi lehtë të plotësojmë kërkesat e kulturës, që të ndihemi mirë brenda saj, sepse kufizimet e imponuara përbëjnë një ngarkesë të rëndë psikike.” (Frojd, *Nova predavanja*, Matica srpska, Novi Sad, 1969, f. 206)

<sup>550</sup> Po aty, f. 116.

<sup>551</sup> “Askush nuk mund ta shohë marrëzinë për aq sa ndodhet brenda saj.” (Frojd, *Iz kulture i umetnosti*, f. 284)

## PREDIKIMET FETARE

“...tani Zoti vallëzon brenda meje.”

Nietzsche

Zoti është një ide e fuqishme, sidomos kur ne e dimë se ka lindur në mendjen e njeriut, i ka shërbyer dhe i shërben atij për qëllime të ndryshme.<sup>552</sup> Pavarësisht idesë së origjinës së Zotit, se a e ka krijuar njeriu idenë për Zotin sipas idesë së Gjeniut<sup>553</sup> apo prej strukturës së çuditshme të botës<sup>554</sup>, apo sipas analogjisë me Krijimin e vetes<sup>555</sup>, pa këtë ide bota do të dukej ndryshe. Pra, *vetë ideja ka shkaktuar aq pasoja*

<sup>552</sup> Në jetën e individit dhe të shoqërisë, religjioni ka qenë e *vërteta* e shoqërisë që në kryeherë, një shoqëri kjo që nuk dinte e nuk do të dijë për të vërteta të tjera. Ndoshta është i vetmi *ngushëllim* për ata që ndihen të vetmuar apo të përhumbur në hapësirat kozmike; *udhërrëfyes* për ata që bredhin apo kanë humbur në pyjet e jetës; *shpresë* për ata që nuk e kanë pranuar mjerimin si fundin e mundësive të tyre; *formë kontrolli* mbi fuqitë natyrore dhe shoqërore, të cilat do të ishin shkatërruese pa pasur rast/mundësi nënshtrimi (magjia); *lidhje simbolike* që arrin t'i derdhë individët në një trup social (vetëdija kolektive si burim i unitetit); përpjekje e njeriut për të veçuar veten si një qenësi e *ndryshme* nga të gjitha qeniet e tjera (e vetmja qenie që beson në shumë qenie).

<sup>553</sup> “Unë nuk e di se ç’është Zoti; por, njeriu i madh më jep një ide për këtë.” (J. Dučić, *Blago cara Radovana*, f. 358) “Sidoqoftë, nëse nuk i besojnë Zotit, meqë janë mendje të mëdha, ata janë një dëshmi se ka Zot.” (Igo, *Jadnici*, I, f. 444)

<sup>554</sup> “Çdo krijesë të shpie te Zoti, por asnjëra nuk e zbulon atë.” (Žid, *Plodovi*, Svjetlost, Sarajevo, 1958, f. 13) “Çdo fije bari, çdo milingonë, çdo bletë, të gjitha këto, për çudi, e dinë rrugën e vet. Edhe pse nuk kanë intelekt, dëshmojnë misterin hyjnor, madje këtë e bëjnë pa reshtur asnjë grimë.” (Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, f. 364) “Kur shikoj qartë, vërej shkallën që të çon nga bima te njeriu; atëherë pse të pandeh që kjo rrugë ndalon me mua dhe nuk shkon më larg, shumë larg? Unë ndiej jo vetëm që mund të zhdukem, edhe pse asgjë nuk zhduket, por edhe të jem ai që kam qenë ngahera. Ndjej se veç meje, mbi mua rrojnë shpirtra, dhe në këtë botë ekziston e vërteta.” (Tolstoj, *Rat i mir*, I, f. 507-508)

<sup>555</sup> “Sepse çdo vatër duhet të ketë një krijues. Kush i ka krijuar të gjitha? Ky është Zoti.” (Mesazh i Shën Palit drejtuar hebrenjve, kap 3, parag. 4)

*socio-psikike, saqë është e vështirë të përfytyrohet një qenie e vërtetë që do të ishte në gjendje të krijonte ndryshime të tilla.*

Edhe pse mbetet e mjegullt se si një simbol (në këtë rast ideja e Zotit) që nuk e ka origjinën nga përvoja<sup>556</sup> mund të shkaktojë kaq pasoja, duke qenë se nga jeta dimë që ndryshimet në botën e ndjenjave, në besim dhe sjellje nuk shkaktohen vetëm nga simbolet (idetë) që i përgjigjen disa gjërave nga përvoja, raporteve apo situatave, por edhe nga ato simbole që nuk i përgjigjen asgjëje reale në botën reale (këto dy tipe simbolesh ndryshojnë jo për nga origjina, por për nga fuqia e veprimit).

Zoti nuk i përgjigjet një simboli (ideje) të caktuar në realitet<sup>557</sup>, por ky simbol ka ndikuar fort dhe vazhdon të ndikojë mbi ndjenjat, besimet dhe sjelljet e njerëzve. Simbolet e mbipërvojës nxisin pasoja te përvoja.

Mbi këtë bindje e mbështesin forcën e tyre predikimet fetare. Nëse ekzistojnë dy rende simbolesh, nga përvoja dhe mbipërvoja, atëherë del se ekzistojnë dy mënyra për të përmbushur nevojat reale njerëzore: reale dhe simbolike. Nëse një simbol joreal shkakton një nevojë reale, atëherë vlen edhe *vice versa*: një nevojë e vërtetë mund të plotësohet në një mënyrë simbolike. Dikush mund të reagojë duke thënë se simbolet fetare (idetë, besimet dhe ritualet) nuk i përmbushin nevojat njerëzore në mënyrë reale, por vetëm simbolikisht, në mënyrë imagjinare dhe fantastike. Në këtë rast mund të themi se plotësimi i nevojave ka më shumë rëndësi

<sup>556</sup> Ne jemi mësuar që përvojat të cilat i fitojmë në raport me gjërat apo me situatat t'i përshkruajmë apo t'i shprehim me anë të simboleve. Me kohën simbolet lidhen aq fort me përvojën, saqë gjërat apo situatat nuk është fare e nevojshme të jenë të pranishme. Vetë prania e simbolit shkakton ndjenja, mendime apo sjellje; sikundërse edhe në rastin kur situata apo gjërat janë të pranishme.

<sup>557</sup> Duket fare qartë se nocioni i realitetit duhet të interpretohet ndryshe: është më i gjerë se bota reale.

sesa mënyra me të cilën plotësohen. Nëse nuk ekziston një mënyrë konkrete për plotësimin e nevojave reale, atëherë mbetet që të plotësohen vetëm përmes atyre mënyrave që mbeten: simbolike, imagjinare dhe fantastike.<sup>558</sup> Ndoshta bota, siç është rasti me këtë tonën, siç e dimë, shpik gjithnjë nevoja të reja dhe artificiale; nuk e çan fort kokën që, njëkohësisht, të krijojë masa që i përmbushin këto nevoja në mënyrë simbolike, imagjinare dhe fantastike, sepse këto masa nuk mund t'i përmbushin në mënyrë reale këto nevoja.<sup>559</sup> “Zoti është i nevojshëm; pra duhet.”<sup>560</sup> “Zoti do ekzistojë për aq sa njerëzit kanë nevojë të besojnë.”<sup>561</sup>

Manipulimi i besimtarëve në formën e predikimeve fetare, mbështetet në të njëjtat parime, njohuri dhe teknika si te të gjitha format e tjera të manipulimit. Edhe për këtë do theksoj vetëm atë që kam zhvilluar në mënyrë sistematike në lidhje me disa elemente të caktuara manipulimi.

1. *Njeriu është një qenie e arsyeshme dhe e paarsyeshme, dhe pikërisht për këtë arsye ailajo mund të bindet për diçka herë me mjete të arsyeshme, here me mjete të paarsyeshme.* Njeriun e arsyeshëm, që thotë se nuk e beson Zotin, megjithatë mund ta luhatim me fjalët: “Zotëri, sikur ai të mos ekzistonte, nuk do flisnim për të.”<sup>562</sup> Njeriun e paarsyeshëm që nuk e beson Zotin, nuk do e bindim me mjete të arsyeshme, por ai do bindet vetë nëse në jetën e tij apo në jetën e njerëzve që e rrethojnë ndodh diçka që mund të përjetohet si çudi nga ana e tij.<sup>563</sup>

<sup>558</sup> “Religioni është (Gj. Sh.) një realizim fantastik i qenies njerëzore, sepse qenia njerëzore nuk e zotëron realitetin njerëzor.” (Marx-Engels, *Rani radovi*, f. 73)

<sup>559</sup> Këtë e shpjegon edhe fakti se numri i besimtarëve nuk zvogëlohet krahas zhvillimit të fuqishëm të shkencës. Numri i atyre që nuk shkojnë në kishë është në rënie.

<sup>560</sup> Dostojevski, *Zli dusi*, II, f. 324.

<sup>561</sup> V. Desnica, *Proljeća Ivana Galeba*, f. 224.

<sup>562</sup> Tolstoj, *Rat i mir*, I, f. 459.

<sup>563</sup> “Është e çuditshme ura e gomarit që shpie nga mbretëria e ideve në praktikë.” (Marx-Engels, *Nemačka ideologija*, Kultura, Beograd, 1964, f. 279) “Por, ti nuk e dije

2. *Njeriu mendon, por edhe ndjen.* Prandaj simbolet (fjalët) përzgjidhen në atë mënyrë që ta godasin njeriun në mendje e në zemër.<sup>564</sup> Në rastin e parë, nga simboli pritet një kuptim; kurse në të dytin një fuqi vepruese.<sup>565</sup> Është e rëndësishme që simboli të shpjegojë, por është edhe më e rëndësishme që ai të pushtojë dikë.<sup>566</sup> “Nuk është si gjetiu kjo, që simboli të jetë vetëm një mjet për të rrëfyer mendimet, ndjenjat dhe brengat personale; ai është një instrument me të cilin kërkojmë të luajmë, i cili i dalldis frymët, si muzika te disa popuj dhe pijet e forta te disa të tjerë.”<sup>567</sup>

3. *Simboli është i pushtetshëm për aq sa është i tillë ai që e hedh atë në turmë.* Pushteti kalon nga i fuqishmi drejt simbolit (fjalës), kështu që simboli fiton pushtet, pavarësisht fuqisë së vlerës domethënëse. Me një fjalë, ai të ul në gjuhë.<sup>568</sup> Kjo sepse nuk mund ta ndash kuptimin e fjalës nga fuqia e autoritetit. Nuk është edhe aq e lehtë të gjykohet sipas fjalëve të tij, sepse ai flet me atë gjuhë që i fsheh kollaj dobësitë dhe zbulon madhësitë. *Pra, cili është ai që dëgjohet edhe nga erërat, edhe nga deti?*<sup>569</sup>

se njeriu, sapo të hedhë poshtë habinë, do hedhë poshtë edhe Zotin, sepse njeriu nuk kërkon aq zota sa kërkon çudira. Por, meqë njeriu nuk është i aftë të mbetet pa çudira, ai do i krijojë vetvetes çudira të reja, dhe do t'i falet frymës së magjive, magjive të plakave, edhe në qoftë njëqind herë kryengritës, heretik e i pafe.” (Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, f. 318)

<sup>564</sup> “Dhe ishte i veshur me një petk ngjyrë gjaku. Emri i tij quhet fjala e Zotit.” (*Zbulesa e Gjonit*, kap. 3, paragraf. 5)

<sup>565</sup> “...edhe gjuha është një copë e vogël mishi që bën shumë: pa shih sa pak zjarr e sa shumë mal që përfshin.” (Qarkorja e Jakovit, kap. 3, paragraf. 5)

<sup>566</sup> “Sepse nuk po kërkoj atë çfarë ju përket: po ju kërkoj ju. (Korintasve, *Qarkorja e dytë e Shën Palit*, kap. 12, paragraf. 14)

<sup>567</sup> O. Jespersen, *Čovječanstvo, narod i pojedinač sa lingvističkog stanovišta*, Sarajevo, 1970, f. 14.

<sup>568</sup> “...dhe unë do i besoj fjalës tënde si fjalës së Zotit, ju betohem. Do vi pas teje edhe në fund të botës. Do të vi, do të vi, si një qen.” (Dostojevski, *Zli dusi*, II, f. 238)

<sup>569</sup> *Ungjilli sipas Markut*, kap. 4., paragraf. 4.

4. *Simboli fiton pushtet në varësi të dobësisë së atij që e pranon.* Kur turma ndodhet në çaste paqartësie, frike, krize apo rreziku, ajo kërkon një *shpëtimtar*. Në këtë rast është fare e lehtë t'i bindësh njerëzit edhe për idenë më të çmendur, por me kushtin që kjo ide t'u premtojë atyre zgjidhjen e halleve. Në çështje që kanë të bëjnë me lëkurën time apo tënden, ndryshimi mes gënjeshtres dhe të vërtetës nuk ka kurrfarë kuptimi. "Në kohë të vështira Zoti gjithnjë ka gjasa."<sup>570</sup> Atëherë thirrje si "ejani tek unë, se jeni të lodhur e të ngarkuar, dhe unë do t'ju jap pushime", bëhen me flatra.

5. *Simboli do ndikojë fuqishëm për aq sa turma ka interes të zgjidhë një çështje publike.* Nëse simboli nuk prek atë problem për të cilin turma është e interesuar ekzistencialisht, ai mbetet pa jehonë, njësoj si të gjuash me një revole të zbrazur.<sup>571</sup>

6. *Simbolet fetare nuk do të imponoheshin nëse do pranohehin nga të gjithë anëtarët e shoqërisë (grupit).* Kjo sepse në një shoqëri, përpos besimtarëve, jetojnë edhe jobesimtarë (ateistë), dhe është logjike që simbolet për të cilat po flasim duhet të bien ndesh me simbolet ekzistuese. "...m'u hap dera e madhe dhe e pasur; ka shumë kundërshtarë."<sup>572</sup> "...do të dalin shumë profetë dhe do mashtrojnë shumë njerëz."<sup>573</sup> "Kini kujdes nga profetët e rremë, që ju afrohen me lëkurë deleje, se brenda tyre fshihet ujku zullumqar. Do i njihni sipas gjinisë. Ah, sikur rrushi të vilej nga therrët dhe fiku nga rrodhëzat?"<sup>574</sup>

7. *Simbolet religjiozë kanë një përparësi të pazakontë krahasuar me simbolet e tjerë, sepse saktësia apo pasaktësia e tyre nuk*

<sup>570</sup> Remarque, *Triumfalna kapija*, f. 93.

<sup>571</sup> Marx, *Kapital*, II, f. 295.

<sup>572</sup> *Korintasve*, qarkorja e parë, kap 16., parag 9.

<sup>573</sup> *Ungjilli sipas Mateut*, kap. 24, parag. 11.

<sup>574</sup> Po aty.

*mund të vihet në provë duke u bazuar te përvoja.*<sup>575</sup> Tërheqëshmëria e simbolit qëndron e kthyer së prapthi në raport me mundësitë e verifikimit bazuar te përvoja. Simbolet religjioze kanë një fuqi mashtruese pikërisht për faktin se nuk mund t'i nënshtrohen asnjëherë verifikimit të mbështetur te përvoja. Këto simbole paraqesin premtime të amshuara.

8. *Dëshmimi i pushtetit së simboleve religjioze (besimeve, ritualeve) nuk bëhet logjikisht, por psikikisht. "Ai që bëhet më i mirë pas lutjes, lutja e tij është pranuar."*<sup>576</sup>

9. *Është i rrallë ai simbol që përbëhet nga disa shtresa, që të mbulojë një numër të madh dëshirash, nevojash, interesash, pritjesh... Nga njëra anë shumë dëshira, nga ana tjetër vetëm një simbol. Dikush sheh të vërtetën në të, dikush ngushëllimin, dikush udhërrëfimin, dikush shpresën, dikush sigurinë, dikush... Prandaj, pse duhet të jetë e çuditshme kur një simbol të tillë shumëshresor, barinjte e shpirtit e kanë shfrytëzuar dhe e shfrytëzojnë për qëllime manipuluese?*

### Funksioni i simboleve religjioze

Nëse simbolet religjioze (ashtu si bindjet dhe ritualet) nuk përmbushin kurrfarë nevoje individuale a kolektive, atëherë thjesht është e pamundur të shpjegohet qëndrueshmëria e këtyre simboleve në historinë ekzistenciale të njeriut (besimet dhe praktika). Pra, simbolet religjioze (besimet dhe praktika) duhet të ishin të organizuar rreth disa nevojave themelore të njeriut. Në këtë rast nuk dua të them se te vetë njeriu ekzistojnë disa nevoja specifike fetare, por vetëm se ekzistojnë nevoja të zakonshme njerëzore të cilat ai i plotëson në mënyrë religjioze, ngaqë nuk mund t'i plotësojë ndryshe.

<sup>575</sup> "E vërteta për vdekjen i takon rrafshit të së paverifikueshmes, dhe mund të jetë vetëm objekt lajmërimi." (Malraux, *Antimemoari*, f. 252)

<sup>576</sup> Dž. Meredit, po aty, f. 104.

Simbolet shkencore, ashtu si bindjet dhe praktika shkencore, përmbushin një prej nevojave bazë njerëzore – nevojën për të ditur. Mirëpo shkenca nuk mund t'i përmbushë të gjitha nevojat njerëzore, dhe pikërisht për këtë optimizmi i njeriut nga shpresa se të gjitha çështjet njerëzore mund të zgjidhen në mënyrë shkencore, në thelb është naiv dhe i rrezikshëm. Unamuno ka të drejtë kur shkruan “se shkenca si ndërrim i religjionit dhe intelekti si ndërrim i fesë, kanë rënë poshtë gjithnjë. Shkenca mund t'i plotësojë në një mase të madhe nevojat tona logjike në rritje apo nevojat intelektuale, dëshirën tonë për të ditur dhe për të njohur të vërtetën, mirëpo ajo *nuk i përmbush dot ndjenjat dhe etjen tonë për pavdekësi. Madje jo vetëm që nuk i përmbush, por edhe u kundërvihet. E vërteta rationale dhe jeta janë të përkundërta. A ekziston ndonjë e vërtetë tjetër përveç të vërtetës rationale?*”<sup>577</sup> Intelekti është si dielli në dimër: shndrit, por nuk ngroh.

Në fakt, rezultati i një kërkimi shkencor mund të jetë një e vërtetë njerëzore, jo e plotë, e papërfunduar, një e vërtetë relative. Për këtë arsye, edhe të vërtetat shkencore vjetrohen shpejt, dhe shpeshherë ndryshojnë. Në shkencë, siç ka thënë Freud-i, mashtrimi i fundit quhet i vërtetë. Mirëpo, njeriu ka nevojë për diçka të sigurt, të plotë, absolute. Këtë nevojë për dijen absolute nuk mund ta përmbushë shkenca. “Shkenca është fragmentare, jo e plotë; ajo përparon ngadalë dhe nuk mbaron kurrë. Por, jeta nuk mund të presë. Teoritë që i janë dedikuar jetës dhe punës njerëzore janë të detyruara të lidhen me shkencën, për ta kompletuar atë para kohe.”<sup>578</sup>

<sup>577</sup> Migel de Unamuno, *O tragičnom osećanju života*, Kultura, Beograd, 1967, f. 94.

<sup>578</sup> Durkheim, *The Elementary Forms of Religious Life*, trans. by J. W. Swain, New York, 1928, p. 431.

Shkenca është një proces i dijës mbi botën dhe jetën. Ajo na ofron një mori njohurish për botën, rreth nesh dhe për vetveten, mirëpo nuk na jep kurrfarë ideje se si duhet të jetojmë dhe cili është kuptimi i jetës sonë. Idetë fetare (bindjet dhe ritualet) janë përgjigje për vlerën dhe kuptimin e jetës.<sup>579</sup> Ne mund t'i konsiderojmë të çuditshme këto ide (bindjet dhe ritualet), jo reale, madje edhe të pavërteta, por nuk mund ta vëmë në pikëpyetje kuptimin e tyre. Idetë fetare mund të jenë të pavërteta (shkencërisht), por jo të pakuptimta. Çdo ide duhet të ketë një kuptim, por jo çdo ide që mendohet duhet të jetë e vërtetë (shkencore).

Idetë religjioze (bindjet dhe ritualet) ndihmojnë individët dhe grupet për t'u *përshtatur*<sup>580</sup> edhe në ato situata që janë të mbushura me frikë, pasiguri, rrezik e me brenga të çdo lloji. Kur njeriu zihet ngushtë, zakonisht kërkon Zotin. M. Laliqi e përshkruan fort mirë njeriun kur ndodhet nën flakët e luftës, kur mendimi i tij vajton, kur kërkon shpëtim dhe mbështetje: "O Zot i madh, – nis pëshpëritja e tij – kam gabuar kur kam thënë se Ti nuk ekziston. Tani jam penduar! Të gjithë thoshin se Ti nuk ekziston; edhe unë këtë bëra, që të mos përjashtohesha nga shoqëria. Por, sidoqoftë, besoja se ekziston diçka nga Ti atje ku nuk dimë për Ty. Zot i dashur, i madh, i plotpushtetshëm, ma bëj të mundur që të shpëtoj! Kam dy fëmijë – mos i lër jetimë siç isha unë dikur, kur nëna ime u martua! Më mbro të paktën për ata të dy dhe mbuloji me dorën Tënde! Ja, do kryqëzohem përpara të gjithëve, ja, e shikon?! Le të shohin, nga të dyja anët. Le të më

<sup>579</sup> "Nuk bëjmë gabim nëse themi se ideja mbi kuptimin e jetës rron dhe shpërbëhet bashkë me një sistem fetar." (Frojd, *Iz kulture i umetnosti*, f. 276)

<sup>580</sup> "Religjioni e ngushton lojën e përzgjedhjes, sepse u imponon të gjithëve në të njëjtën mënyrë rrugën drejt fatit dhe mbrojtjen nga vuajtjet." (Frojd, *po aty*, f. 287) "Religjioni arrin të kursejë shumë njerëz prej neurozave individuale." (po aty)

përqeshin të gjithë. As që më bëhet vonë për ta! Vetëm te Ti kam shpresë dhe do të lutem deri në fund të jetës. Amin!”<sup>581</sup>

Një analizë më e thellë e ideve religjioze, bindjeve dhe ritualeve, zbulon se religjioni është një pikëpamje specifike mbi botën, që u mundëson individëve dhe grupeve *orientimin* drejt një përvoje të larmishme dhe dinamike, që ka të bëjë me njeriun dhe me raportin e tij me natyrën e me veten. Idetë religjioze mbi çfarë është e shenjtë dhe laike, ç’është e keqe dhe e mirë etj., të shprehura në formën e urdhëresave fetare, u japin mundësi individëve dhe grupeve të bëhen pjesë e një realiteti i cili vlon në të gjitha mundësitë përzgjedhëse. Kështu kuptojmë se funksioni i ideve nuk është (vetëm) të *shpjegojnë* realitetin (funksioni i njohjes), por edhe të na shërbejnë si udhërrëfyese në malin e jetës.

Historia e përvojës njerëzore është plot me shembuj që flasin se si idetë (simbolet) dhe bindjet religjioze kanë *arritur* të vënë në lëvizje turma të mëdha (fjala vjen, kryqëzatat) dhe të kenë një ndikim aq të fortë në ndjenja, mendime dhe sjellje, sa këto turma të shpërthejnë në lëvizje radikale apo revolucione. Për asnjë çast nuk duhet harruar se pas këtyre ideve ekzistonin interesa të ndjeshme, mirëpo sukcesi historik i tyre shpjegohet me faktin se këto ide kanë gjetur rrugën më efikase për racionalizimin e interesave dhe ia kanë dalë të lidhen me nevojat dhe pritshmëritë e turmave. “Fjalët më të përunjura sjellin shtrëngatën. Mendimet që ndalojnë mbi këmbët e pëllumbit drejtojnë botën.”<sup>582</sup>

Që simbolet religjioze (idetë) *unifikojnë*<sup>583</sup> njerëz, madje edhe në ato rrethana kur të gjithë mjetet e integritit janë

<sup>581</sup> M. Lalić, *Hajka*, Grafički zavod, Titograd, 1967, f. 460.

<sup>582</sup> Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 135.

<sup>583</sup> “Të gjithë ata që besuan ishin bashkë, dhe i kishin të gjitha të përbashkëta.” (*Veprat e apostujve*, kap. 2, parag. 44) “Te populli që besonte ishte një shpirt dhe një

përdorur, është një fakt që nuk ka edhe aq nevojë të provohet. Një sekt i copëtuar fetar, anëtarët e të cilit mund të shpërndahen në mbarë botën, vazhdon të ndjehet një bashkësi homogjene; sepse këta anëtarë i lidh një ide e padukshme që është çimentuar në qeniet e tyre. Kishat dhe të gjithë vendet e shenjta e manifestojnë në mënyrë simbolike këtë unitet brenda grupit. Nëse simbolet, bindjet dhe ritualet religjioze nuk do transformoheshin nga niveli i tyre i epërm abstrakt në simbole konkrete me trajta qeniesh (prifti), sendesh (objektet e shenjta) dhe institucionesh (kishat), do të ishte e pamundur të pranoheshin e të përcilleshin nëpër turma.<sup>584</sup>

Anëtarët e atyre grupeve që i pranojnë idetë religjioze me devotshmëri e bindje të plotë, me kalimin e kohës humbasin çdo dyshim për vërtetësinë dhe vlerën e këtyre ideve; prandaj dhe në jetën praktike sillen pikërisht siç është parashikuar nga dogmat fetare. Që prej këtij momenti, për këto grupe, idetë fetare e humbasin funksionin *njohës* dhe shndërrohen në një rregullore që lidhet me sjelljet; domethënë, marrin një funksion *normativ*. Kështu, religjioni arrin të realizojë kontrollin mbi sjelljen e besimtarëve, dhe në këtë rast ai nuk ka nevojë të përdorë mjete të tjera të vrazhdëta kont-

zemër." (*Veprat e apostujve*, kap. 4, parag . 32) Se në cilat rrethana mund të luajë feja një rol *çintegruës*, shih: M. J. Yinger, *Religion, Society and the Individual*. The MacMillan Company, New York, 1957, f. 67-69.

<sup>584</sup> Arkitektura është një rast unik ku konkretizohen simbolet fetare. Hugo-i thotë se arkitektura ka qenë një aftësi e madhe shkrimi nga ana e sojit njerëzor – kjo është e vërtetë. Jo vetëm që çdo simbol fetar, por edhe çdo mendim njerëzor ka faqen dhe përmendoren e vet në këtë libër voluminoz. Mendimi bazë, fjala, nuk shihet vetëm në sajë të këtyre ndërtesave, por edhe te forma e tyre. Në këtë mënyrë, fjala që e mbyllur në ndërtesë, në përjashtësinë e saj, si një imazh njerëzor i mbyllur në një arkë mumifikimi. Jo vetëm forma e ndërtesës, por edhe vendi i zgjedhur për ngritjen e saj paraqiste mendimin që ajo do përfaqësonte. (*Zvonar bogorodične crkve*, Svjetlost, Sarajevo, 1961, f. 204-5)

rolli, siç është rasti me sistemin e amshuar të shpërblimeve dhe dënimeve.<sup>585</sup>

Idetë religjioze, bindjet dhe ritualet na bëjnë të mundur të identifikojmë individin dhe të zbërthejmë shtresën e gjërë sociale në të cilën ai lëviz. Nëse njohim idetë religjioze, bindjet dhe ritualet e një individi, që i praktikon rregullisht apo përkohësisht, nuk e kemi të vështirë të mësojmë se cilit grupim fetar i përket ai. Nëse dimë se cilit grup fetar (sekt) i përket, do jemi në dijeni edhe për idetë, bindjet dhe praktikën e tij.

Kjo analizë e kursyer për funksionimin e simboleve religjioze na shpie në përfundimin se këto simbole (po ashtu edhe bindjet e ritualet) plotësojnë disa nevoja individuale dhe kolektive, disa interesa e dëshira të qenësishme. Përdërisa këto simbole lidhen suksesshëm me nevojat ekzistenciale njerëzore, interesat dhe dëshirat, synimi i kishës për t'i shfrytëzuar këto simbole për qëllime manipuluese nuk do ndalojë ndonjëherë.<sup>586</sup> Nga ana tjetër, do tregoheshim miopë nëse nuk do e vinim re që manipulimi fetar i largon besimtarët nga llojet e tjera të manipulimit, sepse ai kërkon prej tyre që t'i nënshtrohen vetëm autoritetit hyjnor, jo atij laik.

Si këshillë për largimin nga propaganda ekonomike, le të shërbejnë fjalët e Ungjillit sipas Lukës: “Më lehtë kalojnë gjilpërat në veshët e devesë sesa i pasuri në mbretërinë e Zotit.” Ndërsa si këshillë për kundërvënien ndaj propagandës

<sup>585</sup> Ndryshimi midis ideologjisë fetare dhe ideologjive të tjera në këndvështrimin e plotësimin të nevojave njerëzore, është se ideologjia fetare premtan përmbushjen e premtimit në botën tjetër, ndërsa ideologjitë laike i shtynjë këto premtime diku në të ardhmen e kësaj bote.

<sup>586</sup> “Kishës i duhet autoriteti për të mbikëqyrur se çfarë ka lidhje me besimin dhe çfarë është e rrezikshme, mirëpo nuk mund të përdorë më ndalesat, por vetëm bindjen.” (Andrija Krešić, *Kraljevstvo božje i komunizam*, IMPR, Beograd, 1975, f. 19)

dës politike, le të shërbejnë fjalët e Pjetrit e të apostujve: “Duhet t’i nënshtrohemi më shumë Zotit sesa njerëzve.”

Nuk e di a do ketë fjalë më të përshtatshme për të shprehur brengën e një propaganduesi ekonomik apo politik sesa këto në vijim: “Ah! Gjithnjë e kam hedhur rrjetën në detet e tyre, për të zënë peshq të mirë; mirëpo përherë kam nxjerrë krena zotash të vjetër.”<sup>587</sup>

<sup>587</sup> *Tako je govorio Zaratustra*, f. 118.

Edhe pse në çdo shoqëri ekziston prirja që institucionet religjioze dhe politike të përmbahen me njëri-tjetrin, ka situata kur ato qëndrojnë në një konflikt të heshtur ose të hapur.



**PJESA E KATËRT**  
**Kufijtë dhe kritika**



## KUFIJTË E MANIPULIMIT

*“I admiroj njerëzit e arsyeshëm dhe i kam zili mendjet e tyre të pastra; por, ç’më duhet mua djallëzia!”*

Sol Belou

Bindësit e fshehtë mendojnë se njeriu nuk është një mister i thellë; ky mister është vetëm një çështje teknike. Prandaj, për bindësit, kufijtë e manipulimit janë vetëm kufij teknikë të mjeteve të manipulimit. Ashtu siç mund të kontrollohet me sukses mjedisi natyror i njeriut, po ashtu mund të kontrollohet edhe mjedisi i tij shpirtëror.<sup>588</sup> Synimit për një kontroll të plotë të realitetit fizik, i përgjigjet synimi për një kontroll të plotë të jetës njerëzore, bindjeve dhe sjelljeve të njeriut. Nevoja për një kontroll të vetëdijshëm kthehet në një nevojë për kontrollin e vetëdijes shoqërore! Krahas inxhinierëve të makinerisë, shfaqen edhe inxhinierët e shpirtërorë njerëzorë.

A ekzistojnë mundësitë e lirisë jashtë manipulimit? A ekzistojnë rezistenca të caktuara vetjake dhe strukturore kundër forcave të manipulimit? A ka shpresë për shpëtim?

Në vend që të ofrojmë përgjigje do bëjmë një pyetje, ku feks edhe një pjesë e përgjigjes: si është e mundur që ata të cilët besojnë te fuqia e manipulimit të jenë akoma të vetëdij-

<sup>588</sup> “Changes in preference, perceptions, needs, purposes, attitudes, opinions and other attributes of mind may be analysed in the same way. We change the way a person looks at something, as well as what he sees when he looks, by changing the contingencies; we do not change something called perception.” (B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, p. 94)

shëm për manipulimin? Si është e mundur që i janë nënshtuar fuqive sunduese të bindjes pa dhembje? A nuk duket e natyrshme që krahas zhvillimit të mjeteve të manipulimit, të zhvillohet edhe vetëdija e manipulimit dhe rezistenca ndaj tij? A nuk e zvogëlon efikasitetin e manipulimit kundër-manipulimit? Këto nuk shkojnë pa njëra-tjetrën.

“Imagjino sikur në botë të shfaqen të ndarë më dysh subjekti dhe kundër-subjekti, që të dallohen nga njëri-tjetri, dhe sikur njëri të mos jetë pranë tjetrit. Nuk do ishte as njëri e as tjetri. Nëse nuk do ishte jeta, nuk do të ekzistonte as vdekja. Po të mos ishte pasuria nuk do të ekzistonte as varfëria. Nëse do zhbëhej marrëzia, të gjithë do të flisnin për mençurinë. Kështu është edhe me pasurinë, kjo është e qartë. Një kafshë e papastër i drejtohet tjetër me këto fljalë: “Duhet të më falënderohesh, sepse sikur të mos isha unë, kush do e merrte vesh se sa e pastër je dhe kush do të quante të tillë.” Ndërsa mëkatari i drejtohet të drejtit: “Përkulu para meje! A do kishe përparësi sikur të mos isha unë?”<sup>589</sup>

Krahas opinionit publik, ekziston dhe opinionin i fshehur, që dëshmon se jo të gjithë njerëzit kanë hequr dorë prej lirisë, dhe manipulimi nuk ka arritur të krijojë ndonjë pajtim të përgjithshëm. Nëse njerëzit do të mendonin publikisht, të flisnin e të vepronin ashtu siç presin prej tyre<sup>590</sup> pushtetarët<sup>591</sup>, kjo akoma nuk nënkupton se ata nuk men-

<sup>589</sup> Man, *Legenda o Josipu*, I, f. 603.

Duke folur në lidhje me këtë çështje, Andrija Kreshiq, vë në dukje se “në qoftë se njeriu është krejtësisht jo i lirë, atëherë çdo manipulim do të ishte i tepërt: manipulimi ka bërë të mundur lirinë”.

<sup>590</sup> Tanimë e kam theksuar se pushtetarët nuk e çajnë shumë kokën se si ndjehet dikush në privatësinë e tij, çfarë mendon dhe çfarë bën. Ata interesohen që sjelljet e njerëzve të mos tradhtojnë pritshmëritë e tyre.

<sup>591</sup> “Pavarësisht gjuhës artificiale të romakëve, – thotë de Bonal-i – popujt primitivë (skitët, keltët, gjermanët, teutonët etj.), që nga Mozeli e deri në Kamçatka, njeriu e pushtetit publik e quanin koenig, king, kan, chagan, keln, fljalë të cilat e

dojnë, nuk ndjejnë e nuk flasin në privatësi, diçka që është krejtësisht tjetër gjë nga publikja.

Madje edhe ky mendim sekret, nga këndvështrimi njohës, mund të konsiderohet si më superior nga mendimi publik. "Mendova të them diçka në lidhje me idetë. Biri im, ato vlejné për aq sa pëshpëriten. Edhe pse i shpreh në hesh-tje, ato dëgjohen larg. Ndërsa kur nis e i shpreh zëshëm, askush nuk të zë besë. Nuk ia vlen që ato të publikohen nëpër gazeta, sepse gazetat përdoren për gjithçka, dhe sa i kap pika e parë e shiut, ato s'vlejné për asgjë."<sup>592</sup> Shkalla në të cilën është i ndarë opinioni shoqëror midis publikes dhe privates, mund të merret si tregues se sa i rrënuar është uniteti i një shoqërie. Shërben si tregues edhe për konfliktet e fshehta të shoqërisë si tërësi.

Rezistenca ndaj manipulimit, në radhë të parë është rezistencë karshi mendimit të institucionalizuar. Nëse fjalët e artistit nuk shndërrohen në fraza<sup>593</sup>, nëse njerëzit e mendimit nuk pranojnë që ta kthejnë në dogmë mendimin, nëse dijetarët nuk mund të imagjinojnë që shkenca të degjenerojë në ideologji, atëherë nuk iu mbetet rrugë tjetër përveç asaj që çon drejt një shqetësimi të përhershëm, drejt nxitjes dhe lëkundjes së mendimit të institucionalizuar. Të paktën në këtë pikë historia mund të jetë një mësuese e mirë; sepse ka pasur kohëra që me të drejtë janë quajtur heroike. Ato kohë kanë qenë heroike para së gjithash në bazë të frymës heroike. Sot ne jetojmë në një kohë tjetër, që meriton të quhet e

kanë rrënjën te folja *koenen*, që në gjuhën e tyre do të thotë "të mundesh". Ndërsa familjarisht, atë që mundet, në mënyrë emfatike ne e quajmë i fuqishëm." (cituar nga Ljubomir Tadić, *Tradicija i revolucija*, f. 26-27)

<sup>592</sup> Dobrica Ćosić, *Vreme smrti*, Prosveta, Beograd, 1972, f. 59.

<sup>593</sup> "Çdo fjalë konsumohet duke "kaluar rrugën e detyruar nga poezia te proza." (V. B. Šklovski, *Uskrnuće riječi*, Zagreb, 1969, f. 14)

mjerë, që nuk lejon as mendimin, as heroizmin.<sup>594</sup> Por, në një kohë të tillë jo të gjithë intelektualët janë moralisht të vdekur – gjithnjë do të ketë nga ata që nuk mund të qëndrojnë duarkryq para forcave të vlerësimit. “Kujdestarët e këtij zjarri të shenjtë” (Hegel), një zjarr ky që në syprinën dhe gjithpërfshirjen e interesave praktike kish nisur të shuhej, vazhdojnë të shpresojnë “se bota, që është bërë e shurdhër ndaj tyre, do mund të dëgjojë një ditë” (Hegel).<sup>595</sup>

Mund të themi se nga individë dhe grupe që nuk janë plotësisht të socializuar në frymën e ideve, bindjeve dhe vlerave të institucionalizuara, duhen pritur forma të reja mendimi, bindjesh dhe vlerësimesh. Nga ky këndvështrim ndoshta është më mirë që ka huqe në socializimin e personalitetit në frymën e vlerave të sistemit të institucionalizuar, sepse nga këto huqe mund të presim një frymë të re në fushën e ideve, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve. Pikërisht për faktin që këto grupe apo individë qëndrojnë pjesërisht apo krejtësisht jashtë sistemit institucional, ose pse nuk përputhen me sistemin ashtu siç bëjnë grupet e tjera shoqërore, ato nuk mund të mbështeten te sistemi, por te vetja, te forcat dhe aftësitë e tyre, për të gjetur kështu rrugën drejt dëshimit të vetes.<sup>596</sup>

<sup>594</sup> M. Selimović, *Tvrđava*, Svjetlost, Sarajevo, 1970, f. 85.

<sup>595</sup> Ata individë që nuk e çajnë kokën për atë që ndjejnë, mendojnë apo bëjnë; të cilët janë të gatshëm t'i ofrojnë të gjithë këto “për një qindarkë dhe një gotë verë”, është shumë më e lehtë t'i bindësh krahasuar me personalitete të cilët janë të vetëdijshëm për fuqinë, vlerat e qëndrimeve dhe mënyrën e sjelljes. Fromm-i ka të drejtë kur shkruan: “The effect of ideas, while these are easy to accept if the majority proclaims them, depends to a large extent on the character structure of a person in a critical situation.” (Fromm, *The Dogma of Christ*, Doubleday dhe Company, Inc, Garden City. New York, 1966, p. 152)

<sup>596</sup> Qëndrimi jashtë rendit institucional, shpeshherë është i lidhur me ndjenjën e përjashtimit, pasigurisë, marginalizimit dhe inferioritetit.

Nuk mund të presim që një ideologji e vetme, që është racionalizim i interesave të një grupi në pushtet, ta pranojnë e ta ndjekin të gjitha klasat sociale etj. në mënyrë të barabartë, sepse interesat e këtyre grupeve – dhe pozita e tyre objektive – është shumë e ndryshme. Prandaj, masat e pranimi dhe të realizimit të një ideologjie do të jenë shumë të ndryshme. Në një shoqëri të ndarë në klasa, mesazhet e përgjithësuara të manipuluesit nuk shkaktojnë pasoja aq të forta sa mesazhet e specializuara që godasin dhe manifestojnë interesat e një klase të caktuar në shoqëri. Kjo është një pengesë strukturore që nuk i lejon inxhinierët e shpirtave njerëzorë të manipulojnë me të njëjtin efikasitet të gjitha shtresat në shoqëri. Pavarësisht manipulimit sistematik, është e vështirë të priten ndryshime të rëndësishme në sjelljen politike: për aq sa biem përfund shkallës shoqërore, numri i atyre që ia falin partive radikale besimin politik rritet; ose për aq sa ana tjetër është e njëjta gjë, numri i atyre që kanë orientim konservator pëson rënie.

Në lidhje me shtresimin dhe diferencimin shoqëror, ekziston edhe një pengesë që “profesorët e bindjes” nuk mund ta heqin aq lehtë – bëhet fjalë për natyrën selektive të shpirtit njerëzor, që mund të hetohet prej fazave më të ulëta të veprimit të tij, deri tek ato më të lartat. Qysh në nivelin e vrojtimit të përditshëm, bindemi me lehtësi se individët dhe grupet vënë re se çytjet e mjedisit të tyre natyror, shoqëror dhe simbolik kanë njëfarë lidhjeje me interesat e tyre, me sistemin vlerësues apo me qëndrimet. Në nivelin e kujtesës individuale dhe kolektive, bindemi se individët dhe grupet mbajnë mend ato përmbajtje (ide, bindje, informacione etj.) që janë të një rëndësie të veçantë për jetën e tyre. Kjo bëhet edhe më e qartë nëse përpiqemi të kujtojmë të gjitha ato që na kanë ndodhur në të kaluarën, dhe menjëherë do zgje-

dhim atë që është më e rëndësishme për ne. Nuk është shaka nëse thuhet se edhe harresa njerëzore është një proces selektiv, pasi ne i harrojmë fort rrallë ato ngjarje që kanë pasur një rëndësi të posaçme për jetën tonë. Nga ana tjetër, kur është fjala për ngjarje sporadike, përgjithësisht i harrojmë. Perceptimi dhe të mbajturit mend është përzgjedhës, harresa po ashtu.

Individët dhe grupet zgjedhin ato mesazhe që konfirmojnë qëndrimet e tyre (perceptimi përzgjedhës); mbajnë mend ato mesazhe ose pjesë të tyre që i forcojnë këto qëndrime (kujtesa përzgjedhëse); dhe hedhin poshtë ato mesazhe ose pjesë mesazhesh që bien në kundërshtim me qëndrimet e tyre. Individët dhe grupet zakonisht lexojnë ato gazeta që i përshtaten orientimit të tyre politik; shikojnë ato programe televizive që iu përshtaten shijeve dhe vlerave e tyre; dhe dëgjojnë fjalimet e të adhuruarve të tyre politikë.

Njerëzit janë më shumë të prirë të kërkojnë dhe të marrin ato mesazhe që konfirmojnë vlefshmërinë e qëndrimeve të tyre<sup>597</sup> sesa të ballafaqojnë qëndrimet e tyre me mesazhet (informacionet) e tjera, me ato që thonë të kundëren.<sup>598</sup>

Madje edhe në ato kushte kur individët janë të ekspozuar ndaj veprimit të mesazheve ku, përveç ideve dhe fakteve me të cilat bien dakord, ekzistojnë edhe ide e fakte që

<sup>597</sup> Nëse mbahet një seminar/konferencë për dëmet e alkoolit dhe duhanit, të pranishmit, zakonisht, janë ata që nuk pijnë e nuk tymosin – për çudi të referuesve. Domethënë, vijnë ata të cilët duan të forcojnë bindjen se kanë të drejtë që nuk pinë dhe tymosin.

<sup>598</sup> Nëse mësuesi organizon një mbledhje me prindër, përgjithësisht në mbledhje vijnë vetëm prindërit e nxënësve të mirë; ndërsa prindërit e nxënësve të dobët e shmangin ftesën, që të mos dëgjojnë fjalë të pakëndshme për fëmijët e tyre. Pra, kjo është arsyeja se pse ata nuk vijnë rregullisht në të tilla mbledhje, megjithëse ato organizohen pikërisht për ta. Ky realitet është në përputhje me rregullat e vendosura: njerëzit ekspozohen përballë atyre mesazheve me të cilët bien dakord, dhe shmangin ato mesazhe me të cilët nuk pajtohen.

nuk pranohen, ata janë të prirë të zgjedhin, të mbajnë mend dhe të miratojnë ato pjesë që janë në përputhje me idetë dhe qëndrimet e tyre. Fakte të këtij lloji kanë shërbyer si bazë për përfundimin se manipuluesi, në shumicën e rasteve nuk mund t'i ndryshojë rrënjësisht qëndrimet e individëve dhe grupeve, por, kryesisht, mund të përforcojë qëndrimet ekzistuese. Manipulimi ndihmon për mbajtjen, forcimin dhe thellimin e racionalitetit të rendit ekzistues të gjërave.

Njerëzit pranojnë dhe ndjekin ato ide (informacione) që përputhen me qëndrime tashmë të formuara, që do të thotë se mes të gjitha ideve të ofruara, – nëse është fjala për tregun e ideve dhe vlerave – njeriu bën një përzgjedhje shumë të mprehtë. Duke pasur parasysh interesin, njerëzit zgjedhin ato ide që justifikojnë apo mbrojnë interesat e tyre; duke pasur parasysh ndjenjat, njerëzit zgjedhin ato ide që janë në përputhje me përjetimet e tyre; duke pasur parasysh vlerat morale, ata zgjedhin ato ide që nuk bien në kundërshtim me ndjenjat dhe vlerat e tyre morale; duke pasur parasysh normën grupore, anëtarët e grupit zgjedhin ato ide që janë në harmoni me rendin normativ të grupit dhe që ndihmojnë unitetin grupor. Në varësi të së vërtetës, njerëzit janë të prirë t'i pranojnë si të mirëqenë ato fakte që përputhen me përvojat, nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

Pra, nëse do e figurativizojmë, ndërmjet mijëra specieve që ka deti, ata zgjedhin gjithnjë vetëm një numër fare të kufizuar syresh.

Shpresoj se tani është bërë shumë e qartë ajo që kemi theksuar më lart: pushtuesit e vetëdijes njerëzore nuk mund të jenë plotësisht të sigurt se çfarë do të ndodhë me mesazhet e tyre kur ato interpretohen në varësi të interesave, ndjenjave, vlerave, normave dhe pritjeve vetjake e kolektive. Kuptimi që ata i japin mesazheve të tyre ndryshon shu-

më nga kuptimi që i japin njerëzit, të cilëve u janë dërguar këto mesazhe. Kuptimi i mesazhit nuk varet nga përmbajtja objektive e vetë mesazhit, por në radhë të parë nga çfarë do zgjedhin, mbajnë mend dhe miratojnë njerëzit nga mesazhi. “Nga fiksonet popullore, njerëzit e ditur marrin atë që mund të përputhet me shprehjet e tyre. Kurse nga fiksonet e njerëzve të ditur populli ka marrë çfarë ka mundur e si ka mundur në saje të kuptimit, dhe nga e gjithë kjo është krijuar një ortek i madh marrëzie publike.”<sup>599</sup>

Ndonjëherë mesazhet e bindësve pothuajse nuk arrijnë te disa grupe të rëndësishme shoqërore (klasa), sepse këta të fundit ose nuk janë të interesuara për këto mesazhe ose nuk janë në gjendje t’i kuptojnë (grupet e mëdha të paarsimuara).

Fakte të këtij lloji, se nuk ka asnjë interesim për mesazhet, dhe se mesazhet nuk mund të miratohen për shkak të nivelit të ulët të arsimimit të popullsisë, veprojnë si një barrierë e pakalueshme për çdo grup që nuk ka arritur në majat e fuqisë ekonomike apo të pushtetit politik – falë arsyes së vet, por, megjithatë, i jep të drejtë vetes që në varësi të arsyes së përgjithshme të publikojë reklama apo slogane politike, funksioni kryesor i të cilave është përmirësimi i ekonomisë dhe politikës; por, në të vërtetë, grupi ka për qëllim të sigurojë përfitime dhe pushtet, sipas atyre rregullave që ka vendosur po vetë.

Psikologët socialë kanë paralajmëruar edhe për një vështirësi, përpara së cilës ndodhen inxhinierët e vetëdijes njerëzore: fuqia e normës së grupit. “Fraza *normë grupore* përkufizohet si një rregull që formulon qëndrimet dhe veprimet që priten prej anëtarëve, si rezultat i rrethanave që

<sup>599</sup> Manconi, *Verenici*, Prosveta, Beograd, 1966, f. 535.

mbizotërojnë dhe që specifikojnë pasojat e përmbajtjes dhe jopërmbajtjes.”<sup>600</sup> Kur anëtarët e një grupi miratojnë një normë grupore në atë masë që nuk e ndejnë më kuptimin e saj represiv, ata janë të fiksuar pas grupit duke shfaqur rezistencë këmbëngulëse karshi çdo mesazhi që dëmton normën grupore.

Nuk duhet të harrojmë se mendimet, qëndrimet dhe bindjet e anëtarëve të grupit janë thellësisht të kushtëzuara nga jeta e tyre në grup, dhe anëtarët nisin t’u binden normave grupore shumë më përpara se pyetjet që mund të bëjnë për arsyeshmërinë dhe vlerën e tyre. Qenia njerëzore është e aftë të miratojë një normë grupore përpara se ta kuptojë atë.<sup>601</sup> Dhe kur norma grupore është e njëjta gjë si “uni i dytë”, atëherë çdo sulm i anëtarëve të grupit ndaj normës përjetohet si një atentat ndaj vetes, ose si një autogol.

Anëtarët që e çmojnë lartë anëtarësinë synojnë që në mënyrë më të plotë të harmonizohen aty për aty me normën e grupit, në çastin kur mbi grupin ka ndodhur sulmi sesa para se të ketë ngjarë kjo.”<sup>602</sup>

Fakti që në situata eksperimentale individët janë më të prirë të binden sesa në situata të përditshme, është i mundur ngaqë në situatat eksperimentale individët janë të përjashtuar nga kuadri i tyre social (në grup) dhe u mungon përkrahja sociale e grupore.

<sup>600</sup> D. Kreč, *Pojedinac u društvu*, f. 254.

<sup>601</sup> Në atë grup ku mbretëron paragjykimi, një qëndrim relativisht i pavarur prej arsyeve të shëndosha, manipuluesi do ketë sukses të pakët në përpjekjen për të ndryshuar qëndrimin e anëtarëve të grupit.

<sup>602</sup> D. Kreč, *Pojedinac u društvu*, f. 291.

“Ai individ që është i mirëpozicionuar në grup, thjesht nuk e lejon mundësinë e ndikimit dhe nuk do që të ekspozohet karshi asnjë lloj bindjeje, sepse nuk ka gjetur dyll të butë tek unë që të shtypë mendimin e tij...” (A. Frans, *Život u cvetu*, f. 192)

Në një situatë eksperimentale ata formojnë një grup të rastësishëm ose një turmë, kurse në situata të përditshme ata janë anëtarë të një komuniteti të konsoliduar. Kështu, rezulton se individët të cilët janë të integruar dobët në grup dhe që janë besnikë të këtij qëndrimi, pa një qëndrim të fortë, janë më të prirë t'i pranojnë dhe t'i ndjekin mesazhet e manipuluesit, krahasuar me ata individë të cilët janë të akomoduar mirë në grup dhe që refuzojnë çdo mesazh që është në kundërshtim me normat grupore.<sup>603</sup>

Kur bëhet fjalë për kufijtë e manipulimit, duhet theksuar se qëndrimet, për nga vetë natyra i rezistojnë ndryshimit, dhe kështu sigurohet çdo bindës në përpjekjet e tij për t'i ndryshuar ato. Siç tregojnë kërkimet e kohëve të fundit<sup>604</sup>, qëndrimet kanë funksione të rëndësishme në jetën e individëve dhe grupeve. Qëndrimet përmbushin disa nga nevojat e individëve dhe grupeve, dhe janë harmonizuar me këto nevoja, prandaj është e vështirë që të ndryshohen.

Roli i parë i qëndrimeve në jetën e individit dhe grupit përbëhet nga përshtatja ndaj mjedisit natyror, shoqëror dhe kulturore. Kur qëndrimin për një fenomen, personalitet, institucion, grup, vlerë apo ide merr formë, ai i reziston ndryshimit, sepse arrin të përmbushë nevojën për t'i zgji-

<sup>603</sup> Sa më shumë ta vlerësojë individi anëtarësimin e tij në grup, aq më shumë i miraton normat e grupit; domethënë, vështirë të heqë dorë nga qëndrimi i tij. Për aq sa individi kërkon një status më të lartë në grup, qëndrimet e tij do të jenë më bindëse, dhe është e vështirë të ndryshojnë. Qëndrueshmëria dhe ekzistenca e qëndrimit varen nga lloji i strukturës shoqërore. Tek ato grupe që kahen drejt një strukture statike, kur lëvizja horizontale dhe vertikale është e dobët dhe e parëndësishme, hasim qëndrime të forta dhe të përhershme, që e është vështirë të ndryshohen (për shembull, paragjykimet). Ndërsa te grupet me një lëvizshmëri të theksuar – qoftë e priturore apo reale – hasim qëndrime jo të thella, dhe si rrjedhim ato mund të ndryshohen me lehtësi. Forca dhe ekzistenca e qëndrimit të individit ka të bëjë me mbylljen ose me hapjen e strukturave shoqërore ku bën pjesë individi.

<sup>604</sup> Në radhë të parë mendoj për studimet e D. Katz; për më tej: *Readings in Attitude Theory and Measurement*, ed. by M. Fishbein, John Wiley and Sons, New York, 1967.

dhur lehtësisht problemet tona jetësore. Ne nuk mund të silllemi në mënyrë unike dhe të papërsëritshme për çdo çështje, por krijojmë modele të caktuara përmes të cilave gjejmë zgjidhje për të gjitha ato probleme që janë identike. Me kalimin e kohës mësohemi që problemet identike t'i zgjidhim në të njëjtën mënyrë, dhe kjo na bën të qetë. "Njerëzit sillen njësoj jo për faktin se këto gjëra janë të njëjta në kuptimin lëndor, por kryesisht ngaqë ata janë mësuar t'i klasifikojnë këto gjëra në të njëjtin grup; sepse mund t'i përdorin për të njëjtën nevojë, ose mund të presin nga këto gjëra atë që edhe të tjerët janë të interesuar të presin."<sup>605</sup>

Një rol tjetër i qëndrimit përbëhet nga fakti se qëndrimi na ndihmon të orientohemi përballë fenomeneve natyrore, shoqërore dhe kulturore. Qëndrimi përmbush nevojën e fortë për orientim në një botë ku mund të devijosh fare lehtë nga rruga. Ngjan vërtet sikur endemi poshtë e përpjetë; sikur përpara nesh është fshirë imazhi i çmuar i Jezuit. Do ishim shkatërruar e do ishim shuar si soj në prag të përmbytjes.<sup>606</sup> Ata që kanë miratuar Dhjetë Urdhëresat e Zotit si qëndrim të tyrin jetësor kanë një pikë referimi shumë të veçantë. Kur një orientim i tillë miratohet, atëherë është shumë e vështirë të braktiset apo të ndryshohet.

Roli i tretë i qëndrimit është se ai bashkon informacionet e shpërndara dhe të paunifikuara me njëri-tjetrin në një tërësi, dhe u jep atyre një kuptim për individin. Zakonisht këto informacione organizohen rreth një pikëpamjeje qendrore, kështu që ato qëndrime të cilat janë larg qendrës mund të ndryshohen me lehtësi, përderisa pikëpamja qendrore, që ka një rëndësi jetike për individin, mbetet e fortë dhe e qëndrueshme.

<sup>605</sup> F. A. Hayek, *The Counter-Revolution of Science, Studies on the Abuse of Reason*, The Press of Glencoe, 1964, f. 26.

<sup>606</sup> Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, Rad, Beograd, 1967, f. 395.

Zakonisht, pikëpamja qendrore është e ndërtuar mbi një përvojë të drejtpërdrejtë, ndërsa qëndrimet periferike arrihen me mësim nga përvojat e të tjerëve. Bindësi zakonisht arrin të ndikojë te të ashtuquajturit individë periferikë, tek ato ndjenja, bindje dhe qëndrime që janë shumë larg përvojës së drejtpërdrejtë, për të cilën ata nuk e vënë ujin në zjarr. Mbetet shpresa që individit thelbësor apo kryesor nuk do e pësojë nga veprimet manipuluese, dhe gjithë ato ndjenja, besime dhe qëndrime që janë arritur nga raporti i drejtpërdrejtë me mjedisin natyror, shoqëror dhe kulturor, për të cilat ai ka nevojë sa çka edhe për vetë jetën, të ofrojnë rezistencë përballë çdo përpjekjeje për ndryshime rrënjësore.

Në faqet e këtij studimi kemi theksuar shpesh se qëndrimi shërben si një mjet mbrojtës<sup>607</sup> për individin në çdo situatë, kur ai ka nevojë të justifikojë ndjenjat apo veprimet, pavarësisht fakteve që nuk i miratojnë këto ndjenja edhe veprime. Për shembull, njeriu që jepet fort pas paragjykimëve racore, – një prej qëndrimeve më të vështirë për t'u ndryshuar – pavarësisht të gjithë argumenteve, madje edhe shkencore, se nuk ekzistojnë dallime thelbësore midis njerëzve të ngjyrave të ndryshme, ai përsëri do e mbrojë me vendosmëri qëndrimin e tij, duke filluar me mbledhje faktesh të reja që e përforcojnë këtë qëndrim dhe mohimin e të gjitha fakteve që bien ndesh me të.<sup>608</sup> Nga kjo shihet qartë se qëndrimi ka edhe funksionin e tij matës në jetën tonë, sepse shërben si një mjet vlerësues me rastin e vrojtimit, kujtesës, harresës, mendimit, vendimit, bindjes dhe sjelljes.

<sup>607</sup> Për më shumë: N. Rot, *Osnovi socialne psihologije*, Socializacija, Beograd, 1973, f. 356.

<sup>608</sup> Nikolla Rot analizon tre "mekanizma mbrojtës": (i.) mohimi i të dhënave të reja, (ii.) përforcimi i qëndrimit të mëparshëm dhe (iii.) izolimi i të dhënave të reja. (po aty, f. 357)

Në kapitullin mbi motivimin kemi tërhequr vëmendjen për nevojën e njeriut që të jetë pjesë e një grupi shoqëror<sup>609</sup>, që të identifikohet me një grup. Qëndrimi është ai që i mundëson njeriut të identifikohet me një grup shoqëror, qoftë në rastin kur i takon atij grupi, qoftë kur thjesht synon të bëjë pjesë në këtë grup. Në këtë mënyrë ai siguron ndjenjën se individi, të paktën, ka diçka të përbashkët me të tjerët. Njerëzit të cilët ndajnë të njëjtin qëndrim, mendojnë se i përkasin të njëjtit grup shoqëror, edhe pse mund të bëjnë pjesë në grupe të ndryshme. Sa më shumë që një individ i pushtetshëm identifikohet me qëndrimin që ndan me të tjerët, dhe sa më shumë që të tjerët janë të pushtetshëm dhe autoritarë, aq më e vështirë do jetë të ndikohet mbi qëndrimin e tij. Pra, si zor të ndryshojë qëndrim.

Së fundi, është e nevojshme të theksohet se njohja e qëndrimeve të individëve dhe grupeve e bën më të lehtë dhe më të saktë parashikimin e sjelljeve të tyre.<sup>610</sup> Supozohet se qëndrimi konsiderohet një lloj prirjeje për veprim, por edhe si një joveprim në vetvete. "Ky ndryshim kuptimor: qëndrimet në veprim dhe veprimi në qëndrim, lejon një interpretimin reciprok."<sup>611</sup>

Këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Nga qëndrimi i individit (ose i grupit) mund të jemi në gjendje të parashikojmë sjelljen e tij vetëm me kushtin që të hiqen të gjithë presionet shoqërore dhe psikologjike; domethënë, njerëzit të jenë të lirë. Vetëm në këto rrethana mund të presim që të

<sup>609</sup> "Bota është atje ku ndodhet njeriu, rrethi i ngushtë ku ai jeton, krijon përvoja dhe vepron. Të tjerat janë mjegull." (Man, *Legenda o Josipu*, II, f. 1071)

<sup>610</sup> "We are still a long way from understanding the theoretical relationship between attitudes and behavior, between attitude change and behavioral change, and we have not yet learned how to predict accurately one from the other." (Milton Rokeach, *Beliefs, Attitudes and Values*, Jossey-Bass Inc, San Diego, 1970)

<sup>611</sup> Habermas, *Saznanje i interes*, f. 210.

përputhen fjalët dhe veprat e tyre. Përderisa shoqëria nuk realizohet pa represion, mund të themi se mospërputhja mes qëndrimeve dhe sjelljeve do të mbetet një tipar i përhershëm i jetës shoqërore. Vetëm njeriu teorik, i verbër, nuk arrin të shohë se njerëzit sillen ndryshe në shumë raste, krahasuar me çfarë kërkojnë qëndrimet e tyre. Pra, nga deklaratat e tyre për një personalitet, grup, send, ide, vlerë, bindje, ndjenjë, veprimtari etj., nuk mund të parashikohet në çdo rast se si do reagojnë.

Dihet se njerëzit janë të prirë të jenë racionalë dhe t'i fshehin motivet e tyre; për këtë arsye, është e nevojshme të ndahet ajo që mendojnë për veten dhe sjelljen e tyre nga sjellja e tyre si e tillë në jetën e jetuar. Kështu, individit mund të deklarohet se nuk ka paragjykime racore (se ky është qëndrimi im jetësor), por, kur i duhet të punojë, të banojë apo të shoqërohet me njerëz të një ngjyre tjetër nga ajo e tija, atëherë çështja ndryshon. Kjo na e bën të qartë se qëndrimet e tij bien në kundërshtim me sjelljen tij reale. Ja një fragment nga Dostojevski në këtë drejtim: "...thotë se e dua njerëzimin, por çuditem me veten: sa më shumë që e dua njerëzimin, aq më pak i dua njerëzit; pra, çdonjërin syresh në veçanti. Prandaj dhe gjithnjë ka ndodhur që, sa më shumë që i kam urryer njerëzit/individët, aq më e zjarrtë është bërë dashuria ime ndaj njerëzimit në përgjithësi."<sup>612</sup>

Nga njohja e qëndrimeve të njerëzve nuk mund të parashikohet gjithnjë sjellja e tyre. Por, edhe nga sjelljet e tyre reale nuk mund të nxjerrim një përfundim të sigurt për pikëpamjet e tyre. Ky është ai tip individësh dhe grupesh që sjellja e tyre publike korrespondon me kërkesat e përkufizuara në mënyrë institucionale. Por, në sferën private ata

<sup>612</sup> Dostojevski, *Braca Karamazovi*, I, f. 72.

mbajnë një qëndrim tjetër, madje sjelljen e tyre e vlerësojnë me standarde të tjera. “Deri në mesditë ndaj të njëjtin mendim me atë shtyp që përfaqëson mendimin tim. Kurse në mbrëmje mendoj atë që më do qejfi.”<sup>613</sup>

Pra, ndodh që bindësi mund ta ndryshojë qëndrimin e një individi apo grupi, por jo sjelljen e tyre reale; sikundërse ndodh shpesh që ai arrin të ndryshojë sjelljet e njerëzve, por ata vazhdojnë të ruajnë qëndrimet e tyre. Ndryshimi i qëndrimit nuk nënkupton gjithmonë edhe ndryshimin e sjelljeve; ashtu sikurse edhe ndryshimi i sjelljes nuk nënkupton ndryshim në qëndrim. Kjo njohuri na flet për natyrën e lakueshme njerëzore, por edhe për fuqinë e kufizuar të manipulimit.

“Për fatin e njerëzimit, natyra njerëzore është identike me karakterin e mushkës, e jo me atë të deles. Kjo ka qenë një cilësi shpëtimtare për njeriun. Por, deri në ditët e sotme, natyrës kryeneçe njerëzore nuk i është dashur asnjëherë t’i kundërvihet armës së re psikologjike që tundet nga tirani modern.”<sup>614</sup>

\* \* \*

Disa mendojnë se manipulimi është i plotfuqishëm, disa se është i pafuqishëm, ndërsa unë mendoj se manipulimi është i fuqishëm. Që nuk është i plotfuqishëm e dimë ngaqë ekzistojnë akoma alternativa në mendim, bindje dhe sjellje. Që manipulimi është i fuqishëm shihet te pasojat që shkakton. I vetmi qëndrim i kuptueshëm është se manipulimi është i fuqishëm dhe do të jetë gjithnjë edhe më i fuqishëm për aq sa shoqëria i afrohet një organizimi autoritar.<sup>615</sup>

<sup>613</sup> Balzac, *Propale iluzije*, Kultura, Zagreb, 1952, f. 312.

<sup>614</sup> Toynebee, *Istraživanje istorije*, II, f. 415.

<sup>615</sup> “Aty ku dominon parimi monarkist, njerëzit janë në pakicë. Ndërsa atje ku ky parim nuk mohohet, nuk ka fare njerëz.” (Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f. 34)

## KRITIKA E MANIPULIMIT NGA PIKËPAMJA E HUMANIZMIT

*“Kritika e fesë mbaron me mësimin se njeriu është një qenie e lartë për njeriun; pra, me imperativin kategorik: të rrënohen të gjitha marrëdhëniet ku njeriu është i shtypur, i përbuzur, i lënë pas dore, një qenie që urrehet, marrëdhënie këto që nuk mund të përshkruhen më mirë se sa në deklaratën e një francezi me rastin e projektimit të një tatimi për çështjen e qenve. Me ju duan të veprojnë si me njerëzit.”*

Marx

Deri më tani jam përpjekur ta shpjegoj manipulimin nga pikëpamja e strukturës dhe funksionit të tij në shoqëri-në civile. Kurse tani do përpiqem ta vlerësoj nga pikëpamja e një filozofie të caktuar humaniste, që është marksizmi. E kam gjykuar mjaftueshëm manipulimin, tani dua ta dënoj.

Jam i vetëdijshëm që një pjesë e madhe eksponentësh të shkencave shoqërore do i ngrysin menjëherë vetullat e do më thonë se detyra jote është të shpjegosh, jo të japësh vlerësime. Ndalo këtu dhe mos e kalo kufirin që ndan gjykimet mbi faktet nga gjykimet vlerësuese. Ata që më njohin e dinë se i kam kaluar kufijtë, duke mos bërë shumë llogari rreth ndarjeve të shkollave të ndryshme në disiplina shkencore dhe rreth kërkesave të shkencës pozitiviste, për t’iu përmbajtur kështu interpretimit të fakteve, si dhe që të mos merakosemi nëse këto fakte lëndojnë dinjitetin tonë njerëzor. Edhe njëherë zgjedh të mos pajtohem me të gjithë ata që thonë “lëri faktet të flasin vetë”, në mënyrë që të pajto-

hem me vetveten dhe me qëndrimin tim, të cilin e jetoj e për të cilin jetoj.

Humanizmi për mua është një qëndrim vlerësues, nga i cili mund të bëhet një kritikë themelore ndaj të gjitha formave të sendëzimit, por edhe ndaj manipulimit si dëshmi e hollë dhe ndaj reduktimit të njeriut në send në mënyrë të pahetueshme. Nga kjo pikëpamje, të gjitha format e sendëzimit tregojnë karakterin e tyre çnjerëzor, dhe nuk ka vend këtu për të shtruar pyetje – siç bëjnë disa<sup>616</sup> – si: a është kjo apo ajo formë sendëzimi një krim i madh apo i vogël mbi njeriun?<sup>617</sup> Në qoftë se lirinë e njeriut e bëjmë zap brenda katër mureve të burgut apo brenda katër rreshtash dialektikë, në të dy rastet pasojat janë të kobshme: “Të dyja këto metoda, shtypje me dhunë dhe thyerje me ndikim borgjez, praktikohen vazhdimisht në mbarë botën, në çdo vend, ku partitë e ndryshme të klasave sunduese vendosin në rendin e ditës herë njërën metodë e herë tjetrën.”<sup>618</sup>

<sup>616</sup> “Sipas modelit tim vlerësues, bindjen, madje edhe bindjen manipuluese, duhet t’ia nënshtrijmë forcës.” (D. Risman, *Usamljena gomila*, Nolit, Beograd, 1965, f. 210) “Mashtrimi me një mjet të së vërtetës, pa dyshim që është më i keq se mashtrimi me një mjet të gënjeshtërs.” (V. Desnica, *Proljeca Ivana Galeba*, SKZ, Beograd, 1967, f. 106)

<sup>617</sup> Pikëpamja teorike për eliminim e të gjitha formave të tjerësimit, historikisht nuk mund të bëhet si një “kërcim nga mbretëria e domosdoshmërisë drejt mbretërisë së lirisë”, por vetëm përmes praktikës historike, këmbëngulëse dhe të vetëdijshme, me anë të tejkalimit të formave brutale të tjerësimit, me forma organizimi që bëjnë të mundur çlirimin e individit.

<sup>618</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, Kultura, Beograd, 1960, f. 336.

“Ajo që është karakteristike për Rusinë është kalimi gjigant i dhunës së egër në një mashtrim të thjeshtë.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 9, f. 404) “Politische Manipulation ist allerdings von den brutalen Unterdrückung mit Gefahr für Leib und Leben zu unterscheiden. Zwar beabsichtigen beide dasselbe: die Anpassung des Burgers an eine bestimmte Ideologie und Moral, schliessen damit die Unfreiheit und der Manipulierten Unterdrückten en Ihr Unterschied - wenn auch nur em gradueller - liegt letztlich in der Anwendung der Mittel” (Dietrich Bäuerle, *Handlexikon zur Politikwissenschaft*, Herausgegeben Axel von Görllitz, Rowohlt, Reinbek bei Hamburg, 1973, S. 231)

Të dyja këto metoda janë metoda dhune, pavarësisht se për një rën palë bëhet fjalë për dhunë fizike, kurse për tjetrën për dhunë shpirtërore. I vetmi ndryshim mes tyre është se metoda e parë shkakton rezistencën e viktimës, ndërsa e dytë jep pëlqimin e viktimës. “Rolin e dajakut e merr teknika e sugjestionit, që do të thotë se xhandari ose gardiani zëvendësohet nga eksperti i propagandës dhe redaktori i gazetës.”<sup>619</sup>

Të zgjedhësh mes formave të ndryshme të sendëzimit, që ofrohen me bollëk nga shoqëria civile moderne, në fund të fundit do të thotë të zgjidhni të njëjtën shoqëri brenda së cilës realizohet sendëzimi, të cilin e imponon çdo ditë. Humanizmi ishte, është dhe do të mbetet një fjalë revolucionare dhe një praktikë konservatore deri në atë çast kur brenda shoqërisë civile të kërkohet dalja nga sendëzimi, shoqëri e cila i krijon vetë të gjitha format e sendëzimit, sepse nuk mund të bëjë ndryshe.

Mendimtari marksist nuk mund ta quajë human raportin mes të pasurit dhe të varfrit, ku i pasuri e argumenton humanizmin e tij duke i dhënë të varfrit një copë bukë. Kjo sepse që i pari të ketë mundësi të tregohet human, i dyti duhet të jetë medoemos i varfër. Ky lloj “humanizmi” i vendos marrëdhëniet e pabarazisë ekonomike si një gjendje normale në jetën shoqërore. Mendimtari marksist nuk mund t’i quajë humane veprimet e një pronari në raport me mjetet e prodhimit dhe me njerëzit që udhëheqin organizmin e punës, që përpiqen t’u sigurojnë punëtorëve kushte më të mira pune dhe rritje të të ardhurave brenda sistemit të shfrytëzimit; sepse ata, në fund të fundit, pandehin se ky sistem është normal në kuadër të punës.

<sup>619</sup> Ivan Kuvačić, “Savremeni oblici duhovnog nasilja”, *Praxis*, nr. 1-2, 1970, f. 145.

Mendimtari marksist nuk mund ta quajë human veprimin e strukturave tekno-politike, që u japin mundësi punëtorëve të marrin pjesë në drejtimin e ndërmarrjeve. Duhet përmendur se është e çuditshme se si sociologët nuk e mënjanojnë prej analizave të tyre këtë frazë konservatore, sepse pjesëmarrja është përfshirë si stimuluese psikologjike në sistemin e përgjithshëm të shfrytëzimit.

Për mendimtarin marksist nuk është e mjaftueshme shprehja e keqardhjes për të varfrin dhe caktimi i disa parave për të në formë lëmoshe. Ai kërkon eliminimin e çdo marrëdhënieje ku njëri paraqitet i pasur dhe tjetri qyqar. Në radhë të parë ai angazhohet që punëtorët të mos luftojnë për të rritur të ardhurat brenda sistemit kapitalist, por për rrënimin e sistemit të shfrytëzimit si të tillë. Për të nuk është e rëndësishme që punëtorët të marrin pjesë në hartimin e vendimeve që kanë të bëjnë me jetën e tyre, por që të vendosin për fatin e tyre. Por, këto janë çështje që prekin çështje themelore se kush është...

## Njeriu

Kemi parë se manipuluesi, me apo pa vetëdije, nisat nga të kuptuarit e njeriut si një produkt i rrethanave dhe çështjeve të jashtme. Një konceptim i tillë i njeriut përbën bazën e psikologjisë bihejvioriste (vështruese), e cila studion psikologjinë dhe sjelljen e njeriut, ekskluzivisht në varësi të mjedisit të jashtëm. "Detyra e analizës shkencore është të shpjegojë se si është sjellja njerëzore e individit si njësi më vete, si sistem fizik i lidhur me kushtet në të cilat jeton individi."<sup>620</sup> Nëse në shkencë e shpjegojmë dhe e kuptojmë

<sup>620</sup> B.E. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 14.

vetveten me ndihmën e diçkaje që është jashtë nesh, që nuk është ne, atëherë, në fakt, ne e privojmë veten nga statusi i genies njerëzore dhe tjetërsohemi. Kjo nuk është asgjë tjetër përpos vdekje e njeriut, sepse kështu njeriu nuk dallohet nga bota e gjërave; ai e humb identitetin e tij. Shkenca mbi njeriun nuk studion njeriun – ajo e mohon atë, sepse shkenca synon ta shpjegojë njeriun me diçka që është jashtë tij, me diçka që nuk i përket atij. Me ndryshimin e kushteve të jashtme – mjedisit natyror, shoqëror dhe simbolik – mund të ndikohet në sjelljen e njësisë individuale në drejtimin e synuar. “Analiza eksperimentale e lëviz kushtëzimin e sjelljes prej njeriut autonom drejt mjedisit jetësor, dhe mjedisi bëhet përgjegjës për zhvillimin e llojit dhe për repertorin që arrin çdo anëtar”.<sup>621</sup>

Nëse çdo gjë varet nga mjedisi (rrethanat) dhe asgjë nga njeriu, atëherë njeriu nuk është i lirë, e meqë nuk ka liri, nuk ka as njeri. “Njeriu nuk mund të imagjinohet pa liri, veçse nëse nuk ka jetë.”<sup>622</sup> Në qoftë se nuk ka jetë, atëherë kjo është tjetër gjë, dhe duhet studiuar si çdo gjë tjetër. Shkenca pozitive kërkon nocionin e gjërave.<sup>623</sup> Vetëm në një botë të tjetërsuar, domethënë në një botë ku edhe vetë njeriu është reduktuar në gjë, bëhet e mundur shkenca mbi njeriun. Shkenca, në bazën e së cilës kuptimi i realitetit është si kuptimi i gjërave, nuk mund ta shohë ndryshe rea-

<sup>621</sup> Po aty, f. 214.

“Pra, ti mendon se njeriu nuk duhet të etiketohet gjithnjë në të njëjtën mënyrë, por emrin e tij duhet t’ia përshtatsë rrethanave. (...) çfarë ndodh me të dhe ku ndodhet ai?” (Man, *Legenda o Jospiu*, II, O. Keršovani, Rijeka, 1960, f. 1624)

<sup>622</sup> Tolstoj, *Rat i mir*, II, Prosveta, Beograd, 1965, f. 775 dhe 785.

<sup>623</sup> Për më shumë: Branko U. Pavlović, *Rasprava o filozofskim osnovama nauka*, Nolit, Beograd, 1973, f. 90.

litetin njerëzor.<sup>624</sup> Metodatat e shkencës pozitive mund të aplikohen vetëm në atë realitet që përbën një gjë, apo që ka karakteristikat thelbësore të një gjëje (një realitet i tjetërsuar). Metoda pozitive e ka në natyrën e vet ta injorojë njeriun si subjekt (personalitet). Ndërsa në natyrën e mendimit shkencor është që çdo fenomen ta shpjegojë me një fenomen tjetër (me fenomene të tjera); domethënë, shkakun ose motivet e ekzistencës apo të sjelljes së fenomenit t'i kërkojë jashtë tij.<sup>625</sup> Nga diçka që nuk i përket thellësisht njeriut, nuk mund të shpjegohet dhe as të kuptohet ajo që është njerëzore. Përderisa shkenca vazhdon ta shpjegojë dhe kuptojë botën e njeriut duke u nisur nga një botë jonjerëzore (ajo e gjërave), për të bota njerëzore mbetet një botë gjërash. “Në njëfarë kuptimi, çdo shkencëtar është një kufomë.”<sup>626</sup> “Te mohimi i plotë i njeriut gjejnë kënaqësinë më të madhe. Pra, njeriu të mos jetë ai që është; t'i ngajë sa më pak vetvetes. Këtë ata e konsiderojnë si progresin më të lartë.”<sup>627</sup> Shkenca pozitive është e zënë dhe e kënaqur me imazhin e njeriut si i jashtëm; teksa njeriu i brendshëm (shpirtëror), në fakt, mbetet një mister.

Vetë nocioni i manipulimit është shfaqur vetëm në një kornizë më të gjerë filozofiko-shkencore të të konceptuarit

<sup>624</sup> Nëse bota në të cilën jetojmë është tjetërsuar, atëherë edhe teoritë për botën, në thelb, janë teori për gjërat. Për këtë arsye, kritika për një botë të tjetërsuar mund të fillojë edhe me kritikën e teorisë mbi këtë botë.

<sup>625</sup> “Shpjegimi shkakësor, në kuptimin e parë, mund të themi se mund të zbatohet vetëm mbi ato fenomene që e kanë diku tjetër shkakun e ekzistencës.” (B. U. Pavlović, po aty, f. 2023)

<sup>626</sup> Hugo, *Çovek koji se smeje*, Rad, Beograd, 1959, f. 85.

“Preokupimi i njeriut me rrethanat e jashtme, me gjëra të jashtme të rrethanave jetësore, e ka shtyrë vetëdijen mbi çështjen se njeriu është rrënja, qëllimi më i lartë dhe masa e njeriut.” (Andrija Krešić, “Filozofski izvori Marksova humanizma”, në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socializam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963, f. 13.

<sup>627</sup> Dostojevski, *Zločin i kazna*, Rad, Beograd, 1967, f. 218.

të njeriut dhe realitetit shoqëror, dhe kjo kornizë është filozofia pozitive dhe shkenca, ku shqyrtimi i sjelljes së njeriut bëhet në të njëjtën mënyrë siç bëhet studimi i kafshëve apo i një sendi që mund të manipulohet në bazë të dëshirës. Foucault e çoi deri në fund atë që ka të brendashkruar shkenca pozitive: shkenca mbi njeriun është e mundur vetëm atëherë kur njeriu pushon së ekzistuari. A nuk është vdekja ajo mbi bazën e së cilës është e mundur çdo njohuri në përgjithësi.<sup>628</sup>

Në qoftë se manipulimi mbështetet te një kuptim i gabuar mbi njeriun dhe sjelljen e tij, atëherë si është e mundur që ai të ketë sukses? Askund nuk kam thënë se manipulimi bazohet te kuptimi i gabuar i njeriut, sepse sikur të ishte kështu, atëherë manipulimi nuk do të ishte fare i mundur. Është një fat i mirë që manipulimi mbështetet te një filozofi pjesërisht e gabuar mbi njeriun dhe shkencën mbi njeriun; prandaj, aq sa është e gabuar kjo filozofi dhe kjo shkencë, po aq i dështuar do të jetë manipulimi i njeriut.

Sa është e gabuar kjo filozofi dhe kjo shkencë mbi njeriun?

Nëse sjellja e individit (po aq dhe mendimi) në grup do të varej veçmas vetëm nga rrethanat e jashtme, atëherë sjellja e tyre duhet të jetë e njëjtë. Por, siç e kemi mësuar nga përvoja dhe kërkimi, një gjë e tillë nuk është e vërtetë. Në të njëjtat kushte objektive (për shembull, depresioni ekonomik), individët reagojnë në mënyra të ndryshme; që do të thotë se për ta kushtet (subjektive) nuk janë të njëjta. Kuptimet për të njëjtat rrethana objektive nuk janë njësoj për të gjithë individët në grup, sepse ata reagojnë në këto kushte edhe në varësi të faktorëve të brendshëm (subjektivë), nga përvoja e kaluar, dija, interesat, nevojat, sistemi i vlerave e

<sup>628</sup> Libri *Rijeçi i stvari* është vetëm një dëshmi për këtë qëndrim. (Foucault, *Rijeçi i stvari*, Nolit, Beograd, 1971)

kështu me radhë. “Çdo njeri ka një pamje të individualizuar për botën, sepse ai është produkt i këtyre përcaktorëve:

- i. i mjedisit fizik dhe shoqëror;
- ii. i strukturave fiziologjike;
- iii. i nevojave dhe qëllimeve;
- iv. i përvojave të deritanishme.<sup>629</sup>

Jo çdo gjë varet nga rrethanat; ka diçka që varet edhe nga ne, edhe pse rrethanat vazhdojnë ta përcaktojnë më fort individin sesa ai ato.”

Rrjedhat e jetës varen shumë pak prej nesh. Ndërsa mënyra se si i përvijojmë ngjarjet, varet kryesisht prej nesh. Pra, për këtë lipsen shpenzuar energji dhe duhet treguar kujdes.”<sup>630</sup>

Ndoshta shkencat mbi njeriun kanë arritur deri në atë pikë të zhvillimit, sa që bëhen të vetëdijshme se pothuajse gjatë gjithë historisë së tyre kanë përdorur ato metoda studimi që u janë dukur objektive, sepse kanë bërë të mundur njohjen e anës objektive (subjektive, tjetërsuese) të sjelljeve të tij; por që, po të mendohet më thellë, këto metoda nuk kanë qenë të përshtatshme për të thënë çfarëdo qoftë kuptimplotë për këto cilësi subjektive të veprimit, që kanë mbetur jashtë veprimit të këtyre metodave<sup>631</sup>, dhe për këtë arsye nuk janë më pak objektive, domethënë më pak njerëzore. Duket se përsëri duhet të mendojmë për nocionin e shkencës objektive, sepse deri më tani, kryesisht, nocioni objektiv është reduktuar në objekt, gjë që është e papranueshme në shkencat mbi njeriun.

<sup>629</sup> D. Kreč, R. S. Kračfeld, I. L. Balaki, *Pojedinac u društvo* (Udžbenik socialne psihologije), Beograd, 1972, f. 17-18.

<sup>630</sup> Ivo Andrić, *Travnička hronika*, Prosveta, Beograd, 1962, f. 261.

<sup>631</sup> “Science as scientific psychology must regard human behavior objectively, as determined by necessary laws, it must represent human behavior as unintentional.” (B. F. Skinner, po aty, 204)

Bindësi i fshehur i merr parasysh arritjet e psikanalizës, që njeriu nuk është vetëm një qenie racionale, por edhe instinktive. Pas Freud-it, do të ishte marrëzi të flitej për njeriun si qenie ekskluzivisht të arsyeshme<sup>632</sup>, si dhe për marrëdhëniet shoqërore si marrëdhënie të rregulluara racionalisht. Ajo çfarë nuk ka marrë parasysh bindësi është se dija e plotë përmes metodës pozitive mund të arrihet vetëm për gjërat, kurse njohuritë për njeriun, të fituara nga kjo metodë, janë të paplota e të pabesueshme për parashikimin e sjelljes së tij, sepse metoda pozitive nuk e studion dot njeriun në tërësi – se çfarë ishte, çfarë është dhe si do jetë.<sup>633</sup>

Filozofia pozitive dhe shkenca besojnë se mund ta përcaktojnë njeriun. Ndërkohë përkufizimi është i mundur vetëm për atë gjë që nuk zhvillohet më tej, që është plotësuar (përfunduar), që nuk ka histori. Marx-i mendonte se njeriu nuk mund të përkufizohet kurrë deri në fund, sepse është e pamundur të njihen të gjitha mundësitë e tij. Njeriu e krijon vazhdimisht vetveten. “Megjithatë, për njeriun socialist, e gjithë e ashtuquajtura histori botërore nuk është gjë tjetër vetëm se prodhimi i njeriut me ndihmën e punës; asgjë më shumë se shfaqje e natyrës për njeriun, ku ai ka një provë të pakundërshtueshme për lindjen e tij, për procesin e tij të krijimit.”<sup>634</sup>

<sup>632</sup> Në të kuptuarit e njeriut, antroplogjia marksiste duhet të gjejë vend edhe për atë shtresën irracionale në të, dhe në këtë mënyrë t’i afrohet një kuptim më objektiv të natyrës njerëzore. Jo gjithçka që është e vërtetë është e kuptueshme, siç na ka mësuar Hegeli. Edhe praktika revolucionare duhet të punojë gjatë për detyrën e madhe të humanizimit të irracionales. Nëse koncepti i njeriut është ndërtuar pavarësisht qenies empirike të tij, atëherë ky nuk është një nocion për njeriun e gjallë, por për një njeri të mundshëm, mangësia e të cilit është se ai nuk ekziston.

<sup>633</sup> Në të vërtetë, si tërësi, njeriu nuk mund të bëhet kurrë objekt i studimit shkencor, sepse: (a) te nocioni i njeriut, ekzistojnë përmasa që nuk mund të studiohen si fakte; (b) përkufizimi shkencor nuk mund të përfshijë diçka që zhvillohet, që ka një histori e cila nuk ka përfunduar.

<sup>634</sup> Marx-Engels, *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953, f, 237.

Njeriu nuk mund të përkufizohet, ngaqë ai që bën përkufizime është pikërisht njeriu. Prandaj, kur ai përpiket të përkufizojë vetveten (dhe të tjerët), me ose pa vetëdije e konsideron veten të përsosur, ashtu siç është përsosur çdo gjë që nuk zhvillohet më shumë. Çdo përpjekje për të përkufizuar vetveten përfundon me vënien e një pike në zhvillimin e tij – me heqjen e historisë ose sendëzimit. Çdo përcaktim mbi njeriun që synon të jetë përfundimtar është vetëm shkatërrim për të. Përcaktimi i njeriut në kuptimin e një përkufizimi përfundimtar e të plotë nuk duhet kërkuar aspak, sepse nëse themi se është i tillë apo i atillë, kjo nënkupton mohimin e gjithçkaje që ai mund të jetë dhe të asaj që ai nuk është.<sup>635</sup> Për njeriun mund të themi vetëm se është një qenie që gjurmon kuptimin e patjetërsueshëm të jetës së tij, mundësitë e tij racionale dhe humane.

Përpjekjet e shkencës pozitive për t'iu përgjigjur pyetjes se ç'është njeriu, mund të përfundojnë vetëm me sendëzimin e tij qenësor. Me anë të metodës së shkencës pozitive, në rastin më të mirë mund të gjejmë të dhëna se çfarë ka qenë njeriu dhe cili është ai tani, por kurrësi se si mund të jetë dhe si do të ishte. Njeriu është një qenie e hapur kah e ardhmja; kështu që, shkenca, e cila nuk mund të thotë asgjë të besueshme për këtë të ardhme, dhe nuk dëshiron të thotë, mbetet një shkencë për gjërat, sepse atje ku nuk ka të ardhme nuk ka as njerëz. Nga këndvështrimi i filozofisë marksiste dhe shkencës kritike, që për arsye të thjeshta nuk e konsiderojnë të përfunduar rendin ekzistues të gjërave,

<sup>635</sup> Nëse themi se njeriu është qenie racionale, atëherë nga ky përkufizim, në të njëjtën kohë lihen mënjanë të gjitha përcaktimet e tjera, si: njeriu është një qenie që bën mjete, një qenie që flet, një qenie morale, një qenie që beson etj. "Ia vlen të shmanget ai mendim që kumton se mund të thotë çdo gjë për njeriun" – më pat thënë njëherë studenti dhe miku im Miodrag Milenković.

zbulimi i mundësive racionale dhe humane në rendin ekzistues është një detyrë e dorës së parë. Kështu, e thënë në mënyrë të prerë, nuk mund të themi se njohuria e plotë racionale është e mundur vetëm në rastin e gjërave<sup>636</sup>, pasi njeriu nuk mund t'i përcaktojë gjërat deri në fund, ngaqë ai i ripërkufizon ato në varësi të përkufizimit të vetvetes; në varësi të nevojave dhe mundësive që ka. Në fakt, ai nuk përkufizon gjërat, por raportin e tij me to.

### Liria

Të jesh i manipuluar do të thotë të humbasësh lirinë, një prej vlerave më të rëndësishme të jetës së njeriut. Humbja e lirisë mund të gjurmohet në të gjitha nivelet e marrëdhënieve të njeriut me botën dhe në cilindo kuptim të lirisë së tij.

Nëse liria e një njeriut shihet te njohja e raporteve natyrore, shoqërore dhe kulturore, atëherë manipulimi e kufizon qenien njerëzore në një mënyrë të vetme njohjeje të këtyre raporteve. Të njohësh një realitet të ndryshueshëm në mënyrë të pandryshueshme (të njëjtë), do të thotë të mbelesh i verbër dhe i shurdhër ndaj mundësive të tjera njohëse të realitetit.<sup>637</sup> Prandaj, lufta kundër manipulimit, në radhë të parë duhet të jetë (a) një luftë për lirinë e nxënies së njohurive të reja (liria për çdo lloj kërkimi); (b) një luftë për qasje të lirë ndaj çdo mjeti teknik për transmetimin e njohurive (qasje e hapur te të gjitha mediat masive); (c) një luftë për lirinë e përhapjes së njohurive; (d) një luftë për të marrë

<sup>636</sup> Ashtu siç mendon Fromm në *The Dogma of Christ*, f. 199.

<sup>637</sup> "Por, në të njëjtën mënyrë, ta shohësh realitetin me të vërtetë është diçka afër marrëzisë." (Kierkegaard, *Bolest na smrt*, botim i veçantë i revistës "Ideje", Beograd, 1974, f. 75.

përgjegjësini e pasojave që mund të shkaktojnë këto njohuri, duke pasur parasysh lirinë e të tjerëve. Me pak fjalë, lufta kundër manipulimit, në fakt, është një luftë për komunikim të vërtetë njerëzor. Komunikimi nënkupton se njerëzit janë marrë vesh, gjë që nuk do të thotë se janë dakord për një çështje publike.

Nëse liria kuptohet si ushtrim zgjedhjeje mes shumë mundësive të ndryshme, – domethënë, këto mundësi tashmë janë të përgatitura dhe në njëfarë kuptimi qëndrojnë përpara nesh – atëherë manipuluesi kërkon që njerëzit të zgjedhin atë mundësi që i përgjigjet më shumë interesit të tij. Ai e parandalon njeriun që të ushtrojë zgjedhje, dhe nëse njeriu jeton pa mundësinë e zgjedhjes, atëherë ai e barazon veten me një të vdekur, kështu që sendëzohet.<sup>638</sup> T'i ngushtosh të gjitha kërkesat e njeriut për nevojat e sistemit – siç synon reklama, që nevojat e njeriut t'i reduktojë në nevoja konsumatori – nënkupton të reduktosh atë që është e mundur tek ajo që është ekzistuese. Nga këndvështrimi ontologjik, manipulimi i asgjëson të gjitha alternativat e njeriut, duke i reduktuar ato në një të vetme. Prandaj, lufta kundër manipulimit nënkupton luftë për mundësitë racionale dhe humane.<sup>639</sup> Kur njeriu bëhet i vetëdijshëm për një mundësi tjetër me dinjitet, ai do përpiqet ta shfrytëzojë atë. “Por, ai rob që bëhet i vetëdijshëm për robërinë, i cili i ka ngjeshur armët për lirinë e tij, ai ka nisur rimëkëmbjen dhe resht së qenuri rob.”<sup>640</sup>

<sup>638</sup> “...sepse është e nevojshme që, të paktën, çdo njeri të ketë njëfarë daljeje.” (Dostojevski, *Zlocin i kazna*, f. 53)

<sup>639</sup> Marksizmi është një rrëfim për pasurinë e mundësive të botës në raport me botën reale. Realiteti është gjithnjë vetëm një pikë nismëtare për diçka të mundshme dhe të re.

<sup>640</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 5, f. 203

Nëse liria kuptohet si liri e autodeterminimit apo e vetëpërcaktimit, – që do të thotë se njeriun nuk bën vetëm zgjedhje midis alternativave të dhëna, faktike ose alternative të trashëguara, por tani ai krijon alternativa të reja – atëherë manipulimi duhet të paraqitet si ndalim dhe shtypje e krijimtarisë. Manipulimi fillon pikërisht aty ku fillon kufizimi i njeriut, që t'i zhvillojë i lirë mundësitë e tij racionale dhe humane.

“Manipulation beginnt dort, wo die Würde und die Grundrechte des Individuums eingeschränkt werden – und zwar Notwendigkeit – in der Absicht, den Menschen für fremde und gegen eigene Interessen verfügbar zu machen.”<sup>641</sup>

### Morali

Pjesa dërrmuese e njerëzve habiten për gjendjen e njerëzve sot. Por, le të kujtojmë se çfarë trajtuam më parë: nëse të gjitha ato që ndjen, mendon dhe bën njeriu nuk varen prej tij, por nga ndarja e fuqive të kontrollit jashtë tij, atëherë ai mund të jetë i lirë – jo përgjegjës, jo fajtor, jo meritör. “Kështu, rasti ka përdhunuar ndërgjegjen.”<sup>642</sup> Kështu që, pse çuditemi kur pranë nesh dhe në veten tonë krijohet një qenia njerëzore “me bërryla të çeliktë e me ndërgjegje prej gome”.<sup>643</sup> Nëse mendojmë objektivisht, atëherë ky lloj njeriu

<sup>641</sup> D. Bäuerle, po aty, f. 233.

<sup>642</sup> Igo, *Čovek koji se smeje*, f. 424.

“Mali i jep formë lisit.” (Žid, *Kovači lažnog novca*, Prosveta, Beograd. 1961, f. 276)  
 “Lumi është gjithmonë më i fortë se një fije kashtë.” (L. Leonov, *Ruska šuma*, Prosveta, Beograd, 1960, f. 38) “Ka mendimtarë të cilët besojnë se institucionet kushtëzojnë veprimet e njeriut, ashtu siç i kushtëzojnë instinktet sjelljet e kafshëve.” (A. Gehlen, *Čovjek*, Veselin Masleša, Sarajevo, 1974)

<sup>643</sup> Remarque, *Crni obelisk*, O. Kerčovani, Rijeka 1966, f. 57.

është pasojë logjike e të kuptuarit të njeriut si një produkt i rrethanave. Kur e kemi pranuar njëherë një filozofi të tillë për njeriun, nuk mund të mos i pranojmë edhe pasojat praktike që vijnë së këndejmi.

Pasoja themelore teorike është e qartë: ajo përbëhet nga mohimi i thjeshtë i mundësisë së çdo morali që do të ishte i drejtuar nga disa norma morale të përhershme, vlera e të cilave nuk varet nga karakteri i ndryshueshëm i rrethanave të jashtme. Filozofët do të thoshin se në këtë mënyrë bëhet e pamundur etika normative. Pasoja themelore praktike, gjithashtu është e qartë, dhe ka të bëjë me mohimin e thjeshtë të çdo përgjegjësie për atë që bën njeriu. Çfarëdo që të bëjë njeriu, ai mund të justifikohet duke thënë se nuk kishte zgjedhje tjetër, se rrethanat ishin të tilla. Atij as që i shkon ndërmend të pranojë se nuk donte ndryshe. Me pak fjalë, veprimet e tij varen nga situatat, jo prej tij, dhe ai vetëpërcaktohet me dëshirë tek i ashtuquajtimi morali i situatës, e jo te ndërgjegjja.

Në jetën publike, megjithatë, ai do të mbështetet përsëri te normat morale dhe te ndërgjegjja, kurse në jetën private do u përshtatet rrethanave. Russell-i vëren: “Shoqëria moderne ka dy lloje morali: një që manifestohet publikisht, por nuk i përmbahen; ndërsa tjetrit i përmbahen por nuk e manifestojnë në publik.”<sup>644</sup>

Nëse morali nuk trashëgohet biologjikisht, por mësohet, atëherë është logjike që qenia njerëzore nuk ka mundësi të mësojë (na radhë të parë te modeli i tjetrit) se si duhet

“Ndërgjegjja, miku im, është shkopi që mban në dorë secili nga ne, për të goditur fqinjin me të, pa e vënë asnjëherë në shërbimin tonë.” (Balzac, *Propale iluzije*, Kultura, Zagreb, 1952, f. 322)

<sup>644</sup> Për natyrën e dyfishtë të moralit borgjez, shih: Marx-Engels, *Nemačka ideologjia*, I, Kultura, Beograd, 1964, f. 195.

të sillet, dhe kështu ajo i dorëzohet diktaturës së rrethanave të jashtme, të cilat e hedhin sa andej-këndej, si një notues i ngathët në mëshirën e dallgëve.

Norma morale (ose ideali moral) është ajo që e ngre njeriun mbi diktaturën e rrethanave dhe i jep fuqi – nëse kjo normë është bërë *alter ego*-ja e tij – për t’iu kundërvënë atyre, si dhe rrethanave shoqërore, nëse di, ndjen dhe beson se duhet vepruar sipas kësaj norme dhe ndërgjegjes, që për të është masa e fundit e veprimeve të tij. Pa një normë morale (apo një ideal moral) njeriu nuk do të dinte se cili veprim është i moralshëm dhe cili i pamoralshëm, sepse sjellja e tij, vetvetiu, nuk është as e moralshme as e pamoralshme, po moralisht neutrale. Vetëm kur ajo vlerësohet nga pikëpamja e normës morale (e idealit moral), ajo bëhet e moralshme ose e pamoralshme.

Në aspektin e sjelljes morale, çdo manipulues sillet në mënyrë të pamoralshme, sepse ai i ndalon njerëzit që të sillen në harmoni me ndërgjegjen e tyre. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një normë njerëzore e miratuar<sup>645</sup> për të dalluar çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë e kështu me radhë. Kjo i shtyn ata që të sillen në përputhje me interesin e tyre. Manipulimi fillon atje ku kufizohet e drejta e njeriut për të menduar, ndjerë dhe për të bërë çfarë i urdhëron ndërgjegjja e tij (ideali moral). Askush nuk ka të drejtë të vendosë në vend të tjetrit dhe në emër të tij, duke përjashtuar ato raste kur qenia njerëzore është e papjekur apo shpirtërisht e paaftë.

Asnjë që është njerëzor nuk mund ta bëjë këtë. E nëse e bën, atëherë ai i konsideron të tjerët fëmijë dhe të sëmurë shpirtërisht. “Njeriu është masa e gjërave, pat shtuar ai. E

<sup>645</sup> Kjo nuk duhet të jetë normë juridike, sepse norma juridike mund të urdhërojë dikça që ndalohet nga norma morale.

drejta e tij për të gjykuar për atë që është e mirë dhe e keqe, për atë që është e vërtetë dhe atë që është iluzion është e patjetërsueshme. Çdokush që guxon ta mashtrtojë atë dhe t'i dëmtojë besimin për këtë të drejtë të krijimtarisë së tij, do ta ketë të vështirë. Do të ishte më mirë sikur ta vrisnin në një pus të thellë me një gur mullirit të lidhur në qafë."<sup>646</sup>

Nuk jemi ne ata që e krijojmë realitetin natyror, dhe për këtë arsye nuk mund ta krahasojmë atë me idetë dhe idealet (qëllimet) tona. Anasjelltas po: ne i krahasojmë idetë tona në lidhje me këtë realitet dhe hetojmë nëse këto ide janë adekuate për të; domethënë, a e shënjojnë dhe shpjegojnë saktësisht këto ide realitetin natyror. Ato ide që nuk e përshkruajnë këtë realitet në mënyrë objektive, logjike, të saktë, sistematike dhe të verifikueshme, duhen hedhur poshtë. Marx-i do të thoshte se ideja duhet të turpërohet përpara realitetit.

Ne e krijojmë realitetin shoqëror duke pasur parasysh idetë dhe idealet (qëllimet) tona, dhe pikërisht për këtë pyesim se çfarë realiteti është? Duke pasur parasysh marrëdhëniet tona shoqërore në përditshmëri, a i përgjigjet ky realitet ideve dhe idealeve tona? Pra, si është ky realitet në raport me kushtet e dhëna historike? Nëse realiteti nuk korrespondon me idealin që synojmë, – ideali është mundësia më racionale dhe më humane – atëherë ai duhet të turpërohet përpara idealit, dhe duhet të tërhiqet vazhdimisht për t'i lënë vend një realiteti të ri shoqëror.

Nëse në përvojën historike të deritanishme kemi vënë re se si e modelojnë rrethanat e jashtme dhe problemet ndjenjën, besimin dhe sjelljen njerëzore, – pikërisht këtë lloj shoqërie e quante parahistorike Marx-i – qenia njerëzore është

<sup>646</sup> Man, *Čarobni breg*, Prosveta, Beograd, 1972, f. 830.

gati t'i kundërvihet diktaturës së rrethanave dhe ta ribëjë botën sipas një ideali i cili mund të arrihet.

### E vërteta

Ky ideal nuk mund të jetë larg dhe utopik. Ne quajmë ideale ato mundësi racionale dhe humane të cilat janë ndrydhur nga organizmi ekzistues i marrëdhënieve shoqërore. Këto mundësi jo vetëm që ia vlen të zbulohen e të njihen, gjë që bëhet nga çdo shkencë kritike, por edhe duhen realizuar, gjë që duhet bërë nga çdo politikë në kuptimin e epërm të fjalës.

Nga kuptimi i shkencës si mendim kritik nga ana e Marx-it, logjikisht vjen edhe kuptimi i së vërtetës dhe kriteve të saj. E vërteta nuk mund të jetë te përputhja e ideve me realitetin, – ky është një pozitivizëm i pastër – por te krahasimi i realitetit me mundësitë racionale dhe humane, që janë të ngrira nga organizmi ekzistues i marrëdhënieve shoqërore. Nëse shoqëria nuk i realizon mundësitë racionale dhe humane, praktika e saj është jashtë së vërtetës, dhe si e tillë nuk mund të jetë kriter i së vërtetës.<sup>647</sup>

Shkenca humaniste nuk e mban këtë emër të madh ngaqë merret me njeriun, por ngaqë tenton të zbulojë dhe të njohë ato mundësi humane që janë bllokuar nga organizmi ekzistues i marrëdhënieve shoqërore, që janë e vërteta e këtyre marrëdhënieve.

Shkencëtari me orientim humanist e ka për detyrë të luftojë edhe praktikisht për “çdo të vërtetë të re që ka mbirë

<sup>647</sup> Në qoftë se praktika ndjek në mënyrë spontane rrugën e disa mundësive më racionale dhe më humane, kur teoria nuk ia ka dalë t'i mendojë në mënyrë racionale dhe humane, atëherë teoria është nën nivelin e praktikës.

këto kohë”<sup>648</sup>, që nuk është në shërbim të këtij apo atij interesi të veçantë<sup>649</sup>, por në shërbim të njeriut, si e vetmja qenie e ngarkuar me dhuntinë dhe përgjegjësinë e të kuptuarit në këtë botë pa kuptim.

Meqë manipuluesi flet gjithnjë nga pikëpamja e një interesi të caktuar, ai është i aftë ta “pështyjë të vërtetën në fytyrë”<sup>650</sup>, vetëm e vetëm që t’i shtyjë njerëzit të pranojnë si të vërtetë të vetme racionalizimin e interesave të tyre. E vërteta dhe e pavërteta janë thjesht shprehje psikologjike për të, që bëjnë pjesë në psikologjinë e turmave, jo në teorinë e njohjes. Për të është e vërtetë çdo ide që i shërben interesit të tij dhe që pranohet njëzëri nga turma. “Supozohet në mënyrë naive se, fakti që shumica e njerëzve ndajnë disa ide apo ndjenja, kjo konfirmon vlerën e tyre.” Asgjë nuk është më larg të vërtetës sesa kjo. Vlerësimi i njëzëshëm si i tillë nuk ka asnjë ndikim në mendjen dhe shëndetin mendor. Pikërisht ashtu siç ekziston *folie a deux* – “marrëzia dyshe”, ekziston edhe *folie a millions* – “marrëzia milionëshe”. Fakti që miliona njerëz ndajnë të njëjtat vese nuk i shndërron ato në virtyte; fakti që ata ndajnë mes tyre shumë gabime nuk i bën gabimet të vërteta; dhe fakti që miliona njerëz vuajnë nga e njëjta patologji mendore, nuk i bën ata njerëz të shëndoshë.<sup>651</sup> “Nëse do të vendosej për vlerën e një ideje në bazë të numrit, do ishim akoma nëpër shpella.”<sup>652</sup>

<sup>648</sup> Ibsen, *Neprijatelj naroda*, Epoha, Zagreb, 1968, f. 78.

<sup>649</sup> Me këtë zgjidhet ajo dilema përpara së cilës pat ndaluar Sartre: “Të tradhtosh proletariatin që t’i shërbesh të vërtetës apo të tradhtosh të vërtetën në emër të proletariatit?”

<sup>650</sup> Ibsen, po aty, f. 45

<sup>651</sup> From, *Zdravo društvo*, Rad, Beograd, 1963, f. 39.

<sup>652</sup> Po aty, f. 318.

“Armiku më i rrezikshëm i së vërtetës dhe lirisë është shumica e pushtetshme.” (Ibsen, op. cit. f. 77) “Të vërtetat që pranon turma – këto janë ato të vërteta për të cilat është bërë luftë në kohën e gjyshërve tanë.” (Ibsen, op. cit. f. 79)

## Politika

Nga këndvështrimi i humanizmit, politika nuk mund të jetë asgjë më shumë sesa shndërrim i së mundshmes në realitet, realizim i mundësive racionale dhe humane, të zbuluara e të njohura nga mendja e njeriut. Ajo politikë që nuk vepron sipas kësaj detyre të epërme e humbet kuptimin e saj dhe kthehet në një luftë pa kompromis rreth dominimit të disa interesave të veçanta. Ajo kthehet në profesion për ata që nuk kanë një profesion të vërtetë, një shkollë mizore e luftës për pushtet për ata që shpeshherë janë pa shkollë, si dhe në një hapësirë njohjeje për ata që kanë etje për pushtet. Ajo është bërë një hapësirë tjetërsuese ku grupe të caktuara shoqërore luftojnë që të marrin, të forcojnë dhe të mbajnë pushtetin. Shpirtrat e mëdhenj i shtyjnë tutje “mjeshtërit e mëdhenj të politikës së vogël” në jetën politike.<sup>653</sup> Njerëzit parimorë ua lënë vendin njerëzve “dritëshkurtër me gishtërinj të gjatë”.<sup>654</sup> Udhëheqësit e lartë politikë i ndërrojnë “mashtuesit e popullit, duke e tërhequr popullin pas fjalëve të bukura dhe frazave të rreme, sa më larg detyrës konkrete historike të lirisë...”<sup>655</sup> E thënë shkurt, duan ta udhëheqin popullin ata që nuk janë të aftë të udhëheqin vetveten.

Marrja, stabilizimi dhe mbajtja e pushtetit, po mbështetet gjithnjë e më pak te forca fizike dhe terrori, dhe gjithnjë e më shumë te teknikat shkencore të manipulimit të opinionit publik.<sup>656</sup> Manipulimi nënkupton ta ushtrosh pushtetin në mëny-

<sup>653</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 13, f. 31.

<sup>654</sup> Ivo Andrić.

<sup>655</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 13, f. 31.

<sup>656</sup> “Në të kaluarën, ekspertët e ndryshimit të vetëdijes njerëzore ishin empiristët. Sot, aftësia e kontrollimit të mendimeve është në rrugë e sipër për t’u bërë shkencë. Ata procedojnë në punën e tyre me teori dhe hipoteza të mbështetura fort në të dhënat eksperimentale.

rë sekrete; pra, i atillë sa as ata që i janë ekspozuar këtij ndikimi nuk janë të vetëdijshëm.<sup>657</sup> Në mënyrë krejt të pandjeshme ata thonë se opinionin privat të atij grupi që ka pushtet duhet ta pranojmë si opinion publik të shoqërisë. Zhdërvjelltësia politike vepron në drejtim të mbulimit të dallimeve klasore dhe të parandalimit të konflikteve ideologjike.

Detyra e shkencës humaniste dhe e filozofisë në fushën e jetës politike nuk mund të bazohet në asgjë tjetër përveç kritikës së pamëshirshme dhe sistematike ndaj ideologjisë sunduese, me ndihmën e së cilës grupi vendos dhe mban jo vetëm unitetin ideologjik, por edhe atë shoqëror. Duhet treguar se prapa kësaj ideologjie fshihen interesa të kufizuar të grupit sundues, dhe se ideologjia, kryesisht, është racionalizim i këtyre interesave.<sup>658</sup> Aq sa është e suksesshme kritika e ideologjisë sunduese, po aq kontribuojnë në krijimin e opinionit të vërtetë publik apo të opinionit kritik shkenca humaniste dhe filozofia.<sup>659</sup>

Klasikët e marksizmit kanë qenë të pamëshirshëm në demaskimin e asaj ideologjie që përpiqej të shfaqej si një vetëdije e përbashkët e klasave shoqërore, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët. Kështu, Lenini, disa herë radhazi ka shkruar: “Përderisa klasat nuk janë zhbërë akoma, të gjitha fjalët për lirinë dhe barazinë në përgjithësi janë vetëm mashtrim, ose mashtrim ndaj punëtorëve.”<sup>660</sup>

<sup>657</sup> R. Mils, *Elita vlasti*, f. 407.

<sup>658</sup> “Që të dimë se si të pozicionohemi në luftën partiake, nuk duhet t’u besojmë fjalëve, por të mësojmë historinë e vërtetë të partive. Nuk duhet të studiojmë atë që thonë partitë për veten, por atë që ato bëjnë, si veprojnë në rastin e zgjidhjes së problemeve të ndryshme politike; si sillen kur preken interesat jetike të klasave të ndryshme shoqërore – spahinjve, kapitalistëve, fshatarëve, punëtorëve etj.” (Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 8, f. 89)

<sup>659</sup> O. Negt dhe A. Kluge mendojnë se lufta për opinionin publik – e opinionit proletar kundër opinionit qytetar – është pjesë përbërë e luftës për një shoqëri të re. (*Öffentlichkeit und Erfahrung*)

<sup>660</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 14, f. 83.

“Ai që flet për politikën joklasore dhe për socializmin joklasor pas përvojës së Europës dhe Azisë, duhet futur në kafaz bashkë me një kangur australian.”<sup>661</sup> “Duke mos iu frikësuar të vërtetës, proletariati duhet të shohë drejt e në sy dhe duhet të nxjerrë që këtej të gjitha përfundimet politike.”<sup>662</sup>

E vërtetë është se borgjezi, në realitetin jetësor bën të kundërtën e asaj që ka shënuar tek e drejta, morali, religjioni dhe ideologjia. “Një ekzistence të ndyrë i përgjigjet shprehja e shenjtë nëpër formulat zyrtare dhe në dyfytirësinë e përgjithshme.”<sup>663</sup> Ai thur rrjeta merimangash me fjalë si barazi, liri dhe vëllazëri, dhe brenda tyre zë të gjithë ata që nuk janë në gjendje të shohin se pas “formave të fryra ideologjike”<sup>664</sup> fshihen interesat dhe lakmia materiale. “Nëse këto çështje lihen në heshtje, sloganet e lirisë dhe barazisë për pronën private e për mjetet e prodhimit janë gënjeshtër dhe hipokrizi të shoqërisë borgjeze, që me njohjen formale të lirisë dhe barazisë fsheh lirinë reale ekonomike dhe pabarazinë për punëtorët, për të gjithë punonjësit dhe ata që shfrytëzojnë kapitalin, pra për shumicën dërrmuese të popullsisë në të gjitha shtetet kapitaliste.”<sup>665</sup>

Shkenca kritike dhe filozofia, që furnizohen nga buri-  
met e traditës humaniste dhe nuk mjaftohen vetëm me të qenurit një mendim i pastër për shoqërinë, por një fuqi aktive, duhet t’i ndihmojnë njerëzit e ndershëm, të paditurit dhe të paaftët, që pas frazave ideologjike të kërkojnë intere-

<sup>661</sup> Po aty, vëll. 8, f. 167.

<sup>662</sup> Po aty, vëll. 13, f. 21.

<sup>663</sup> Marx-Engels, *Nemačka ideologjia*, f. 195.

<sup>664</sup> Po aty, f. 279.

<sup>665</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 14, f. 84. (nënvizoi Gj. Sh.)

“Është shumë më e sigurt t’i manifestosh liritë qytetare sesa t’i mbrosh ato; është mëse e sigurt t’i mbrosh ato si një e drejtë formale sesa t’i shfrytëzosh në mënyrë efikase politike.” (R. Mils, po aty, f. 427)

sat e ndjeshme klasore; të dallojnë ideologjinë prej ideve dhe të strehohen nën përkujdesjen ideologjike, e cila i lejon të hapin sytë dhe “të ngrihen kundër çdo gjëje që baltos dhe poshtëron idenë e njeriut”.<sup>666</sup>

Për këtë arsye, kritika e ideologjisë është hapi i parë i çdo shkencë shoqërore objektive. Por, si marksist humanist nuk duhet harruar<sup>667</sup> se kritika rrënjësore e ideologjisë është e mundshme vetëm si një kritikë radikale ndaj atyre shoqërive (pra si revolucionare) që prodhojnë një vetëdije të shtrembër për vetveten, sepse ato janë shoqëri të deformuara/të tjetërsuara.<sup>668</sup>

## Revolucioni

Kundër dhunës shpirtërore mund të luftohet vetëm me mjete shpirtërore – për këtë arsye, revolucionet e së ardhmes, nëse do ndodhin, nuk do ndryshojnë asgjë në mjedisin tonë, por në veten tonë. Ka ikur koha e revolucioneve të jashtëm, shkaqet e të cilëve ishin te varfëria materiale, dhe po vjen koha e revolucioneve të brendshëm, arsyet e të cilëve do jenë te varfëria shpirtërore.<sup>669</sup> Të gjitha ato revolu-

<sup>666</sup> Man, *Čarobni breg*, f. 214.

<sup>667</sup> “Ata harrojnë se me këto fraza nuk luftojnë asgjë, vetëm sa bëjnë luftë me fjalë. Ata nuk po luftojnë fare kundër botës ekzistuese nëse ngrihen vetëm kundër frazave të kësaj bote.” (Marx-Engels, *Nemačka ideologija*, f. 15)

<sup>668</sup> Marx-i nuk e ka lënë mënjanë nevojën për një kritikë teorike: “...por, a nuk e humb kritika karakterin e saj racional nëse nuk vepron haptazi por fshehurazi, praktikisht por teorikisht; në qoftë se nuk ndodhet mbi partitë, jo t’i formojë ato; nëse nuk përdor thikën e mprehtë të arsyes, në vend të gërshtëre të topitura të arbitraritetit; nëse do vetëm të ushtrojë kritikë, por jo ta durojë atë; nëse me realizimin e vet mohon vetveten dhe, në fund, është aq jokritike për të parë meçunurinë universale te një individ, fjalët e kuptimit të fjalët e dhunës, njollat e diellit te njollat e bojës, konstruktet matematikore te vizatimi i censorit dhe argumentet bindëse te goditjet?” (Marks, *Birokratija i javnost*, Vuk Karadžić, Beograd, 1965, f. 92-93)

<sup>669</sup> Natyrisht kjo ka të bëjë me botën e zhvilluar perëndimore, e cila ia ka dalë mbanë varfërisë materiale.

cione të zhurmshme, të drejtuara kah ndryshimi i rrethana-ve të jashtme, e kanë lënë të paprekur brendësinë e njeriut; sepse njeriu e shton vazhdimisht fuqinë mbi botën e jashtme, por nuk ka shenja të rritjes së pushtetit të tij mbi vetveten (fuqia e vetëpërcaktimit).

Do ishte shenjë mençurie që në çdo bisedë tonën mbi revolucionin të fusim këtë dallim midis revolucionit të jashtëm dhe të brendshëm, – revolucionit në kushtet materiale të ekzistencës dhe revolucionit në kushtet e jetës shpirtërore – ngaqë është e sigurt se i dyti nuk ndjek të parin, e thënë kjo në bazë të atij ligjit të vjetër për raportin e themelit me ngrehinën. Kush mund ta mohojë të vërtetën se revolucioni shpirtëror, shpeshherë i ka paraprirë revolucionit material?<sup>670</sup> A nuk duket shkoqur që ana shpirtërore shpie drejt ndryshimeve rrënjësore materiale, por që baza materiale ngelet gati e paprekur? Mos ndoshta duhet dëshmuar se në të njëjtën situatë materiale janë të mundura përgjigje të ndryshme shpirtërore?

Dhe vjen koha e diktatorëve shpirtërorë, të cilët nuk premtojnë mbushjen e barkut, por mbushjen e kokave me ushqim të përzgjedhur shpirtëror. Mashtruesit shpirtërorë duan të ndryshojnë shpirtin e popullit të tyre, në mënyrë që të përjashtojnë prej tyre të gjitha pyetjet për lirinë, përgjegjësinë<sup>671</sup>, të vërtetën, drejtësinë, dinjitetin. Ata synojnë që idetë e tyre të bëhen fat i popullit. Ata duan ta çojnë revolucionin në muzeun e marrëzisë njerëzore.

Vetëm njerëzit shpirtërisht të verbër nuk arrijnë të shohin se pse luftojnë sot këta dhunues shpirtërorë me të gjitha forcat kundër mendimit humanist (kritik, revolucionar).

<sup>670</sup> "A duhet të shfaqet në formë materiale revolucioni? Të godasë, në vend që të flasë?" (Marks, *Birokratija i javnost*, f. 74)

<sup>671</sup> Njeriu nuk mund të quhet shpirtërisht i shëndetshëm pa ndjenjën e përgjegjësisë.

Ata e dinë shumë mirë se humanistët i ruajnë kujtimet për njeriun autonom, dhe këto kujtime do zhbëhen vetëm kur të zhbëhen ata që i shpërndajnë ato nëpër botë.<sup>672</sup> “Të parëndësishëm, të pamerakosur, të dhunshëm – të tillë na do mençuria: ajo është një grua që puth vetëm luftëtarët.”<sup>673</sup>

Luftëtari bashkëkohor është një humanist që ka guximin të thotë të vërtetën e ta mbrojë atë me ndërgjegje. Duke mbrojtur të vërtetën ai kundërshton “të vërtetën” e grupit sundues, dhe kështu ndihmon jetëgjatësinë e së vërtetës. Mos më thoni se kjo është një punë kot! Dhe mos citoni Marx-in: “...çdo hap i një lëvizjeje konkrete është më i rëndësishëm se një duzinë programesh”, sepse mund të merrni si përgjigje fjalët e Leninit, të cilat janë të njomura me përvojë, gjë që i mungonte Marx-it, dhe me siguri që ai do i firmoste ato: pa teori revolucionare nuk mund të ketë as lëvizje revolucionare.<sup>674</sup>

“Asgjë nuk ka më shumë pushtet se fjalët. Bashkimi i motiveve të forta dhe mendimeve të mëdha është një lidhje që nuk mund të këputet – është një armë e domosdoshme. Fjala, ashtu si hobeja e Davidit, i rrëzon dhunuesit dhe i shemb përtokë të pushtetshmit. Pa të bota do u përkiste dhunuesve të armatosur. Kush mund t’i frenojë ata? Vetëm mendimi, pa armë, lakuriq.”<sup>675</sup>

Një mendimi i mençur, shpeshherë shfaqet në një kohë të çartur, e cila nuk e kupton dhe nuk e miraton si ndriçues. Nga kjo del se ky mendim, sado vlerë të ketë, në fakt është i

<sup>672</sup> “Humanistët nuk duhen privuar nga detyra edukative; nuk mund t’i ndalojmë, sepse vetëm ata e ruajnë traditën për dinjitetin dhe bukurinë e njeriut.” (Mann, *Çarobni breg*, f. 106)

<sup>673</sup> Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 36.

<sup>674</sup> Lenin, *Izabrana dela*, vëll. 3, f. 242.

<sup>675</sup> France, *Savremena istorija*, II, f. 280.

pafuqishëm dhe i tepërt. Por, kohët ndryshojnë dhe njerëzit, hap pas hapi, me ose pa vetëdije, fillojnë ta kërkojnë këtë mendim duke e nuhatur në bazë të pasojave të mira që ai lë pas, si një mësues që lë pas studentë që mendojnë dhe bëjnë mirë. “Kemi bindjen e fortë se rreziku i vërtetë është jo te përpjekja praktike, por te zbatimi teorik i ideve komuniste, sepse në përpjekjet praktike, qofshin edhe në masë, mund të marrin si përgjigje të shtëna armësh të rënda, sapo të bëhen të rrezikshme. Por, idetë që kanë mundur inteligjencën tonë, që kanë pushtuar ndjenjat tona, mbi të cilat mendja jonë ka farkëtuar ndërgjegjen tonë, janë zinxhirët prej të cilëve njeriu nuk çlirohet dot, përndryshe i pëlçet zemra. Ata janë demonë, të cilët mund të mposhten vetëm duke iu dorëzuar.”<sup>676</sup>

Pak nga pak bota po bëhet e vetëdijshme për pushtetin e saj të vërtetë, që është pikërisht pushteti i shpirtit. Po ikin ato kohë ku heronjtë ishin princat, udhëheqësit e shteteve dhe shifrat e mëdha që vinin pas tyre.<sup>677</sup> Po vijnë kohë kur bota do e festojë përsëri përpjekjen e shpirtave fisnikë – filozofët, artistët, shkencëtarët... Ata janë në gjendje që “t’u kthejnë shëndetin shpirtave të sëmurë perëndimore”.<sup>678</sup> Ata janë në gjendje të mbjellin farën<sup>679</sup> në arën shpirtërore,

<sup>676</sup> Cituar nga Predrag Vranicki, *Historija marksizma*, I, Naprijed, Zagreb, 1971, f. 46-47. Në original: Marx, *Der Kommunismus und die Augsburger*, “Allgemeine Zeitung”, Werke, vëll. 1, f. 108.

<sup>677</sup> “...kam atë kurajë të këndshme të pohoj se këta përfaqësues të mbijetuar, këto rrënoja të botës së vogël që po vdes, po i bëjnë vetes nderimet e fundit në mënyrë të shkëlqyer.” (Ibsen, *Neprijatelji naroda*, Epoha, Zagreb, 1968, f. 76)

<sup>678</sup> Toynbee, *Istrazivanje istorije*, II, f. 293.

<sup>679</sup> “Është e nevojshme vetëm pak farë e imët: le ta hedhin në shpirtin e njeriut të thjeshtë dhe ajo nuk do të vdesë, por do rrojë në shpirtin e tij gjithë jetën; do mullullojë në të pas errësirës, mes aromës së keqe të mëkateve të tij, si një pikë ndriçuese, si një vërejtje e madhe.” (Dostojevski, *Braća Karamazovi*, I, f. 363)

nga e cila do marrin fryte “të gjithë ata që nuk duan të jetojnë ndryshe përveçse duke shpresuar sërish”.<sup>680</sup>

Njeri, përmendu: je njeri!

<sup>680</sup> Nietzsche, *Tako je govorio Zaratustra*, f. 260.

“Gjendja njerëzore sot është shumë serioze, që t’i lejojmë vetes të dëgjojmë demagogët, aq më pak ata demagogë që janë të prirë për shkatërrim; madje edhe ata udhëheqës që udhëhiqen me trurin e tyre, e zemrat i kanë gur. Mendimi kritik dhe radikal do jetë frytëdhënës vetëm nëse përzihet me vetinë më të çmuar me të cilën është i pajisur njeriu: dashurinë për jetën.” (Fromm, *Anatomija ljudske destruktivnosti*, II, Naprijed, Zagreb, 1975, f. 248)



## SHËNIM PËR AUTORIN

Gjuro Shushnjiq ka lindur më 2 maj të vitit 1934 në një vend të vogël të Likës, në Rudopolje të Kroacisë. Shkollën e mesme e ka kryer në Vinkovci, ndërsa të lartën për filozofi në Zagreb. Doktoratën e ka mbrojtur në vitin 1965, në Fakultetin Filozofik të Beogradit.

Ka punuar në Institutin e Shkencave Shoqërore në Beograd që prej vitit 1960 deri më 1971, vit ky kur emërohet profesor në Fakultetin Filozofik të Nishit, ku jep lëndët sociologjia e dijes dhe hyrje në metodologjinë e shkencave shoqërore.

Ka botuar tre libra: “Nocioni i ligjit në sociologji” (*Pojam zakona u sociologiji*, Instituti i Shkencave Shoqërore, Beograd, 1967), “Kundërtitë e mendimit kritik” (*Otpori kritičkom mišljenju*, Vuk Karadžić, Beograd, 1971) dhe “Kritika e metodës sociologjike” (*Kritika sociološke metode*, Gradina, Niš, 1973)

Në revistat e njohura të ish-Jugosllavisë ka botuar më shumë se pesëdhjetë artikuj, ese, polemika, kronika dhe analiza, disa prej të cilave kanë marrë çmime speciale në disa konkurse, ndërsa disa të tjera janë përkthyer në gjuhë të huaja.



## LITERATURA

1. Abelson, R. et al. (Eds.), *Theories of Cognitive Consistency*, Rand McNally, Chicago, 1968.
2. Abernathy, E. *The Advocate: A Manual of Persuasion*, David McKay Co., New York, 1964.
3. Adams, J. A., *Human Memory*, McGraw-Hill, New York, 1967.
4. Adler, A., *Poznavanje coveka*, Kosmos, Beograd, 1934.
5. Adorno, T. W., *The Authoritarian Personality*, Harper and Row, New York, 1950.
6. Alexander, H. G., *Meaning in Language*, Scott Foresman and Co., 1969.
7. Allport, G. W., Vernon, P. B. and Lindzey, G., *A Study of Values*, Houghton Mifflin, Boston, 1960.
8. Allport, G. W., *The Nature of Prejudice*, Addison-Wesley, Cambridge, 1954.
9. Allport, G. W. and Postman L., *The Psychology of Rumor*, Holt, New York, 1947.
10. Arnosov, N. M., *Modeling of Thinking*, New York, 1967.
11. Andersen, K. B. *Persuasion: Theory and Practice*, Allyn and Bacon, Boston, 1971.
12. Andreës L. and Karlins, M., *Requiem for Democracy?*, Holt, New York, 1971.
13. Armistead N., *Reconstructing Social Psychology*, Penguin, 1974.
14. Back, K. W., *Beyond Words*, Basic Books, New York, 1972.
15. Baker G. W. and Chapman, D. W. (eds.), *Man and Society in Disasters*, Basic Books, New York, 1962.
16. Baker, S. S., *The Permissible Lie: The Inside Truth About Advertising*, World, Cleveland, 1968.
17. Bandura, A., *Principles of Behavior Modification*, Rinehart and Winston, New York, 1969.
18. Bandura, A. and Walters, R. H., *Social Learning and Personality Development*, Holt, Rinehart and Winston, New York, 1963.
19. Bart, R., *Književnost, mitologija, semiologija*, Nolit, Beograd, 1971.
20. Bass. B. M., *Leadership, Psychology and Organizational Behavior*, Harper and Row, New York and Evanston, 1960.

21. Bass, B. M., "Conformity, Deviation and a General Theory of Interpersonal Behavior", in: *Conformity and Deviation*, ed. by I. A. Berg and B. M. Baas, Harper, New York, 1961.
22. Bauman Z., "Osnove marksističkog shvatanja sociologije saznanja", "Sociologija", Nr. 2, 1968.
23. Becker, H. and Barnes, H., *Social Thought from Lore to Science*, New York, Dover, 1961.
24. Beisecker, T. D. and D. W. Parson, *The Process of Social Influence: Readings in Persuasion*, Prentice – Hall, Englewood Cliffs, 1972.
25. Berelson, B. and Janowitz M. (eds), *Reader in Public Opinion and Communication*, 2d ed., Free Press, New York, 1966.
26. Berg, I. A., and Bass, B. M. (Eds.), *Conformity and Deviation*, New York, Harper, 1961 (Symposium on Conformity and Deviation, Louisiana State University).
27. Berger, P. L., Berger, B. and Kelniner, H., *The Homeless Mind*, Vintage Books, New York, 1974.
28. Biderman, A. D. and H. Zimmer, *The Manipulation of Human Behavior*, John Wiley and Sons, New York, 1961.
29. Blanshard P., *The Right to Read: The Battle Against Censorship*, Beacon, Boston, 1955.
30. Blau, P. M., *Exchange and Power in Social Life*, John Wiley and Sons, Inc., New York, 1964.
31. Bord, R. J. "Toward a Social-Psychological Theory of Charismatic Social Influence Processes", *Social Forces*, March 1975, vol. 53, no. 3, pp. 485-496.
32. Bosnjak, B., "Problem i razvoj ideje humanizma u filozofiji", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, II, Naprijed, Zagreb, 1963.
33. Božović, R., *Iskušenja slobodnog vremena*, botim i veçantë i revistës "Ideje", Beograd, 1975.
34. Brehm, J. W. and Cohen, A. R., *Explorations in Cognitive Dissonance*, Wiley, New York, 1952.
35. Brebeck, W. L. and W. S. Howell, *Persuasion: A Means of Social Control*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, 1952.
36. Brown, J. A. C., *Techniques of Persuasion*, Penguin, Baltimore, 1963.
37. Brown, L. B., *Ideology*, Penguin, 1973.
38. Brown, R., *Social Psychology*, The Free Press, New York, 1965.
39. Brown, R., "Models of Attitude Change", in *New Directions in Psychology*, I, Holt. New York, 1962.

40. Brzezinski, Z., *Between Two Ages*, The Viking Press, New York, 1971.
41. Bugarski, R., *Jezik i lingvistika*, Nolit, Beograd, 1972.
42. Burke, K., *Language as Symbolic Action*, University of California Press, Berkeley, 1966.
43. Burke, K., *A Grammar of Motives*, University of California Press, Berkeley, 1970.
44. Campbell, K. K., *Critiques of Contemporary Rhetoric*, Wadsworth Publishing Co., Belmont, Calif, 1972.
45. Carswell, E. A. and Rommetveit, R., *Social Contexts of Messages*, Academic Press, London and New York, 1971.
46. Carpenier, E. and M. McLuhan, *Explorations in Communications*, London, 1970.
47. Cohen, A. R., *Attitude Change and Social Influence*, Basic Books, New York, 1964.
48. Cohen, S. and J. Young (eds.), *The Manufacture of News*, Constable, London, 1973.
49. Collins, B. F. and Guetzkow, H., *A Social Psychology of Group Processes for Decision Making*, John Wiley, New York, 1964.
50. Coser, L. A., *Men of Ideas: a sociologists view*, The Free Press, New York, 1965.
51. Cronkrite, G., *Persuasion: Speech and Behavioral Change*, Bobbs-Merrill Co., Indianapolis. 1969.
52. Crowne, D. P. and Marlowe, D., *The Approval Motive*, Wiley, New York, 1964.
53. Curtis, J. F. and Petras, J. W. (eds.), *The Sociology of Knowledge*, London, Gerald Duckworth and Co., 1970.
54. Čomski, N., *Gramatika i um*, Nolit, Beograd, 1972.
55. Damjanović, M. "O estetskom vaspitanju" në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
56. Dichter E., *Handbook of Consumer Motivations*, McGraw-Hill, New York, 1964.
57. Dirkem E. *O podeli društvenog rada*, Prosveta, Beograd, 1972.
58. Deutsch K. W., *The Nerves of Government: Models of Political Communication and Control*, Free Press New York, 1963.
59. Dexter L. A. and White, D. M. (eds.), *People, Society and Mass Communications*, Free Press, New York, 1964.
60. Đurić, M., *Sociologija Maxa Webera*, Matica hrvatska, Zagreb, 1964.
61. Edelman L., *Politics as Symbolic Action*, Markham Publishing Co., Chicago, 1971.

62. Eko U., *Kultura, informacija, komunikacija*, Nolit, Beograd, 1973.
63. Ellul, J. *Propaganda: The Formation of Men's Attitudes*, Knopf, New York, 1965.
64. Erlich, V., *U društvu sa čovjekom*, Naprijed, Zagreb, 1968.
65. Eysenck H., *Dynamics of Anxiety and Hysteria*, Routledge and Kegan Paul, London, 1957.
66. Fast J., *Body Language*, M. Evans and Co, New York, 1970.
67. Feldman S. (ed), *Cognitive Consistency*, Academic Press, New York, 1966.
68. Felkner, B. L., *Dirty Politics*, W. W. Norton and Co., New York, 1966.
69. Festinger L., *A Theory of Cognitive Dissonance*, Stanford University Press, Stanford, Calif., 1962.
70. Festinger L., *Conflict Decision and Dissonance*, Stanford University Press, Stanford, Calif., 1964.
71. Festinger L. and Maccoby, N., "On Resistance to Persuasive Communications", *Journal of Abnormal and Social Psychology*, 68:359-366, 1964.
72. Filipović, V., "Prilog ideji humaniteta", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
73. Fishbein M. (ed), *Readings in Attitude Theory and Measurement*, Wiley, New York, 1967.
74. Fletcher, J., *Situation Ethics: The New Morality*, Westminster Press, Philadelphia, 1966.
75. Fletcher, J., *Moral Responsibility: Situation Ethics at Work*, Westminster Press, Philadelphia, 1967.
76. Focht. I., "Humanost umjetnosti", në: përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
77. Fotheringham, W. C., *Perspectives on Persuasion*, Allyn and Bacon, Boston, 1966.
78. Fraisse P., *The Psychology of Time*, Harper, and Row, New York, 1963.
79. Frank, J. D., *Persuasion and Healing*, Johns Hopkins Press, Baltimore, 1961.
80. Frojd, S., *Uvod u psihoanalizu*, Matica srpska, Novi Sad, 1969.
81. Frojd, S., *Iz kulture i umetnosti*, Matica srpska, Novi Sad, 1969.
82. Frojd, S., *Nova predavanja, Aurobiografija*, Matica srpska, Novi Sad, 1968.
83. Frojd, S., *Psihopatologija svakodnevnog života*, Matica srpska, Novi Sad, 1969.
84. Frojd, S., *O seksualnoj teoriji, Totem i tabu*, Matica srpska, Novi Sad, 1969.

85. Frojd, S., *Dosetka i njen odnos prema nesvesnom*, Matica srpska, Novi Sad, 1969.
86. Frojd, S., *Tumačenje snova*, I i II, Matica srpska, Novi Sad, 1969.
87. From, H., *Zdravo društvo*, Beograd, Rad, 1963.
88. From, E., *Bekstvo od slobode*, Nolit, Beograd, 1964.
89. From, E., *Čovjek za sebe*, Naprijed, Zagreb, 1966.
90. Fromm, E. *The Dogma of Christ*, Doubleday and Company, Inc., Garden City, New York, 1966.
91. Fuko M. *Riječi i stvari*, Nolit, Beograd, 1973.
92. Golubović, Z., *Čovek i njegov svet*, Prosveta, Beograd, 1973.
93. Galbraith, J. K., *Economics and the Public Purpose*, A Signet Book, New York, 1975.
94. Gehlen, A., *Čovjek*, Veselin Masleša, Sarajevo, 1974.
95. Gibson; W. B. (ed.) *The Fine Art of Swinling*, Grosset and Dunlap, New York, 1966.
96. Giglioli, P. P. (ed.), *Language and Social Context*, Penguin Education, 1972.
97. Goffman, E., *Interaction Ritual*, Doubleday and Co., Garden City, 1967.
98. Goffman, H., *Behavior in Public Places*, The Macmillan Co., New York, 1963.
99. Goldiamond I., "Statement on Subliminal Advertising", in: R. Ulrich, T. Stachnik and J. Mabry (eds.) *Control of Human Behavior*, Scott, Foresman and Co., Glenview, III. 1966.
100. Gordon, G. N., *Persuasion: The Theory and Practice of Manipulative Communication*, Hastings House, New York, 1971.
101. Habermas, J., *Javno mnjenje*, Kultura, Beograd, 1969.
102. Habermas, J., *Toward a Rational Society*, Heinemann, London, 1971.
103. Hall H. T., *The Hidden Dimension*, Doubleday and Co., New York, 1966.
104. Hall, H. T., *The Silent Language*, Doubleday and Co., Garden City, 1959.
105. Hass R. G. and Linder, D. F., "Counterargument Availability and the Effects of Message Structure on Persuasion", *Journal of Personality and Social Psychology*, USA, 1972, 23, no. 2, pp. 219-233.
106. Hayek, F. A., *The Conter-Revolution of Science*, The Free Press of Glencoe, Glencoe III., 1964.
107. Henry J., *Culture Against Man*, Vintage Books, New York, 1965.
108. Hllilgard, F. R. and Atkinson, R. C., *Introduction to Psychology*, Harcourt, Brace and Wodd, New York, 1967.

109. Hoffer E., *The True Believer*, Harper and Row, New York, 1951.
110. Hofstadter, R., *The Paranoid Style in American Politics and Other Essays*, Vintage Books, New York, 1967.
111. Hollander, E. P., *Leaders, Groups and Influence*, Oxford University Press, New York, 1964.
112. Hollander, F. P., *Principles and Methods of Social Psychology*, Oxford University Press, London – Toronto, 1967.
113. Hovland, C. and Janis, I. (eds.), *Personality and Persuasibility*, Yale University Press, New Haven, 1954.
114. Hovland, C. I., Janis, K. L. and Kelly, H. H., *Communication and Persuasion: Psychological Studies of Opinion Change*, Yale University Press, New Haven, 1953.
115. Huxley, A., *Brave New World Revisited*, Harper and Row, New York, 1965.
116. Iljenkov, F. V., *O idolima i idealima*, Skolska knjiga, Zagreb, 1975.
117. Inkeles, A., *Public Opinion in Soviet Russia: A Study in Mass Persuasion*, Harvard University Press, Cambridge, Mass. 1962.
118. Insko, C., *Theories of Attitude Change*, Appleton-Century-Crofts, New York. 1967.
119. Jakobson, R., "Closing statements: Linguistics and poetics", in: *Style in Language*, (T. A. Secheok, ed), pp. 350-377, MIT Press, Cambridge, Mass., 1960.
120. Janis, I. L., *Victims of Groupthink*, Houghton Mifflin, Boston, 1972.
121. Janis, I. L. et. al., *Yale Studies in Attitude and Communication*, vol. 2, Yale Univ. Press, New Haven, 1959.
122. Jaspers, J., Rommetveit, R., Cook, M., Havelka, N., Henry, P., Herkner, W., Pecheux, M. and Peeters, O., "Order effects in impression formation", in: *Social Contexts of Messages*, (Ii. A. Carswell and R. Rommetveit, eds.), pp. 109-125, Academic Press, London and New York, 1971.
123. Jaspers, K., *Filozofija egzistencije*, Prosveta, Beograd, 1967.
124. Jerotić V., *Psihoanaiiza i kultura*, BIGZ, Beograd, 1974.
125. Jespersen, O., *Covjecanstvo, narod i pojedinac sa lingvistickog stanovista*, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo, 1970,
126. Johannesen, R. L. (ed) *Ethics and Persuasion: Selected Readings*, Random House, New York, 1967.
127. Johnson, N. F., "Linguistic models and functional units of language behavior", in: *Directions in Psycholinguistics* (S. Rosenberg, ed). Macmillan, New York, 1965.

128. Ju-Lan, F., *Istoriја kineske filozofije*, Nolit, Beograd, 1971
129. Jung, C. G., *Labirint o coveku*, Vuk Karadžic (Zodijak) Beograd, 1969.
130. Jung C. G., *Čovjek i njegovi simboli*, Mladost, Zagreb, 1973.
131. Kangrga, M., "Problem otudenja u Marxovu djelu", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963
132. Karlins, M., *The Last Man is Out*, Prentice-Hall, New York, 1969.
133. Karlins, M. and Abelson H. I., *Persuasion, How Opinions and Attitudes are Changed*, Springer, New York, 1970.
134. Katz, D. et. al. (eds.), *Public Opinion and Propaganda: A Book of Readings*, Holt, New York, 1960.
135. Katz, H. and Lazarsfeld, P. F., *Personal Influence*, The Free Press, Glencoe, Ill., 1955.
136. Kemp, C. G.. "Change in Values in Relation to Open-Closed Systems", in: M. Rokeach *The Open and Closed Mind*, Basic Books, New York, 1960.
137. Kecmanović, D. *Između normalnog i patološkog*, botim i veçantë i revistës "Ideje", Beograd, 1973.
138. Kiesler, C., Collins, B., and Miller, N., *Attitude Change: A Critical Analysis of Theoretical Approaches*, Wiley, New York, 1969.
139. Kiesler, C. A. and Kiesler, S. B., *Conformity*, Addison-Wesley, Reading, Mass., 1969.
140. Kierkegaard. S.. *Bolest na smrt*, botim i veçantë i revistës "Ideje", Beograd, 1974.
141. Klapper I. T., *The Effects of Mass Communication*, The Free Press, New York, 1960.
142. Kluckhohn, F. R. and Strodtbeck, F. L., *Variations in Value Orientation*, Row, Peterson, Evanston, Ill, 1961,
143. Kolakovski, L., *Filozofija pozitivizma*, Prosveta, Beograd, 1972.
144. Kolakovski, L., *Filozofiki eseji*, Nolit, Beograd, 1964.
145. Krasner, L., and Ullman, L. P. (Eds.), *Research in Behavior Modification*, Holt, Rinehart, and Winston, New York, 1965.
146. Kreč, D., *Pojedinac a društvu*, Beograd, 1972.
147. Krešić, A., "Filozofski izvori Marksova hurmanizma", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
148. Kuvacić, I., "Savremeni oblici duhovnog nasilja", *Praxis*, 1-2, 1970.
149. Larsen, O. N., "Social Effects of Mass Communication", in: *Handbook of Modern Sociology*, Chicago, 1966.
150. Larson, Ch. U., *Persuasion*, Wadsworth Publishing Company, Belmont, Calif., 1973.

151. Lasswell. H. D., *Psychopatology and Politics*, Viking, New York, 1960.
152. Lasswell, H. D., Lerner, D. and Pool, I. de Sola, *The Comparative Study of Symbols*, Stanford University Press, 1952.
153. Lasswell, H. D., "The Structure and Function of Communication in Society", in: Lynien Bryson (ed.), *The Communication of Ideas*, Institute for Religious and Social Studies, 1948 ..
154. Lausch, E., *Manipuliranje mozgom*, Stvarnost, Zagreb, 1976.
155. Lenjin, V. I., *Izabrana dela*, Kultura, Beograd, 1960.
156. Lenski, C., *Power and Privilege*, A Theory of Social Stratification, New York, 1966.
157. Lerner, D., (ed.), *Propaganda in War and Crisis*, Geo. W. Stewart, New York, 1951.
158. Lifton, R. J., *Thought Reform and the Psychology of Totalism*, Norton, New York, 1961.
159. Lindseg, G. L. and Aronson, E. (Eds.) *The Handbook of social Psycho-logy*, vol. III, Reading, Mass: Addison-Wesley, 969.
160. Lorenc, K., *O agresivnosti*, Vuk Karadzic, Beograd, 1970.
161. Makluan, M., *Poznavanje opštita čovekovih produžetaka*, Prosveta, Beograd, 1971.
162. McLuhan, M., *The Gutenberg Galaxy*, University Press, Toronto, 1962.
163. McLuhan, M., *The Mechanical Bride: Folklore of Industrial Man*, Van-guard, New York, 1951.
164. Maletzke, G., *Propaganda, Eine begriff skritische Analyse*, Publizistik, Allom. 1972, 17, No. 2, 153-64.
165. Manhajm, K., *Ideologija i utopija*, Nolit, Beograd, 1968.
166. Marcuse, H., *Čovjek jedne dimenzije*, Veselin Masleša, Sarajevo, 1968.
167. Markin, R. J., *Consumer Behavior*, MacMillan Publishing Co., Inc., New York, 1974.
168. Marković, M., *Humanizam i dijalektika*, Prosveta, Beograd, 1967.
169. Marx, K., *Grundrisse*, Vintage Books, New York, 1973.
170. Marx, K. – Engels, F., *Nemačka ideologija*, 1, Kultura, Beograd, 1964.
171. Marx, K., *Kapital*, II, Kultura, 1947.
172. Marx. K. – Engels, F., *Rani radovi*, Kultura, Zagreb, 1953.
173. Marks, K., *Birokratija i javnost*, V. Karadic, Beograd, 1965.
174. Maslow A., *Motivation and Personality*, Harper and Row, New York, 1954.
175. Matson F. W., *The Broken Image*, Anchor Books, Doubleday and Co., Inc., Garden City, New York, 1966.
176. McGinnis, J., *The Selling of the President*, Trident Press, New York, 1969.

177. Mehrabian A., *Silent Messages*, Wadsworth Publishing Co. Belmont, Calif. 1971.
178. Merton, R. K., *Mass Persuasion*, Harper and Row, New York, 1946.
179. Merton, R. K., *The Sociology of Knowledge*, Chicago, 1973.
180. Merton R. K., *The Sociology of Science*, ed. by N. W. Storer, The University of Chicago Press, Chicago, 1973.
181. Milbourn, M. T. and Stone. J. A., "Source Message Orientation and Components of Source Credibility", *Journalism Quart*, USA, 1972, 49, no. 4, 663-8.
182. Milić, V., "Ideja otudenja i savremena sociologija", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, II, Naprijed, Zagreb, 1963,
183. Milić V. *Društvo i sociologija u delu Žorža Gurviča*, parathënia e librit të Zhorzh Gurviçit: *Savremeni poziv sociologije*, V. Masleša, Sarajevo, 1965.
184. Miler, R. F., *Stada i pastiri*, Vođi i buntovnici. Ko i kako narode vodi i zavodi i za čim žudi çovečanstvo, Narodno delo, Beograd, 1934.
185. Milošević, N., *Antropološki eseji*, Nolit, Beograd, 1964.
186. Miller, C., *The Process of Persuasion*, Crown, New York, 1946.
187. Mills, G. E., *Reason in Controversy*, 2nd ed., Allyn and Bacon, Boston, 1968
188. Mils, R., *Elita vlasti*, Kultura, Beograd, 1964.
189. Mils, R., *Znanje i moć*, Vuk Karadžić, Beograd, 1966.
190. Mils, R., *Sociološka imaginacija*, Savremena škola, Beograd, 1964
191. Minnick, W., *The Art of Persuasion*, 2nd ed., Houghton Mifflin Co., Boston, 1968.
192. Mischel, W. *Personality Assesment*, Wiley, New York, 1968.
193. Moscovici, S., "Communication processes and the properties of language", in: *Advances in Experimental Social Psychology*, (Berkowitz, ed.), vol. III, pp. 225-270, Academic Press, New York and London, 1967.
194. Negt, O. und Kluge, A., *Offentlichkeit and Erfahrung*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main, 1972.
195. Nimmo, D., *The Political Persuaders*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, N. J., 1970.
196. Ogilny, D., *Confessions of an Advertising Man*, Atheneum, New York, 1963
197. Oliver R. T., *The Psychology of Persuasive Speech*, David McKay Co., New York, 1968.
198. Orwell, G., 1984., Secker and Warburg, London, 1949.

199. Pakard, V., *Industrija svesti*, Skriveni ubeđivači, Sedma sila, Beograd, 1967.
200. Pandeya, R. C., *Indijska filozofija jezika*, botim i većantë i revistës "Ideje", Beograd, 1975.
201. Pavlović, B. V., *Rasprava o filozofskim osnovama nauka*, Nolit, Beograd, 1973.
202. Petrović, G., "Marksovo shvaćanje čovjeka", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
203. Pijaže, Z., *Psihologija inteligencije*, Nolit, Beograd, 1968.
204. Pool L. de Sola with the coloboration of H. D. Lasswell and others, *The Prestige Press: A Comparative Study of Political Symbols*, The M. I. T. Press, Cambridge, Mass, 1970.
205. Проблемы Социальной психологии и пропаганда, Москва, 1971.
206. Reich, W., *Listen, Little Man!* A Condor Book, London, 1972.
207. Remmling, C W., (ed.), *Towards the Sociology of Knowledge*, Routledge and Kegan Paul, London, 1973.
208. Rieff, Ph., *On Intellectuals*, Doubleday and Company, Inc., Garden City, New York, 1969.
209. Riesman, D., *Usamljena gomila*, Nolit, Beograd, 1965.
210. Rokeach, M., *Beliefs, Attitudes and Values*, Jossey-Bass Inc., San Francisco, 1970.
211. Rokeach, M., "The Nature of Attitudes", in: *International Encyclopedia of the Social Sciences*, MacMiilan, New York, 1968.
212. Rokeach, M., *The Open and Closed Mind*, Basic Books, New York, 1960.
213. Rommetveit, R., *Words, Meanings and Messages: Theory and Experiments in Psycholinguistics*, Academic Press and Universitetsforlaget, New York, London and Oslo, 1968.
214. Rosnow, R. and Robinson, E. (eds), *Experiments in Persuasion*, Academic Press, New York, 1967.
215. Rot, N., *Osnovi socijalne psihologije*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Srbije, Beograd, 1979.
216. Rot, N., *Inteligencija i uticaji mišljenja većine na uverenost pri sudjenju*, Zbornik Filozofskog Fakulteta, libri VII-2, Beograd, 1963.
217. Rot, N., "Sticanje otpornosti prema ubeđivanju", *Sociologijanr. 2*, Beograd, 1969.
218. Rot, N., "Uticaj mišljenja vecine na stepen uverenosti sudova različite psihološke strukture" , *Sociologija*, nr. I, 1960
219. Rot, N., *Psihologija licnosti*, Zavod za izdavanje udžbenika, Beograd, 1970.

220. Rubin, J., *Do it!*, Simon and Schuster, New York, 1970.
221. Sargant, W., *Battle for the Mind*, Pan Books Ltd., London, 1959.
222. Schramm, W. L. (ed.), *The Process and Effects of Mass Communication*, University of Illinois Press, Urbana, 1954.
223. Schramm, W. L., *Mass Media and National Development: The Role of Information in the Developing Countries*, Stanford Univ. Press, 1964.
224. Schramm, W. (ed.), *The Science of Human Communication: New Directions and New Findings in Communication Research*, Basic Books, New York. 1963.
225. Scott, W, A., *Values and Organizations*, Rand McNally, Chicago, 1965.
226. Scott, R. A., *The Making of Blind Men*, Russell Sage, New York, 1969.
227. Seymour-Ure. C., *The Political Impact of Mass Media*, Constable, London, 1974.
228. Sherif, C. and Sherif, M. (Eds.), *Attitude, Ego-involvement and Change...*, Wiley, New York, 1967.
229. Sherif, C. and Sherif, M.with Nebergall, R., *Attitude and Attitude Change*, W. B. Saunders. Philadelphia, 1965.
230. Shostrom, B. L., *Man, the Manipulator*, Bantam Books, New York, 1968.
231. Skinner, B. F., *Nauka i ljudsko ponasanje*, Obod, Cetinje, 1969.
232. Skinner, B. F., *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972.
233. Smith, M. B., "Attitude Change", in: *Interantional Encyclopedia of the Social Sciences*, Macimillian, New York, 1968.
234. Snook, I. A., *Indoctrination and education*, Rotledge and Kegan Paul, London, 1972.
235. Sorokin, P., *Social and Cultural Mobility*, The Free Press, of Glencoe (paperback) 1964,
236. Stark, W., *The Sociology of Knowledge*, Routledge and Kegan Paul, London, 1958.
237. Supek, R., "Masovne komunikacije i propaganda", *Socijalna psihologija* (grup autorësh), botimi i dytë, Rad, Beograd, 1972.
238. Swingle, P. G. (ed.), *Social Psychology in Everyday Life*, Penguin Education 1973.
239. Šklovski V. B., *Uskrsnuće riječi*, Stvarnost, Zagreb, 1969.
240. Šušnjić, Đ., *The Idea of Manipulation and Manipulation of Ideas*, Praxis, 1/2, 1970.
241. Tadić, Lj., *Tradicija i revolucija*, Srpska književna zadruga, Beograd, 1972.

242. Tadić, Lj., *Autoritet i autoritarno mišljenje*, Književne novine, 1968.
243. Thayer, L. (ed.), *Communication: Ethical and Moral Issues*, 2 vols., Gordon and Breach, New York, 1973.
244. Toffler, A., *Future Shock*, Bantam Books, New York, 1971.
245. Tojnbi, A., *Istraživanje istorije*, I, Prosveta, Brpgrad, 1970.
246. Tojnbi, A., *Istraživanje istorije*, II, Prosveta, Beograd, 1971.
247. Toulmin, S., *The Uses of Argument*, Cambridge University Press, Cambridge, 1969.
248. Vranicki, P., "Marginalije uz problem humanizma", në përmbledhjen e punimeve *Humanizam i socijalizam*, I, Naprijed, Zagreb, 1963.
249. Warren, N. and Jahoda, M., *Attitudes*, Penguin, 1973.
250. Weaver, R. M., *The Ethics of Rhetoric*, Henry Regnery Co., Chicago, 1953.
251. Werkmeister, W. H., *An Introduction to Critical Thinking*, rev. ed., Johnson Publishing Co., Lincoln, Neb., 1957.
252. Wiener M. and Mehrabian, A., *Language within Language Immediacy, Channel of Communication*, Appleton, New York, 1968.
253. White, T. H., *The Making of the President*, Atheneum, New York, 1965.
254. Whyte, W., *Is Anybody Listening?* Simon and Schuster, New York, 1952.
255. Williams, R. M., "Values", in: *International Encyclopedia of the Social Sciences*, Macmillan, New York, 1968.
256. Wirth, L., *Consensus and Mass Communication*, American Sociological Review, 13: 1-15, 1948.
257. Zeman, Z. A. B., *Nazi Propaganda*, Oxford University Press, London, 1964.
258. Zimbardo, P. and Ebbesen, H., *Influencing Attitudes and Changing Behavior*, Addison-Wesley, Boston, 1969.
259. Zimbardo, P. (ed.), *The Cognitive Control of Motivation*, Scott, Foresman and Co., Glenview, III, 1969.
260. Životić, M., "Problemi definisanja ideologije", *Filozofski pregled*, nr. 3, 1957.
261. Žubrinić, D., *Marksizam i teorija elita*, Skolska knjiga, Zagreb, 1975.
262. Yu, Te-Chi, *Mass Persuasion in Communist China*, Praeger, New York, 1964.

## INDEKSI

### A

autoriteti i zgjedhur, 100  
 autoriteti irracional, 62, 94, 96, 106  
 autoriteti i imponuar, 100

### B

Balzaku, 48, 273  
 Bass, 98, 100, 137, 146, 159, 180,  
 216, 223, 259, 289, 325, 357-8, 366  
 bihejviorizmi, 258  
 bota antike, 194

### C

censura, 78, 173, 287

### D

David Risman, 295  
 de Bonal, 314  
 dehumanizimi, 107  
 deideologjizimi, 228  
 departamenti i zhurmës, 269  
 diferencimi shoqëror, 195, 317  
 diktatorët shpirtërorë, 107, 350

### E

e shenjta, 23, 297, 307  
 ekonomia e mendimit, 99  
 epoka parakapitaliste, 228  
 epoka burokratike, 282  
 epoka elektronike, 175  
 etika, 186, 212, 341

### F

fetishizimi i mallit, 73  
 filozofia, 16, 26, 50, 72, 115, 118,

212, 272, 288, 334, 337, 341, 347-8,  
 355

Foerbah, 286

Freud, 76, 77, 106, 110, 212, 281,  
 304, 336

fuqia karizmatike, 49

### G

grupi i pushtetshëm, 38

### Gj

gjuha ideologjike, 32, 66, 127, 128,  
 261,

### H

Huxley, 235, 270, 274, 282, 362

### I

ideologjizimi, 60-1  
 imperativët moralë, 48, 210  
*Indoktrinimi*, 68  
 industria e vetëdijes, 60-1, 67, 289  
 interesi klasor, 65-6  
 intime, 157

### K

katarsisi moral, 158  
 klasë e mesme, 120  
 Kolakovski, 242, 363  
 konflikti ideologjik, 197, 347  
 konformizmi, 234  
 konsumi masiv, 45, 170, 295  
 konsumi iracional, 7, 260  
 krizë identiteti, 113

**L**

Lenini, 48, 53, 62, 65, 113, 119,  
121-2, 126-7, 130, 132, 134-7, 142,  
155, 156, 187, 198-9, 202-6, 220,  
222, 226, 230, 241-2, 250, 266,  
268, 270, 275, 282-6, 293, 329, 339,  
346-8, 351

liberalizmi, 53, 180

liria e kritikës, 113

logosi, 121

**M**

Makineria reklamuese, 260

manipulimi i turmave, 55

manipuluesi i thellësisë, 258

Mann, 36, 38, 49, 82, 83, 93, 105,  
129, 141, 183, 206, 214, 222, 271,  
273-4, 285, 351

Marcuse, 44, 64, 160, 227, 364

Marx, 40, 52, 63, 65, 73, 79, 88, 105,  
112, 127, 136, 138, 149, 151, 153,  
197, 202-3, 207, 240, 246, 250-1,  
254, 257, 260, 262, 264-5, 267, 271,  
273, 276, 286-9, 292-3, 295, 300,  
302, 327-8, 336, 341, 343-4, 348-9,  
351-2, 364

Maslow, 64, 219, 364

media masive, 44-5, 50, 167, 172,  
233, 242-3, 267, 269, 272, 338

Mills, 85, 123, 365

Miti, 212

motivi afiliativ, 213

Musolini, 103

**N**

Nietzsche, 40, 42-3, 46, 105-7, 122,  
128, 147, 162, 164, 212, 218, 220,  
276, 278, 298, 306, 351, 353

Nikola Rot, 136, 145, 207, 215

*normat grupore*, 154, 319-22

*normat shoqërore*, 48, 163, 218

**Nj**

njeriu veprimtar, 103

njeriu tribal, 166

**P**

*Përbrendësimi*, 48

pikëpamje shpirtërore, 152

Pravda, 226

proletariati, 65, 155, 220, 345, 348

propaganda, 44, 60-1, 67, 90, 97,  
124, 131, 137, 155, 168, 171-2, 226,  
231, 246-7, 265-7, 270, 290, 308,  
330, 367

propaganda e zezë, 124

propaganda e bardhë, 124

Proust, 80, 131, 178, 187

psikanaliza, 12, 76, 259, 297

psikologjia individuale, 158

psikologjia sociale, 54, 72

publiku masiv, 84

**R**

reforma ideologjike, 61

reforma e vetëdijes, 150

Remark, 121, 213

revolucioni seksual, 231

Riesman, 86, 170, 366

Rudi Supek, 40, 44, 168

Russell, 341, 367

**S**

sanksionet sociale, 193

Sartre, 44, 49, 162, 223, 345

sendëzimi, 329-30, 337

socializmi, 53, 119, 137, 220, 348

sociologjia konservatore, 229

sociologjia e manipulimit, 230  
Stanisllavski, 169

**Sh**

shkenca humaniste, 344  
shoqëria klasore, 64, 198, 200

**T**

teoricieni i manipulimit, 165, 225  
teoria e njohjes, 345  
tjetërsimi, 5, 64, 72, 73, 229, 240-1,  
267, 294  
Toynbee, 38, 234, 327, 352  
tradicionalizmi konservator, 228  
turma psikologjike, 106

**U**

Umberto Eco, 131, 221

**V**

vlera estetike, 202

**Z**

Zamjati, 235  
zgjatimi, 165, 171, 173-6, 258

**W**

Weber, 49  
William James, 215

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

CIP - katalogu në publikim  
Biblioteka Kombëtare Universitare  
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

32.019.5

ŠUŠNJIĆ, Đuro  
Peshkatarët e shpirtave njerëzorë: ideja e manipulimit dhe  
manipulimi i ideve / Gjuro Shushnjiq ; e përktheu nga serbishtja:  
Skënder Latifi. - Shkup : Logos-A, 2017. - 372 стр. ; 21 см. -  
(Biblioteka Lexo)

Превод на делото: Ribari ljudskih duša : ideja manipulacije i  
manipulacija idejama / Đuro Šušnjić

ISBN 978-9989-58-670-5

I. Shushnjiq, Gjuro види Šušnjić, Đuro  
a) Политичка пропаганда  
COBISS.MK-ID 103095050

**www.logos-a.com**  
Copyright©Logos-A, 2017



LOGOS·A